



**THE AIRE CENTRE**  
Advice on Individual Rights in Europe



# Balancimi i Mbrojtjes së të Dhënave me Drejtësinë Transparente Korniza Ligjore Evropiane







**THE AIRE CENTRE**

Advice on Individual Rights in Europe



**CIVIL  
RIGHTS  
DEFENDERS**

# **Balancimi i Mbrojtjes së të Dhënave me Drejtësinë Transparente Korniza Ligjore Evropiane**

## Redaktorë

---

**Biljana Braithwaite**, Drejtoreshë e Programit për Ballkanin Perëndimor, Qendra AIRE  
**Catharina Harby**, Konsulente e Lartë Ligjore, Qendra AIRE  
**Goran Miletić**, Drejtor për Evropë dhe MENA, Mbrojtësit e të Drejtave Civile

## Kontribues kryesorë

---

**Ledi Bianku**, ish-Gjyqtar i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Profesor i Asociuar, Universiteti i Strasburgut  
**Hannah Smith**, Avokate Stazhiere, Doughty Street Chambers

U jemi shumë mirënjohës **Dechert LLP**, **Ishaani Shrivastava**, Avokate në Devereux Chambers, **Florence Powell**, Juriste dhe Menaxhere e Projekteve Ligjore pranë Qendrës AIRE, dhe **Sihana Cara**, Juriste e Trajnuar në Herbert Smith Freehills, si dhe **Robert Ford** për kontributet e tyre në këtë publikim.

© 2023 AIRE Centre

### Version i shtypur

100

Versioni origjinal në gjuhën angleze është përkthyer gjithashtu në gjuhët boshnjake/kroate/malazeze/serbe, shqipe dhe maqedonase

### Dizajni nga

Kliker Dizajn

### Printuar nga

Kuća Štampe Plus

# Parathënie

Transparenca e gjykatave është një prej mbrojtjeve më të fuqishme të pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor. Administrimi transparent i drejtësisë mundëson komentimin dhe kritikën publike të procedurave, rrit të kuptuarit e gjyqësorit nga publiku dhe besueshmërinë e gjyqësorit tek publiku, dhe ndërton besim më të madh tek gjykatat dhe institucionet e tjera demokratike nga të cilat gjykatat kërkojnë llogari.

Megjithatë, teknologjitë - gjithnjë në evolucion - që përdoren në kontekstin e procedurave hetimore dhe gjyqësore ngrenë çështje të reja dhe komplekse që kanë të bëjnë me mënyrat më efektive për garantimin e administrimit të drejtë, efikas dhe transparent të drejtësisë, duke kapitalizuar njëkohësisht mbi përfitimet potenciale të teknologjive të reja.

Kur përdoren metoda inovative për hetimin e krimeve, interesi legjitim i mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe luftimit të krimeve duhet të balancohet me mbrojtjen e të drejtës për jetën private të atyre që janë objekt i masave të vëzhgimit të shënjestruar ose të tërësishëm. Kur autoritetet shtetërore zhvillojnë ndjekje penale mbi bazën e provave të marra përmes vëzhgimit ose komunikimeve të interceptuara, shpesh nuk duan të zbulojnë prejardhjen e saktë të materialeve të tilla, e as të zbulojnë përmbajtjen e tyre, për shkak të frikës së dëmtimit të efikasitetit të një instrumenti të fshehtë hetimor. Një mosdashje e tillë ka pasoja të qarta dhe potencialisht të rënda për të drejtën për proces të rregullt dhe publike dhe barazi të armëve.

Pyetja se si të balancohen më së miri këto interesa jetike, sado konkurruese, është sjellë në krye të vëmendjes teksa gjykatat dhe autoritetet shtetërore përsiaten me çështje të pranueshmërisë së provave të marra përmes interceptimeve nga EncroChat, Sky ECC, ANOM dhe sisteme të ngjashme. Prova të marra nga këto interceptime janë përdorur për të hetuar dhe ndjekur penalisht mijëra njerëz në Evropë, përfshirë shumë prej tyre në Ballkanin Perëndimor. Është një praktikë e cila sa është lavdëruar aq edhe është qortuar, është lartësuar nga ata që e shohin si instrument me rëndësi kritike për luftën kundër krimit, por është kritikuar nga ata që ngrenë shqetësime rreth impaktit tek e drejta për proces të rregullt.

Pavarësisht nga pikëpamjet e secilit në lidhje me këtë çështje, është e qartë se është tejet e rëndësishme që gjykatat dhe juristët në Ballkanin Perëndimor të thellojnë njohuritë e tyre rreth këtyre mënyrave të reja për mbledhjen e provave. Tërësia e provave dhe informacioneve të mbledhura nga komunikimet e interceptuara ka potencialin të galvanizojë përpjekjet për parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve të rënda dhe krimit të organizuar në rajon. Megjithatë, është e nevojshme të zhvillohet një qasje parimore dhe pragmatike për balancimin e interesave të shumta dhe të ndryshme që vihen në lojë, për t'u siguruar që çdo synim për t'u mbështetur tek këto prova për të luftuar krimin të mos dëmtojë njëkohësisht drejtësinë e sistemit gjyqësor dhe besimin tek ai. Në këtë kontekst, si dhe në shumë kontekste të tjera, zhvillimet ligjore me vështirësi kanë mbajtur ritmin në hap me zhvillimet teknologjike të cilat përpiqen t'i rregullojnë. Në kohën e këtij shkrimi, jemi në pritje të vendimeve kyçe nga gjykatat e Strasburgut dhe Luksemburgut të cilat shpresohet se do të ofrojnë udhërrëfim tejet të nevojshëm në lidhje me këtë temë. Në ndërkohë, ky publikim ofron sqarime rreth parimeve ligjore ekzistuese dhe relevante.

Zhvillimet teknologjike gjithashtu po ndikojnë tek mënyrat se si gjykatat sillen dhe komunikojnë në lidhje me procedurat gjyqësore. Kjo ngre pyetje po aq urgjente rreth mënyrave më të mira për mbrojtjen e natyrës publike të procedurave gjyqësore dhe komunikimin publik të vendimeve (ku të dyja janë aspekte themelore të të drejtave për proces të rregullt dhe liri të shprehjes), duke mbrojtur njëkohësisht të drejtën për jetë private, atë për prezumim të pafajësisë, dhe të drejtën për t'u harruar të atyre që janë të përfshirë. Përveç kësaj, gjykatat duhet të publikojnë dhe të shpjegojnë vendimet e tyre për të krijuar besimin publik dhe të kuptuarit e sistemit gjyqësor. Megjithatë, publikimet e pasakta, konfuze ose shtrembëruese rreth vendimeve kanë potencialin për të dëmtuar besimin tek gjykatat.

Prandaj, zhvillimi i të kuptuarit të të drejtave dhe detyrimeve nga Nenet 6, 8 dhe 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut është një hap fillestar thelbësor drejt garantimit që secila prej interesave të shumta dhe të ndryshme në këtë sferë të jetë e mbrojtur. Megjithatë, puna e gjykatave në sigurimin e drejtësisë transparente nuk përqendrohet vetëm në kuptimin dhe aplikimin e praktikës gjyqësore relevante, por edhe në ndërtimin e marrëdhënieve konstruktive me mediat, hartimin e strategjive të kujdesshme dhe koherente të komunikimit, dhe zbatimit të politikave që rregullojnë publikimin dhe anonimizimin e vendimeve.

Shpresojmë që ky publikim do të shërbejë për thellimin e njohurive ligjore dhe praktike që kërkohen për të ndërmarrë një qasje të tillë gjithëpërfshirëse. Po ashtu, shpresojmë se ky publikim do të frymëzojë gjyqtarët dhe juristët e rajonit për të ndërmarrë detyrën e vështirë por të nevojshme të integritit të teknologjive dhe praktikave të reja në punën e tyre, për të përfituar nga gjithçka që ato kanë për të ofruar, pa komprometuar garancitë themelore të ofruara në Nenet 6, 8 dhe 10.

**Biljana Braithwaite**

Drejtoreshë, Qendra AIRE  
Programi i Ballkanit Perëndimor

**Goran Miletić**

Drejtor për Evropë dhe MENA  
Mbrojtësit e të Drejtave Civile





# Përmbajtja

<b>Lista e shkurtesave .....</b>	<b>12</b>
<b>PJESA 1 - Hyrje .....</b>	<b>13</b>
<b>Kapitulli 1 - Shikim mbi instrumentet ligjore relevante.....</b>	<b>19</b>
a) Instrumentet e Këshillit të Evropës .....	19
b) Instrumentet e Bashkimit Evropian .....	29
c) Komisioneri i Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Dhënave .....	38
d) Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave.....	39
<b>Kapitulli 2 - Çfarë është informacioni privat dhe të dhënat personale? .....</b>	<b>41</b>
<b>Kapitulli 3 - Mbrojtja e informacionit privat gjatë fazës hetimore të procedurave .....</b>	<b>46</b>
a) Masat Hetimore Speciale .....	46
b) Përdorimi i materialeve të përfutuara në shkelje të Nenit 8 në procedura gjyqësore.....	63
<b>Kapitulli 4 - Publikimi i informacionit gjatë procedurave gjyqësore .....</b>	<b>68</b>
a) E drejta për prezumim të pafajësisë deri në vërtetim të fajësisë sipas Nenit 6 .....	69
b) Publikimi i informacioneve lidhur me procedurat në vijim – mbrojtja sipas Nenit 8.....	72
c) E drejta për seancë dëgjimore publike sipas Nenit 6(1) .....	75
d) E drejta për shqiptimin publik të vendimeve sipas Nenit 6(1).....	81
<b>Kapitulli 5 - E drejta për t'u harruar dhe e drejta për fshirje.....</b>	<b>91</b>
<b>Kapitulli 6 - Përfundim .....</b>	<b>117</b>

**PJESA 2 - Përmbledhjet e Çështjeve..... 119**

1. ALGIRDAS BUTKEVIČIUS k. LITUANISË .....	119
2. B. DHE P. k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....	123
3. BIANCARDI k. ITALISË .....	126
4. 'BIG BROTHER WATCH' DHE TË TJERË k. MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	130
5. MITOV DHE TË TJERË k. BULLGARISË .....	140
6. BYKOV k. RUSISË .....	143
7. CENTRUM FÖR RÄTTVISA k. SUEDISË.....	147
8. CRAXI k. ITALISË (NR. 2).....	152
9. DRAGOJEVIĆ k. KROACISË .....	155
10. FIGUEIREDO TEIXEIRA k. ANDORRËS.....	159
11. GUTSANOVI k. BULLGARISË .....	163
12. HALFORD k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....	168
13. HAŠČÁK k. SLOVAKISË .....	172
14. HEGLAS k. REPUBLIKËS ÇEKE .....	176
15. HURBAIN k. BELGJIKËS .....	180
16. KENNEDY k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....	186
17. KHAN k. MBRETËRISË SË BASHKUAR .....	191
18. KLASS DHE TË TJERË k. GJERMANISË .....	194
19. L.B. k. HUNGARISË .....	198
20. L.L. k. FRANCËS .....	203
21. MALONE k. MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	206
22. MARGARI k. GREQISË .....	210
23. ROMAN ZAKHAROV k. RUSISË .....	214
24. S. DHE MARPER k. MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	220
25. SCHENK k. ZVICRËS .....	223
26. SHIPS WASTE OIL COLLECTOR B.V. k. HOLLANDËS .....	226
27. SOCIÉTÉ COLAS EST DHE TË TJERË k. FRANCËS .....	230
28. VICENT DEL CAMPO k. SPANJËS.....	233
29. E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE k. FACEBOOK IRELAND LIMITED DHE MAXIMILLIAN SCHREMS.....	236
30. DIGITAL RIGHTS IRELAND LTD k. MINISTRIT TË KOMUNIKIMEVE, MARINËS DHE BURIMEVE NATYRORE DHE TË TJERËVE DHE KÄRNTNER LANDESREGIERUNG DHË TË TJERËVE .....	241

31. BASHKUARA TË LA QUADRATURE DU NET DHE TË TJERË k. PREMIER MINISTRE DHE TË TJERËVE, FRENCH DATA NETËORK DHE TË TJERË k. PREMIER MINISTRE DHE TË TJERËVE, SI DHE ORDRE DES BARREAUX FRANCOPHONES ET GERMANOPHONE DHE TË TJERË v. CONSEIL DES MINISTRES .....	245
32. LIGUE DES DROITS HUMAINS ASBL k. CONSEIL DES MINISTRES .....	250
33. BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND k. SPACENET AG AND TELEKOM DEUTSCHLAND GMBH .....	254
34. GOOGLE (DÉRÉFÉRENCIEMENT D'UN CONTENU PRÉTENDUMENT INEXACT) .....	258
35. UI k. ÖSTERREICHISCHE POST (PRÉJUDICE MORAL LIÉ AU TRAITEMENT DE DONNÉES PERSONNELLES).....	262

# LISTA E SHKURTESAVE

Tabela e mëposhtme përshkruan domethënien e shkurtësive dhe shkurtimeve të ndryshme të përdorura në këtë doracak.

Shkurtesa	Përkufizimi
KEDNj / Konventa	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GjEDNj / Gjykata	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GjDBE	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
ZEE (ang. EEA)	Zona Ekonomike Evropiane
Charter of the Fundamental Rights of the European Union (CFR)	Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore
MEMDh (ang. EDPS)	Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave
Shteti(et) / Shteti(et) Kontraktues(e)	Shteti(et) Kontraktues(e) i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut
GjND (ang. ICJ)	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
PNDPCP (ang. ICCPR)	Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike
Konventa 108	Konventa për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS No. 108)
Konventa 108+	Protokolli Ndryshues i Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale (Protokolli CETS Nr. 223)
RrMDhP (ang. GDPR)	Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme
TFBE (ang. TFEU)	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
Konventa e Budapestit	Konventa për Krimet Kibernetike (ETS Nr. 185)
KMDh (ang. DPC)	Komisioneri i Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Dhënave
PI (ang. IP)	Protokolli i Internetit
OShl (ang. ISP)	Ofruesi i Shërbimit të Internetit
KSAI (ang. SIAC)	Komisioni Special për Apelet e Imigracionit

# P J E S A 1

## Hyrje

Ky publikim është i ndarë në dy Pjesë. Pjesa 1 përbëhet nga seksioni narrativ dhe Pjesa 2 përbëhet nga përmbledhje të vendimeve të zgjedhura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("Gjykata" ose "GjEDNj").

Mbrojtja e të dhënave dhe privatësia, në lidhje me informacionet private të individëve, është një fushë gjithnjë në rritje. Instrumentet ligjore dhe praktikët gjyqësore janë në evolucion të vazhdueshëm teksa përpiqen të mbajnë ritmin në hap me zhvillimet e hovshme në teknologjinë moderne, ndërkohë që gjithnjë e më shumë të dhëna personale prodhohen, regjistrohen dhe ruhen. Teknologjia krijon mundësi të pamata, gjë që kryesisht zgjeron dhe zhvillon ndërveprimet mes individëve dhe organizatave me njëri-tjetrin. Megjithatë, ndërkohë që teknologjia zhvillohet, dhe ndërveprimet e individëve dhe Shteteve me teknologjinë shtohen, do të vazhdojnë të dalin në pah çështje të reja të të drejtave të njeriut të cilat do të duhet të adresohen nga gjykatat vendase dhe ndërkombëtare dhe nga instrumentet ligjore.

Pjesa 1 e këtij publikimi mëton të analizojë këto çështje potenciale të të drejtave të njeriut në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë e informacionit në kontekstin e procedurave gjyqësore. Ajo hedh një shikim mbi hetimet që zhvillohen para procedurave, çështjet që mund të dalin gjatë procedurave, dhe më pas gjatë shqiptimit të vendimeve, dhe gjithashtu merr në shqyrtim praktikën gjyqësore në rritje lidhur me 'të drejtën për t'u harruar' për ata që janë të përfshirë në hetime dhe procedura gjyqësore.

Publikimi merr në shqyrtim praktikën gjyqësore të mëparshme dhe çështjet e reja të mundshme që mund të dalin në pah me teknologjinë e re që vazhdon të zhvillohet dhe të përdoret. Për shembull, ai konsideron përdorimin nga autoritetet shtetërore të teknologjisë për të interceptuar komunikimet e koduara (enkriptuara) dhe sfidat në fushën e të drejtave të njeriut që kjo mund të nxjerrë, përfshirë rastet kur të dhënat ndahen mes Shteteve.

Fokusi është tek Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ("KEDNj" ose "Konventa") dhe praktika gjyqësore e GjEDNj-së, si dhe instrumente të tjera të Këshillit të Evropës. Megjithatë, publikimi gjithashtu merr në konsideratë zhvillimet në të drejtën e Bashkimit Evropian ("BE") dhe vendimet e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian ("GjDBE"). E drejta e BE-së dhe jurisprudenca e GjDBE-së janë të rëndësishme për Ballkanin Perëndimor jo vetëm për shkak të çështjes së aderimit, por edhe sepse GjEDNj merr parasysh jurisprudencën e GjDBE-së dhe instrumentet e BE-së – dhe kjo është theksuar në mënyrë të veçantë në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave.

Narrativi në Pjesën 1 është i ndarë në gjashtë nënseksione. Pas Hyrjes, **nënseksioni i dytë** është një vështrim mbi instrumentet ligjore përkatëse në këtë fushë. Këto janë të ndara në instrumentet e Këshillit të Evropës dhe instrumentet e Bashkimit Evropian. Ky nënseksion gjithashtu shqyrton rolet e Komisionerit të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Mbikëqyrësit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave.

Sa i përket KEDNj-së, ky nënseksion shpjegon se si mbrojtja e të dhënave personale nuk është e drejtë e ndarë e KEDNj-së, megjithatë kontrolli i informacionit rreth vetes, pra mbrojtja e të dhënave, është gjetur nga GjEDNj të ketë rëndësi themelore për të drejtën për respekt ndaj jetës private dhe familjare të garantuar nga Neni 8 i KEDNj-së. Jurisprudenca e GjEDNj-së në këtë fushë është voluminoze në një sërë kontekstesh, që nga vëzhgimi sekret i zhvilluar nga autoritetet publike për të luftuar krimin e organizuar e deri tek përdorimi i të dhënave personale si prova në kontekst gjyqësor. Mbrojtjet kundër abuzimit dhe arbitraritetit janë kyçe, sidomos ato që përcaktojnë kufijtë brenda të cilëve autoritetet mund të operojnë dhe të ofrojnë kompensim dhe ndreqje.

E drejta për proces të rregullt sipas Nenit 6 të KEDNj-së po ashtu mund të luajë rol kur të dhënat personale të një personi janë përpunuar në kontekstin e procedurave gjyqësore. Megjithatë, Neni 6 mund të jetë në konflikt me Nenin 8 në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave dhe procedurave gjyqësore – për shembull në lidhje me të drejtën për seancë publike dhe të drejtën për shpalljen publike të vendimeve. Më tej, e drejta për lirinë e shprehjes sipas Nenit 10 të KEDNj-së angazhohet shpesh. Kjo e drejtë mund të jetë në konflikt me Nenin 8 në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave – për shembull në lidhje me të drejtën për t'u harruar – dhe autoritetet kombëtare dhe gjykatat duhet të vendosin ekuilibër të drejtë mes dy të drejtave. Analiza të këtyre të drejtave dhe konflikteve potenciale bëhen në nënseksionet e mëvonshme të këtij Udhërrëfyesi.

Ky nënseksion gjithashtu shqyrton, mes instrumenteve të tjera, Konventën e vitit 1981 për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS Nr. 108) – një instrument themelor i cili synon të fuqizojë individët që të dinë, të kuptojnë dhe të kontrollojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale nga të tjerët ndërkohë që ofron një kornizë për rrjedhën e të dhënave, dhe modernizimin vijues të protokolleve, të cilat adresojnë sfidat që dalin nga përdorimi i informacioneve të reja dhe shfrytëzimi i teknologjive të reja të komunikimit.

Në lidhje me instrumentet e Bashkimit Evropian, më kryesorja është Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, Neni 7 i së cilës ka të bëjë me respektin për jetën private dhe familjare, dhe Neni 8 përmban mbrojtje të veçantë të të dhënave personale. Gjithashtu me rëndësi të veçantë është Rregullorja e BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme ("GDPR"), e cila modernizoi legjislacionin e BE-së për mbrojtjen e të dhënave dhe ofroi rregulla të qëndrueshme për të gjitha Shtetet Anëtare.

**Nënseksioni i tretë** shqyrton me hollësi çështjen se çka përbën informacion privat dhe të dhëna personale. Ai shtjellon se si, dhe kur, grumbullimi, depozitimi, modifikimi, zbulimi, përdorimi dhe publikimi i informacioneve lidhur me jetën private të një individi mund të përbëjë ndërhyrje tek Neni 8 KEDNj. GjEDNj ka zhvilluar jurisprudencë të gjerë mbi atë se çka mund të përbëjë të dhëna personale. Shembuj të informacioneve dhe të dhënave të tilla vijnë nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së, përfshirë praktikën gjyqësore që bën pjesë në domenin publik dhe të dhënat personale më 'të ndjeshme'.

**Nënseksioni i katërt** mbulon mbrojtjen e informacioneve private gjatë fazës hetimore të procedurave. Autoritetet shtetërore mund të përpiqen të mbledhin të dhëna personale në një sërë kontekstesh të ndryshme që kanë të bëjnë me gjyqësorin, për shembull në kuadër të përpjekjeve për të luftuar krimin, dhe për të mbledhur prova për procedura prokuroriale dhe gjyqësore. Ky nënseksion sjell shembuj të masave të tilla që Shtetet mund të miratojnë, përfshirë bastisjen dhe konfiskimin e të dhënave personale, vëzhgimin sekret, interceptimet e tërësishme dhe ato të shënjestruara të komunikimeve, dhe infiltrimin e komunikimeve të koduara (enkriptuara), dhe mënyrat se si këto masa mund të përbëjnë ndërhyrje tek Neni 8 KEDNj.

Ndërkohë që teknologjia zhvillohet, sasia e të dhënave që mund të mblidhen nga Shtetet vetëm do të rritet, çka do të korrespondojë me rritjen potenciale

të ndërhyrjeve tek Neni 8 KEDNj. Sa u përket interceptimeve të tërësishme të komunikimeve, të cilat nuk kanë në shënjestër një individ specifik, për shembull, këto masa kanë potencial të jashtëzakonshëm për t'u shtrirë brenda dhe jashtë Shtetit për zhvillimin e vëzhgimeve. Ngjashëm, përdorimi i programeve softuerike nga autoritetet shtetërore për t'u infiltruar në komunikimet e koduara ka ngritur një sërë çështjesh të të drejtave të njeriut, përfshirë në lidhje me Shtetet që interceptojnë mesazhet e dërguesve me qëndrim në vende të tjera dhe i transferojnë të dhënat nëpër juridiksione.

Ekziston rreziku i shtuar për abuzime në lidhje me vëzhgimet sekrete. Për shkak të vetë natyrës së tyre, ekzistenca dhe zbatimi i masave të vëzhgimit sekret mund të mbetet e panjohur për personat e vëzhguar dhe autoritetet shtetërore nuk duan të zbulojnë hollësi rreth, ose ekzistencën e, vëzhgimeve meqenëse kjo do të dëmtonte efektivitetin e tyre. Prandaj, ky nënseksion analizon se si GjEDNj është përpjekur të njohë natyrën domosdoshmërisht sekrete të këtyre masave të vëzhgimit, duke kufizuar njëkohësisht potencialin për abuzime dhe për të siguruar që masat mund të kontestohen. Ky nënseksion thekson rëndësinë e ekzistencës, dhe zbatimit efektiv, të garancive të përshtatshme kundër abuzimit të fuqive të mbledhjes së të dhënave.

Nënseksioni i katërt gjithashtu bën një analizë të situatave kur përdorimi i materialeve të mbledhura në shkelje të Nenit 8 në procedura gjyqësore mund të angazhojë çështjet e procesit të rregullt sipas Nenit 6. Ky nënseksion nënvizon se si përdorimi i provave të tilla në procedura gjyqësore nuk i jep shkas automatikisht shkeljes së Nenit 6 dhe GjEDNj ka përsëritur që rregullat e pranueshmërisë së provave janë kryesisht çështje e të drejtës vendase. Pyetja është nëse procedurat në tërësi janë të drejta, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, përfshirë nëse kërkuesi ka pasur mundësi të kontestojë pranueshmërinë e provave në procedura të kontradiktorialitetit.

Ka shumë mënyra se si garancitë e Nenit 6 mund të preken nga kriteret për mbrojtjen e të dhënave personale sipas Nenit 8. Për këtë arsye, **nënseksioni i pestë** adreson publikimin e informacioneve gjatë procedurave gjyqësore dhe ndërveprimet mes Nenit 8 dhe Nenit 6 në këtë kontekst. Ky nënseksion është i ndarë më tej në konsideratat e prezumimit të pafajësisë sipas Nenit 6, mbrojtjet e Nenit 8, e drejta për seancë publike nga Neni 6, dhe e drejta për shpalljen publike të vendimeve sipas Nenit 6.



Së pari, ky nënseksion shqyrton fazën hetimore të procedurave gjyqësore dhe mënyrat se si të drejtat e Konventës mund të angazhohen kur informacionet rreth atyre procedurave ndahen me publikun. Në këtë kontekst e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm deri në vërtetimin e fajësisë sipas Neni 6(2) ka rëndësi të veçantë në lidhje me procedurat penale, për shembull kur deklaratat publike mund të përfshijnë konstatime të parakohshme që i akuzuari është fajtor.

Natyra publike e procedurave gjyqësore mund t'u japë shkas shqetësimeve lidhur me mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale të një personi që mund të diskutohen ose të zbulohen në seanca publike. Gjithashtu e përfshirë është një analizë e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së rreth mënyrave se si autoritetet kombëtare mund të vendosin ekuilibër të drejtë mes karakterit publik të procedurave, çka KEDNj e njuh si parim themelor të shoqërive demokratike, dhe mbrojtjes së interesave të një pale (ose pale të tretë) në procedurë për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të saj, për shembull duke kufizuar llojin dhe shtrirjen e të dhënave të zbuluara në seancë, ose, në rrethana të caktuara, duke zhvilluar seanca me dyer të mbyllura.

Po ashtu bëhet një analizë mbi rrethanat kur shpallja publike e vendimeve përfundimtare, e cila është e drejtë vetqëndruese nga Neni 6, mund të kufizohet, për shembull në rastet e çështjeve të sigurisë kombëtare. Shpallja publike e një vendimi gjithashtu ka potencialin për të shkelur të drejtat për mbrojtjen e të dhënave personale, integritetit fizik dhe moral, reputacionit dhe nderit të atyre që përmenden në vendim; dhe duhet vënë një ekuilibër mes procesit të rregullt dhe mbrojtjes së të dhënave. Qasjet e ndryshme ndaj kërkesave për anonimitet para GjEDNj-së dhe GjDBE-së merren në shqyrtim, si dhe bëhen krahasime mes qasjeve të ndërmarra nga gjykatat e Mbretërisë së Bashkuar dhe atyre të Gjermanisë.

Kjo e çon Pjesën 1 në **seksionin e fundit** të saj i cili përqendrohet tek koncepti evolues i 'të drejtës për t'u harruar' dhe të drejtës për fshirjen e të dhënave. Ky seksion shqyrton burimet e ndryshme të 'së drejtës për t'u harruar' e cila, në kontekstin e KEDNj-së, nuk është e drejtë vetqëndruese por mund të bëjë pjesë tek Neni 8. Në kontekstin e procedurave hetimore dhe gjyqësore, çështjet në lidhje me 'të drejtën për t'u harruar' janë ngritur në dy kontekste të gjera. Së pari, çështjet që dalin nga operimi i sistemit të drejtësisë penale dhe civile të Shtetit dhe mbajtja e regjistrave përkatës, për shembull mbajtja e raporteve rreth individëve që janë dyshuar për kryerjen e një veprë por nuk janë dënuar. Së dyti, çështjet në lidhje me përmbajtjen gazetareske të publikuar rreth individëve të cilët kanë qenë objekt i hetimeve ose procedurave penale ose civile.

Kjo kategoria e dytë mund të ngrejë çështje të veçanta në lidhje me lirinë e shprehjes dhe lirinë e shtypit, sidomos duke pasur parasysh zhvillimet e teknologjisë dhe mjeteve të komunikimit, informacionet personale të një personi që publikohen online kanë potencialin që të jenë në dispozicion aty për një kohë të gjatë dhe të kenë pasoja të mëdha. Prandaj, nënseksioni i fundit adreson në thelb konsideratat konkurruese mes të drejtës për privatësi dhe të drejtës për liri të shprehjes ashtu siç dalin në kontekstin e 'të drejtës për t'u harruar'.

**Pjesa 2 e këtij publikimi** përfshin përmbledhje të vendimeve të Gjykatës të cilat konsiderohen të rëndësishme dhe relevante për temën e diskutuar. Në këtë rast, aty përfshihen çështje të GjEDNj-së si dhe vendime të GjDBE-së.

# Kapitulli 1

## Shikim mbi instrumentet ligjore relevante

Ka instrumente dhe autoritete të ndryshme në nivel evropian në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe detyrimet për mbrojtjen e të dhënave të cilat aplikohen në kontekstin e procedurave hetimore dhe gjyqësore. Ky seksion ravijëzon disa nga instrumentet ligjore kryesore, përfshirë edhe nenet përkatëse për secilin.

### a) Instrumentet e Këshillit të Evropës

#### Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Mbrojtja e të dhënave personale nuk është e drejtë e ndarë sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“**KEDNj**” ose “**Konventa**”)<sup>[1]</sup>. Megjithatë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“**GJEDNj**”) ka gjetur se mbrojtja e të dhënave ka rëndësi jetike për gëzimin nga individ i të drejtave të garantuara me Nenin 8 KEDNj.<sup>[2]</sup> Ky është Neni kryesor përmes të cilit KEDNj mbron të dhënat personale.

#### **Neni 8**

Neni 8, i cili mbron të drejtën për respekt ndaj jetës private dhe familjare, deklaron:

*“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.*

[1] Shih poshtë dhe krahaso me Nenin 8 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së.

[2] *Satakunnan Markkinaporssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 27 qershorit 2017, nr. 931/13, §137; *Z.k. Finlandës*, vendimi i 25 shkurtit 1997, nr. 22009/93, në §95.

2. *Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”*

Qëllimi kryesor i Nenit 8 është të mbrojë kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike në jetën private dhe familjare, shtëpinë dhe korrespondencën. Për të dëshmuar shkëlqen e Nenit 8, një kërkues duhet të tregojë se ankesa e tij hyn brenda të paktën njëres prej katër interesave të mbrojtura nga Neni, pra jeta private, jeta familjare, shtëpia dhe korrespondenca. Në lidhje me katër interesat, GjEDNJ ka përkufizuar fushëveprimin e Nenit gjerësisht, përfshirë kontekstin e mbrojtjes së të dhënave.<sup>[3]</sup> Jurisprudenca e GjEDNJ-së në lidhje me mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave personale është voluminoze dhe mbulon një gamë të gjerë situatash, duke nisur nga vëzhgimi sekret i zhvilluar nga autoritetet publike dhe luftimi i krimit të organizuar e deri tek përdorimi i të dhënave personale si prova në kontekstin gjyqësor.

Gjykata ka treguar qartë se:

*“Mbrojtja e të dhënave personale ka rëndësi themelore për gëzimin nga personi i të drejtës së tij/saj për jetë private dhe familjare, siç garantohet nga Neni 8 i Konventës. E drejta vendase duhet të ofrojë mbrojtje të përshtatshme për të parandaluar çdo përdorim të të dhënave personale që është në mospërputhje me garancitë e këtij Neni. Neni 8 i Konventës parashikon të drejtën për një formë të vet-përcaktimit informacional, duke u lejuar individëve të mbështeten në të drejtën e tyre për privatesi sa u përket të dhënave të cilat, sado neutrale qofshin, mbliidhen, përpunohen dhe shpërndahen në mënyrë kolektive dhe në mënyrë ose formë të atillë që të mund të angazhohen të drejtat e tyre nga Neni 8.”<sup>[4]</sup>*

Shteti mund të ndërhyjë tek një e drejtë e mbrojtur nga Neni 8 kur është (a) në përputhje me ligjin, (b) në synim të një qëllimi legjitim, dhe (c) e nevojshme në një shoqëri demokratike në lidhje me njërin prej interesave të renditura në Nenin 8(2).

---

[3] Shih për shembull *Klass k. Gjermanisë*, vendimi i 6 shtatorit 1978, nr. 5029/71, në §41.

[4] *Satakunnan Markkinaporssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës*, vendim i Dhomës së Madhe i 27 qershorit 2017, Nr. 931/13 tek §137.

Më tej, Shteti është i detyruar të garantojë që të drejtat e Nenit 8 respektohen në kontekstin e marrëdhënieve mes palëve private, p.sh. duke miratuar masa të veçanta që synojnë të arrijnë pikërisht këtë.

Kriteret e Nenit 8 në lidhje me mbrojtjen e të dhënave merren në shqyrtim me hollësi më poshtë. Megjithatë, për të dhënë një shembull, në *Zoltan Varga k. Sllovakisë*<sup>[5]</sup>, GjEDNJ konsideroi përputhshmërinë e vëzhgimeve sekrete me Nenin 8. Në këtë çështje, kërkuesi ishte objekt i vëzhgimit sekret që kishte për qëllim monitorimin e tij dhe të takimeve që ndodhën në një pronë të tij. Urdhrat që autorizuan vëzhgimin më pas u anuluan, dhe një pjesë e materialit të vëzhgimit u postua online në mënyrë anonime.

GjEDNJ gjeti se vëzhgimi i fshehtë përbënte shkelje të së drejtës së kërkuarit për jetë private mbi bazën e vetme që ndërhyrja tek të drejtat e tij nga Neni 8 nuk ishte "në përputhje me ligjin", pa e parë të nevojshme të shqyrtonte nëse ndërhyrja i shërbente një qëllimi legjitim. Faktorët vijues ishin relevantë për këtë gjetje:

- » urdhrat më pas u anuluan nga gjykatat vendase sepse ishin të paligjshme dhe jokushtetuese;
- » nuk pati shqyrtim nga gjykata lëshuese nëse bazat për vëzhgimin vazhdonin të ekzistonin siç kërkohet nga statuti;
- » dosjet e gjykatës në lidhje me urdhrat ishin shkatërruar;
- » nuk kishte rregulla të veçanta që qeverisnin zbatimin e urdhrave ose shkatërrimin e materialit të mbledhur;
- » kontrolli i Shërbimit Sllovak të Inteligjencës (ang. SIS) ishte kryesisht politik; nuk ishte ngritur asnjë komision për ta mbikëqyrur atë dhe gjykatat vendase nuk i kishin shqyrtuar veprimet e SIS;
- » zbatimi i urdhrave ishte jashtë ndikimit të gjyqësorit administrativ dhe përtej fushëveprimit të legjislacionit për përgjegjësinë shtetërore; dhe
- » ruajtja e materialit të vëzhguar nuk kishte bazë të mjaftueshme në ligj, dhe depozitimi i materialit të vëzhgimeve i ishte nënshtruar rregullave konfidenciale të miratuara dhe të zbatuara nga SIS pa asnjë element kontrolli të jashtëm.

Siç tregohet nga ky vendim, mbrojtjet kundër abuzimit dhe arbitraritetit gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale janë kyçe, sidomos ato që

---

[5] *Zoltan Varga k. Sllovakisë*, vendim i 20 korrikut 2021, Nr. 58361/12, 25592/16 dhe 27176/16.

përkufizojnë kufijtë brenda të cilëve autoritetet mund të operojnë dhe të ofrojnë mundësi për shqyrtim dhe zgjidhje kur besohet se ato kufij janë shkelur.

Me rëndësi të veçantë për gjyqtarët dhe prokurorët janë çështjet e mbrojtjes së të dhënave që luajnë rol gjatë procedurave gjyqësore.<sup>[6]</sup> Përveç të drejtave të tyre sipas Nenit 8 të KEDNj-së, çdo person të dhënat personale të të cilit mblidhen dhe procesohen automatikisht në kontekstin e procedurave gjyqësore duhet të gëzojë po ashtu garancitë e Nenit 6.

## Neni 6

Neni 6, në lidhje me të drejtën për gjyq të drejtë, deklaron:

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

*2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.*

*3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

- a. të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;*

---

[6] Shih, si shembuj të kohëve të fundit, *Ships Waste Oil Collector B.K. k. Holandës*, vendim i 16 majit 2023, Nr. 2799/16 (i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), dhe *Janssen de Jong Groep B.K. dhe të tjerë k. Holandës*, vendim i 16 majit 2023, Nr. 2800/16, nuk është ende final në kohën e shkrimit të këtij Udhërrëfyesi.

- b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;
- c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;
- d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;
- e. të ndihmohet falas nga një përkthyes në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq."

*Eternit k. Francës*<sup>[7]</sup> është një shembull i ekuilibrit që duhet gjetur mes Nenit 6 dhe Nenit 8 në sferën e mbrojtjes së të dhënave. Këtu, kompania kërkuese u ankua se ishte shkelur Neni 6 kur asaj nuk i ishte ofruar informacioni mjekësor mbi të cilin u mbështet mjeku konsultues nga Zyra e Sigurimeve Shëndetësore për të arritur në përfundimin se një punonjës i kompanisë kërkuese kishte marrë një sëmundje të lidhur me punën.

GjEDNj gjeti se pretendimi ishte i papranueshëm (dukshëm i pabazuar). Pjesa civile e Nenit 6 u gjet se angazhohej kur një punonjës kontestonte një vendim nga Zyra e Sigurimeve Shëndetësore që një sëmundje kishte të bënte me punën. Megjithatë, e drejta për procedurën e kontradiktoriaritetit sipas Nenit 6 duhet të balancohet me të drejtën për konfidencialitet mjekësor në mënyrë të atillë që asnjëra të mos dëmtohet në thelbin e vet. Gjykata sugjeroi që një mënyrë për të respektuar të dy Nenet 6 dhe 8 ishte që gjykata vendase të emëronte një ekspert të pavarur mjekësor për të shqyrtuar raportet mjekësore përkatëse me qëllim që ta udhëhiqte gjykatën dhe palët pa shkelur konfidencialitetin e atyre të dhënave mjekësore. Megjithatë, ky mekanizëm nuk është i detyrueshëm çdo herë që kërkon punëdhënësi; mjafton që një ekspert mjekësor të caktohet vetëm kur gjykata konsideron se nuk ka informacione të mjaftueshme. GjEDNj gjithashtu theksoi se mjeku në këtë rast nuk ishte nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Zyrës së Sigurimeve Shëndetësore, dhe se

[7] *Eternit k. Francës*, vendimi i 27 marsit 2012, Nr. 20041/10.

procedura përmes së cilës ajo zyrë merrte vendimin e saj ishte përgjithësisht në linjë me parimin e kontraktiktoriaritetit.

Përveç Neneve 8 dhe 6 të KEDNj-së, në shumë raste çështjet e mbrojtjes së të dhënave janë shqyrtuar po ashtu sipas Nenit 10 të KEDNj-së.

## Neni 10

Neni 10, në lidhje me të drejtën për lirinë e shprehjes, deklaron:

*“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me liçencë.*

*2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”*

GJEDNj ka deklaruar se “liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të shoqërisë [demokratike], një nga kushtet bazë për avancimin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu”.<sup>[8]</sup>

Neni 10 është i gjerë në fushëveprimin e tij. Mbrojtjet e tij nuk janë të kufizuara me lloje të veçanta të informacioneve ose ideve, apo formave të shprehjes. Ai u aplikohet njësoj, për shembull, pikturave, realizimit të pjesëve teatrale, informacioneve të natyrës komerciale, fotografive dhe foto-montazheve, si dhe sjelljes.

---

[8] *Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 7 dhjetorit 1976, Nr. 5493/72 në §49.



GjEDNj ka theksuar se Neni 10 mbron informacionet dhe idetë që ofendojnë, shokojnë ose shqetësojnë, jo vetëm ato që janë të pandjeshme apo çështje indiferente; por nxitja e intolerancës ose dhunës dhe urrejtjes janë kufij legjitimë të Nenet 10.

Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave, Neni 8 dhe Neni 10 mund të shihen si të tillë që qëndrojnë në opozitë me njëri-tjetrin. Gjatë balancimit të të drejtave të mbrojtura nga secili Nen, GjEDNj ka gjetur se rezultati i një çështjeje në parim duhet të varet nga Neni mbi bazën e të cilit është bërë ankesa.

Vendimi i *Dupuis dhe të Tjerë k. Francës*<sup>[9]</sup> është ilustrim i balancimit të të drejtave të Nenet 6 dhe të Nenet 10 në lidhje me publikimin e materialeve të përfutuara nga hetimet gjyqësore në vazhdim. Në këtë rast, kërkuesit – dy gazetarë dhe një kompani (shtëpi) botuese – u gjetën fajtorë për veprën e përdorimit të informacioneve të përfutuara ilegalisht (përmes shkeljes së konfidencialitetit të hetimeve ose të konfidencialitetit profesional) në librin e tyre ku përshkruheshin operacionet e vëzhgimit të urdhëruara në nivelin më të lartë shtetëror. Operacionet e vëzhgimit provokuan interes të konsiderueshëm në media kur u zbuluan. Gjatë një hetimi gjyqësor, një prej asistentëve kryesorë të Presidentit francez, GM, u vu nën hetime formale; ai qe personi i cili bëri ankesën që çoi në dënimin e kërkuesve.

GjEDNj pranoi që dënimi ishte i parashikuar me ligj dhe kishte një qëllim legjitim. Në lidhje me nevojshmërinë e ndërhyrjes, nga njëra anë, libri i kërkuesve i kontribuoi një debati me interes publik të konsiderueshëm dhe publiku kishte interes legjitim në informacionet që përmbante libri, pra ndaj kujt ishin urdhëruar vëzhgime, kushtet e vëzhgimeve dhe nxitësit e tyre. GM nuk ishte politikan, por ishte figurë publike me ndikim. Nga ana tjetër, është legjitime të ofrohet mbrojtje speciale për konfidencialitetin e hetimeve gjyqësore. Megjithatë, me publikimin e librit, mbulimi medial tashmë ishte i gjerë dhe ishte fakt i njohur se GM ishte nën hetime; në fakt ai kishte komentuar rregullisht në shtyp. Prandaj, nuk ishte përcaktuar se si zbulimi i librit mund të kishte pasur efekt negativ tek e drejta e GM për prezumim të pafajësisë. Gazetarët kishin vepruar në pajtueshmëri me standardet e profesionit të tyre. GjEDNj gjeti se kishte shkelje të Nenet 10.

Në *N.S. k. Kroacisë*,<sup>[10]</sup> kërkuesja u gjet fajtorë për shkeljen e konfidencialitetit të procedurave administrative në lidhje me kujdestarinë e një fëmije duke zbuluar

---

[9] *Dupuis dhe të tjerë k. Francës*, vendim i 7 qershorit 2007, Nr. 1914/02.

[10] *N.S. k. Kroacisë*, vendim i 10 shtatorit 2010, nr. 36908/13.

informacione konfidenciale. Pas një aksidenti tragjik, pati një mosmarrëveshje mes familjarëve të babait dhe të nënës në lidhje me kujdestarinë e NG, fëmijë. Për këtë ngjarje pati mbulim medial të gjerë. Kërkuesja kishte dhënë intervista, përfshirë në televizionin kombëtar, në të cilat ajo kishte paraqitur informacione të marra nga procedurat konfidenciale të kujdestarisë; si rezultat, ajo u gjet fajtoare.

GjEDNj konsideroi nëse ndërhyrja tek Neni 10 ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. E drejta e kërkueses për të informuar publikun në lidhje me funksionimin e papërshtatshëm të procedurave për kujdestarinë e fëmijëve – ajo kishte vepruar në mirëbesim për të mbrojtur interesat e NG – duhet të balancohej kundrejt të drejtës së NG për privatësi dhe kundrejt ndalimit të zbulimit pa autorizim të informacioneve të zbuluara gjatë procedurave të zhvilluara privatisht. GjEDNj gjeti që gjykatat kombëtare kishin aplikuar një qasje formaliste ndaj konfidencialitetit. Mbrojtja e të dhënave personale të fëmijëve ishte esenciale; megjithatë, nuk ishte konsideruar fare sfondi i zbulimit dhe fakti që informacionet e zbuluara tashmë ndodheshin në sferën publike, nganjëherë të ofruara nga vetë autoritetet vendase.

### **Konventa 108 dhe Konventa 108+**

Konventa për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (ETS Nr. 108) ("**Konventa 108**") është një instrument i rëndësishëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave i miratuar nga Këshilli i Evropës në janar 1981.<sup>[11]</sup> Konventa 108 ka për qëllim të fuqizojë individët që të informohen, të kuptojnë dhe të kontrollojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale nga të tjerët, ndërkohë që ofron një kornizë për rrjedhën ndërkombëtare të të dhënave. Këtë e bën duke vendosur kriteret dhe kufizimet në lidhje me përpunimin e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe duke fuqizuar bashkëpunimin ndërkombëtar mes autoriteteve mbikëqyrëse. Ajo vendos një ekuilibër delikat mes të drejtës për autonomi personale dhe dinjitet njerëzor, nga njëra anë, dhe rëndësisë së rrjedhës ndërkombëtare së të dhënave gjatë ushtrimit të të drejtave themelore dhe fuqizimit të progresit social dhe ekonomik.<sup>[12]</sup>

---

[11] Konventa 108 është ratifikuar nga 55 shtete, përfshirë shtetet jo-anëtare të Këshillit të Evropës, si Uruguaji, Tunizia dhe Meksika. Nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëria e ka ratifikuar Konventën 108 në vitin 2005, Bosnja dhe Hercegovina në 2006, Mali i Zi në 2005, Maqedonia e Veriut në 2006, dhe Serbia në 2005. <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=treaty-detail&treatynum=108>.

[12] Konventa e KE-së 108+, p.16. <https://www.coe.int/en/web/data-protection/convention108-and-protocol>.

Protokolli Shtesë në Konventën për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave, për sa u përket autoriteteve mbikëqyrëse dhe rrjedhës ndërkufitare të të dhënave (ETS Nr. 181) ("**Protokolli Shtesë**") u miratua nga Këshilli i Evropës në nëntor 2001. Qëllimi i Protokolli Shtesë ishte të përmirësonte zbatimin e parimeve të përmbajtura në Konventën 108 në dy pikëpamje kryesore. Së pari, ai ofron mundësinë që palët të kenë autoritete mbikëqyrëse përgjegjëse për sigurimin e respektimit të ligjeve të miratuara në pajtim me Konventën 108. Së dyti, ai kufizon rrjedhën ndërkufitare të të dhënave drejt vendeve të treta dhe/ose organizatave ndërkombëtare që mund të ofrojnë një shkallë të përshtatshme mbrojtjeje.

Në maj 2018, Komiteti i Ministrave miratoi Protokollin e Amendamenteve të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale (Protokolli CETS Nr. 223) ("**Konventa 108+**").<sup>[13]</sup> Ky synon të modernizojë Konventën 108 (dhe protokollet e miratuara që nga viti 1981) për të trajtuar sfidat që dalin nga përdorimi i të dhënave të reja dhe teknologjive të reja të komunikimit dhe për të fuqizuar zbatimin e tij efektiv.<sup>[14]</sup>

Ka dallime të ndryshme mes Konventës 108 dhe Konventës 108+. Për shembull, formulimi dhe struktura e Nenit 1, që merret me objektivin dhe qëllimin, është ndryshuar për të "theksuar faktin që përpunimi i të dhënave personale mund të mundësojë në mënyrë pozitive ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tjera themelore".<sup>[15]</sup>

Ndërkohë që përkufizimet e të dhënave personale dhe objekteve të të dhënave nuk u modifikuan nga Konventa 108+, u futën përkufizime të tjera, si marrësi dhe përpunuesi. Konventa 108+ i aplikohet përpunimit të automatizuar dhe jo të automatizuar të të dhënave; megjithatë, ajo vazhdon t'u aplikohet si sektorit privat ashtu edhe atij publik pa dallim.<sup>[16]</sup>

---

[13] Deri në kohën e këtij shkrimi, Konventa 108+ është ratifikuar nga 26 shtete dhe do të hyjë në fuqi sapo të ratifikohet prej të paktën 38 shteteve. Nga vendet e Ballkanit Perëndimor, Serbia (2020), Maqedonia e Veriut (2021) dhe Shqipëria (2022) e kanë ratifikuar Konventën 108+. Bosnja dhe Hercegovina është palë nënshkruese; megjithatë, Mali i Zi ende nuk është nënshkruar. <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list?module=signatures-by-treaty&treatynum=223>.

[14] Konventa 108+ e KE-së, fq. 16, 34. <https://www.coe.int/en/web/data-protection/convention108-and-protocol>.

[15] Këshilli i Evropës, Konventa 108 e modernizuar: përmbledhje e të reja: <https://rm.coe.int/16808accf8>, p.1.

[16] Këshilli i Evropës, Konventa 108 e modernizuar: përmbledhje e të reja: <https://rm.coe.int/16808accf8>, p.2

Palët nuk mundën më të përjashtojnë lloje të caktuara të përpunimit të të dhënave nga aplikimi i Konventës 108+ p.sh. për qëllime të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare. Kategoritë e caktuara të të dhënave (p.sh. ato që përfshijnë nga mbrojtje më të larta) janë zgjeruar për të përfshirë të dhënat gjenetike dhe biometrike, anëtarësinë sindikale dhe prejardhjen etnike. Subjekteve të të dhënave u jepen të drejta të reja për t'u mundësuar kontroll më të madh mbi të dhënat e tyre, përfshirë ofrimin e informacioneve të mëtejshme kur ato ushtrojnë të drejtën e tyre për qasje dhe të drejtën për të marrë informacione rreth arsyeve për përpunimin e të dhënave.<sup>[17]</sup>

GjEDNj i është referuar Konventës 108 në praktikën e saj gjyqësore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, në mënyrë të veçantë Gjykata mbështetet në përkufizimet e të dhënave personale, kategorive të përpunimit të të dhënave dhe kategorive të ndjeshme / të veçanta që përcaktohen në Konventën 108.<sup>[18]</sup>

Gjithashtu, duhet theksuar se puna në Konventën 108+ dhe në reformën e paketës së BE-së për mbrojtjen e të dhënave "ka vazhduar paralelisht, dhe është treguar kujdes maksimal për të siguruar pajtueshmëri mes dy kornizave ligjore."<sup>[19]</sup>

#### **Rekomandimi Nr. R (95) 4**

Rekomandimi Nr. R (95) 4 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e shërbimeve të telekomunikacionit, me referencë të veçantë për shërbimet telefonike ("**Rekomandimi Nr. R (95) 4**") është miratuar nga Komiteti i Ministrave më 7 shkurt 1995.

Ky instrument synon të aplikojë aplikimin e parimeve të Konventës 108 në sektorin e telekomunikacioneve, në mënyrë të veçantë telefonia, për të garantuar privatësinë e një individi gjatë përdorimit të shërbimeve të telekomunikimit. Ai ofron rregulla dhe udhëzime specifike se si sektori t'i adresojë dobësitë aktuale në mbrojtjen e të dhënave në komunikimet telefonike, siç është përgjimi i paautorizuar dhe gjenerimi e ruajtja e më shumë të dhënave personale. Një gjë e tillë u ndërmor sepse u vu re që nuk ishte dukshëm e qartë se si të gjendeshin zgjidhje në përputhje me Konventën 108 për problemet e dala nga teknologjia e re.

---

[17] Këshilli i Evropës, Konventa 108 e modernizuar: përmbledhje e të rejave: <https://rm.coe.int/16808accf8>, p.3

[18] *Aman k. Zvicrës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 16 shkurtit 2000, nr. 27798/95; *Benedik k. Sllovenisë*, vendimi i 24 prillit 2018, nr. 62357/14; *Catt k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 janarit 2019, nr. 43514/15 tek §§58-60.

[19] Konventa 108+ Raport Shpjegues, fq.15. <https://rm.coe.int/convention-108-convention-for-the-protection-of-individuals-with-regar/16808b36f1>

## Konventa e Budapestit

Konventa për Krimet Kibernetike (ETS Nr. 185) ("Konventa e Budapestit") është i pari, dhe konsiderohet më i rëndësishmi, traktat ndërkombëtar për krimet kibernetike dhe provat elektronike. Ai u hap për nënshkrim më 23 nëntor 2001 dhe, që nga data e hartimit, është ratifikuar nga 68 vende në Evropë, Afrikë, Amerikë Veriore e Jugore dhe Azi, përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Qëllimi i Konventës së Budapestit është të mbështesë zhvillimin e një politike të përbashkët penale që synon mbrojtjen e shoqërisë nga krimet kibernetike, për shembull duke inkurajuar miratimin e legjislacionit të duhur dhe fuqizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar. Si i tillë, ai parashikon (i) kriminalizimin e sjelljes që nga qasja ilegale, ndërhyrja tek sistemet e të dhënave, shkelja e të drejtës autoriale, mashtrimi kompjuterik dhe pornografia e fëmijëve; (ii) instrumentet ligjore procedurale për të hetuar krimet kibernetike dhe për të siguruar prova elektronike; dhe (iii) bashkëpunimi efikas ndërkombëtar.

Konventa e Budapestit vendos një ekuilibër mes lejjimit të shoqërive për të përdorur internetin lirshëm dhe sigurimit të një reagimi efektiv të drejtësisë penale ndaj krimeve kibernetike. Çdo kufizim në përdorimin e kompjuterit dhe internetit është definuar ngusht; hetimet dhe ndjekjet penale janë të kufizuara me vepra penale të caktuara; dhe sigurohen vetëm të dhëna specifike që kërkohen si prova në procedura penale, varësisht nga mbrojtjet e ndryshme.<sup>[20]</sup>

## **b) Instrumentet e Bashkimit Evropian**

### Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian ("**Karta**") përmban 50 të drejta dhe parime themelore, me katër nene shtesë në lidhje me interpretimin dhe aplikimin e Kartës. Ajo është ligjërishd detyruese që nga 1 dhjetori 2009 me të njëjtën vlerë ligjore si traktatet e tjera të Bashkimit Evropian<sup>[21]</sup>. Ndërkohë që Karta është gjithmonë detyruese për institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e BE-së, Shtetet Anëtare i nënshtrohen asaj vetëm gjatë zbatimit të së drejtës së BE-së<sup>[22]</sup>.

[20] KEDNJ i është referuar në disa vendime të Konventës në lidhje me krimet kibernetike. Shih për shembull *K.U. k. Finlandës*, vendimi i 2 dhjetorit 2008, nr. 2872/02 tek §§24-27.

[21] Neni 6(1), Traktati i Bashkimit Evropian (ang. "TEU").

[22] Neni 51, Karta.

Individët, personat ligjorë privatë e madje edhe entitetet publike në rrethana të caktuara mund të mbështeten tek Karta në lidhje me marrëdhëniet e tyre me institucionet dhe organet e BE-së etj., dhe me Shtetet Anëtare që zbatojnë të drejtën e BE-së.<sup>[23]</sup>

Neni 7, në lidhje me respektin për jetën private dhe familjare, deklaron:

*"Secili ka të drejtën për respektim të jetës së tij/saj private dhe familjare, shtëpisë dhe komunikimeve të tij/saj."*

Shpjegimet në lidhje me Kartën<sup>[24]</sup> parashtrojnë se Neni 7 korrespondon me Nenin 8 të KEDNJ-së. Duke pasur parasysh zhvillimet teknologjike, "komunikimet" janë përdorur në vend të "korrespondencës" e cila gjendet në Nenin 8 të KEDNJ-së. Sipas Nenit 52(3) (shih poshtë), kufizimet që mund të vihen në mënyrë legjitime mbi këtë të drejtë janë të njëjtat si ato që lejohen nga Neni 8(2) KEDNJ.

Në mënyrë të ngjashme me Nenin 8, për t'u angazhuar Neni 7 i Kartës, duhet të ketë një ndërhyrje tek ajo e drejtë, e cila varet nga konteksti dhe faktet e secilit rast.<sup>[25]</sup>

Neni 8 i Kartës, i cili parashikon specifikisht mbrojtjen e të dhënave personale, deklaron:

*"1. Secili ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale të tij/saj.*

*2. Të dhëna të tilla duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë për qëllime të caktuara dhe me pëlqimin e personit në fjalë ose sipas një baze tjetër legjitime të përcaktuar me ligj. Secili ka të drejtë të ketë në dispozicion të dhënat e grumbulluara për të, si dhe të drejtën e korrigjimit të këtyre të dhënave.*

*3. Pajtimi me këto rregulla i nënshtrohet kontrollit nga një autoritet i pavarur."*

---

[23] FRA, "Aplikimi i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian në të drejtën vendase dhe politikëbërjen në vend: Udhërrëfyes", 2020, fq. 20.

[24] OJ C 303, 14.12.2007, fq. 17-35.

[25] FRA, "Doracaku mbi të drejtën evropiane të mbrojtjes së të dhënave", 2018, fq. 20.

Nuk ka një të drejtë vetqëndruese për mbrojtjen e të dhënave personale që njihet nga KEDNJ. Siç u diskutua më lart, e drejta e mbrojtjes së të dhënave është e ngërthyer brenda të drejtës për jetën private sipas Nenit 8 të KEDNJ-së. Megjithatë, hartuesit e Kartës ndjenë se zhvillimet teknologjike, së bashku me avancimin e të drejtës ndërkombëtare dhe kombëtare, përfshirë praktikën gjyqësore që ka të bëjë specifikisht me përpunimin e të dhënave, kërkonte një dispozitë të ndarë për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ("**GjDBE**") ka shpjeguar se Nenet 7 dhe 8 të Kartës janë të lidhura kaq afër sa që mund të shihen si të tilla që vendosin 'të drejtën për respektim të jetës private në lidhje me përpunimin e të dhënave personale'<sup>[26]</sup>, ku Neni 8 merr rolin e *lex specialis* në lidhje me Nenin 7.<sup>[27]</sup>

Neni 8 i Kartës angazhohet sapo përpunohen të dhënat personale. Ndryshe nga Neni 7 i Kartës dhe Neni 8 i KEDNJ-së, nuk ka nevojë të tregohet se personave të përfshirë u është shkaktuar ndonjë pengesë.

Për të qenë i ligjshëm, i gjithë përpunimi i të dhënave duhet të plotësojë kriteret e Nenit 52(1) (shih poshtë). Neni 52(1) cakton kriteret e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit kur kufizohen të drejtat e parashikuara në Kartë, ngjashëm me ato të Nenit 8(2) KEDNJ. Megjithatë, sipas Kartës, ka potencial më të madh që këto kritere të aplikohen në përpunimin e të dhënave, duke qenë se (në krahasim me Nenin 8 KEDNJ) nuk është e nevojshme të tregohet shkelja e të drejtave të një personi; thjesht përpunimi i të dhënave personale mjafton për të angazhuar Nenin 7 të Kartës.

Neni 52, në lidhje me fushëveprimin dhe interpretimin e të drejtave dhe parimeve, deklaron:

*"1. Çdo lloj kufizimi i ushtrimit të të drejtave dhe lirive të njohura me këtë Kartë duhet doemos të parashihet me ligj dhe të respektojë esencën e këtyre të drejtave dhe lirive. Varësisht nga parimi i proporcionalitetit,*

---

[26] Shih *Volker und Markus Schecke GbR dhe të tjerë k. Land Hessen*, vendimi i Dhomës së Madhe 9 nëntor 2010, Çështjet e Bashkuara C-92/09 dhe C-93/09 tek §52.

[27] Në këtë aspekt, GjDBE ka theksuar që: "*Mbajtja e të dhënave për qëllime të qasjes së mundshme në to nga autoritetet kombëtare kompetente... direkt dhe specifikisht prek jetën private, e rrjedhimisht, të drejtat e garantuara nga Neni 7 i Kartës. Më tej, një mbajtje e tillë e të dhënave gjithashtu hyn brenda Nenit 8 të Kartës sepse përbën përpunim të dhënave personale brenda kuptimit të atij Neni, prandaj ajo domosdo që duhet të plotësojë kriteret e mbrojtjes së të dhënave që dalin nga ai Nen...*" *Digital Rights Ireland Ltd k. Ministrin të Komunikimeve, Marinës dhe Burimeve Natyrore dhe të tjerë*, vendimi i Dhomës së Madhe 8 prill 2014 – Çështjet e Bashkuara C-293/12 dhe C-594/12 tek §29 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

*kufizimet mund të bëhen vetëm nëse vërtet i plotësojnë synimet e interesave të përgjithshme të njohura nga Bashkimi Evropian ose nevoja për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e të tjerëve.*

...

*3. Përderisa kjo Kartë përmban të drejta që korrespondojnë me të drejtat e garantuara në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, kuptimi dhe fushëveprimi i këtyre të drejtave do të jenë të njëjtat si ato që janë përcaktuar nga Konventa e përmendur. Kjo dispozitë nuk e parandalon të drejtën e Bashkimit Evropian për të siguruar mbrojtje më të përgjithshme.*

...”

Sipas Nenit 52(3), ndërkohë që KEDNj përcakton kufirin minimal të mbrojtjes, e drejta e BE-së (përfshirë Kartën) mund të ofrojë më shumë mbrojtje të gjerë. Në lidhje me të drejtat e Kartës të cilat korrespondojnë me të drejtat e mbrojtura nga KEDNj, ato të drejta të Kartës mund të kenë të njëjtin kuptim dhe fushëveprim si ato të KEDNj-së, përfshirë përmes referencës në praktikën gjyqësore të KEDNj-së.<sup>[28]</sup>

Në praktikën e tyre gjyqësore, GjDBE dhe GjEDNj shpesh i referohen vendimeve të njëra-tjetrës si pjesë e dialogut të vazhdueshëm mes dy gjykatave. Prandaj, jurisprudenca e GjDBE-së është relevante për Ballkanin Perëndimor jo vetëm për shkak të çështjes së aderimit, por edhe për shkak se GjEDNj merr parasysh jurisprudencën e GjDBE-së dhe instrumenteve të BE-së, posaçërisht në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave.

*Të Drejtat Dixhitale në Irlandë*<sup>[29]</sup> është një shembull se si GjDBE ka aplikuar dispozitat e Kartës në lidhje me mbrojtjen e të dhënave në fushën e hetimeve dhe parandalimit të krimit. Kjo çështje diskutohet poshtë në kuadër të Direktivës 2006/24/EC.

---

[28] FRA, "Aplikimi i Kartës së të Drejtave Themelore në Bashkimin Evropian në të drejtën vendase dhe politikëbërjen në nivel vendi: Udhërrëfyes", 2020, fq. 22.

[29] *Digital Rights Ireland Ltd k. Ministrit të Komunikimeve, Marinës dhe Burimeve Natyrore dhe të tjerë*, vendimi i Dhomës së Madhe 8 prill 2014 – Çështjet e Bashkuara C-293/12 dhe C-594/12 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).



## Direktiva 2006/24/EC

Direktiva 2006/24/EC kishte të bënte me mbajtjen e të dhënave të gjeneruara ose të përpunuara në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike të komunikimit elektronik ose të rrjeteve të komunikimit publik. Ajo kërkonte që ofruesit e shërbimeve elektronike publike ose rrjetet e komunikimeve publike të mbanin të dhënat e përdoruesve për një periudhë kohore deri në dy vjet për të lejuar parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të rënda. Përmbajtja e komunikimeve elektronike nuk kërkohet që të ruhej.

Në prill 2014, GjEDNJ e deklaroi direktivën të pavlefshme në çështjen *Të Drejtat Dixhitale në Irlandë*<sup>[30]</sup> sepse ajo përfshinte ndërhyrje të rënda tek Nenet 7 dhe 8 të Kartës të cilat nuk ishin rreptësisht të kufizuara brenda asaj çka ishte e nevojshme.

Pra, *Të Drejtat Dixhitale në Irlandë* është shembull se si GjDBE ka aplikuar dispozitat e Kartës për mbrojtjen e të dhënave në fushën e hetimeve dhe parandalimit të krimeve. Në mënyrë të veçantë, GjDBE deklaroi se kishte pasur ndërhyrje tek Neni 8 i Kartës sepse direktiva kërkonte përpunimin e të dhënave personale. Gjithashtu, kishte pasur ndërhyrje tek Neni 7 i Kartës sepse të dhënat lejonin që "të nixirreshin përfundime shumë të sakta në lidhje me jetët private të personave të dhënat e të cilëve ishin mbajtur, siç janë shprehitë e përditshmërisë, vendbanimet e përhershme ose të përkohshme, lëvizjet ditore, aktivitetet e zhvilluara, marrëdhëniet shoqërore të atyre personave dhe ambientet e frekuentuara prej tyre".<sup>[31]</sup>

## Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave<sup>[32]</sup> (ang. "GDPR") u miratua sipas Nenet 16 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian (ang.

[30] *Digital Rights Ireland Ltd k. Ministrit të Komunikimeve, Marinës dhe Burimeve Natyrore dhe të tjerë*, vendimi i Dhomës së Madhe 8 prill 2014 – Çështjet e Bashkuara C-293/12 dhe C-594/12 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[31] *Digital Rights Ireland Ltd k. Ministrit të Komunikimeve, Marinës dhe Burimeve Natyrore dhe të tjerë*, vendimi i Dhomës së Madhe 8 prill 2014 – Çështjet e Bashkuara C-293/12 dhe C-594/12 tek §27 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[32] Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 prill 2016 për mbrojtjen e personave natyrorë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lirinë e lëvizjes së këtyre të dhënave, dhe heqjen e Direktivës 95/46/EC (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave). Rregullorja hyri në fuqi më 25 maj 2018.

“TFEU”), dhe ofron një bazë ligjore të pavarur për mbrojtjen e të dhënave e cila shtrihet tek të gjitha çështjet për të cilat BE-ja është kompetente për të shtrirë legjislacionin e saj, përfshirë bashkëpunimin e policisë dhe gjyqësorit në çështje penale. GDPR e modernizoi legjislacionin e BE-së për mbrojtjen e të dhënave dhe ofroi rregulla të qëndrueshme për të gjitha Shtetet Anëtare.<sup>[33]</sup>

## Neni 10

Neni 10 GDPR, i cili ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale në lidhje me veprat dhe dënimet penale, deklaron

*“Përpunimi i të dhënave personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale ose masat e sigurisë mbi bazën e Nenit 6(1) [rrethanat në të cilat përpunimi është i ligjshëm] zhvillohet vetëm nën kontrollin e autoritetit zyrtar ose kur përpunimi është autorizuar nga e drejta e Bashkimit (Unionit) ose Shtetit Anëtar që ofron mbrojtjet e duhura për të drejtat dhe liritë e objekteve të të dhënave. Çdo regjistër përmbledhës i dënimeve penale mbahet vetëm nën kontrollin e autoritetit zyrtar.”*

## Aplikueshmëria e GDPR-së ndaj gjykatave

Recitali 20 i GDPR-së deklaron:

*“Ndërkohë që kjo Rregullore u aplikohet, inter alia, aktivitetet në gjykatave dhe autoritetet të tjera gjyqësore, Unioni ose Shteti Anëtar mund të specifikojë operacionet e përpunimit dhe procedurat e përpunimit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga gjykatat dhe autoritetet e tjera gjyqësore. Kompetenca e autoritetet mbikëqyrëse nuk duhet të mbulojë përpunimin e të dhënave personale kur gjykatat janë duke vepruar në cilësinë e tyre gjyqësore, me qëllim që të mbrohet pavarësia e gjyqësorit në kryerjen e detyrave të tij gjyqësore, përfshirë vendimmarrjen. Do të duhet të ishte e mundur që mbikëqyrja e operacioneve të përpunimit të këtyre të dhënave t’u besohet organeve*

---

[33] GDPR e hoqi Direktivën 95/46/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 24 tetor 1995 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (Direktiva për mbrojtjen e të dhënave). Shih gjithashtu FRA, “Doracaku për të drejtën evropiane për mbrojtjen e të dhënave”, 2018, fq. 30.

*të veçanta brenda sistemit gjyqësor të Shtetit Anëtar, i cili duhet, në mënyrë të veçantë, të sigurojë vetëdijesimin mes anëtarëve të gjyqësorit për detyrimet e tyre sipas kësaj Rregulloreje dhe të trajtojë ankesat në lidhje me operacione të tilla të përpunimit të të dhënave.” (theksi i shtuar)*

Ky Recital përcakton se, ndërkohë që GDPR u aplikohet gjykatave, autoriteti kombëtar mbikëqyrës që kërkohet nga GDPR nuk duhet të mbikëqyrë përpunimin e të dhënave personale të ndërmarrë nga gjykatat kur veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore. Kjo detajohet në Nenet e GDPR-së të cilat theksojnë përjashtimet nga rregullat e përgjithshme për gjykatat që veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore.

Neni 9 GDPR, mbi përpunimin e kategorive të caktuara të të dhënave personale, parashikon:

*“1. Ndalohet përpunimi i të dhënave personale që zbulon origjinën racore ose etnike, opinionet politike, besimet fetare ose filozofike, ose anëtarësinë sindikale, dhe përpunimi i të dhënave gjenetike, të dhënave biometrike me qëllim të identifikimit unik të një personi natyral, të dhënave lidhur me shëndetin ose të dhënave lidhur me jetën seksuale ose orientimin seksual të një personi natyror.*

*2. Paragrafi 1 nuk aplikohet në rastet e mëposhtme:*

...

*(f) përpunimi është i nevojshëm për sistemin, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore ose kurdo që gjykatat veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore;”*

Neni 23 GDPR rendit situatat në të cilat shtetet lejohen të kufizojnë ose të bëjnë përjashtime në detyrimet për mbrojtjen e të dhënave që vendosen nga GDPR. Kjo përfshin rastet kur është e nevojshme dhe proporcionale për:

...

*(f) mbrojtjen e pavarësisë gjyqësore dhe procedurave gjyqësore;”*

Neni 37 GDPR, mbi kriteret për zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave, deklaron:

*"1. Kontrolluesi dhe përpunuesi do të emërojnë një zyrtar të mbrojtjes së të dhënave në rastet kur:*

*a) përpunimi zhvillohet nga një autoritet ose organ publik, përveç kur gjykatat veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore;"*

Neni 55 GDPR, mbi kompetencat e autoritetit mbikëqyrës të kërkuar nga Neni 51, deklaron:

*"...*

*3. Autoritetet mbikëqyrëse nuk janë kompetente për të mbikëqyrur operacionet e përpunimit të gjykatave kur këto të fundit veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore."*

Duket se 18 nga 30 Shtetet Anëtare të Zonës Ekonomike Evropiane (ang. "EEA") e kanë interpretuar shprehjen "duke vepruar në cilësinë e tyre gjyqësore" në mënyrë të atillë që gjykatat mund të veprojnë në cilësitë e tyre gjyqësore, por gjithashtu mund të veprojnë edhe në cilësi të tjera. Ky njihet si interpretim funksional. Nga ana tjetër, vetëm tetë vende i janë përmbajtur interpretimit që gjykatat gjithmonë veprojnë në cilësitë e tyre gjyqësore, i njohur si interpretim institucional.<sup>[34]</sup>

Sa i përket interpretimit funksional, praktikat e vendeve të EEA-s janë homogjene. Të dhënat personale në të gjitha gjykatat ligjore shihen si të tilla që janë brenda fushëveprimit të cilësisë gjyqësore. Këtu përfshihen të dhënat personale në dokumentet e përpunuara në raste të tilla, përfshirë verdiktet, procesverbalet e çështjeve etj. Megjithatë, të dhënat personale që nuk kanë lidhje me përmbajtjen e çështjeve gjyqësore, siç janë të dhënat lidhur me organizimin dhe proceset e brendshme dhe personelin e gjykatave, janë përtej fushëveprimit të cilësisë gjyqësore. Në vendet relevante, gjykatat e kanë mbikëqyrjen të organizuar përbrenda kur veprojnë në cilësinë e tyre gjyqësore, pra përmes gjykatave më të larta në hierarki ose përmes departamenteve të veçanta.<sup>[35]</sup>

---

[34] Custers dhe të tjerë, "Quis custodiet ipsos custodias? Mbrojtja e të dhënave në gjyqësor në BE dhe Shtetet Anëtare të EEA-s" *E Drejta Ndërkombëtare e Privatësisë së të Dhënave* (2022), fq. 103, 108-111.

[35] Custers dhe të tjerë, "Quis custodiet ipsos custodias? Mbrojtja e të dhënave në gjyqësor në BE dhe Shtetet Anëtare të EEA-s" *E Drejta Ndërkombëtare e Privatësisë së të Dhënave* (2022), fq. 111.

Në çështjen *X dhe Z k. Autoriteit Persoonsgegevens*<sup>[36]</sup>, GjDBE duket se ka ndërmarrë interpretimin funksional. Z, një palë në procedurën gjyqësore e përfaqësuar nga X, kërkoi që autoriteti mbikëqyrës holandez të merrte masa zbatuese kundër autoritetit përkatës gjyqësor për shkelje të GDPR-së. Pala pretendoi se GDPR ishte shkelur kur autoriteti gjyqësor kishte vënë në dispozicion të gazetarëve të pranishëm ditën e seancës dëgjimore dokumente që u mundësonin gazetarëve të ndiqnin seancat, konkretisht një kopje të lajmërimit të apelit, një kopje të përgjigjes, dhe një kopje të vendimit gjyqësor të kontestuar. Ato dokumente u shkatërruan në fund të asaj dite. Autoriteti mbikëqyrës holandez refuzoi meqenëse nuk ishte kompetent sipas Nenit 55(3) GDPR, pra për shkak se autoriteti gjyqësor ishte duke vepruar në cilësinë e vet gjyqësore.

GjDBE vendosi që Neni 55(3):

*“duhet të kuptohet... si tillë që nuk është i kufizuar me përpunimin e të dhënave personale që bëhet nga gjykatat në raste të caktuara, por si i tillë që u referohet gjerësisht të gjitha operacioneve të përpunimit që zhvillohen nga gjykatat në vazhden e aktivitetit të tyre gjyqësor, siç janë ato operacione përpunuese mbikëqyrja e të cilave nga autoriteti mbikëqyrës me gjasë, qoftë direkt apo indirekt, do të kishte ndikim tek pavarësia e anëtarëve të tyre ose do të peshonte në vendimet e tyre, janë të përfshyrtura nga kompetenca e atij autoriteti.”<sup>[37]</sup>*

Kështu, përpunimi i të dhënave personale nga gjykatat në kontekstin e politikave të tyre të komunikimit në çështjet që kanë përpara bie jashtë kompetencës së autoritetit mbikëqyrës. Përcaktimi i informacionit nga një lëndë që mund të ndahet me gazetarët për t'u mundësuar atyre të raportojnë në lidhje me procedimet gjyqësore është “qartazi” i lidhur me faktin që gjykatat janë duke vepruar në cilësinë e tyre gjyqësore. Nuk ka rëndësi nëse ka apo jo bazë ligjore në të drejtën vendase për zbulimin e informacione tek palët e treta.<sup>[38]</sup>

---

[36] *X dhe Z k. Autoriteit Persoonsgegevens*, vendimi i Dhomës së Parë i 24 marsit 2022, C-245/20.

[37] *X dhe Z k. Autoriteit Persoonsgegevens*, vendimi i Dhomës së Parë i 24 marsit 2022, C-245/20 tek §34.

[38] *X dhe Z k. Autoriteit Persoonsgegevens*, vendimi i Dhomës së Parë i 24 marsit 2022, C-245/20 tek §§36-38.

## c) Komisioneri i Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Dhënave

Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave në Këshillin e Evropës (ang. "DPC") është një funksion i pavarur i vendosur sipas Nenit 4 të Rregullores së Sekretarit të Përgjithshëm të 17 prillit 1989 që ngre një sistem mbrojtjesh të të dhënave për dosjet personale në Këshillin e Evropës ("**Rregullorja e vitit 1989**").

DPC siguron që të gjitha të dhënat personale të mbledhura dhe të përpunuara nga Këshilli i Evropës të jenë në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave të përcaktuara në Rregulloren e vitit 1989. DPC gjithashtu ka funksione të tjera, përfshirë:

- » hetimin e ankesave nga stafi që dalin nga implementimi i Rregullores së vitit 1989;
- » formulimi i opinioneve me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm mbi çështje që kanë të bëjnë me implementimin e Rregullores së vitit 1989; dhe
- » sjellja në vëmendje të Sekretarit të Përgjithshëm të propozimeve për përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së të dhënave.<sup>[39]</sup>

DPC gjithashtu mund të ftohet për të marrë pjesë në punën e Komitetit Konsultativ të Konventës 108 dhe në takimet e organeve jashtë Këshillit të Evropës, siç është Asambleja Globale e Privatësisë.<sup>[40]</sup>

Mes viteve 2020 dhe 2022, DPC ka marrë pjesë, gjatë Asamblesë Globale të Privatësisë në Meksikë, në një panel të Konventës 108 dhe inteligjencës artificiale. Gjithashtu, ai ka marrë pjesë në një seancë para Komisionit të Asamblesë Parlamentare për Kulturë, Shkencë, Arsim dhe Media në lidhje me aplikacionet e monitorimit dhe gjurmimit të përdorura gjatë pandemisë COVID-19.<sup>[41]</sup>

DPC ka dhënë rekomandime lidhur me çështjen e anonimizimit të të dhënave dhe mbrojtjes së të dhënave personale në procedura gjyqësore në adresë të Kancelarit të Tribunalit Administrativ. Atij iu kërkua një opinion në lidhje me

[39] Këshilli i Evropës, Raporti i Aktiviteteve i Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave: nëntor 2020 – tetor 2022, DPCOM Report 2020-2022, fq. 5.

[40] Këshilli i Evropës, Raporti i Aktiviteteve i Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave: nëntor 2020 – tetor 2022, DPCOM Report 2020-2022, fq. 5.

[41] Këshilli i Evropës, Raporti i Aktiviteteve i Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave: nëntor 2020 – tetor 2022, DPCOM Report 2020-2022, fq. 7.

ligjshmërinë e zbulimit të të dhënave rreth një hetimi të brendshëm për mashtrim, dhe u konsultua në lidhje me përditësimin e rregulloreve të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale. Rregulloret e reja të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u miratuan më 15 qershor 2022.<sup>[42]</sup>

## **d) Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave**

Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (ang. "EDPS") është autoriteti i pavarur i mbrojtjes së të dhënave brenda Bashkimit Evropian përgjegjës për mbikëqyrjen e përpunimit të të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian.<sup>[43]</sup>

Fuqitë e tij janë të përcaktuara në Rregulloren 2018/1725, sipas së cilës, për shembull, ajo mund të vendosë gjopa administrative ndaj institucioneve të BE-së ose ta referojë një çështje në GjDBE. EDPS ka fuqi të veçanta për të mbikëqyrur mënyrën se si organe dhe agjenci të caktuara përpunojnë të dhënat personale; për shembull, Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin në Zbatimin e Ligjit (Europol) dhe Prokuroria Publike Evropiane.<sup>[44]</sup>

Përveç monitorimit të përpunimit të të dhënave personale për të garantuar pajtueshmërinë me rregullat e mbrojtjes së të dhënave, EDPS:

- » Këshillon Komisionin Evropian, Parlamentin Evropian dhe Këshillin rreth propozimeve dhe iniciativave legjislative në lidhje me mbrojtjen e të dhënave;
- » Monitoron dhe vlerëson zhvillimet teknologjike me ndikim tek mbrojtja e të dhënave personale; dhe
- » Punon me autoritetet e mbrojtjes së të dhënave për promovimin e mbrojtjes së qëndrueshme të të dhënave në tërë BE-në.<sup>[45]</sup>

Në vitin 2022, EDPS kishte në vijim disa hetime të ndryshme në institucionet dhe agjencitë e BE-së lidhur me përdorimin nga ato të produkteve dhe shërbimeve 'cloud' nga entitete me seli jashtë Zonës Ekonomike Evropiane, përfshirë

[42] Këshilli i Evropës, Raporti i Aktiviteteve të Komisionierit për Mbrojtjen e të Dhënave: nëntor 2020 – tetor 2022, DPCOM Report 2020-2022, fq. 10 dhe 12.

[43] Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, Përmbledhje Ekzekutive e Raportit Vjetor, '22, fq. 3.

[44] Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, Përmbledhje Ekzekutive e Raportit Vjetor, '22, fq. 4-5.

[45] Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, Përmbledhje Ekzekutive e Raportit Vjetor, '22, fq. 4.

përdorimin nga Komisioni Evropian i Microsoft Office 365.<sup>[46]</sup> Gjithashtu, ai kërkoi që GjDBE të anulonte dispozita të caktuara të Rregullores së ndryshuar të Europolit meqenëse ato dëmtonin sigurinë ligjore për të dhënat personale të individëve dhe kërcënonin pavarësinë e EDPS-së.

Në lidhje me Bordin Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave, EDPS lëshoi një Opinion të Përbashkët mbi Propozimin për Hapësirën Evropiane të të Dhënave Shëndetësore – e para e një serie propozimesh për hapësira të përbashkëta evropiane të të dhënave për fusha specifike – dhe një Opinion të Përbashkët mbi Propozimin për Ligjin për të Dhënat, i cili synon të vendosë rregulla të harmonizuara për qasjen në, dhe përdorimin e, të dhënave të gjeneruara nga një gamë e gjerë produktesh dhe shërbimesh, siç janë objektet e lidhura dhe asistentët virtualë.<sup>[47]</sup>

---

[46] Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, Përmbledhje Ekzekutive e Raportit Vjetor, '22, fq. 13.

[47] Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave, Përmbledhje Ekzekutive e Raportit Vjetor, '22, fq. 16.



# Kapitulli 2

## Çfarë është informacioni privat dhe të dhënat personale?

Mbrojtja e të dhënave personale ka rëndësi themelore për gëzimin nga një person i të drejtës për respektim të jetës private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës, siç garantohet nga Neni 8 i KEDNJ-së.<sup>[48]</sup> Prandaj, mbledhja, ruajtja, modifikimi, zbulimi, përdorimi dhe publikimi i informacioneve lidhur me jetën private të një individi mund të përfaqësojë ndërhyrje tek Neni 8 KEDNJ.<sup>[49]</sup>

Gjykata e përkufizon "informacionin në lidhje me jetën private të një individi" duke iu referuar përkufizimit të të dhënave personale në Konventën 108.<sup>[50]</sup> Neni 2(a) i Konventës 108 parashikon:

*"të dhënat personale" nënkuptojnë çdo informacion në lidhje me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm ("subjekti i të dhënave");*<sup>[51]</sup>

Ky përkufizim i të dhënave personale nuk duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtëzuar. Është një koncept i gjerë<sup>[52]</sup> i cili përfshin informacione që direkt identifikojnë një individ (si p.sh. emri i tij/saj) si dhe informacione që mund të përdoren për ta identifikuar atë indirekt përmes referencës në një identifikues

[48] *Satakunnan Markkinaporssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës*, vendimi i Dhomës së Madhe i 27 qershorit 2017, Nr. 931/13 tek §137.

[49] *Rotaru k. Rumanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 4 majit 2000, Nr. 28341/95 tek §46.

[50] Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale e 28 janarit 1981 (ETS Nr. 108), e cila hyri në fuqi në vitin 1985 dhe u përditësua në 2018.

[51] *Amann k. Zvicrës*, Vendim i Dhomës së Madhe i 16 shkurtit 2000, Nr. 27798/95 tek §65; *Rotaru k. Romanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 majit 2000, Nr. 28341/95 tek §43.

[52] *Rotaru k. Romanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 majit 2000, Nr. 28341/95 tek §43.

siç janë të dhënat e lokacionit ose adresa e protokollit të internetit të tij/saj (IP address).

Koncepti i të dhënave personale është gjetur nga Gjykata se përfshin llojet vijuese të informacioneve (kjo listë nuk është shteruese):

- » Emrin e një personi dhe mbiemrin e tij/saj<sup>[53]</sup>
- » Datën e lindjes së një personi<sup>[54]</sup>
- » Adresën e banimit të një personi<sup>[55]</sup>
- » Numrat e telefonave të thirrur, numrin e telefonit të vet, përdorimin e emailit dhe internetit, përfshirë datat, kohën, kohëzgjatjen e komunikimeve<sup>[56]</sup>
- » Mesazhet e dërguara në shërbimet e mesazherisë online<sup>[57]</sup>
- » Adresën dinamike në Protokollit të Internetit ("IP") të një personi, e cila zbulon detaje siç janë lokacioni më i gjerë i një personi dhe Ofruesi i Shërbimit të Internetit ("ISP") me të cilin është i lidhur përdoruesi (edhe kur nuk është i shënuar me emër si abonent në atë ISP)<sup>[58]</sup>
- » Të dhënat gjenetike dhe biometrike, përfshirë mostra të celularit, profile të ADN-së,<sup>[59]</sup> gjurmët e gishtërinjve<sup>[60]</sup> dhe mostra të zërit<sup>[61]</sup>
- » Të dhënat shëndetësore, për shembull informacione për diagnozën e HIV,<sup>[62]</sup> shtatzaninë<sup>[63]</sup> dhe kryerjen e një aborti<sup>[64]</sup>, shëndetin mendor

---

[53] *Guillot k. Francës*, vendim i 24 tetorit 1996, Nr. 22500/93.

[54] *Catt k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 janarit 2019, Nr. 43514/15.

[55] *Catt k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 janarit 2019, Nr. 43514/15.

[56] *Copland k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 3 prillit 2007, Nr. 62617/00 tek §§41 dhe 43.

[57] *Bărbulescu k. Romanisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 5 shtatorit 2017, Nr. 61496/08 tek §§18 dhe 74-81.

[58] *Benedik k. Sllovenisë*, vendim i 24 prillit 2018, Nr. 62357/14, §§107-108, ku kërkuesi u gjet se ishte 'i identifikueshëm' (e jo i identifikuar) përmes IP adresës së tij dinamike. IP adresa tregoi se ai ishte i lidhur me njëfarë ISP, por ishte babai i tij ai që emërtohej si abonenti. Edhe pse IP adresa nuk zbuloi emrin ose adresën e tij, informacionet e marra (lokacioni, përdorimi etj.) e bënë atë të identifikueshëm.

[59] *Trajkovski dhe Chipovski k. Maqedonisë së Veriut*, vendim i 13 shkurtit 2020, Nr. 53205/13 dhe 63320/13; *Boljević k. Serbisë*, vendim i 16 qershorit 2020, Nr. 47443/14.

[60] *S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2008, Nr. 30562/04 dhe 30566/04 tek §§70-77 dhe 84 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[61] *P.G. dhe J.H. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 25 shtatorit 2001, Nr. 44787/98 tek §§38 dhe 63.

[62] *Z. k. Finlandës*, vendim i 25 shkurtit 1997, Nr. 22009/93 tek §§113-114.

[63] *Kononova k. Rusisë*, vendim i 9 tetorit 2014, Nr. 37873/04 tek §§39-50.

[64] *M.S. k. Suedisë*, vendim i 27 gushtit 1997, Nr. 20837/92 tek §§41-42.

- dhe vendosjen e detyruar në një institucion të shëndetit mendor<sup>[65]</sup>
- » Informacione rreth orientimit seksual të një personi dhe/ose jetës së tij/saj seksuale<sup>[66]</sup>
  - » Profesionin e një personi<sup>[67]</sup>
  - » Të dhënat e lokacionit me GPS<sup>[68]</sup>
  - » Situata financiare e një personi, transaksionet financiare ose marrëdhëniet profesionale<sup>[69]</sup>
  - » Detaje mbi të ardhurat e taksueshme të fituara dhe të pafituara dhe aseteve neto të taksueshme<sup>[70]</sup>
  - » Informacione mbi angazhimin në aktivitete politike dhe protesta<sup>[71]</sup>
  - » Opinione politike, fetare, filozofike dhe besime të tjera<sup>[72]</sup>
  - » Anëtarësia në shoqata ose sindikata<sup>[73]</sup>
  - » Informacione për veprat penale, procedurat, dënimet, kaucionet ose masa të ngjashme parandaluese (si për shembull mbajtja në paraburgim në stacionin e policisë)<sup>[74]</sup>
  - » Prejardhja etnike<sup>[75]</sup>

## Të Dhënat Personale në Sferën Publike

Edhe kur informacioni tashmë është pjesë e sferës publike, ose mund të gjendet nga publiku, prapë se prapë ai mund të konsiderohet si "e dhënë personale", çka meriton mbrojtjen e Nenit 8. Fakti nëse të dhënat publike në dispozicion publik angazhojnë ose jo mbrojtjen e Nenit 8 varet nga rrethanat e rastit, përfshirë mënyrën se si të dhënat janë mbledhur, përdorur dhe ruajtur. Për shembull, edhe

[65] *Malanicheva k. Ruisë* (dec.), vendim i 31 majit 2016, Nr. 50405/06 tek §§13 dhe 15-18.

[66] *Dudgeon k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 22 tetorit 1981, Nr. 7525/76 tek §41.

[67] *Khelili k. Zvicrës*, vendim i 18 tetorit 2011, Nr. 16188/07 tek §56.

[68] *Uzun k. Gjermanisë*, vendim i 2 shtatorit 2010, Nr. 35623/05 tek §§49-53.

[69] *M.N. dhe të tjerë k. San Marinos*, vendim i 7 korrikut 2015, Nr. 28005/12 tek §51.

[70] *Satakunnan Markkinaporssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës*, Vendim i Dhomës së Madhe i 27 qershorit 2017, Nr. 931/13.

[71] *Rotaru k. Romanisë*, Vendim i Dhomës së Madhe i 4 majit 2000, Nr. 28341/95 tek §44.

[72] *Catt k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 janarit 2019, Nr. 43514/15, §112; *Sinan Işık k. Turqisë*, vendim i 2 shkurtit 2010, Nr. 21924/05 tek §37.

[73] *Catt k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 janarit 2019, Nr. 43514/15 tek §112.

[74] *M.M. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 nëntorit 2012, Nr. 24029/07 tek §188.

[75] *S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2008, Nr. 30562/04 dhe 30566/04 tek §71 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

kur informacionet rreth të ardhurave dhe asetëve të taksueshme të një personi mund të gjendet nga publiku, zbulimi i këtyre informatave e ka angazhuar Nenin 8 kur ato në mënyrë sistematike u mbledhën dhe u publikuan në gazetë.<sup>[76]</sup> Ngjashëm, të dhënat për dënimin penal të një personi shpesh janë të qasshme në sferën publike; gjyqi penal i tij me gjasë është i hapur për publikun dhe i raportuar në media, dhe dënimi i tij është i regjistruar në një dosje qendrore në të cilën kushdo ka qasje sipas kërkesës. Megjithatë, teksa kalon kohë nga data e dënimit dhe ai zbehet nga ndërgjegjja publike, të dhënat e dënimit gjithnjë e më shumë bëhen pjesë e jetës private të personit. Sa më shumë kohë që kalon qysh prej dënimit, aq më shumë theksohet mbrojtja e privatësisë së këtij informacioni.<sup>[77]</sup>

## **Informacionet e Ndjeshme dhe Kategoritë Speciale të të Dhënave Personale**

Konventa 108 dallon disa "Kategori Speciale të të Dhënave" të cilat duhen mbrojtur më shumë. Neni 6 i Konventës 108 parashikon:

*"Të dhënat personale që zbulojnë origjinën racore, opinionet politike ose fetare ose të tjera, si dhe të dhëna personale rreth shëndetit ose jetës seksuale, mund të mos përpunohen automatikisht nëqoftëse e drejta vendase nuk parashikon mbrojtje të përshtatshme. E njëjta gjë vlen edhe për të dhënat personale në lidhje me dënimet penale."*

Konventa 108+ shtoi lloje të reja të të dhënave në përkufizimin e "Kategorive Speciale të të Dhënave", duke përfshirë të dhënat gjenetike dhe biometrike, anëtarësinë sindikale, të dhëna lidhur me vepra dhe dënime penale, përveç të dhënave rreth dënimeve penale dhe të dhënave që zbulonin prejardhjen etnike si dhe origjinën racore. Neni 6 i Konventës 108+ parashikon:

*"1. Përpunimi i: - të dhënave gjenetike; - të dhënave personale lidhur me veprat, procedurat penale dhe dënimet, dhe masat e ndërlidhura të sigurisë; - të dhënat biometrike unike që identifikojnë një person; - të dhëna personale për informacionin që zbulojnë në lidhje me origjinën racore ose etnike, opinionet politike, anëtarësinë sindikale, besimet fetare ose të tjera, shëndetin ose jetën seksuale, do të lejohen vetëm"*

---

[76] Satakunnan Markkinaporssi Oy dhe Satamedia Oy k. Finlandës, vendim i Dhomës së Madhe i 27 qershorit 2017, Nr. 931/13.

[77] M.M. k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i 13 nëntorit 2012, Nr. 24029/07.

*kur mbrojtjet e përshtatshme janë të mishëruara në ligj, duke plotësuar mbrojtjet e kësaj Konvente.*

*2. Mbrojtje të tilla do të shërbejnë si mburojë kundër rreziqeve që mund të paraqesë përpunimi i të dhënave të ndjeshme për interesat, të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave, pra rreziku i diskriminimit."*

Gjykata gjithashtu i trajton këto kategori të dhënash si forma "të ndjeshme" të të dhënave të cilat kërkojnë një shkallë më të lartë mbrojtjeje. Një mbrojtje e tillë e lartë është në njohje të faktit se zbulimi i këtyre të dhënave mund të ndikojë në mënyrë dramatike tek jeta private dhe familjare e një personi, tek situata sociale dhe e punësimit, ose mund ta ekspozojë atë ndaj rrezikut të tëhuajzimit.<sup>[78]</sup>

---

[78] *Z.k. Finlandës, vendim i 25 shkurtit 1997, Nr. 22009/93.*

# Kapitulli 3

## Mbrojtja e informacionit privat gjatë fazës hetimore të procedurave

Ka një sërë kontekstesh në të cilat autoritetet e Shtetit mund të përpiqen të mbledhin të dhëna personale, për shembull në kuadër të përpjekjeve për të luftuar krimin, dhe për të mbledhur prova për t'u përdorur në procedura prokuroriale dhe gjyqësore. Mbledhja e të dhënave personale në këto kontekste, në rrethana të caktuara, mund të përbëjë ndërhyrje tek e drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës, sipas Neni 8.

Kur tregohet se është angazhuar Neni 8, mbledhja e të dhënave në këtë kontekst përbën shkelje të Neni 8 nëqoftëse Shteti nuk arrin të dëshmojë që mbledhja dhe ruajtja e të dhënave: (i) synon një qëllim legjitim; dhe (ii) është mjet proporcional për arritjen e një qëllimi të tillë. Ekzistenca dhe zbatimi efektiv i garancive të përshtatshme kundër abuzimit të fuqive për mbledhjen e të dhënave është një prej aspekteve thelbësore që tregon se vëzhgimi dhe mbledhja e të dhënave në këtë kontekst zhvillohet vetëm deri në shkallën e nevojshme për synimin e qëllimit legjitim. Secili prej këtyre faktorëve diskutohet me hollësi poshtë.

### a) Masat Hetimore Speciale

#### Çfarë përbën ndërhyrje tek Neni 8?

Ka një sërë faktorësh relevantë që përcaktojnë nëse privatësia e një personi është prekur nga masat e vëzhgimit dhe hetimit të zbatuara në vende publike ose mbi komunikimet publike. Në disa rrethana, njerëzit me dijeni ose me qëllim përfshihen në aktivitete të cilat incizohen ose mund të incizohen apo të raportohen publikisht, për shembull kur hyjnë në një zonë të mbuluar me kamera CCTV të cilat mbikëqyren nga një roje sigurie. Prandaj, ka rëndësi të shqyrtohet shkalla deri

ku një person mund të presë që privatësia e tij/saj të mbrohet në çdo skenar të mundshëm, për të përcaktuar nëse angazhohet Neni 8.<sup>[79]</sup>

Poshtë jepen disa shembuj të masave që përbëjnë ndërhyrje tek Neni 8:

### **i) Ruajtja e të dhënave personale**

---

Ruajtja e të dhënave personale në lidhje me jetën private të një individi përbën ndërhyrje brenda kuptimit të Nenit 8.<sup>[80]</sup> Kjo aplikohet edhe kur materiali i ruajtur është në formë të koduar, i lexueshëm vetëm përmes teknologjisë kompjuterike dhe i mundshëm për t'u interpretuar vetëm nga një numër i kufizuar personash.<sup>[81]</sup>

### **ii) Bastisja dhe Konfiskimi i të Dhënave Personale dhe Korrespondencës**

---

Bastisja e shtëpisë së një individi, si dhe kontrolli dhe konfiskimi i pajisjeve elektronike personale të tij/saj, dosjeve personale dhe korrespondencës, angazhojnë të drejtën për jetë private dhe familjare, shtëpi dhe korrespondencë sipas Nenit 8<sup>[82]</sup>. Koncepti i "shtëpisë" sipas Nenit 8 nuk është i kufizuar brenda shtëpisë private të një individi dhe gjithashtu përfshin zyrën e regjistruar të një kompanie ose ambiente të tjera biznesi. Prandaj, bastisja e zyrave të një kompanie<sup>[83]</sup>, kontrolli dhe konfiskimi i dosjeve elektronike ose fizike të një kompanie, ose imponimi i një urdhri mbi kompaninë që ajo të ofrojë qasje dhe t'u lejojë autoriteteve të bëjnë

---

[79] *Herbecq dhe Association "Ligue des droits de l'homme" k. Belgjikës*, nr. 32200/96 dhe 32201/96, vendim i Komisionit i 14 janarit 1998, Vendime dhe Raporte (DR) 92-B, fq. 92 ku shënohen të dhënat vizuale të mbledhura; *Perry k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 17 korrikut 2003, Nr. 63737/00 tek §37. Nga ana tjetër, krijimi i një regjistri sistematik ose permanent të këtyre materialeve publike mund t'i japë shkas konsideratave të aspektit të privatësisë. (*P.G. dhe J.H. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 25 shtatorit 2001, Nr. 44787/98, §57; *Peck k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 28 janarit 2003, Nr. 44647/98 tek §§58-59; dhe *Perry k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 17 korrikut 2003, Nr. 63737/00 tek §38.)

[80] *Leander k. Suedisë*, vendim i 26 marsit 1987, Nr. 9248/81 tek §48.

[81] *Amann k. Zvicrës*, vendim i Dhomës së Madhe i 16 shkurtit 2000, Nr. 27798/9 tek §69; *S. dhe Harper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2008, Nr. 30562/04 dhe 30566/04 tek §67 dhe 75 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[82] *Trabajo Rueda k. Spanjës*, vendim i 30 majit 2017, Nr. 32600/12 tek §§44-47; *K.S. dhe M.S. k. Gjermanisë*, vendim i 6 qershorit 2016, Nr. 3369/11.

[83] *Société Colas Est dhe të tjerë k. Francës*, vendim i 16 prillit 2002, Nr. 37971/97 tek §§40-42 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

kopje të të gjitha të dhënave të përdorura në serverët e kompanisë<sup>[84]</sup>, angazhojnë të drejtën për respekt ndaj shtëpisë dhe korrespondencës sipas Neni 8.

### iii) Vëzhgimi Sekret

---

Ka metoda të shumta se si realizohet vëzhgimi sekret nga autoritetet shtetërore, të cilat mund të ndërhyjnë tek Neni 8. Këtu përfshihen:

- » **Përgjimet telefonike:** kur thirrjet e një personi interceptohen, monitorohen, zbardhen dhe/ose incizohen, duke zbuluar përmbajtjen e thirrjeve gjatë kohës që ndodhin.<sup>[85]</sup> Kjo përfshin situata ku linja telefonike e një pale të tretë është nën përgjim.<sup>[86]</sup>
- » **Matjet telefonike:** ku përfshihet zbulimi i numrave të thirrur, si dhe ora dhe kohëzgjatja e secilës thirrje telefonike.<sup>[87]</sup>
- » **Vëzhgimi me audio video:** i cili përfshin incizimin e një bisede duke përdorur pajisje të fshehta në trupin e një personi, incizimi i zërave në stacionin e policisë, video-vëzhgimi me kamera CCTV në stacionin e policisë, dhe instalimin e pajisjeve të dëgjimit në shtëpinë e një personi ose në ambiente private.<sup>[88]</sup>
- » **Vëzhgimi i gjeo-lokacionit:** kur përdoren pajisje GPS (p.sh. instalimi i pajisjes së GPS në makinë) për të ofruar informacione në kohë reale rreth lokacionit dhe lëvizjeve të një personi.<sup>[89]</sup>

---

[84] *Bernh Larsen Holding AS dhe të tjerë k. Norvegjisë*, vendim i 14 marsit 2013, Nr. 24117/08 ku urdhri u vlerësua se angazhonte të drejtat për respekt ndaj shtëpisë dhe korrespondencës së kompanive kërkuese.

[85] *Klass dhe të tjerë k. Gjermanisë*, vendim i 6 shtatorit 1978, Nr. 5029/71 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Malone k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 2 gushtit 1984, Nr. 8691/79 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[86] *Lambert k. Francës*, vendim i 24 gushtit 1998, Nr. 23618/94 tek §21.

[87] *Malone k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 2 gushtit 1984, Nr. 8691/79 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[88] *Bykov k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 marsit 2009, Nr. 4378/02 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Perry k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 17 korrikut 2003, Nr. 63737/00; *Heglas k. Republikës Çeke*, vendim i 1 marsit 2007, Nr. 5935/02 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[89] *Uzun k. Gjermanisë*, vendim i 2 shtatorit 2010, Nr. 35623/05.

---



#### iv) Interceptimi i Tërësishëm kundrejt Interceptimit të Shënjestruar

Interceptimi i tërësishëm i komunikimeve mund të dallohet nga interceptimi i shënjestruar i komunikimeve, si nga natyra e ndërhyrjes tek Neni 8, ashtu edhe nga mënyrat se si Shtetet duhet ta rregullojnë secilin lloj të ndërhyrjes.

Ndërkohë që interceptimi i shënjestruar i komunikimeve kryesisht përdoret për parandalimin e krimeve, interceptimi i tërësishëm shpesh përdoret nga shërbimet e inteligjencës së huaj për mbledhjen dhe identifikimin e kërcënimeve të reja, nga aktorë të njohur e të panjohur, të cilët mund të jenë duke vepruar përmes kufijve, për shembull ata që janë të përfshirë në terrorizëm global, trafikim të drogës, trafikim të qenieve njerëzore dhe sulme kibernetike.

Duke marrë parasysh qëllimin më të gjerë të interceptimit të tërësishëm, argumentohet se sekretësia e ekzistencës dhe veprimit të tij është çelësi i suksesit të tij. Megjithatë, në këtë epokë gjithnjë e më shumë dixhitale, shumica dërrmuese e komunikimeve janë në formë dixhitale dhe transportohen përmes rrjeteve globale të telekomunikimeve pa asnjë lidhje domethënëse me kufijtë kombëtarë. Kjo do të thotë se masat e vëzhgimit të tërësishëm potencialisht kanë shtrirje jashtëzakonisht të gjerë si brenda ashtu edhe jashtë Shtetit që zhvillon vëzhgimin. Ndërkohë që vihet theksi tek nevoja për sekretësi për t'i mundësuar interceptimit të tërësishëm që të identifikojë kërcënime më të gjera, hapësira e fushëveprimit të tij gjithashtu mund ta bëjë atë më intruziv sesa interceptimi i shënjestruar, duke kërkuar mbrojtje më të mëdha rreth përdorimit të tij.

Gjykata e përkufizon interceptimin e tërësishëm si proces gradual, ku shkalla e ndërhyrjes tek Neni 8 intensifikohet teksa procesi përparon. Ajo e ndan procesin në katër fazat e mëposhtme:<sup>[90]</sup>

- i) Përgjimi dhe ruajtja fillestare e komunikimeve dhe të dhënave lidhur me komunikimet (pra, trafiku i të dhënave të komunikimeve të përgjuara).<sup>[91]</sup>

[90] *Centrum för rättvisa k. Suedisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 25 majit 2021, Nr. 35252/08 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[91] Të dhënat përmbajtëse janë të rrethuara nga copëza të shumta të dhënash të komunikimit. Ndërkohë që të dhënat e përmbajtjes mund të jenë të enkriptuara dhe mund të mos zbulojnë ndonjë gjë me rëndësi rreth dërguesit ose marrësit, të dhënat e ndërlidhura të komunikimeve mund të zbulojnë shumë rreth informatave personale, si identitetet dhe lokacionet gjeografike të dërguesit dhe marrësit dhe pajisjet përmes të cilave janë transmetuar komunikimet. Të dhënat e komunikimeve të ndërlidhura të tërësishme mund të analizohen dhe pyeten për të

- Në këtë fazë, përgjohen komunikimet e një numri më të madh të njerëzve, shumë prej të cilëve nuk do të jenë me interes në aspektin e shërbimit të inteligjencës dhe të cilët do të filtrohen jashtë sistemit.
- ii) Përdorimi i kërkimeve fillestare, kryesisht të automatizuara, përmes selektorëve specifikë për të filluar shënjestrimin e individëve duke përdorur të dhënat e ruajtura të komunikimeve.
  - iii) Ekzaminimi i komunikimeve të selektuara / të dhënave të ndërlidhura të komunikimeve nga analistët.
  - iv) Ruajtja vijuese e të dhënave dhe përdorimi i "produktit final", përfshirë ndarjen e të dhënave me palë të treta si janë shërbimet sekrete të huaja. Kjo është hera e parë që materiali i interceptuar faktikisht përdoret nga shërbimet sekrete.

Secila nga katër fazat e mësipërme të interceptimit të tërësishëm përbën ndërhyrje tek Neni 8.<sup>[92]</sup>

#### **v) Infiltrimi i Komunikimeve të Koduara (enkriptuara)**

Ndërkohë që teknologjia e përdorur nga autoritetet shtetërore vazhdon të zhvillohet, po kështu zhvillohen edhe softuerët e komunikimeve dhe pajisjet e përdorura nga qytetarët. EncroChat, Sky ECC dhe Exclu janë tri kompani të cilat kanë dizajnuar mjete komunikimi me qëllimin specifik të mbrojtjes së komunikimeve private nga përgjimi. Megjithatë, të tre sistemet janë interceptuar dhe çmontuar nga agjencitë ligjzbatuese. Të dhënat e marra nga sistemet janë përdorur për të informuar hetimet penale në shumë juridiksione, për t'i dhënë fund krimit të organizuar, dhe për të ndërmarrë veprime për parandalimin e veprimeve të ardhshme kriminale. Sipas agjencive ligjzbatuese, të dhënat e marra kanë çuar në qindra arrestime dhe konfiskime të shumta të pasurive kriminale. Duke njohur këtë potencial për përfitim të informacioneve të gjera për operimin e krimeve të rënda dhe krimit të organizuar, Zyra Federale e SHBA-ve për Hetime (FBI) ka shpërndarë teknologjinë e saj që supozohet të jetë e sigurt për mesazhe, ANOM, me qëllim që të monitorojë komunikimet e personave të përfshirë në aktivitete kriminale.

---

përfuar një pamje intime të një personi përmes hartëzimit të rrjeteve sociale, gjurmimit të lokacionit, gjurmimit të historisë së përdorimit të internetit, hartëzimit të modeleve të komunikimit, dhe një pamje të thelluar tek ato me të cilët personi ka ndërvepruar (*Centrum för rättvisa k. Suedisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 25 majit 2021, Nr. 35252/08 tek §256 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim)).

[92] *Centrum för rättvisa k. Suedisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 25 majit 2021, Nr. 35252/08 tek §§239–244 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

### **Softueri i Koduar i Komunikimeve: Si funksionon?**

**EncroChat:** Pajisjet e EncroChat janë celularë të modifikuar (të cilëve u është hequr kamera, GPS, dhe porti USB, dhe është shtuar një opsion për fshirjen e shpejtë të përmbajtjes së telefonit) që mund të përdoren vetëm për të komunikuar me pajisje të tjera EncroChat. Softueri EncroChat i kodon ose enkripton mesazhet pasi dërgohen, meqenëse ato kalojnë nëpër serverin qendror të EncroChat i cili ndodhet në Francë. Më pas, mesazhet dekodohen përmes softuerit në pajisjen marrëse dhe kështu, në teori, janë të lexueshme vetëm nga marrësi i synuar.

**Sky ECC:** Shumë ish-përdorues të EncroChat kaluan tek platforma Sky ECC, pasi EncroChat u çmontua në vitin 2020. Sky ECC solli telefona që ofronin vetëshkatërrimin dhe kodimin e mesazheve dhe nuk i ruanin mesazhet e koduara në serverët e tyre, pra nëqoftëse mesazhi nuk lexohej brenda 48 orësh, ai nuk mund të lexohej më.

**ANOM:** ANOM është kompani e pajisjeve të koduara e krijuar nga FBI. Ajo u shpërnda mes grupeve kriminale që shisnin dhe promovonin teknologjinë në botë. Një kopje e çdo mesazhi të dërguar nga një pajisje ANOM përcillet tek një server në një vend-palë e tretë ku mesazhet mblidheshin, ruheshin dhe i dërgoheshin FBI-së rregullisht mbi bazën e një marrëveshjeje ndërkombëtare bashkëpunimi. ANOM, ndryshe nga EncroChat dhe Sky ECC, u shfrytëzua nga FBI që prej fillimit. Mbledhja e të dhënave nga ANOM nuk qe infiltrim i një kompanie ekzistuese të komunikimeve të koduara.

Një sërë metodash u përdorën për të marrë dhe interceptuar të dhënat nga ky softuer i komunikimeve të koduara. Agjencitë ligjzbatuese të përfshira në interceptimin e këtyre komunikimeve të koduara interceptuan, ndanë dhe analizuan miliona mesazhe. Për shembull, në lidhje me EncroChat, policia franceze mbolli softuer malinj në të gjitha pajisjet e EncroChat i cili kapë të dhëna që nuk ishin fshirë dhe të gjitha mesazhet që u shkruan prej atij momenti e tutje. Ata arritën të lexonin mesazhet në kohë reale.

Një pjesë e madhe e njerëzve që dërgonin mesazhet e interceptuara ndodheshin jashtë vendeve agjencitë e të cilave po zhvillonin interceptimin në kohë reale.<sup>[93]</sup> Kështu, të dhënat e korrura gjithashtu u ndanë me hetuesit në shumë juridiksione të tjera.<sup>[94]</sup> Kjo ngre dy ndërhyrje potenciale tek Neni 8: (i) në lidhje me mbledhjen e të dhënave; dhe (ii) në lidhje me transferimin e të dhënave nga një juridiksion tek tjetri. Duke ditur shtrirjen e përkufizimit të të dhënave personale (përshkruar lart), dhe gamën e gjerë të veprimeve që deri tani janë vlerësuar se përbëjnë ndërhyrje tek Neni 8 në këtë kontekst (po ashtu përshkruar lart), duket se ka gjasa që të dy veprimet do të vlerësohet se përbëjnë ndërhyrje tek Neni 8.

## **Statusi i Viktimës**

### **i) Demonstrimi i statusit të viktimës**

Sipas Nenit 34 të KEDNJ-së, kërkuesi duhet të tregojë se ai/ajo ka qenë "viktimë" e shkeljes së të drejtave të tij/saj në mënyrë që të mund të ngrejë pretendim në GjEDNJ. Kjo dispozitë është interpretuar të nënkuptojë se Konventa nuk lejon që kërkuesit të ngrenë pretendime *in abstracto*. Përkundrazi, kërkuesit përgjithësisht duhet të tregojnë se si ata/o janë prekur direkt nga masa e ankimuar.

Megjithatë, ky test aplikohet me një shkallë fleksibiliteti në kontekstin e vëzhgimit sekret, duke marrë parasysh tiparet e veçanta të masave të vëzhgimit sekret. Vetë nga natyra e tyre, ekzistenca dhe zbatimi i masave të vëzhgimit sekret mund të mbeten të panjohura për personat e prekur prej tyre.<sup>[95]</sup> Prandaj, një aplikim i rreptë i testit të statusit të "viktimës" në këtë kontekst do të çonte në një situatë ku masat e vëzhgimit të fshehtë mund të bëhen efektive të pasfidueshme, duke nulifikuar kështu mbrojtjet e Nenit 8, ku një person mund të trajtohet në kundërshtim me Nenin 8 pa e marrë vesh kurrë. Një qasje më fleksibile ndaj testit të "viktimës" në këtë kontekst është

---

[93] Agjencia e BE-së për Bashkëpunim në Drejtësinë Penale, "Ndërhyrje të reja të mëdha për të bllokuar komunikimet e enkriptuara në rrjetet kriminale" (2021) gjendet tek <https://t.ly/ZTUzn>.

[94] Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Mali i Zi dhe Sllovenia, kanë arrestuar dhe akuzuar gati 100 persona si rezultat i provave të marra nga komunikimet në Sky ECC: shih Ivana Jeremic dhe të tjerë, "Encrypted Phone Crack No Silver Bullet against Balkan Crime Gangs" (*Balkan Insight*, 25 prill 2022) gjendet tek <https://t.ly/SCBvp>; dhe Europol, "Balkans' biggest drug lords arrested after investigation into encrypted phones" (12 maj 2023) gjendet tek <https://t.ly/liDtO>.

[95] Shih *Klass dhe të tjerë k. Gjermanisë*, vendim i 6 shtatorit 1978, Nr. 5029/71 tek §§34-36 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

e rëndësishme për të siguruar që masa të tilla mbeten nën mbikëqyrjen dhe analizën e gjykatave.

Kështu, në rrethana të caktuara, kërkuesi mund të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje të të drejtave të tij nga Neni 8 thjesht si pasojë e ekzistencës së masave të vëzhgimit të fshehtë, ose për shkak të legjislacionit që lejon masat e vëzhgimit të fshehtë. Në rastet e lidhura me këto masa, Gjykata ka dalë me përfundimin që *"...secilit prej kërkuesve u takon të "(pretendojnë) se është viktimë e një shkeljeje" të Konventës, edhe pse ai nuk është në gjendje të pretendojë në mbështetje të kërkesës së tij që ai ka qenë objekt i një mase konkrete të vëzhgimit sekret. Çështja nëse kërkuesi ka qenë faktikisht viktimë e ndonjë shkeljeje të Konventës përfshin përcaktimin nëse legjislacioni i kontestuar është në vetvete i krahasueshëm me dispozitat e Konventës."*<sup>[96]</sup>

Faktorët e mëposhtëm janë relevantë për të përcaktuar nëse një kërkues mund të pretendojë statusin e viktimës:

» **Mundësia e shfrytëzimit dhe efikasiteti i zgjidhjeve në shkallë vendi:** këtu mund të dallohen dy skenare kyçe:

- ii) Kur sistemi kombëtar nuk ofron zgjidhje efektive për një person i cili dyshon se i është nënshtruar vëzhgimit sekret, kjo mund t'i japë shkas dyshimit dhe shqetësimit të gjerë mes publikut që fuqitë e vëzhgimit janë duke u abuzuar. Në këto rrethana, kërcënimi i vetë vëzhgimit mund të kufizojë komunikimin e lirë dhe të ndërhyjë tek të drejtat e Nenit 8 të të gjithë përdoruesve potencialë të shërbimeve të komunikimit. Një individ në këtë situatë nuk do të kishte nevojë të demonstronte ekzistencën e rrezikut që masat e vëzhgimit sekret i janë aplikuar atij.
- iii) Kur sistemi kombëtar ofron zgjidhje efektive për ata që dyshojnë se i janë nënshtruar vëzhgimit sekret, një dyshim më i gjerë i abuzimit të fuqisë është më i vështirë për t'u justifikuar. Një individ në këtë situatë do të duhej të tregonte se, për shkak të situatës personale, ai është potencialisht i rrezikuar që të jetë objekt i masave të vëzhgimit sekret (shih poshtë).

---

[96] *Klass dhe të tjerë k. Gjermanisë*, vendim i 6 shtatorit 1978, Nr. 5029/71 tek §38 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

» **Fushëveprimi i legjislacionit që lejon masat e vëzhgimit sekret:**

një individ mund të tregojë se ai është në rrezik t'i nënshtrohet masave të vëzhgimit sekret në situatat e mëposhtme:

- i) Personi i përket një grupi njerëzish të vënë në shënjestër nga legjislacioni; ose
- ii) Legjislacioni ngre një sistem ku çdo përdorues i komunikimeve të sistemit të komunikimeve mund të përgjohet.
- iii) A kanë entitetet ligjore të drejtë për mbrojtjen e të dhënave?

Rregullat e BE-së për mbrojtjen e të dhënave (sipas CFR dhe GDPR) u aplikohen vetëm të dhënave personale të individëve ose "personave natyralë", ato nuk qeverisin të dhënat e kompanive apo entiteteve të tjera ligjore. Megjithatë, informacionet lidhur me kompanitë një-personëshe mund të përbëjnë të dhëna personale kur kjo lejon identifikimin e një personi natyral.<sup>[97]</sup>

Ngjashëm, sipas KEDNj-së, entitetet ligjore nuk kanë të drejtën për respektim të jetës së tyre private, *per se*. Megjithatë, entitetet ligjore, përfshirë kompanitë, firmat ligjore, organizatat joqeveritare etj., kanë të drejtë të mbështeten tek Neni 8 në këtë kontekst kur ato preken nga një masë e cila shkel të drejtën e tyre për respektim të "korrespondencës" ose "shtëpisë" sipas Nenit 8. Koncepti i "shtëpisë" sipas Nenit 8 përfshin zyrën e regjistruar të një kompanie ose ambiente të tjera biznesi (shih lart).<sup>[98]</sup> Prandaj, bastisja e ambienteve të zyrës së një kompanie, kontrolli dhe konfiskimi i të dhënave elektronike ose dosjeve të kompanisë, ose imponimi i një urdhri mbi një kompani që ajo të ofrojë qasje dhe të lejojë autoritetet të bëjnë kopje të të gjitha të dhënave të përdorura në serverët e kompanisë<sup>[99]</sup> angazhojnë të drejtën për respektim të shtëpisë dhe korrespondencës sipas Nenit 8. Ngjashëm, vëzhgimi dhe interceptimi i komunikimeve me telefon, email dhe faks mes stafit të entiteteve ligjore mund të ndërhyjë tek të drejtat e atyre entiteteve për respektim të korrespondencës.<sup>[100]</sup>

---

[97] *Camera di Commercio, Industria, Artigianato e Agricoltura di Lecce k. Salvatore Manni* C-398/15, GjDBE vendim i 9 marsit 2017.

[98] *Société Colas Est dhe të tjerë k. Francës*, vendim i 16 prillit 2022, Nr. 37971/97 tek §§40-42 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[99] *Bernh Larsen Holding AS dhe të tjerë k. Norvegjisë*, vendim i 14 marsit 2013, Nr. 24117/08.

[100] *Liberty dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 1 Korrikut 2008, Nr. 58243/00.

Më tej, si Neni 8 i KEDNj-së ashtu edhe rregullat e BE-së për mbrojtjen e të dhënave u aplikohen të gjitha të dhënave personale të lidhura me persona natyralë gjatë aktiviteteve profesionale, siç janë punonjësit e një kompanie ose organizate, përfshirë emaili i tyre i biznesit ose numrat e telefonit të biznesit të punëdhënësve të tyre.

### **Në përputhje me ligjin**

Kriteri që çdo masë që ndërhyt tek Neni 8 të jetë "në përputhje me ligjin" do të thotë se masa: (i) duhet të ketë bazë në të drejtën vendase; dhe (ii) duhet të jetë në pajtueshmëri me shtetin e së drejtës. Kjo përgjithësisht nënkupton se ligji që rregullon një masë e cila ndërhyt tek të drejtat e Nenit 8 duhet të jetë në dispozicion të personit në fjalë dhe të shfrytëzohet me qartësi të mjaftueshme në mënyrë që efektet e tij të jenë të parashikueshme.<sup>[101]</sup>

Megjithatë, ky kriter i "parashikueshmërisë" duhet të interpretohet paksa ndryshe në kontekstin specifik të masave të vëzhgimit të fshehtë. Për shkak të nevojës për sekretësi rreth urdhrat dhe vënies së masave të tilla, parashikueshmëria në këtë kontekst nuk do të thotë se individët duhet të jenë në gjendje të parashikojnë se kur autoritetet me gjasë do ta përdorin këtë masë, në mënyrë që t'ia përshtasin sjelljen e tyre përkatësisht.

Përkundrazi, në këtë kontekst, parashikueshmëria nënkupton që Shtetet duhet të kenë rregulla të qarta e të detajuara në lidhje me përdorimin e masave të vëzhgimit sekret, të cilat u ofrojnë qytetarëve së paku një tregues të rrethanave dhe kushteve në të cilat autoritetet publike kanë fuqinë të përdorin masa të tilla.<sup>[102]</sup> Ligji që autorizon përdorimin e këtyre masave duhet të tregojë fushëveprimin e çdo diskrecioni dhënë autoriteteve dhe mënyrën e ushtrimit të tij.<sup>[103]</sup>

Në këtë kontekst, testi i "përputhshmërisë me ligjin" është ngusht i lidhur me testin e "nevojshmërisë" (përkthuar poshtë). Baza ligjore për masat dhe regjimin ligjor që qeveris përdorimin e tyre duhet të jetë e mjaftueshme për të

---

[101] *Roman Zakharov k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2015, Nr. 47143/06 tek §228 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[102] *Roman Zakharov k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2015, Nr. 47143/06 tek §229 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[103] *Roman Zakharov k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2015, Nr. 47143/06 tek §230 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

ofruar mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive kundër abuzimit dhe të sigurojë që masat e vëzhgimit të përdoren vetëm kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike.<sup>[104]</sup>

### **Ndjekja e një synimi legjitim**

Neni 8(2) parashikon:

*“Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”*

Kështu, mekanizmat e kërkimit, marrjes dhe ruajtjes së të dhënave dhe vëzhgimit të diskutuara në seksionin (a) lart nuk shkelin Nenin 8, nëqoftëse janë mënyra të nevojshme dhe proporcionale për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, sigurisë publike, ose për parandalimin e trazirave dhe krimit. Për shembull, Gjykata ka gjetur se Neni 8 nuk ndalon përdorimin e interceptimit të tërësishëm për të mbrojtur sigurinë kombëtare dhe interesat të tjera thelbësore kombëtare kundër kërcënimeve serioze të jashtme.<sup>[105]</sup> Ngjashëm, në shumë raste, ajo ka theksuar se Shtetet mund ta konsiderojnë të nevojshëm rekursin në bastisje dhe konfiskime për të mbledhur prova fizike të veprave.<sup>[106]</sup>

### **Nevojshmëria**

Në përgjithësi, Shteteve u lejohet një hapësirë e gjerë vlerësimi për të përcaktuar mënyrën më të mirë për të arritur qëllimin e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, përfshirë çështjen se cili lloj regjimi për vëzhgim ose interceptim të komunikimeve është i nevojshëm.<sup>[107]</sup>

---

[104] *Roman Zakharov k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2015, Nr. 47143/06 tek §36 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Centrum för rättvisa k. Suedisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 25 majit 2021, Nr. 35252/08 tek §248 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[105] *Centrum för rättvisa k. Suedisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 25 majit 2021, Nr. 35252/08 tek §261 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[106] *Vasylchuk k. Ukraine*, vendim i 13 qershorit 2013, Nr. 24402/07 tek §79; *K.S. dhe M.S. k. Gjermanisë*, vendim i 6 tetorit 2016, Nr. 33696/11 tek §43.

[107] *Weber dhe Saravia k. Gjermanisë (dec.)*, vendim i 29 qershorit 2006, Nr. 54934/00 tek §106; *Centrum för rättvisa*



Megjithatë, duke njohur rrezikun serioz të abuzimit të pushtetit dhe potencialisht ndërhyrjeve të gjera tek të drejtat e Nenit 8 që mund të dalin nga masat e bastisjes, konfiskimit dhe vëzhgimit, Shtetet duhet të jenë në gjendje të tregojnë se kanë zbatuar garanci të mjaftueshme dhe efektive kundër abuzimit. Çdo ndërhyrje tek të drejtat e Nenit 8 duhet të bëhet vetëm deri në atë shkallë që është “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

Gjatë përcaktimit nëse një ndërhyrje është e nevojshme në një shoqëri demokratike, duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat e një çështjeje. Në mënyrë të veçantë, faktorët e mëposhtëm janë me rëndësi:

- » Peshë e veprës së hetuar dhe urgjenca me të cilën duhen ndërmarrë veprime për ta hetuar atë.
- » Natyra, fushëveprimi dhe kohëzgjatja e masave.
- » Mundësitë për burime të tjera provash.
- » Natyra dhe fushëveprimi i bazave të kërkuara para urdhërimit të masave të tilla.
- » Natyra e autoriteteve dhe sistemeve të ngritura për të autorizuar dhe zbatuar masat.
- » Mekanizmat kontrolluese të ngritura për të mbikëqyrur urdhërimin dhe zbatimin e këtyre masave.
- » Ekzistenca dhe efikasiteti i zgjidhjeve për ata që kanë qenë ose dyshojnë se kanë qenë objekt i masave të tilla.

Varësisht nga natyra, fushëveprimi dhe kohëzgjatja e masave të vëzhgimit, mund të kërkojnë mbrojtje të ndryshme. Për shembull, një bastisje e gjerë ose jo-diskriminuese ka më pak gjasa të jetë e justifikuar sesa një masë e shënjestruar, sidomos kur përdoret për të hetuar një vepër kundërvajtëse ose kur zhvillohet në lidhje me një palë të tretë, e jo të akuzuarin.<sup>[108]</sup>

Sa u përket masave të vëzhgimit, ka dy faktorë kyç që përdoren për të vlerësuar nëse një ndërhyrje është e nevojshme në një shoqëri demokratike: (i) cilësia e regjimit ligjor që autorizon dhe rregullon përdorimin e këtyre masave; dhe (ii) mundësinë dhe efikasitetin e mekanizmave të pavarura të shqyrtimit.

---

*k. Suedisë, vendim i Dhomës së Madhe i 25 majit 2021, Nr. 35252/08 tek §261 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).*

[108] *Buck k. Gjermanisë, vendim i 28 prillit 2005, Nr. 41604/98 tek §§30-53.*

## **i) Regjimi ligjor që autorizon dhe rregullon përdorimin e masave të vëzhgimit të shënjestruar**

---

Siç u përshkrua më lart, regjimi ligjor që autorizon dhe qeveris përdorimin e masave të vëzhgimit sekret duhet të sigurojë që këto masa vihen në punë vetëm kur është "e nevojshme në një shoqëri demokratike".

Minimalisht, për të vepruar si mbrojtje efektive kundër abuzimit të pushtetit, ligjet që rregullojnë përdorimin e fuqive të vëzhgimit sekret duhet të përcaktojnë dhe të ofrojnë qartësi në lidhje me faktorët e mëposhtëm:

- i) natyrën e veprave të cilat mund t'i japin shkas një urdhri për interceptim;
- ii) një përkufizim të kategorive të njerëzve komunikimet e të cilëve kanë gjasa të interceptohen;
- iii) një kufi për kohëzgjatjen e interceptimit;
- iv) procedura që duhet ndjekur për ekzaminimin, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave të përfutuara;
- v) masat parapake që duhen marrë gjatë komunikimit të të dhënave tek palët e tjera; dhe
- vi) rrethanat në të cilat të dhënat e interceptuara mund ose duhet të fshihen ose të shkatërrohen.

Këto kritere aplikohen kur masat e vëzhgimit të shënjestruar përdoren në hetime penale, si dhe kur masat e shënjestruara përdoren për arsye të sigurisë kombëtare.<sup>[109]</sup>

## **ii) Mbikëqyrja dhe shqyrtimi i masave të vëzhgimit të shënjestruar**

---

Mekanizmat e shqyrtimit dhe mbikëqyrjes duhet të zbatohen sipas tri fazave të mëposhtme të vëzhgimit sekret:

- i) Kur vëzhgimi urdhërohet në fillim;
- ii) Gjatë kohës që vëzhgimi është duke u zhvilluar; dhe
- iii) Pasi vëzhgimi ka përfunduar.

Për t'i mbajtur masat e vëzhgimit sekrete, fazat (i) dhe (ii) lart duhet të zhvillohen pa njohurinë ose përfshirjen e individit që është objekt i masës. Prandaj,

---

[109] *Roman Zakharov k. Russia*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2015, Nr. 47143/06 tek §231.

është thelbësore që të zbatohet një procedurë përmes së cilës kontrolli mbikëqyrës i urdhërimit dhe zbatimit të vëzhgimit sekret ushtrohet nga një autoritet i pavarur dhe i paanshëm. Ideale do të ishte që të ketë një gjyqtar për të ofruar garancitë më të mira të pavarësisë, paanshmërisë dhe procedurës së duhur.<sup>[110]</sup>

Ekzistenca e një procedure për të njoftuar një person për masën e marrë, pasi ka përfunduar vëzhgimi, është faktor kyç për të përcaktuar efikasitetin e masave të shqyrtimit në fazën (iii). Personi duhet të informohet për masat e marra për t'i mundësuar atij që të kontestojë ligjshmërinë e tyre në retrospektivë. Nëqoftëse Shteti nuk ka një procedurë lajmërimi, së paku duhet të ketë një sistem për t'i mundësuar personit që të ngrejë pretendim para gjykatave vendase nëse ai thjesht dyshon se ka qenë objekt vëzhgimi.

### iii) Masat e vëzhgimit të tërësishëm

---

Kur bëhet fjalë për ekzaminimin e masave të vëzhgimit të tërësishëm, ka konsiderata të tjera. Siç përshkruhet në seksionin 4(a)(iv) lart, interceptimi i tërësishëm i shërben një qëllimi tjetër dhe u jep Shteteve qasje në një gamë më të gjerë informacionesh, të cilat kanë të bëjnë me një gamë më të gjerë njerëzish.<sup>[111]</sup> Përdorimi i tij për mbledhjen e të dhënave të inteligjencës së huaj mund të mos ketë në shënjestër ndonjë individ të caktuar, por shpesh përdoret për të përfutur shtigje të reja kërkimi.

Ndërkohë që Neni 8 nuk ndalon operimin e sistemeve të interceptimit të tërësishëm për të mbrojtur sigurinë kombëtare dhe interesa të tjera thelbësore të kombit, hapësira e vlerësimit e Shteteve është më e ngushtë në këtë kontekst, dhe nevoja për mbrojtje është më e madhe.<sup>[112]</sup> Përveç kësaj, fazat fillestare të interceptimit të tërësishëm shpesh përfshijnë përpunimin automatik të të dhënave dhe nevoja për mbrojtje shpesh është më e madhe kur të dhënat personale janë objekt i përpunimit automatik.<sup>[113]</sup> Mbrojtjet që zbatohen kundër abuzimeve në përdorimin e interceptimit të tërësishëm duhet të adaptohen duke marrë parasysh tiparet specifike të tij.

---

[110] *Roman Zakharov k. Russia*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2015, Nr. 47143/06 tek §233.

[111] Shih seksionin 4(a)(iv) të këtij publikimi dhe shënimin në fund të faqes 96 lart.

[112] *Centrum för rättvisa k. Suedisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 25 majit 2021, Nr. 35252/08 tek §261 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[113] *S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2008, Nr. 30562/04 dhe 30566/04 tek §103 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

## **Regjimi ligjor që autorizon dhe rregullon masat e interceptimit të tërësishëm**

Mbrojtjet minimale të aplikueshme në rastet e interceptimit të shënjestruar, të cilat kërkojnë një përkufizim të qartë të natyrës së veprave dhe kategorive të njerëzve që kanë gjasa t'u përgjohen komunikimet, nuk mund të zbatohen menjëherë në kontekstin e interceptimit të tërësishëm.

Prandaj, është thelbësore që Shtetet të zbatojnë ligje vendase që specifikisht rregullojnë përdorimin e masave të interceptimit të tërësishëm. Këto rregulla duhet të definojnë qartë:

- i) bazat mbi të cilat mund të autorizohet interceptimi i tërësishëm;
- ii) rrethanat në të cilat mund të përgjohen komunikimet e një personi;
- iii) procedura që duhet ndjekur për dhënien e autorizimit;
- iv) procedura që duhet ndjekur për selektimin, ekzaminimin, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave të marra;
- v) masat parandaluese që duhen marrë kur të dhënat u komunikohen palëve të tjera;
- vi) kufijtë e kohëzgjatjes së përgjimit, ruajtja e materialeve të interceptuara dhe rrethanat në të cilat këto materiale duhen fshirë ose shkatërruar;
- vii) procedurat dhe modalitetet e mbikëqyrjes nga një autoritet i pavarur i pajtueshmërisë me mbrojtjet e mësipërme dhe fuqitë e tij për adresimin e papajtueshmërive; dhe
- viii) procedurat për shqyrtimin e pavarur *ex post facto* të kësaj pajtueshmërie dhe fuqive të mveshura organit kompetent gjatë adresimit të rasteve të papajtueshmërisë.

### **Mbikëqyrja dhe shqyrtimi i masave të interceptimit të tërësishëm**

Për arsye të sigurisë kombëtare, Shtetet shpesh nuk e kanë lirinë të zbulojnë informacione rreth operimit të një regjimi të interceptimeve të tërësishme (qoftë edhe në retrospektivë). Kjo e rrit mundësinë e abuzimit dhe amplifikon rëndësinë e mekanizmave efektive për mbikëqyrje dhe shqyrtim. Prandaj autorizimi dhe mbikëqyrja e proceseve janë mbrojtjet më domethënëse për pajtueshmërinë me Nenin 8.

Regjimet e interceptimit të tërësishëm duhet t'u nënshtrohen mbrojtjeve të plota si më poshtë:

- i) Autorizimi i pavarur që në fillim, ku vlerësohet nevojshmëria dhe proporcionaliteti i objektit dhe fushëveprimit të operacionit.
  - a) Autorizimi gjyqësor është i preferueshëm por jo i nevojshëm, për sa kohë që autorizimi bëhet nga një organ i pavarur.
  - b) Organi i pavarur autorizues duhet të informohet në lidhje me qëllimin e interceptimit dhe bartësit e kanaleve të komunikimit që do të interceptohen.
  - c) Nuk ka nevojë të përfshihen të gjithë "selektorët" që do të përdoren në kërkesën për autorizim, por ajo duhet së paku të identifikojë llojet e kategorive të selektorëve që do të përdoren.
- ii) Çdo fazë e procesit të interceptimit të tërësishëm – përfshirë autorizimin fillestar dhe çdo rinovim të mëtejshëm, selektimi i bartësve, zgjedhja dhe aplikimi i selektorëve dhe kushteve të kërkimit, si dhe përdorimi, ruajtja, transmetimi i mëtejshëm dhe fshirja e materialit të interceptuar gjithashtu duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes intensive nga një autoritet i pavarur për ta mbajtur "ndërhyrjen" deri aty ku është "e nevojshme në një shoqëri demokratike".
- iii) Duhet vendosur mbrojtje të shtuara kur shërbimet e inteligjencës fusin në punë selektorë të fuqishëm të lidhur me individë të identifikueshëm. Përdorimi i çdo selektori të tillë duhet të jetë i justifikuar – sa i përket parimeve të nevojshmërisë dhe proporcionalitetit.
- iv) Shërbimet e inteligjencës duhet të mbajnë regjistra të hollësishëm në secilën fazë të procesit për të lehtësuar mbikëqyrjen dhe shqyrtimin.
- v) Duhet të ngrihen mekanizmat për shqyrtimin *ex post facto*:
  - a) Duke pasur parasysh se kërkesa për njoftim me gjasë nuk zbatohet në këtë kontekst, duhet të ekzistojë një zgjidhje efektive për këdo që dyshon se komunikimet i janë përgjuar nga shërbimet e inteligjencës, për të kontestuar qoftë ligjshmërinë e interceptimit të dyshuar apo pajtueshmërinë e regjimit të interceptimit me Konventën.
  - b) Zgjidhja duhet të bëhet para një organi / autoriteti i cili është i pavarur nga ekzekutivi dhe ofron, me aq sa është e mundur, një proces të kontradiktorialitetit për të vlerësuar drejtësinë e tërësishme të regjimit dhe, kryesisht, nëse korniza ligjore vendase është në përputhje me tetë kriteret e cekura më lart.

## **Transferimi i materialit të interceptuar tek palët e treta**

Transmetimi i materialeve të interceptimit të tërësishëm nga një Shtet tek një Shtet tjetër ose tek një organizatë ndërkombëtare duhet të kufizohet me materialin që është mbledhur dhe ruajtur në pajtueshmëri me Konventën, dhe transferimi duhet t'i nënshtrohet mbrojtjeve shtesë:

- i) Rrethanat në të cilat transferimi mund të ndodhë duhen përcaktuar qartë në të drejtën vendase.
- ii) Shteti transferues duhet të sigurohet që Shteti pranues, gjatë punës me të dhënat, do të ketë të ngritura mbrojtje që mund të parandalojnë abuzimin dhe ndërhyrjen joproporcionale gjatë menaxhimit të të dhënave, për të garantuar ruajtjen e sigurt të tyre dhe për të kufizuar zbulimin e mëtejshëm.
- iii) Do të nevojiten mbrojtje të shtuara gjatë transferimit të materialeve që kërkojnë konfidencialitet special – siç janë materialet konfidenciale të gazetarisë.
- iv) Transferimi i materialeve tek partnerët e shërbimeve të huaja të inteligjencës duhet t'i nënshtrohet kontrollit të pavarur.

## **Aplikimi ndaj interceptimit të komunikimeve të koduara (enkriptuara)**

Nuk është ende e qartë nëse grumbullimi, ruajtja dhe transferimi i të dhënave të marra nga EncroChat, Anom dhe Sky ECC përbën shkelje të Nenit 8. Për shembull, në lidhje me EncroChat, ka gjasa të jetë relevante që gjyqësori francez i autorizoi masat përpara mbi bazën se ato ishin të nevojshme për të identifikuar dhe arrestuar përdoruesit e implikuar në aktivitete ilegale. Megjithatë, avokatët francezë e kanë kontestuar mungesën e limitit kohor të masës së interceptimit në këto urdhra të gjykatës, natyrën masive dhe pa dallim të masave të autorizuar, dhe faktin që masat e autorizuar shkojnë përtej veprimeve të cilat mund të justifikohen nga bazat ligjore të parashikuara për to.<sup>[114]</sup>

---

[114] Parlamenti Evropian, "Në një shikim: Rruga e EncroChat drejt gjykatave më të larta të Evropës", gjendet tek <https://t.ly/iineP>.

## b) Përdorimi i materialeve të përfthuara në shkelje të Nenit 8 në procedura gjyqësore

Ndërkohë që masat hetimore të diskutuara lart mund t'i japin shkas një shkeljeje të Nenit 8, individët e prekur nga këto masa po ashtu mund të tentojnë të kontestojnë përdorimin e tyre si prova në procedura gjyqësore, mbi bazën e shkeljes së të drejtës së tyre nga Neni 6 për proces të rregullt. Megjithatë, vetëm sepse provat janë përftuar në shkelje të Nenit 8 nuk do të thotë domosdoshmërisht që ato do të vlerësohen si të papranueshme në procedura gjyqësore, dhe përdorimi i tyre në procedura të tilla nuk i jep automatikisht shkas shkeljes së Nenit 6.

Neni 6 KEDNj garanton të drejtën për proces të rregullt gjyqësor, por ai nuk përcakton ndonjë rregull specifike për pranueshmërinë e provave. Hartimi i rregullave për pranueshmërinë e provave është kryesisht çështje e të drejtës vendase. Gjykata ka theksuar në mënyrë të përsëritur se nuk është roli i saj të përcaktojë, në parim, nëse lloje të caktuara provash janë ose jo të pranueshme.<sup>[115]</sup>

Këtu, pyetja kyçe gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë me Nenin 6 është nëse procedurat në tërësi janë të drejta, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat dhe si janë pranuar në procedurë. Prandaj pranimi i provave të marra në shkelje të Nenit 8 është një prej faktorëve të shumtë që duhen marrë parasysh gjatë përcaktimit nëse procedura është e drejtë. Në procedura penale, administrative<sup>[116]</sup> dhe civile,<sup>[117]</sup> provat e marra në shkelje të Nenit 8 mund të pranohen pa shkelur të drejtën për proces të rregullt sipas Nenit 6 pa komprometuar domosdoshmërisht drejtësinë e procedurës në tërësi. Për shembull, provat dhe informacionet e marra përmes përgjimit të telefonit,<sup>[118]</sup> ose përmes pajisjeve të fshehta dëgjuese dhe incizuese<sup>[119]</sup> në shkelje të Nenit 8, jo domosdoshmërisht shkelin Nenin 6 nëse përdoren si prova në një gjyq penal.

[115] *Khan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 12 majit 2000, Nr. 35394/97 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Allan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 5 nëntorit 2002, Nr. 48539/99; *Heglas k. Republikës Çeke*, vendim i 1 marsit 2007, Nr. 5935/02 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Dragojevic k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2015, Nr. 68955/11 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Bykov k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 marsit 2009, Nr. 4378/02 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[116] *Vukota-Bojic k. Zvicrës*, vendim i 18 tetorit 2016, Nr. 61838/10 tek §77.

[117] *Bărbulescu k. Romania*, vendim i Dhomës së Madhe i 5 shtatorit 2017, Nr. 61496/08 tek §§140-141.

[118] *Dragojevic k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2015, Nr. 68955/11 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[119] *Khan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 12 majit 2000, Nr. 35394/97 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

Kur vlerësohet nëse procedurat në tërësi janë ose jo të drejta (e rrjedhimisht nëse janë ose jo në pajtueshmëri me Nenin 6), është e nevojshme të merren parasysh faktorët e mëposhtëm:

- » Natyra e paligjshmërisë në fjalë dhe natyra e shkeljes së Nenit 8.
- » Nëse kërkuesit i është dhënë ose jo mundësia për të kontestuar autenticitetin e provave dhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre.
- » Nëse ka pasur ose jo procedura të drejta për kontestimin e pranueshmërisë së provave, e në mënyrë të veçantë, procedurë kontradiktorialet.
- » Shkalla deri ku kundërshtimet për pranueshmërinë e materialeve të tilla janë shqyrtuar dhe adresuar nga gjykatat, dhe shkalla deri ku gjykatat kanë marrë vendime të arsyetuara për lejimin e provave në gjyq.
- » Cilësia e provave, dhe shkalla deri ku rrethanat në të cilat ato janë përfutur hedh dyshime mbi besueshmërinë ose saktësinë e tyre.
- » Ekzistenca e mbrojtjeve për të garantuar ose vlerësuar besueshmërinë e provave. Për shembull, thirrja e ekspertëve të pavarur si dëshmitarë për të analizuar dhe shpjeguar provat dhe / ose paraqitja dhe pranimi i provave të pavarura dhe raporteve eksperte që analizojnë provat.<sup>[120]</sup>
- » Mundësia për prova të tjera dhe shkalla deri ku dënimi bazohet mbi gamën e burimeve të provave, p.sh. deklaratat e dëshmitarëve dhe provat e mbledhura gjatë bastisjes dhe konfiskimit, përveç provave të mbledhura përmes vëzhgimit të fshehtë.<sup>[121]</sup>
- » Shkalla deri ku i shërbehet një interesi të rëndësishëm publik duke pranuar prova të marra në shkelje të Nenit 8, për shembull nëse ato përdoren për të hetuar, dënuar dhe ndëshkuar një vepër të rëndë penale.<sup>[122]</sup>

Shkalla deri ku kërkohen prova të tjera mbështetëse varet nga forca dhe autenticiteti i provave të marra në mënyrë të paligjshme. Kur provat e marra në mënyrë të paligjshme janë shumë të forta, dhe nuk ka rrezik që janë të pabesueshme, nevoja për prova mbështetëse është më e dobët.<sup>[123]</sup>

---

[120] *Bykov k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 marsit 2009, Nr. 4378/02 tek §§37 dhe 103 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[121] *Dragojević k. Kroacisë*, vendim i 15 janarit 2015, Nr. 68955/11 tek §§133-134 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[122] *Heglas k. Republikës Çeke*, vendim i 1 marsit 2007, Nr. 5935/02 tek §§90-91 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[123] *Khan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 12 majit 2000, Nr. 35394/97 tek §§35 dhe 37 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); dhe *Allan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 5 nëntorit 2002, Nr. 48539/99 tek §43.



Megjithatë, ka rëndësi të shqyrtohet nëse provat e marra përmes vëzhgimit ose interceptimit ofrojnë qasje në biseda dhe informacione të cilat janë ofruar lirisht dhe spontanisht, apo nëse individit relevant është vënë nën presion apo është shtrënguar që të japë deklaratime apo pranime të caktuara. Kur prova të incizuara ose të interceptuara merren përmes presionit ose shtrëngimit, pranimi i tyre është shkelje e Nenit 6(1) nëse presioni i bërë ka prekur natyrën vullnetare të pranimit deri në masën ku do të shihej si i tillë që ka shkelur të drejtën e personit për të qëndruar në heshtje dhe privilegjin kundër vetinkriminimit.<sup>[124]</sup> Për shembull, kur natyra e një bisede të incizuar mund të shihej si ekuivalent funksional i marrjes në pyetje, por ka ndodhur pa asnjë prej mbrojtjeve që normalisht do të shoqëronin një intervistë formale me policinë, siç është kujdesi ose prania e mbështetësit ligjor.<sup>[125]</sup>

### **Pranueshmëria e komunikimeve të interceptuara të koduara (enkriptuara)**

Meqenëse provat e marra nga interceptimet në pajisjet e EncroChat, Sky ECC dhe ANOM tashmë janë përdorur për të hetuar dhe ndjekur penalisht mijëra njerëz në tërë Evropën, janë ngritur ankesa në lidhje me pranueshmërinë e këtyre materialeve si prova në gjyqe penale. As GjEDNJ e as GjDBE nuk janë përcaktuar ende në lidhje me impaktin e pranimit të provave të tilla tek e drejta për proces të rregullt sipas Nenit 6.<sup>[126]</sup> Megjithatë, parimet e mësipërme vazhdojnë të jenë relevante, dhe për çdo rast do të kërkohet një analizë e drejtësisë së tërësishme të procedurave për secilën çështje.

Në kontekstin specifik të provave të përfuara përmes EncroChat, Sky ECC, dhe ANOM, një prej faktorëve kyç që me gjasë është relevant është shkalla deri ku mbrojtja ka mundësi të kontestojë dhe ekzaminojë autenticitetin dhe

---

[124] *Bykov k. Rusisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 10 marsit 2009, Nr. 4378/02 tek §§100-102 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), i cili qëndron në kontrast me *Allan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 5 nëntorit 2002, Nr. 48539/99, ku u gjet shkelje e Nenit 6, me *Heglas k. Republikës Çeke*, vendim i 1 marsit 2007, Nr. 5935/02 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim), ku Neni 6 nuk u gjet se ishte shkelur.

[125] *Allan k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 5 nëntorit 2002, Nr. 48539/99 tek §§45-53.

[126] Gjykata Rajonale e Berlinit ka kërkuar një vendim paraprak nga GjDBE në lidhje me 14 pyetjet kritike lidhur me përdorimin e provave të marra nga EncroChat. Pyetjet e ngritura janë nëse autoritetet hetimore gjermane kanë shkelur Të Drejtën e BE-së kur i kanë marrë të dhënat, dhe nëse po, a nënkuptojnë këto shkelje të së drejtës së BE-së që të dhënat nuk mund të përdoren si prova në procedura penale. Shih: Kërkesë për vendim paraprak nga Landgericht Berlin (Gjermani) e bërë më 24 tetor 2022 — *Procedurat penale kundër M.N.* (Çështja C-670/22).

besueshmërinë e provave.<sup>[127]</sup> Interceptimi i pajisjeve të EncroChat, Sky ECC dhe ANOM mbështetet mbi teknologji inovative që tejkalon kufijtë. Efikasiteti i kësaj teknologjie për të ndihmuar në hetimin dhe luftimin e krimit pjesërisht mbështetet në ruajtjen e sekretësisë rreth mënyrës se si zhvillohet dhe përdoret, në mënyrë që të mos u mundësojë rrjeteve kriminale që të zhvillojnë mënyra për ta kundërluftuar këtë lloj interceptimi. Kështu, autoritetet shtetërore shpesh nuk duan të zbulojnë informacione të hollësishme teknike rreth mënyrës se si përftohen, analizohen, përpunohen dhe transferohen të dhënat.<sup>[128]</sup> Pa këto njohuri, mund të jetë thuajse e pamundur për të pandehurit që të kontestojnë autenticitetin dhe legjitimitetin e provave.<sup>[129]</sup> Kjo pavarësisht mundësisë që mund të ketë pasur defekte në teknologjinë e përdorur, gabime të bëra gjatë analizimit të të dhënave dhe rreziku që të dhënat e papërpunuara mund të manipulohen.<sup>[130]</sup>

Kur ka të dhëna të kufizuara për procesin e marrjes dhe analizimit të këtij lloj materiali të interceptuar, ka gjasa që ekzistenca e provave të tjera për të siguruar dënimin të jetë faktor kyç për të përcaktuar nëse procedura në tërësi është e drejtë. Për shembull, një i pandehur që fillimisht është identifikuar përmes

---

[127] Për shembull, Gjykata Supreme e Italisë vendosi që mesazhet e koduara të marra nga operacionet e policisë ndërkombëtare për të hyrë në një rrjet të dytë telefonik të përdorur nga grupe të organizuara kriminale nuk mund të përdoret në seancë parajgjyqësore nëqoftëse prokurorët nuk shpjegojnë se si janë përfutur provat. Gjykata e Kasacionit e Italisë gjeti se një i pandehur jo vetëm që duhet ta ketë mundësinë që të bëjë pyetje lidhur me përmbajtjen e mesazheve të policisë të marra nga rrjeti telefonik Sky ECC, por gjithashtu edhe për të pyetur se si është zhvilluar procesi i hetimeve: Parlamenti Evropian, "Në një shikim: Rruga e EncroChat drejt gjykatave më të larta të Evropës", gjendet tek <https://t.ly/iineP>.

[128] Për shembull, Xhandarmëria Franceze nuk ka dashur të zbulojë detajet teknike të hetimeve EncroChat: Parlamenti Evropian, "Në një shikim: Rruga e EncroChat drejt gjykatave më të larta të Evropës", gjendet tek <https://t.ly/iineP>.

[129] Në dy letra të hapura, më shumë se 100 avokatë mbrojtës hollandezë dhe 22 avokatë evropianë që praktikojnë të drejtën penale, respektivisht, shumë prej tyre të lidhur direkt me mbrojtjen e përdoruesve të EncroChat, kritikuan faktin se të pandehurit përballen me gjyqe të padrejta sepse prokurorët refuzojnë të tregojnë informata rreth operacioneve të hyrjes në telefona: Bill Goodwin, "Avokatët holandezë ngrënë shqetësime njerëzore lidhur me të dhënat telefonike të ndërhyra në kriptofonë" (*ComputerWeekly.com*, tetor 2022) gjendet tek <https://t.ly/UOGVi> dhe Gjyqe të Drejta, "Ndërhyrja në EncroChat: Gjyqe të Drejta denoncon mungesën e transparencës dhe mbikëqyrjes" (shkurt 2022) gjendet tek <https://t.ly/n1BYX>.

[130] Ivana Jeremic dhe të tjerë, "Thyerja Enkriptike e Telefonave nuk Është Plumb Argjendi kundër Bandave Kriminale të Ballkanit" (*Balkan Insight*, 25 prill 2022) gjendet tek <https://t.ly/SCBvp> – ku Prof. Dennis-Kenji Kipker, anëtar bordi i Akademisë Evropiane për Lirinë e Informacionit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, EAID, deklaroi: "Kur të dhënat e papërpunuara, të dhëna dixhitale, përdoren, ato mund të ndryshohen, ku autenticiteti dhe integriteti i të dhënave nuk mund të garantohet."

provave të EncroChat, por më pas është gjetur se posedon armë të paligjshme ose drogë, ka më pak gjasa të mund ta kontestojë drejtësinë e procedurës kur dënimi i tij bazohet mbi prova që përbëhen nga provat e EncroChat përveç provave të marra përmes bastisjes dhe konfiskimit. Nga ana tjetër, një person dënimi i të cilit bazohet vetëm mbi të dhënat nga EncroChat mund të ketë bazë më të fortë për të kontestuar drejtësinë e procedurës. Ekspertët e pavarur të teknologjisë, me përvojë në teknologjinë e përdorur, po ashtu mund të luajnë rol kyç kur ftohen të analizojnë dhe shpjegojnë autenticitetin e provave, ose të shprehin dyshime rreth legjitimitetit të tyre.

Më tej, një sasi tepër e madhe e të dhënave të interceptuara është marrë në një vend por është transferuar për përdorim nga autoritetet hetimore në një vend tjetër. Ndërkohë që hartimi i rregullave për pranueshmërinë e provave është detyrë e autoriteteve kombëtare, dhe jo e GjEDNj-së, GjEDNj do të mbikëqyrë pajtueshmërinë me Nenin 8 dhe Nenin 6 duke vlerësuar nëse provat janë marrë, dhe procedurat kanë vazhduar, në përputhje me ligjin ose "sipas ligjit". Prandaj, autoritetet kombëtare duhet të sigurohen që procedurat të zhvillohen, dhe provat të pranohen, në mënyrë të atillë që është e parashikueshme dhe në përputhje me ligjet vendase. Kjo mund të jetë më e vështirë për t'u garantuar kur provat janë mbledhur në një juridiksion tjetër, ligjet dhe mbrojtjet e të cilit për mbledhjen e provave mund të jenë ndryshe prej atyre të vendit në të cilin provat pranohen në gjyqe. Megjithatë, gjykatat vendase duhet të zbatojnë rregullat e vendit për të vlerësuar nëse të dhënat e marra nga jashtë vendit janë ose jo të pranueshme.

# Kapitulli 4

## Publikimi i informacionit gjatë procedurave gjyqësore

Përveç mënyrave në të cilat pranimi i provave të marra në shkelle të Nenit 8 mund të ndikojë tek drejtësia e tërësishme e procedurës (siç u diskutua më parë në këtë Udhërrëfyes), ka shumë mënyra të tjera se si garantitë specifike të Nenit 6 ndërveprojnë dhe mund të ndikohen nga kriteret për mbrojtjen e të dhënave personale sipas Nenit 8. Për shembull, kur informacionet rreth një të dyshuari publikohen gjatë hetimeve, kjo mund të ndikojë tek e drejta për prezumim të pafajësisë deri në vërtetim të fajësisë. Më tej, kur të dhënat personale janë pjesë e provave të paraqitura gjatë një seance, është e nevojshme të balancohen, nga njëra anë, mbrojtja e natyrës publike të procedurës gjyqësore, çka është e rëndësishme për të ruajtur besimin tek gjykatat dhe, nga ana tjetër, interesat e një pale ose një personi të tretë në ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të tij/saj.

Gjatë fazës hetimore të procedurës gjyqësore, ka dy mënyra kyçe se si mund të angazhohen të drejtat e Konventës kur informacionet rreth asaj procedure ndahen me publikun. Në kontekstin specifik të procedurave penale, deklaratat publike të bëra para përfundimit të gjyqit penal kanë potencialin që të shkelin të drejtën e prezumimit të pafajësisë, e mbrojtur nga Neni 6(2) KEDNj, kur deklarime të tilla përfshijnë konstatime të parakohshme që i akuzuari është fajtor.

Përveç kësaj, mund të ketë kontekste ku informacionet personale ndahen me personat e përfshirë në procedura gjyqësore në vazhdim e sipër, ku nuk angazhohet Neni 6(2) por angazhohet Neni 8. Për shembull, publikimi i fotografisë së të akuzuarit, ose në kontekstin e procedurave civile, jo penale, ku Neni 6(2) nuk aplikohet.

## a) E drejta për prezumim të pafajësisë deri në vërtetim të fajësisë sipas Nenit 6

Neni 6(2) KEDNj parashikon që:

*“Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.”*

Kjo dispozitë kërkon që anëtarët e gjykatës nuk duhet ta fillojnë një seancë penale me para-konceptin që i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën është akuzuar. Ajo imponon kritere në lidhje me (mes të tjerash) çdo publicitet apo deklaratë të bërë para gjyqit nga zyrtarët publikë. Çdo deklaratë ose publicitet i tillë duhet të hartohet me kujdes për t'u siguruar që nuk përfshin shprehje apo konstatime të parakohshme për fajësinë e një personi, për të shmangur ndërhyrjen tek e drejta e tij për t'u prezumuar i pafajshëm.

### i) Kujt i aplikohet Neni 6(2)?

Detyrimi për të shmangur bërjen e deklaratave që dëmtojnë prezumimin e pafajësisë i aplikohet të gjitha autoriteteve publike. Prandaj, ai ndalon deklarimin e parakohshëm nga një gjyqtar, gjykatë ose anëtarë të gjykatës që një person i akuzuar për një vepër penale është fajtor para përfundimit të gjyqit. Gjithashtu, ndalon bërjen e deklaratimeve nga çdo zyrtar tjetër publik në lidhje me hetimet penale të cilat mund ta bëjnë publikun të besojë se i dyshuari është fajtor, duke paragjykuar kështu vlerësimin e fakteve nga autoriteti gjyqësor kompetent.<sup>[131]</sup> Në këtë aspekt, kriteret e Nenit 6(2) shtrihen edhe tek presidenti, kryeministri, politikanët, ministrat e qeverisë, prokurorët dhe policia e Shtetit, dhe mund të ngrihen, për shembull, kur zyrtarët publikë japin deklaratat gjatë një interviste në gazetë ose televizion, ose kur mbajnë konferenca shtypi.<sup>[132]</sup>

Kur deklaratat të kontestuara bëhen nga entitete private (si gazetat) dhe nuk përbëjnë riprodhim fjalë-për-fjalë të (apo citat të drejtpërdrejtë nga) ndonjë pjesë e informacioneve zyrtare të ofruara nga autoritetet, nuk lindin çështje nga Neni 6(2). Megjithatë, mund të lindin çështje nga Neni 8 (shih poshtë).<sup>[133]</sup>

[131] *Allenet de Ribemont k. Francës*, vendim i 10 shkurtit 1995, Nr. 15175/89 tek §36.

[132] *Peša k. Kroacisë*, vendim i 8 prillit 2010, Nr. 40523/08 tek §§138 dhe 141.

[133] *Mityanin dhe Leonov k. Rusisë*, vendim i 7 majit 2019, Nr. 11436/06 dhe 22912/06 tek §§102 dhe 105.

## ii) Kur aplikohet Neni 6(2)?

---

Kriteret e Nenit 6(2) aplikohen në procedurat penale në tërësinë e tyre. Normalisht, mbrojtja e Nenit 6(2) angazhohet sapo iniciohet akuzat penale kundër një personi, pra kur ai njoftohet zyrtarisht nga autoriteti kompetent për akuzën që ka kryer vepër penale.<sup>[134]</sup> Ai vazhdon të aplikohet përgjatë të gjitha procedurave, deri në përfundim të të gjitha të drejtave finale për apel. Për shembull, Neni 6(2) nuk pushon së aplikuari vetëm sepse procedura e shkallës së parë rezulton me dënim, nëqoftëse ai vendim është duke kaluar nëpër apel.<sup>[135]</sup>

## iii) Çfarë kërkon Neni 6(2)?

---

Neni 6(2) nuk i ndalon autoritetet publike nga informimi i publikut rreth hetimeve penale që janë duke u zhvilluar. E drejta për lirinë e shprehjes nga Neni 10 KEDNJ, i cili përfshin të drejtën për të marrë e dhënë informacione, mbron të drejtën e publikut për të marrë, dhe të autoriteteve publike për të dhënë, informacione në lidhje me hetimet penale që janë duke u zhvilluar.<sup>[136]</sup> Në mënyrë të veçantë, kur procedurat penale kanë rëndësi të karakterit publik ose interes publik, autoritetet shtetërore mund të duhet ta mbajnë publikun të informuar në lidhje me akuzën e pretenduar dhe procedurat penale të ndërlidhura. Për shembull, kur procedurat penale kanë të bëjnë me akuzat për sjellje të pahijshme në pozitë zyrtare nga një figurë e lartë politike.<sup>[137]</sup>

Megjithatë, çdo deklaratë publike rreth procedurave penale në vazhdim duhet të bëhet me diskrecionin dhe maturinë e nevojshme për të respektuar prezumimin e pafajësisë.<sup>[138]</sup> Zyrtarëve publikë u lejohej të bëjnë deklaratat faktike që dikush thjesht dyshohet të ketë kryer një krim dhe mund të ofrojnë lajme objektive

---

[134] *Gogitidze dhe të tjerë k. Gjeorgjisë*, vendim i 12 majit 2015, Nr. 36862/05 tek §§125-126; megjithëse, shih në kontrast, *Batiashvili k. Gjeorgjisë*, vendim i 10 tetorit 2019, Nr. 8284/07 tek §79, ku Neni 6(2) përjashtimisht u aplikua nga momenti që autoritetet manipuluan një incizim audio dhe e shpërndanë në publik për të lënë të kuptohej ekzistenca e një krimi, kur akuzat formalisht u ngritën kundër kërkuetit katër ditë më pas.

[135] *Konstas k. Greqisë*, vendim i 24 majit 2011, Nr. 53466/07 tek §36.

[136] *Allenet de Ribemont k. Francës*, vendim i 10 shkurtit 1995, Nr. 15175/89 tek §38; *Daktaras k. Lituanië* (dec.), vendim i 11 janarit 2000, Nr. 42095/98 tek §41; *Gutsanovi k. Bullgarisë*, vendim i 15 tetorit 2013, Nr. 34529/10 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[137] *Arrigo dhe Vella k. Maltës* (dec.), vendim i 10 majit 2005, Nr. 6569/04; *Algirdas Butkevičius k. Lituanië*, vendim i 14 qershorit 2022, Nr. 70489/17 tek §51 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[138] *Allenet de Ribemont k. Francës*, vendim i 10 shkurtit 1995, Nr. 15175/89 tek §38.

---

mbi statusin e hetimeve në vazhdim. Për shembull, poshtë renditen të gjitha deklaratat që mund të bëhen, dhe informacionet që mund të jepen, në përputhje me Nenin 6(2).<sup>[139]</sup>

- » Deklaratë që dikush është arrestuar dhe vënë në paraburgim në pritje të hetimeve të mëtejshme;
- » Shpjegimi që është hapur dosja penale;
- » Leximi i deklaratës së akuzave;
- » Shpjegimi i natyrës së akuzave dhe dënimeve të mundshme; dhe
- » Përshkrimi i masave hetimore të ndërmarra deri tani, siç është deklarimi që janë zhvilluar bastisje.

Megjithatë, për të shmangur shkeljen e Nenit 6(2), zyrtarët publikë nuk duhet të bëjnë deklaratë ku thuhet se një individ e ka kryer veprën në fjalë. Ata nuk duhet të shprehin opinione që përbëjnë deklaratë të fajësisë së një personi ose të cilat nxisin publikun të besojë se personi është fajtor e rrjedhimisht të paragjykojnë vlerësimin e fakteve nga autoritetet gjyqësore.<sup>[140]</sup>

Në këtë kontekst, zgjedhja e fjalëve të përdorura nga autoritetet publike ka rëndësi themelore. Për të vlerësuar nëse Neni 6(2) është shkelur, duhet të merren në konsideratë të gjitha rrethanat e çështjes, përfshirë mënyrën se si është formuluar deklarata publike, fjalët specifike të përdorura në të dhe konteksti në të cilin janë bërë deklaratimet.<sup>[141]</sup>

Deklaratat nuk duhet të shkojnë përtej thjesht përcjelljes së informatës. Për shembull, zyrtarët duhet të shmangin përdorimin e gjuhës që pa ekuivoke thotë se i akuzuari i ka kryer veprimet për të cilat akuzohet, ose që e përshkruan atë si personi që i ka kryer ato veprime. Kjo përfshin përdorimin e frazave si "ajo që ka bërë ai person paraqet një komplot të detajuar" për të treguar pa ekuivoke se operacione kriminale janë zhvilluar nga i akuzuari,<sup>[142]</sup> përdorimin e frazave si "nuk kam dyshim"

[139] *Gutsanovi k. Bullgarisë*, vendim i 15 tetorit 2013, Nr. 34529/10 tek §197 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[140] *Algirdas Butkevičius k. Lituaniës*, vendim i 14 qershorit 2022, Nr. 70489/17 tek §53 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Gutsanovi k. Bullgarisë*, vendim i 15 tetorit 2013, Nr. 34529/10 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Garycki k. Polonisë*, vendim i 6 shkurtit 2007, Nr. 14348/02 tek §67.

[141] *Daktaras k. Lituaniës* (dec.), vendim i 11 janarit 2000, Nr. 42095/98 tek §§41-42.

[142] *Gutsanovi k. Bullgarisë*, vendim i 15 tetorit 2013, Nr. 34529/10 tek §200 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

që i akuzuari e ka kryer veprën, ose përshkrimi i të akuzuarit si “mitmarrës” përpara se të ketë prova që ai ka marrë mito<sup>[143]</sup> dhe ndarja e fotografive të të dyshuarve duke iu referuar atyre si “anëtarë të organizatës ilegale”.<sup>[144]</sup>

Faktorë të tjerë relevantë, përveç fjalëve të përdorura në deklarime, përfshijnë kohën e deklarimeve, e cila mund të shkelë Nenin 6(2) nëqoftëse deklarimet bëhen në periudhën kur ka interesim të madh publik për një çështje të caktuar, për shembull, menjëherë pas arrestimit të një personi ose menjëherë pasi ai del para gjyqit.<sup>[145]</sup> Shkalla e mbulimit medial të deklarimeve dhe statusit, pozitës dhe nivelit të autoritetit të personit që e bën deklaratën gjithashtu kanë relevancën e tyre.<sup>[146]</sup> Mungesa e qëllimit për të dëmtuar prezumimin e pafajësisë është jorelevante në këtë vlerësim.

## **b) Publikimi i informacioneve lidhur me procedurat në vijim – mbrojtja sipas Nenit 8**

Siç shpjegohet më lart, Neni 6(2) nuk mund t'i ndalojë autoritetet nga informimi i publikut rreth hetimeve penale në vijim e sipër. Sipas Nenit 6(2), informacionet personale mund të ndahen, dhe fotografia e një të dyshuari mund të publikohet ka shkelur prezumimin e pafajësisë, për sa kohë që informacioni dhe fotografitë publikohen pa ndonjë vlerësim ose paragjykim rreth fajësisë.<sup>[147]</sup> Megjithatë, edhe kur nuk angazhohet Neni 6(2), publikimi i këtyre të dhënave mund të përbëjë ndërhyrje tek Neni 8. Për të shmangur shkeljen e Nenit 8, publikimi i të dhënave të tilla duhet të bëhet në përputhje me ligjin, në vijim të një qëllimi legjitim, dhe të vlerësohet si mjet proporcional për arritjen e atij qëllimi legjitim.

### **i) Qëllimi legjitim**

Në kontekstin e procedurave penale, publikimi i të dhënave personale mund të vlerësohet se i shërben qëllimit legjitim të hetimit dhe ndjekjes penale të krimin.

[143] *Algirdas Butkevičius k. Lituanië*, vendim i 14 qershorit 2022, Nr. 70489/17 tek §§52-53 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[144] *Y.B. dhe të tjerë k. Turqisë*, vendim i 28 tetorit 2004, Nr. 48173/99 dhe 48319/99.

[145] *Algirdas Butkevičius k. Lituanië*, vendim i 14 qershorit 2022, Nr. 70489/17 tek §51 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[146] *Gutsanovi k. Bullgarisë*, vendim i 15 tetorit 2013, Nr. 34529/10 tek §§199-201 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Algirdas Butkevičius k. Lituanië*, vendim i 14 qershorit 2022, Nr. 70489/17 tek §§50-53 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[147] *Y.B. dhe të tjerë k. Turqisë*, vendim i 28 tetorit 2004, Nr. 48173/99 dhe 48319/99 tek §47.



Për shembull, një fotografi dhe informacione personale rreth një të akuzuari mund të publikohen për të ndihmuar mbledhjen e informacioneve relevante për hetimet në vijim, për të identifikuar nëse janë kryer vepra të tjera, ose në përpjekje për të gjetur vendndodhjen e të dyshuarit. Më tej, publikimi i informacioneve të tilla mund të vlerësohet se ndihmon parandalimin e kryerjes së veprave të tjera dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, përmes dekurajimit të publikut nga afërsia apo marrëdhëniet me të dyshuarin.<sup>[148]</sup>

Sidoqoftë, është e nevojshme të sigurohet që, kur një fotografi publikohet në kontekstin e raportimit rreth procedurave penale, ajo ka njëfarë vlere informative ose hetimore. Për shembull, kur i akuzuari tashmë ndodhet në paraburgim, tregimi i fotografisë së tij nuk mund të justifikohet duke iu referuar qëllimit të mbrojtjes së publikut nga ai person ose mbështetjes publike për përcaktimin e vendndodhjes së tij.<sup>[149]</sup> Kjo situatë mund të vihet në kontrast me situatën kur një i dyshuar është liruar me dorëzani, ose kur i dyshuari nuk dihet ku ndodhet, për shembull.<sup>[150]</sup>

Përveç kësaj, publikimi i informacioneve personale mund të vlerësohet se i shërben qëllimit të reduktimit ose pengimit të mos-respektimit të rregullave dhe rregulloreve civile. Për shembull, publikimi i emrave, adresave dhe të dhënave financiare të debitorëve të mëdhenj tatimorë për të parandaluar mos-respektimin e rregulloreve tatimore dhe për të inkurajuar njerëzit që të paguajnë taksat.<sup>[151]</sup>

## ii) Proporcionaliteti

---

Gjatë vlerësimit nëse publikimi i informacionit është i nevojshëm në një shoqëri demokratik, dhe nëse është mjet proporcional i arritjes së qëllimeve legjitime të përshkruara më lart, duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm:<sup>[152]</sup>

- » Shkalla deri ku publikimi i informacionit përfaqëson një masë që shënjestron një individ, ose përbën pjesë të një skeme të përgjithshme.

---

[148] *Margari k. Greqisë*, vendim i 20 qershorit 2023, Nr. 36705/16 tek §§47-49 dhe 52 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[149] *Khuzhin dhe të tjerë k. Rusisë*, vendim i 23 tetorit 2008, Nr. 13470/02 tek §117.

[150] *Margari k. Greqisë*, vendim i 20 qershorit 2023, Nr. 36705/16 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[151] *L.B. k. Hungarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 9 marsit 2023, Nr. 36345/16 tek §§108-114 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[152] *L.B. k. Hungary*, vendim i Dhomës së Madhe i 9 marsit 2023, Nr. 36345/16 tek §§118 – 122 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

- Marrja e masave të përgjithshme brenda një skeme më të gjerë legislative lidhur me publikimin e informacioneve rreth njerëzve që hyjnë brenda situatave të paracaktuara ka më shumë gjasa të jetë proporcionale sesa masat që kanë në shënjestër individë të caktuar.
- » Nëse publikimi i informacionit ka ose jo afat kohor.
  - » Shkalla deri ku një aspekt posaçërisht i rëndësishëm i identitetit të individit është në rrezik, për shembull:
    - » Informacione intime, si të dhëna shëndetësore, orientimi seksual, dhe bindjet fetare duhet të meritojnë mbrojtje të shtuar.
    - » Të dhënat financiare të një personi nuk vlerësohet se përbëjnë detaje intime rreth jetës së tij, ndaj nuk meritojnë mbrojtje të shtuar.
  - » Pasojat e publikimit të informacioneve rreth jetës private të një personi, për shembull, shkalla deri ku ai/ajo përjeton ndjenja të pasigurisë, poshtërimin dhe përjashtimit nga jeta publike si pasojë e publikimit.
  - » Niveli i interesit publik në shpërndarjen e informacionit dhe serioziteti i çështjes në fjalë, për shembull, pesha e veprës penale ose shkelja e rregulloreve civile të cilat publikimi i informacionit mëton të pengojë.
  - » Mediumi i përdorur për shpërndarjen e informacionit, për shembull, botimi i informacionit në shtyp normalisht vlerësohet se ka më pak impakt sesa publikim i informacionit në internet.
  - » Shtrirja e audiencës që ka qasje në mediumin e përdorur për publikimin e informacionit.
  - » Ekzistenca e mbrojtjeve procedurale, për shembull njoftimi i individit që informacioni ose fotografia e tij do të publikohet, duke i dhënë mundësinë për të kundërshtuar ose të drejtën për apel në mënyrë që ai të konstatojë se të drejtat e tij nga Neni 8 janë shkelur.

Parimet e mëposhtme të mbrojtjes së të dhënave po ashtu janë relevante për çdo vlerësim të proporcionalitetit.<sup>[153]</sup>

- » **Kufizimi i qëllimit:** çdo përpunim të dhënash duhet bërë për një qëllim specifik të mirëdefiniuar, dhe vetëm për qëllime shtesë të cilat janë në përputhje me qëllimin origjinal.
- » **Minimizimi i të dhënave:** të dhënat personale duhet të jenë të përshtatshme, relevante, dhe të kufizuara brenda asaj çka është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohet.

[153] *L.B. k. Hungarisë*, vendim i Dhomës së Madhe i 9 marsit 2023, Nr. 36345/16 tek §§123 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

- » **Saktësia e të dhënave:** duke njohur që informacionet e pasakta ose të reme të përmbajtura në regjistrat publike mund të jenë të dëmshme ose potencialisht dëmtuese për reputacionin e objektit të të dhënave, duhet të jenë të ngritura mbrojtje procedurale statusore për korrigjimin dhe rishikimin e informacionit.
- » **Kufizimi i ruajtjes:** të dhënat personale duhet të ruhen në një formë e cila lejon identifikimin e objekteve të të dhënave për jo më gjatë sesa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat.
- » Përpunimi fillestar i ligjshëm i të dhënave të sakta me kalimin e kohës mund të shpërputhet me kriteret e Nenit 8 kur ato të dhëna nuk janë më të nevojshme për qëllimet për të cilat janë mbledhur ose publikuar.

### **Aplikimi i parimeve të mësipërme në kontekstin e procedurave penale**

Publikimi dhe përpunimi i të dhënave personale lidhur me akuza penale kërkon mbrojtje të shtuar për shkak të ndjeshmërisë së veçantë të të dhënave në fjalë. Kur të dhëna të ndjeshme publikohen në kontekstin e procedurave penale në vijim e sipër ose në kontekstin e hetimeve për vepra penale, është imperative që të dhënat e publikuara të pasqyrojnë saktë situatën dhe akuzat e ngritura kundër të akuzuarit, gjithnjë duke mbajtur parasysh respektimin e prezumimit të pafajësisë.

#### **c) E drejta për seancë dëgjimore publike sipas Nenit 6(1)**

Neni 6 ECHR garanton të drejtën për “seancë dëgjimore të drejtë dhe publike”.

E drejta për “seancë publike” dhe parimi i publicitetit sipas Nenit 6 ngërthen dy aspekte: zhvillimin e seancave publike (diskutuar më poshtë) dhe shpalljen publike të vendimeve (diskutuar në seksionin vijues të këtij publikimi).<sup>[154]</sup>

Karakteri publik i procedurave është parim themelor në çdo shoqëri demokratike. Është thelbësore që të mundësohet këqyrja publike e administrimit të drejtësisë dhe të ruhet besimi tek gjykatat.<sup>[155]</sup> Normalisht, për të vepruar në përputhje me kriteret e publicitetit, publiku duhet të jetë në gjendje të marrë informacione në lidhje me datën, kohën dhe vendin e seancës, dhe në seancë duhet të ketë qasje të lehtë publiku.<sup>[156]</sup> Megjithatë, natyra publike e seancave gjyqësore

[154] *Sutter k. Zvicrës*, vendim i 22 shkurtit 1984, Nr. 8209/78 tek §27.

[155] *Riepan k. Austrisë*, vendim i 14 nëntorit 2000, Nr. 35115/97 tek §27.

[156] *Riepan k. Austrisë*, vendim i 14 nëntorit 2000, Nr. 35115/97 tek §29.

mund t'i japë shkas shqetësimeve në lidhje me mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale të një personi, të cilat mund të diskutohen ose të zbulohen në një seancë publike. Autoritetet kombëtare duhet të gjejnë një ekuilibër të drejtë mes, nga njëra anë, mbrojtjes së natyrës publike të procedurave në përputhje me Nenin 6, dhe, nga ana tjetër, mbrojtjes së interesave të një pale në procedurë, ose të një pale të tretë, për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave të tij/saj në përputhje me Nenin 8.<sup>[157]</sup> Kjo mund të përfshijë: i) vënien e kufijve mbi llojin dhe fushëveprimin e të dhënave që zbulohen në seancë; ose ii) në rrethana të caktuara, Shtetet mund ta gjykojnë të udhës që seanca të zhvillohet me dyer të mbyllura.

### **i) Kufizimi i informacioneve të zbuluara në seancë**

Pranimi i të dhënave personale dhe të ndjeshme si prova në seancë publike mund të përbëjë ndërhyrje tek Neni 8 KEDNj, meqenëse kjo përfshin zbulimin e këtyre informacioneve në publik.

Për të qenë në pajtueshmëri me Nenin 8 në këtë kontekst, zbulimi i të dhënave personale duhet të jetë në përputhje me ligjin, t'i shërbejë një qëllimi legjitim, dhe duhet të kufizohet për aq sa është e mundur brenda asaj që është rreptësisht e nevojshme siç kërkohet nga karakteristikat e veçanta të procedurës dhe fakteve të çështjes.<sup>[158]</sup>

### **Qëllimi legjitim**

Zbulimi i të dhënave personale gjatë procedurave publike, duke përfshirë edhe të dhëna mjekësore të ndjeshme, mund të jetë i nevojshëm për të arritur qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Në mënyrë të veçantë, e drejta për të paraqitur prova me qëllim të mbështetjes së një pretendimi të ngritur para gjykatave.<sup>[159]</sup> Synimi i këtij qëllimi kërkon zbulimin e informacioneve të mjafta për t'i dhënë një gjyqtari njohuri të mjaftueshme rreth një çështjeje që ai të mund të vendosë në lidhje me themelet e çështjes dhe të sigurojë ecurinë e duhur të procedurës gjyqësore.<sup>[160]</sup>

---

[157] C.C. k. *Spain*, vendim i 6 tetorit 2009, Nr. 1425/06 tek §35.

[158] L.L. k. *Francës*, vendim i 10 tetorit 2006, Nr. 7508/02 tek §45 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[159] L.L. k. *Francës*, vendim i 10 tetorit 2006, Nr. 7508/02 tek §40 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[160] C.C. k. *Spanjës*, vendim i 6 tetorit 2009, Nr. 1425/06 tek §29.

## Proporcionaliteti

Gjatë përcaktimit të shkallës deri ku zbulimi i të dhënave personale bëhet "rreptësisht i nevojshëm" nga faktet dhe karakteristikat e një çështjeje, duhet të merret parasysh lloji i të dhënave personale në fjalë, natyra e procedurës, dhe shkalla deri ku të dhënat janë vendimtare për çështjen. Për shembull, mbrojtja e kategorive të ndjeshme ose të veçanta të të dhënave, siç janë të dhënat e ndjeshme shëndetësore, vlerësohet me rëndësi jetike, dhe të dhëna të tilla duhet të përfitojnë mbrojtje të shtuar.<sup>[161]</sup> Nga ana tjetër, disa lloje të caktuara procedurash, për shembull procedurat familjare dhe ato të divorcit, domosdoshmërisht kërkojnë që gjykatat të trajtojnë informacionet më intime dhe private të njerëzve, pra të ndërhyjnë në jetën e tyre personale dhe familjare, në mënyrë që të vendosin për llojet e mosmarrëveshjeve përpara tyre.<sup>[162]</sup>

Kur vlerësohet se kërkohet zbulimi i të dhënave të ndjeshme, kjo duhet të kufizohet me aq sa është rreptësisht e nevojshme për të zgjidhur çështjen. Testi kyç është: i) nëse gjyqtari do të kishte njohuri të mjaftueshme për zgjidhjen e çështjes sikur të mos zbuloheshin informacionet e ndjeshme; dhe ii) nëse gjyqtari do arrinte të njëjtin përfundim me ose pa zbulimin e informacioneve të ndjeshme.<sup>[163]</sup>

### ii) Seancat me dyer të mbyllura

Kërkesa për të mbajtur seancë publike ka disa përjashtime të lejuara. Në disa rrethana të caktuara, mund të lindë nevoja që të përjashtohet publiku dhe shtypi nga seanca për të mbrojtur të drejtën e jetës private të palëve të përfshira. Po ashtu, mund të lindë nevoja që të kufizohen të drejtat e pjesëmarrjes për të

[161] *L.L. k. Francës*, vendim i 10 tetorit 2006, Nr. 7508/02 tek §44 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[162] *L.L. k. Francës*, vendim i 10 tetorit 2006, Nr. 7508/02 tek §45 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[163] *Krahaso L.L. k. Francës*, vendim i 10 tetorit 2006, Nr. 7508/02 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim) me *C.C. k. Spanjës*, vendim i 6 tetorit 2009, Nr. 1425/06. Tek i pari, zbulimi i materialit të ndjeshëm mjekësor shkeli Nenin 8 sepse ky material nuk u vlerësua se ishte i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes. Vendimi i gjykatave vendase për të lejuar divorcin u bazua në shumë prova të tjera, kryesisht deklaratat e dëshmitarëve, dhe prandaj u gjet se, edhe pse provat e kontestuara u deklaruan të papranueshme, gjykatat do të kishin arritur të njëjtin përfundim. Në çështjen e dytë, zbulimi i të dhënave mjekësore të kërkuesit nuk shkeli Nenin 8. Çështja kishte të bënte me një pagesë kompensimi për shkak të pamundësisë së kërkuesit për të punuar (e rrjedhimisht gjendja / historia e tij mjekësore). Dosja e tij mjekësore përmbante informacione që formuan lëndën e procedurave, dhe zbulimi i saj që i nevojshëm për të shqyrtuar dhe vendosur çështjen.

mbrojtur drejtësinë e tërësishme të procedurës sipas Nenit 6. Për shembull, kur publiciteti pengon mundësinë e palëve për të marrë pjesë efektivisht në seancë.<sup>[164]</sup>

Neni 6(1) parashikon:

*“Prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij ... kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.”*

Edhe në kontekstin e procedurës penale, kur ka theks të shtuar mbi nevojën për publicitet, është e mundur të kufizohet natyra e hapur dhe publike e procedurës, për shembull, për të mbrojtur sigurinë ose privatësinë e dëshmitarëve ose për të promovuar shkëmbimin e lirë të informacioneve dhe opinionëve në vijim të drejtësisë.<sup>[165]</sup>

Megjithatë, ka nevojë të tregohet se vendimi për të zhvilluar një seancë qoftë tërësisht apo pjesërisht me dyer të mbyllura kërkon rreptësisht që të merren në konsideratë të gjitha rrethanat e çështjes.<sup>[166]</sup> Rrethanat përkatëse përfshijnë moshën dhe cenueshmërinë e palëve të përfshira. Gjithashtu, ka rëndësi të merret parasysh shkalla deri ku palëve u kërkohet të shprehen haptas në lidhje me çështje shumë personale pa frikën e kureshtjes ose komenteve nga publiku, në mënyrë që gjyqtari të marrë një vendim të mirinformuar duke kuptuar saktë të gjitha faktet relevante.<sup>[167]</sup> Në këtë kontekst, Shteteve madje mund t’u lejohet që të bëjnë një prezumim të përgjithshëm në favor të seancave me dyer të mbyllura për

---

[164] *T. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 16 dhjetorit 1999, Nr. 24724/94, ku gjyqi penal i një fëmije tërhoqi interes të madh publik dhe mediatik, dhe kërkuesi u gjet se e kishte të pamundur të merrte pjesë efektivisht në procedurën penale kundër tij, në shkelje të së drejtës së tij për proces të rregullt në shkelje të Nenit 6 § 1. U gjet se seanca duhet të ishte zhvilluar në mënyrë të atillë që të reduktonte sa më shumë që ishte e mundur ndjenjat e tij të frikësimit dhe pengimit, për shembull duke i ofruar të drejta selektive të pjesëmarrjes.

[165] *B. dhe P. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 prillit 2001, Nr. 36337/97 dhe 35974/97 tek §37 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[166] *Kilin k. Ruisë*, vendim i 11 majit 2021, Nr. 10271/12, §§111-112; *Martinie k. Francës*, Vendim i Dhomës së Madhe i 12 prillit 2006, Nr. 58675/00 tek §40.

[167] *B. dhe P. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 prillit 2001, Nr. 36337/97 dhe 35974/97 tek §38 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

disa kategori të caktuara çështjesh, për shembull kur kanë të bëjnë me fëmijë, në mënyrë që të mbrohen të drejtat e të miturve, jeta private e palëve, dhe drejtësia e tërësishme e procedurave.<sup>[168]</sup> Megjithatë, është thelbësore që të ketë mbrojtje procedurale që nënkupton se është e mundur të bëhet kërkesë për shqyrtim juridik të çdo vendimi për të mbajtur seancë me dyer të mbyllura, dhe që gjithmonë ekziston së paku mundësia për të mbajtur seancë publike kur vlerësohet e nevojshme pas një shqyrtimi të tillë.<sup>[169]</sup>

Nga ana tjetër, vendimi për të mbajtur seancë publike, në vend të seancës me dyer të mbyllura, mund të shkelë të drejtat e një personi nga Neni 8, kur seanca publike përfshin ekzaminimin e informacioneve personale dhe delikate rreth atij personi. Në këtë kontekst, mbrojtjet procedurale janë po aq të rëndësishme. Kur një person kërkon që seanca të mbahet me dyer të mbyllura, gjykatat duhet të ndërmarrin një vlerësim të individualizuar proporcionaliteti për të përcaktuar nëse seanca publike, dhe ndërhyrja rezultuese tek të drejtat e personit nga Neni 8, është e nevojshme, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes. Ky vlerësim i individualizuar i proporcionalitetit duhet të kërkojë ekuilibrimin e procedurës transparente me rëndësinë e respektimit të konfidencialitetit të informacionit personal. Gjykatat duhet të marrin parasysh shkallën deri ku kërkohet zbulimi i informacioneve të ndjeshme për të vendosur lidhur me çështjen (siç diskutohet në seksionin e mësipërm). Kufizimi i fushëveprimit të të dhënave personale që zbulohen gjatë procedurave mund të jetë një mënyrë për të ruajtur natyrën e tyre publike, ndërkohë që po ashtu kufizohet impakti mbi të drejtat e personit nga Neni 8. Kur zbulimi nuk mund të kufizohet (siç diskutohet në seksionin e mësipërm)<sup>[170]</sup>, seanca me dyer të mbyllura mund të konsiderohet e nevojshme. Ajo që është e rëndësishme nga perspektiva e Nenit 8 është që të ekzistojë një procedurë që i trajton si duhet këto çështje pas kërkesës për seancë me dyer të mbyllura, në mënyrë që të rezultojë me një përgjigje të arsyetuar dhe justifikuar siç duhet për këtë kërkesë.<sup>[171]</sup>

---

[168] *B. dhe P. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 prillit 2001, Nr. 36337/97 dhe 35974/97 tek §39 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Campbell dhe Fell k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 28 qershorit 1984, Nr. 7819/77 dhe 7878/77 tek §§87-88.

[169] *B. dhe P. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 prillit 2001, Nr. 36337/97 dhe 35974/97 tek §39 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[170] *C.C. k. Spanjës*, vendim i 6 tetorit 2009, Nr. 1425/06.

[171] *Frëncu k. Romanisë*, vendim i 13 tetorit 2020, Nr. 69356/13 tek §§62-75.

## E drejta për shqyrtimin e ligjshmërisë së paraburgimit sipas Nenit 5

Çështje lidhur me publikimin e të dhënave konfidenciale ose të ndjeshme gjithashtu mund të dalin edhe në kontekstin e procedurave që dalin nga e drejta për ta vënë ligjshmërinë e paraburgimit nën shqyrtim nga gjykata sipas Nenit 5(4) KEDNj.

Çështja *A dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>[172]</sup> thekson se si këto dy pika të diskutuara më sipër në këtë publikim në kontekstin e Nenit 6 (kufizimi i zbulimit të materialeve të ndjeshme gjatë procedurave dhe mbajtja e seancave me dyer të mbyllura) mund të shfaqen po ashtu në lidhje me të drejtat e mbrojtura nga Neni 5. 11 kërkuesit u paraburgosën sipas një fuqie të zgjeruar të krijuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar që lejoi paraburgimin e tyre kur Sekretari i Shtetit me arsye besoi se prania e tyre në Mbretërinë e Bashkuar përbënte rrezik për sigurinë kombëtare dhe me arsye dyshoi se ata ishin terroristë ndërkombëtarë.<sup>[173]</sup>

Vendimi për të paraburgosur një individ iu nënshtrua çdo 6 muaj rishikimit nga një Komision Special i Apeleve të Imigracionit (ang. "SIAC"). SIAC arriti të shqyrtonte prova të cilat mund të bëheshin publike (materiali i hapur) dhe prova të ndjeshme të cilat nuk mund të zbuloheshin për arsye të sigurisë kombëtare (materiali i mbyllur). Të paraburgosurit dhe ekipi i tyre ligjor patën qasje në materialin e hapur dhe mundën të komentnin rreth tij me shkrim dhe gjatë një seance. Materiali i mbyllur iu zbulua vetëm një avokati special, të caktuar në emër të secilit të paraburgosur nga Zv/Kryeprokurori. SIAC zhvilloi edhe seanca të hapura, edhe seanca të mbyllura. Në seancat e mbyllura, SIAC do të merrte në shqyrtim materialet e mbyllura dhe do t'i lejonte avokatit special të bënte parashtrime procedurale dhe substanciale në emër të të paraburgosurve. Pasi avokati special pati qasje në materialin e mbyllur, ai nuk u lejua më të kishte asnjë kontakt me të paraburgosurit apo me avokatët e tyre pa lejen e gjykatës.

SIAC i rrëzoi të gjitha apelet e kërkuesve kundër paraburgimit të tyre. Kërkuesit argumentuan se procedura e SIAC ishte në papajtueshmëri me Nenin 5(4) KEDNj mbi bazën se procedura ishte e padrejtë sepse atyre nuk u ishin bërë të ditura të gjitha provat kundër tyre. GjEDNj pranoi se në kohën relevante ekzistonte nevoja urgjente për të mbrojtur popullsinë e Mbretërisë së Bashkuar nga sulmet terroriste dhe kishte interes të madh publik për informacione rreth al-Qaedës duke ruajtur

[172] *A dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 19 shkurtit 2009, kërkesa Nr. 3455/05.

[173] Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar bëri një njoftim për derogim sipas Nenit 15 të KEDNj-së.



sekretësinë e burimeve. Kjo duhet të balancohej me të drejtat e kërkuesve sipas Nenit 5(4) KEDNj.

GjEDNj deklaroi se ishte thelbësore që të zbuloheshin sa më shumë që të ishte e mundur informacione rreth akuzimeve dhe provave kundër secilit kërkues, pa komprometuar sigurinë kombëtare ose sigurinë e të tjerëve. Edhe kur zbulimi i plotë nuk është i mundur, prapë se prapë secilit kërkues duhet t'i jepet mundësia për të kontestuar efektivisht akuzat kundër tij. SIAC, një gjykatë krejtësisht e pavarur, ishte në pozitën më të mirë për të siguruar që asnjë material të mos mbahej i pazbuluar nga të parburgosurit pa nevojë; ndërkohë që avokati special ofroi mbrojtje të rëndësishme shtesë për të kundërpeshuar mungesën e zbulimit të plotë dhe mungesën e një seance të plotë, të hapur, të kontradiktoriaritetit. GjEDNj pranoi që sekretësia e zbatuar dhe mungesa e zbulimit në lidhje me secilin kërkues ishin të justifikuar dhe proporcionale.

Megjithatë, GjEDNj gjeti që avokati special nuk mund ta kryente funksionin e tij si duhet kur materiali i hapur përbëhej vetëm nga konstatime të përgjithshme ndërsa vendimi i SIAC ishte i bazuar mbi materialin e mbyllur. Për shembull, në lidhje me disa prej kërkuesve, materiali i hapur përmbante akuza mjaft të detajuara në lidhje me, për shembull, blerjen e pajisjeve të caktuara të telekomunikimeve, për t'u mundësuar kërkuesve që t'i kontestonin në mënyrë efektive. Ndryshe nga kjo, sa u përket kërkuesve të tjerë që përballeshin me akuza që kishin qenë të përfshirë në mbledhjen e fondeve për financimin e grupeve terroriste, provat që paraqisnin lidhjet mes parave të mbledhura dhe terrorizmit nuk u zbuluan dhe prandaj ata nuk patën mundësinë që t'i kontestonin akuzat në mënyrë efektive.

Prandaj, në këtë kontekst mbrojtja thelbësore është që kërkuesit duhet t'i jepen informacione të mjaftueshme në lidhje me akuzat kundër tij në mënyrë që ai të mund t'i japë udhëzime efektive përfaqësuesit të tij ligjor.

#### **d) E drejta për shqiptimin publik të vendimeve sipas Nenit 6(1)**

Neni 6 KEDNj parashikon që "*Vendimi duhet të jepet publikisht*". E drejta për shqiptimin publik të një vendimi është e drejtë vetqëndruese sipas Nenit 6, e cila është e ndarë nga e drejta për seancë publike (diskutuar lart). Pra, nëqoftëse një seancë mbahet me dyer të mbyllura pa justifikim, shqiptimi i vendimit nuk mund të përdoret për të korrigjuar shkeljen e të drejtës për seancë publike.<sup>[174]</sup>

---

[174] Artemov k. Rusisë, vendim i 3 prillit 2014, Nr. 14945/03 tek §109.

## i) Çka përbën shqiptim publik të vendimit?

Fjalët "shqiptuar publikisht" nuk kanë nevojë të interpretohen në mënyrë të fjalëpërfjalshme, që do të thotë se vendimet përfundimtare nuk kanë nevojë të lexohen me zë të lartë në gjyq të hapur. Ka njëfarë fleksibiliteti në lidhje me mënyrën se si vendimet mund të shqiptohen. Megjithatë, fshehja e plotë nga publiku e tërësisë së një vendimi gjyqësor nuk ka gjasa që të justifikohet ndonjëherë.<sup>[175]</sup>

Forma e publicitetit e kërkuar sipas Nenit 6(1) varet nga rrethanat e një çështjeje dhe nga karakteristikat specifike të procedurave. Ajo duhet të vlerësohet nën dritën e qëllimit të tërësishëm të dispozitës, që është sigurimi i këqyrjes së gjyqësorit nga publiku për të ndihmuar mbrojtjen e të drejtës për proces të rregullt dhe ruajtjen kundër arbitraritetit.<sup>[176]</sup> Gjykatat gjithashtu duhet të marrin parasysh kriteret e Nenit 8 KEDNj gjatë interpretimit dhe implementimit të së drejtës për publicitet sipas Nenit 6 (diskutuar poshtë).

Përgjithësisht, më së pakti, publiku duhet të jetë në gjendje të ketë qasje në të paktën pjesët operative të një vendimi përfundimtar. Prandaj, koncepti i shqiptimit publik mund të përfshijë depozitimin e tekstit të një vendimi në regjistrin ose uebfaqen e gjykatës ku mund të qaset secili.<sup>[177]</sup> Në kontekstin penal, kjo mund të përfshijë leximin e dënimit penal në seancë publike dhe më vonë depozitimi i arsytimit të vendimit në regjistrin e gjykatës, kur dënimi i lexuar përmban informacione të mjaftueshme në lidhje me akuzat, gjetjen e fajësisë, praninë e rrethanave rënduese dhe ndëshkimin e caktuar.<sup>[178]</sup>

Natyra e procedurave në tërësi është relevante për përcaktimin nëse kriteri i shqiptimit publik është respektuar. Kjo përfshin moshën dhe cenueshmërinë e palëve të përfshira, nëse ka ndonjë autoritet publik si palë në çështje, dhe shkallën deri ku ndonjëra prej fazave të procedurave është zhvilluar me publik.

Për shembull, në rastet e çështjeve mes palëve individuale lidhur me rezidencën e fëmijëve, dhe kur tashmë është gjetur e justifikuar seanca me dyer të mbyllura, qasja në urdhrat dhe vendimet e gjykatës ku përmbahen informacione private

---

[175] *Raza k. Bullgarisë*, vendim i 11 shkurtit 2010, Nr. 31465/08 tek §53.

[176] *Pretto dhe Të tjerë k. Italisë*, vendim i 8 dhjetorit 1983 tek §§21 dhe 26; *Raza k. Bullgarisë*, vendim i 11 shkurtit 2010, Nr. 31465/08 tek §53.

[177] *Pretto dhe Të tjerë k. Italisë*, vendim i 8 dhjetorit 1983 tek §§27-28.

[178] *Crociani dhe Të tjerë k. Italisë (dec.)*, vendim i 18 dhjetorit 1980, Nr. 8603/79, 8722/79, 8723/79 dhe 8729/79.

rreth rezidencës së fëmijëve mund të kufizohet duke u lejuar qasje vetëm atyre që kanë interes të vërtetuar.<sup>[179]</sup> Në rrethana të tilla, gjykatat duhet së paku të marrin vendime me interes të veçantë të hapura për publikun e gjerë.<sup>[180]</sup> Nga ana tjetër, kur një autoritet shtetëror është palë në procedurë, ka nevojë të shtuar që vendimi të jetë i hapur për krejt publikun, dhe kufizimi i qasjes për ata që kanë interes ligjor në çështje ka më pak gjasa të jetë në pajtueshmëri me Nenin 6.<sup>[181]</sup> Ka rëndësi të veçantë në kontekstin e procedurave kundër autoriteteve shtetërore për publikun (si dhe për palët) që të kenë qasje në arsyetimin e vendimit, përveç pjesëve operative.<sup>[182]</sup>

## Rastet e Sigurisë Kombëtare

Në kontekstin e çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, nganjëherë mund të jetë e nevojshme të klasifikohen disa pjesë të një vendimi të cilat u referohen materialeve konfidenciale. Megjithatë, fshehja e plotë nga publiku e tërësisë së një vendimi gjyqësor në procedura të tilla nuk mund të shihet si e nevojshme. Shtetet duhet të klasifikojnë / redaktojnë vetëm pjesë të vendimeve të tyre zbulimi i të cilave do të komprometonte sigurinë kombëtare ose sigurinë e të tjerëve. Ata duhet të miratojnë teknika për të adresuar shqetësimet legjitime pa mohuar krejtësisht garancitë procedurale themelore siç është publiciteti i vendimeve gjyqësore.<sup>[183]</sup>

---

[179] *B. dhe P. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 prillit 2001, Nr. 36337/97 dhe 35974/97 tek §47 (përfshirë si përmblendhje në këtë publikim). Shih gjithashtu *Sutter k. Zvicrës*, vendim i 22 shkurtit 1984, Nr. 8209/78, ku, duke marrë parasysh natyrën e veçantë të procedurave ushtarake, Gjykata gjeti se kriteri i publicitetit u plotësua nga fakti që kushdo që vërtetonte se kishte interes mund të merrte një kopje të tekstit të plotë të Gjykatës Ushtarake të Kasacionit. Po ashtu qe relevante që seanca publike ishte mbajtur vetëm nga gjykata e shkallës më të ulët.

[180] *B. dhe P. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 prillit 2001, Nr. 36337/97 dhe 35974/97 tek §47; *Sutter k. Zvicrës*, vendim i 22 shkurtit 1984, Nr. 8209/78 tek §34 (përfshirë si përmblendhje në këtë publikim).

[181] *Moser k. Austrisë*, vendim i 21 shtatorit 2006, Nr. 12643/02 tek §§101-103, çështja kishte të bënte me transferimin e kujdestarisë së një fëmije tek shteti, ndryshe prej çështjes *B. dhe P. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 prillit 2001, Nr. 36337/97 dhe 35974/97 (përfshirë si përmblendhje në këtë publikim) e cila ishte mosmarrëveshje mes dy individëve.

[182] *Ryakib Biryukov k. Rusisë*, vendim i 17 janarit 2008, Nr. 14810/02.

[183] *Raza k. Bullgarisë*, vendim i 11 shkurtit 2010, Nr. 31465/08 tek §53; *Vasil Vasilev k. Bullgarisë*, vendim i 16 nëntorit 2021, Nr. 7610/15; *Fazliyski k. Bullgarisë*, vendim i 16 prillit 2013, Nr. 40908/05.

## Seancat që kanë të bëjnë me Vëzhgimin e Gjykatës dhe Interceptimin e Provave

Shtetet gjithashtu mund të kufizojnë shkallën deri ku një vendim bëhet publik në kontekstin e gjyqeve penale ku përfshihen prova të marra nga operacionet e fshehta të policisë. Njihet që Shtetet kanë interes legjitim në ndjekjen penale të veprave dhe që ato mund të duhet të marrin masa për të mbajtur sekrete metodat e policisë për vëzhgim dhe hetime. Në këtë kontekst, kur publikimi i arsytimit të një vendimi do të paragjykonte operimin efektiv të hetimeve sekrete të policisë dhe metodat e tyre të vëzhgimit, gjykatave u lejohet të kufizojnë qasjen në vendimin e plotë (përfshirë arsytimin e tij) vetëm me palët. Megjithatë, gjykatat duhet gjithsesi t'i bëjnë publike pjesët operative të vendimeve të tyre, përfshirë informacione rreth kërkuesve, akuzat kundër tyre dhe klasifikimet e tyre, gjetjet lidhur me fajësinë e tyre, dënimin dhe urdhrin për kostot.<sup>[184]</sup>

### ii) Marrja e vendimeve përfundimtare: Vënia e ekuilibrit mes procesit të rregullt dhe mbrojtjes së të dhënave

Shqiptimi publik i një vendimi ka potencialin që të shkelë të drejtat për mbrojtjen e të dhënave personale, integritetin fizik dhe moral, reputacionin dhe nderin e atyre që përmenden në vendim. Shqiptimi publik i një vendimi nuk duhet të ndërhyjë tek këto të drejta përtej shkallës ku është e nevojshme që të synojë një qëllim legjitim.

### Kur angazhohet Neni 8?

Në këtë kontekst, mbrojtjet nga Neni 8 shtrihen jo vetëm tek palët në procedura, por edhe tek çdo palë e tretë së cilës i përmendet identiteti ose informatat personale në vendim.<sup>[185]</sup>

Neni 8 angazhohet kur një person identifikohet me emër në një vendim krahas informacioneve që hyjnë brenda prizmit të të dhënave personale (siç përshkruhet më lart në këtë publikim) ose deklaratave të cilat dëmtojnë reputacionin ose nderin e tij.<sup>[186]</sup> Gjithashtu, ai angazhohet edhe kur një person nuk identifikohet

[184] *Welke dhe Białek k. Polonisë*, vendim i 1 marsit 2011, Nr. 15924/05 tek §§83-84.

[185] *Z. k. Finlandës*, vendim i 25 shkurtit 1997, Nr. 22009/93; *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendim i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[186] *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendim i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

me emër por është i identifikueshëm si rezultat i informacioneve të tjera të publikuara në një vendim. Për shembull, kur një individ të dhënat personale të të cilit diskutohen në një vendim përmendet si bashkëshort ose familjar i një personi që emërtohet në vendim, duke u bërë kështu i identifikueshëm përmes lidhjes.<sup>[187]</sup>

Megjithatë, Neni 8 nuk mund të përdoret si bazë për ankesë për humbjen e reputacionit, i cili është pasojë e parashikueshme e veprimeve të vetë personit. Për shembull, një individ nuk mund të ankohet mbi bazën e Nenet 8 që reputacioni i tij është paragjykuar nga publikimi i një vendimi në të cilin ai dënohet për një vepër penale, ose i cili gjen se ai e ka kryer sjelljen për të cilën është akuzuar gjatë procedurave.<sup>[188]</sup>

## Qëllimi Legjitim

Publikimi i informatave personale relevante në një vendim mund të shërbejë si qëllim legjitim në sigurimin e transparencës së procedurave të gjykatës, e rrjedhimisht ruajtjen e besimit publik tek gjykatat.<sup>[189]</sup> Publikimi i informatave rreth sjelljes së një personi po ashtu mund t'i shërbejë qëllimit të "mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve" duke njohur dhe zbuluar publikisht faktet si mënyrë riparimi për dëmet e pësuar nga viktimat prej asaj sjelljeje dhe në interes të administrimit të duhur të drejtësisë.<sup>[190]</sup>

## Proporcionaliteti

Për të vlerësuar nëse një ndërhyrje tek Neni 8 është proporcionale në këtë kontekst, është e nevojshme që të ekzaminohet nëse ka arsye të mjaftueshme e konkrete për të justifikuar zbulimin e informatave personale. Kjo përfshin

---

ku kërkuesi u përmend me emër në vendim dhe u përshkrua si person që kishte kryer një sjellje e cila përbënte ngacmim psikologjik dhe bullizim.

[187] *Z. k. Finlandës*, vendim i 25 shkurtit 1997, Nr. 22009/93, ku kërkuesja nuk u përmend me emër në vendim por emri i plotë i burrit të saj u përmend, çka do të thotë se referenca ndaj "gruas" së tij si "bartëse e virusit HIV" shkeli të drejtat e saj nga Neni 8 për privatësi dhe jetë familjare.

[188] *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendim i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13 tek §41 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[189] *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendim i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13 tek §45 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[190] *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendim i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13 tek §45 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

ekzaminimin nëse gjykata e ka pasur aftësinë të marrë masa mbrojtëse të cilat do të kishin kufizuar impaktin mbi të drejtat e një personi për jetë private dhe familjare, gjithnjë duke ruajtur respektin për parimin e publicitetit sipas Nenit 6(1).

Për shembull, gjykatat mund të anonimizojnë vendimet duke hequr emrat që lejojnë identifikimin e një individi dhe duke i zëvendësuar ato me iniciale. Ato po ashtu mund të publikojnë një version të shkurtuar të vendimit, ku përmbahen pjesët operative të vendimit dhe çdo analizë ligjore relevante, duke kufizuar ndërkohë qasjen në arsyetimin e plotë të vendimit.<sup>[191]</sup>

Shtetet shkelin Nenin 8 nëqoftëse gjykatat e kanë mundësinë për të marrë masa të tilla por zgjedhin të mos i marrin, pa dhënë ndonjë arsye konkret përse.<sup>[192]</sup> Faktorët e mëposhtëm po ashtu kanë rëndësi gjatë vlerësimit të proporcionalitetit në këtë kontekst:

- » Nëse informatat personale kanë qenë relevante / vendimtare për përfundimin e vendimit.<sup>[193]</sup>
- » Impakti i zbulimit tek personi në fjalë, përfshirë impaktin mbi situatën e tij personale dhe profesionale, nderin dhe reputacionin, dhe shkallën deri ku mund t'i shkaktonte stigmatizim ose tëhuajzim nga komuniteti i tij.<sup>[194]</sup>
- » Shtrirja e mbulimit medial dhe interesi publik për çështjen, dhe madhësia e mundshme e publikut që e lexon vendimin.<sup>[195]</sup>
- » Kur vendimi i referohet një pale të tretë, nëse ka mbrojtje procedurale efektive siç është procedura e njoftimit për të informuar personin rreth procedurave, dhe ekzistenca e një mekanizmi që i mundëson personit të kërkojë mos-zbulimin e identitetit të tij ose informatave personale para publikimit të vendimit.<sup>[196]</sup>

---

[191] *Z. k. Finlandës*, vendim i 25 shkurtit 1997, Nr. 22009/93; *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendim i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[192] *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendim i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *C.C. k. Spanjës*, vendim i 6 tetorit 2009, Nr. 1425/06.

[193] *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendim i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13 tek §§47 dhe 49 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[194] *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendim i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13 tek §48 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[195] *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendim i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13 tek §§48 dhe 54 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[196] *Vicent Del Campo k. Spanjës*, vendim i 6 nëntorit 2018, Nr. 25527/13 tek §53 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

### iii) Anonimizimi i vendimeve

---

Ky seksion ofron një shikim krahasues të procedurave të ndjekura nga disa gjykata (në nivel evropian dhe vendor) për të qeverisur anonimizimin e vendimeve të tyre dhe për të ndihmuar të sigurohen që publikimi i vendimeve nuk ndërhyt në masë të panevojshme tek të drejtat e Nenit 8.

### Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Të gjitha informacionet në procedurat para GjEDNJ-së janë publike, nëqoftëse nuk autorizohet anonimiteti nga ajo gjykatë. Kërkesa për anonimitet mund të bëhet nga kërkuesi në lidhje me identitetin e tij dhe dokumentet në procedurat në formularin e aplikimit ose sa më shpejt pas kësaj. Megjithatë, GjEDNJ po ashtu mund të veprojë me mocion të saj. Nëqoftëse një kërkues bën kërkesë për anonimitet, ai duhet të japë arsye me shkrim ku të justifikojë derogimin nga rregulla normale e qasjes publike dhe të specifikojë impaktin që publikimi i vendimit mund të ketë mbi të.

Rregullat procedurale të GjEDNJ-së po ashtu lejojnë kërkesat retroaktive për anonimitet. Nëse kërkuesi dëshiron ta bëjë një kërkesë të tillë, ai duhet të shpjegojë arsyet dhe të specifikojë impaktin e publikimit, dhe po ashtu të shpjegojë përse anonimiteti nuk është kërkuar gjatë kohës së procedimit të çështjes para GjEDNJ-së. Kryetari do t'i shqyrtojë shpjegimet e kërkuesit, nivelin e publicitetit që ka marrë çështja, dhe nëse është e përshtatshme ose praktike që ta lejojë kërkesën. Nëqoftëse Kryetari e autorizon kërkesën, ai gjithashtu vendos hapat që duhen ndërmarrë për të mbrojtur kërkuesin nga identifikimi.

Për të mbrojtur jetën private, Kryetari gjithashtu lejohet të "marrë çdo masë tjetër që e konsideron të nevojshme ose të dëshirueshme" në lidhje me publikimet e GjEDNJ-së.<sup>[197]</sup>

---

[197] Rregulla 47 e Rregullave të Gjykatës datë 23 qershor 2023, gjendet tek <https://t.ly/HKYxc>. §12(a) e direktivës për praktikantët e Institutit të Procedurave të 1 nëntorit 2003 dhe e ndryshuar më 22 shtator 2008, 24 qershor 2009, 6 nëntor 2013, 5 tetor 2015, 27 nëntor 2019, 25 janar 2021 dhe 1 shkurt 2022. Kjo direktivë praktike plotëson Rregullat 45 dhe 47, që gjenden tek <https://t.ly/HKYxc>, fq. 60-62. Kërkesat për praktikantët e anonimitetit të bëra nga Kryetari i Gjykatës në përputhje me Rregullën 32 të Rregullores së Gjykatës më 14 janar 2010, që gjendet tek <https://t.ly/HKYxc>, fq. 73.

## Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian

Kur anonimiteti është dhënë nga gjykata referuese, GjDBE e respekton atë. Po ashtu, GjDBE mund të japë anonimitet edhe në lidhje me të dhënat personale me kërkesë të gjykatës referuese, si pjesë e procedurës kryesore ose me mocion të saj. Anonimiteti mund të jetë në lidhje me një ose disa persona apo entitete të lidhura me çështjen.<sup>[198]</sup>

Në Udhëzimet Praktike<sup>[199]</sup> për palët, GjDBE thekson se si rregull i përgjithshëm ajo i trajton çështjet në formë të anonimizuar me qëllim që të mbrojtë të dhënat personale. Nëqoftëse një palë në procedura dëshiron të anonimizojë identitetin e saj ose detaje të caktuara, ajo palë mund të bëjë kërkesë për këtë pranë GjDBE-së. Më pas GjDBE vendos nëse ta anonimizojë çështjen relevante tërësisht apo pjesërisht, apo ta mbajë anonimitetin ashtu siç është.

Kërkesa për anonimitet duhet të bëhet sa më shpejt që është e mundur në procedurë, sepse anonimiteti bëhet i vështirë pasi personave të interesuar u serviren njoftimi për çështjen ose kërkesa për vendim paraprak, rreth një muaj pasi kërkesa është depozituar në GjDBE.

## Mbretëria e Bashkuar

Mbretëria e Bashkuar (MB) i përpunon të dhënat në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave; megjithatë, të drejtat e qasjes së subjektit sipas Rregullores së Përgjithshme të MB-së për Mbrojtjen e të Dhënave nuk i aplikohet të dhënave personale të përpunuara nga gjyqësori në ushtrimin e funksioneve gjyqësore.<sup>[200]</sup>

Rregulla e përgjithshme është që procedurat e gjykatës zhvillohen publikisht, ku publiku dhe mediat kanë të drejtë të marrin pjesë, dhe mediat mund të raportojnë rreth procedurave në mënyrë të plotë dhe në kohë reale. Çdo kufizim ndaj kësaj rregulle është përjashtim: ai duhet të jetë i nevojshëm dhe proporcional.<sup>[201]</sup> Kur

---

[198] Neni 95 i Rregullores së Procedurave të Gjykatës së Drejtësisë i 25 shtatorit 2012, i ndryshuar më 18 qershor 2013, më 19 korrik 2016, më 9 prill 2019 dhe më 26 nëntor 2019, tek: <https://t.ly/lWB7g>.

[199] §§7-9 e Direktivës Praktike për Palët në lidhje me Çështjet e sjella para Gjykatës e 14 shkurtit 2020, tek <https://t.ly/lWB7g>.

[200] Lordi Kryegjyqtar i Anglisë dhe Uejllsit dhe Kryetari i Lartë e Tribunaleve, "Gjyqësori dhe Mbrojtja e të Dhënave: njoftimi i privatësisë", tek: [https://t.ly/qhG\\_j](https://t.ly/qhG_j).

[201] Kolegji Gjyqësor, "Raportimi i Kufizimeve në Gjykatat Penale" (shtator 2022), fq. 9, tek: <https://tinyurl>.



ky kriter plotësohet, gjykata mund të kufizojë të dhënat personale në vendim, mund të zhvillojë procedura ligjore private, ose të vendosë kufizime mbi qasjen në dosjet e gjykatës. Çdo vendim lidhur me kufizimet mund të merret vetëm gjatë procedurave ligjore.<sup>[202]</sup>

Në procedura penale, gjykata mundet, me iniciativën e vet ose me kërkesë të një pale, të kufizojë raportimin rreth ose qasjen në seancë ose të mos japë informacione në një seancë publike. Pala duhet ta bëjë një kërkesë të tillë me shkrim sa më shpejt, duke theksuar derogimin që duhet të bëjë gjykata nga rregulla e përgjithshme dhe duke shpjeguar përse është e nevojshme. Për shembull, sa i përket raportimit të informacioneve të caktuara në procedura penale lidhur me jetën e dëshmitarëve dhe viktimave nën moshën 18-vjeçare, pala duhet të shpjegojë përse këto kufizime do të përmirësonin cilësinë e provave duke pasur parasysh nivelin e bashkëpunimit nga dëshmitari ose viktimja. Faktorët që duhen marrë në konsideratë, mes të tjerash, janë natyra dhe rrethanat e supozuara të veprës, moshja e dëshmitarit ose viktimës, sfondi social dhe kulturor i tij/saj dhe prejardhja etnike. Informacionet që mund të mos raportohen përfshijnë emrin, adresën, institucionet arsimore të ndjekura dhe vendi i punës së dëshmitarit ose viktimës.<sup>[203]</sup>

Në rrethana të jashtëzakonshme, procedurat penale mund të zhvillohen në formë private. Pala që e kërkon këtë duhet ta bëjë kërkesën jo më pak se pesë ditë pune para gjyqit, me shpjegimin përse procedurat private janë të nevojshme dhe përse masat e tjera nuk mjaftojnë. Testi është nëse procedimi në formë private është i nevojshëm për të shmangur ngushtimin ose vështirësimin e administrimit të drejtësisë. Nuk mjafton që procedura publike do t'i shkaktonte turpërim ose dëm reputacionit të individit. Kriteri nuk plotësohet nëqoftëse pasoja e procedurës private do të ishte gjyq i padrejtë. Mediave u jepet mundësia për përfaqësim.<sup>[204]</sup>

---

com/3endbhpk.

[202] Lordi Kryegjyqtar i Anglisë dhe Uejllsit dhe Kryetari i Lartë e Tribunaleve, "Gjyqësori dhe Mbrojtja e të Dhënave: njoftimi i privatësisë", tek: [https://t.ly/qhC\\_j](https://t.ly/qhC_j).

[203] Seksioni 45A i Ligjit për Drejtësinë e të Rinjve dhe Provat Penale i vitit 1999; rregulla 6.4 e Rregullores së Procedurës Penale 2020.

[204] Rregullat 6.6-6.7 e Rregullores së Procedurës Penale 2020; Kolegji Gjyqësor, "Raportimi i Kufizimeve në Gjykatat Penale", 2022, fq. 11-12, tek: <https://tinyurl.com/3endbhpk>.

## Gjermania

Gjykata Federale Kushtetuese e Gjermanisë mund të ofrojë informacione nga ose të lejojë qasje në dosjet e saj për:

- » Entitetet publike, deri në shkallën ku është e nevojshme për administrimin e drejtësisë (mes arsyeve të tjera); dhe
- » Individët dhe entitetet e tjera jo-publike pasi procedurat përfundojnë, për sa kohë që ato mund të vërtetojnë se kanë interes legjitim dhe që të dhënat e palëve të treta janë të mbrojtura.

Qasja në dosje jepet vetëm kur informacioni i ofruar nga dosjet është i pamjaftueshëm për t'i kërkuar entitetit publik të kryejë detyrat e veta ose kur nuk do të plotësonte interesat legjitime të individit ose entitetit jo-publik, ose kur dhënia e informacionit do të kërkonte një përpjekje joproporcionale.

Kur informacioni i kërkuar nuk është pjesë e dosjes së lëndës, pala kërkuese duhet të tregojë që entiteti dosjet e të cilit po trajtohen ka dhënë pëlqimin që ai informacion t'i përcillet asaj pale.

Të dhënat personale të mbajtura nga Gjykata Federale Kushtetuese në dosjet e saj janë të mbrojtura nga ligji për mbrojtjen e të dhënave të përgjithshme. Prandaj, subjektet kanë të drejtë të kenë qasje në të dhënat e tyre personale për të korrigjuar pasaktësitë. Megjithatë, fshirja e të dhënave personale mund të kërkohet vetëm kur të dhënat personale nuk duhen më (p.sh. procedurat gjyqësore kanë përfunduar dhe periudhat statutores të ruajtjes nuk aplikohen më ose janë përmbyllur), ato janë përpunuar në mënyrë të ligjshme ose pëlqimi është tërhequr.

### iv) Anonimizimi i vendimeve dhe Neni 10 KEDNJ

Çështja kryesore në këtë fushë është vendimi i kohëve të fundit i Dhomës së Madhe në *Hurbain k. Belgjikës*,<sup>[205]</sup> i cili adresohet në seksionin poshtë.

---

[205] *Hurbain k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 korrikut 2023, Nr. 57292/16 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

# Kapitulli 5

## E drejta për t'u harruar dhe e drejta për fshirje

### E drejta për t'u harruar

Përmbajtjet gjithnjë në zhvillim e sipër, dhe rëndësia për individin, e “të drejtës për t'u harruar” – apo e drejta për fshirjen e të dhënave – u vu në pah kohët e fundit nga Dhoma e Madhe në çështjen *Hurbain k. Belgjikës*. Dhoma e Madhe deklaroi që:

*“Ka shumë vite që, me zhvillimin e teknologjisë dhe mjeteve të komunikimit, një numër gjithnjë e më i madh njerëzish kanë nisur të kërkojnë mbrojtjen e interesave të tyre sipas asaj që quhet “e drejta për t'u harruar”. Kjo bazohet mbi interesin e individit për të pasur fshirjen ose modifikimin e, ose kufizimin e qasjes në, informacione të kaluara që ndikojnë tek mënyra se si personi perceptohet në të tashmen. Duke kërkuar që ato informacione të hiqen, personat në fjalë dëshirojnë që të mos përballen me veprimet ose deklaratat e tyre publike të kaluara, në një sërë kontekstesh, për shembull kur kërkojnë punë dhe në marrëdhëniet biznesore.”[206]*

Dhoma e Madhe njohu që informacionet personale që publikohen dhe qëndrojnë në internet për një kohë mund të kenë impakt të shtrirë negativ mbi mënyrën se si personi në fjalë perceptohet nga opinioni publik.<sup>[207]</sup> Gjithashtu, ka rreze të tjera, siç është rreziku i përmbledhjes së informacionit i cili mund të çojë tek krijimi i një profili të personit në fjalë dhe më tej tek fakti që personat që

[206] *Hurbain k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 korrikut 2023, Nr. 57292/16 tek §191 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[207] *Hurbain k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 korrikut 2023, Nr. 57292/16 tek §192 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

lexojnë artikullin online mund të nxjerrin nga konteksti një pamje të fragmentuar dhe të shtrembëruar të realitetit. Po ashtu, ekziston kërcënimi i vazhdueshëm dhe frika rezultuese që individi në fjalë mund të përballet papritmas me të kaluarën e tij/saj në çdo moment.

Dhoma e Madhe theksoi se koncepti i të drejtës për t'u harruar ka shumë aspekte dhe është ende në konstruktivitet sipër.<sup>[208]</sup> Dhoma e Madhe po ashtu theksoi se kjo e drejtë mund t'i japë shkas në praktikë masave të ndryshme të cilat mund të merren nga operuesit e makinave të kërkimit online ose nga publikues të rinj.<sup>[209]</sup> Këto mund të kenë lidhje qoftë me përmbajtjen e një artikulli të arkivuar (p.sh. heqja, modifikimi ose anonimizimi i artikullit) qoftë me kufizimet e qasjes në informacion. Në rastin e këtij të fundit, kufizimet e qasjes mund të vihen si nga makinat e kërkimit ashtu edhe nga publikuesit e lajmeve. Dhoma e Madhe sqaroi që ajo do të përdorte termin “deindeksim” për të përcaktuar masat e marra nga publikuesi i lajmeve përgjegjës për uebfaqen në të cilën ishte arkivuar artikulli në fjalë.

Fokusi në këtë seksion është tek procedurat hetimore dhe gjyqësore. Çështjet në këtë fushë janë ngritur në dy kontekste të gjera. Së pari, çështjet e dala nga operimi i sistemit penal dhe civil të Shtetit dhe mbajtja e regjistrave përkatës. Së dyti, çështjet në lidhje me gazetarët dhe gazetatat, dalë nga përmbajtjet e publikuara rreth individëve që kanë qenë objekt i hetimeve ose procedurave penale ose civile. Çështjet kyçe mund të detajohen në kategoritë e mëposhtme:

- 1) Individë të cilët kanë qenë nën hetime nga policia, ose kanë qenë të dyshuar ose të akuzuar për kryerjen e një vepre penale ose civile.
- 2) Individë të cilët janë dënuar për një vepër.
- 3) Individë për të cilët shërbimet e sigurimit kanë mbledhur dhe ruajtur informacione.
- 4) Individë të cilët kanë qenë objekt i mbulimit gazetaresk si pasojë e hetimeve, arrestimit ose dënimit.

---

[208] *Hurbain k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 korrikut 2023, Nr. 57292/16 tek §194 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[209] *Hurbain k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 korrikut 2023, Nr. 57292/16 tek §175 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

## Burimet e të drejtës për t'u harruar

Në çështjet e Konventës, individët të cilët kanë kërkuar t'u fshihet informacioni rreth tyre në domenin publik janë mbështetur tek Neni 8, e drejta për respektim të jetës private dhe familjare. Në lidhje me këtë, Dhoma e Madhe deklaroi në *Hurbain* që pretendimi që personit i takon të harrohet nuk përbën të drejtë vetqëndruese të mbrojtur nga Konventa dhe, për aq sa mbulohet nga Neni 8, mund të ndërlidhet vetëm me situata të caktuara dhe për informacione të caktuara.<sup>[210]</sup>

Dhoma e Madhe përmendi instrumentet ndërkombëtare kyçe në lidhje me të drejtën për t'u harruar në paragrafët 17-80 të vendimit të saj. Këtu përfshihen disa nga instrumentet kryesore të mbrojtjes së të dhënave të diskutuara në pjesën 2 të këtij publikimi, siç është Konventa 108, konventa 108+ dhe GDPR.

Ajo gjithashtu përfshin instrumente që ndërlidhen më ngusht me të drejtën për t'u harruar, siç janë:

### *Instrumenti i Kombeve të Bashkuara*

- » Deklarata Universale për Arkivat u iniciua nga Këshilli Ndërkombëtar për Arkivat dhe u miratua nga UNESCO më 10 nëntor 2011. Kjo deklaratë jodetyruese ofron përkufizimin e arkivave që përfshijnë të gjitha vendimet e regjistruara, veprimet dhe dokumentet zyrtare në të gjitha formatet përfshirë në letër, dixhitale dhe audiovizuale. Qëllimet që identifikohen aty përfshijnë garancinë që arkivat të jenë (i) të menaxhuara dhe të ruajtura në mënyra që sigurojnë autenticitetin, integritetin dhe përdorshmërinë, dhe (ii) në dispozicion për të gjithë, duke respektuar ligjet përkatëse dhe të drejtat e individëve.

### *Instrumentet e Këshillit të Evropës*

- » Rekomandimi Nr. R (2000) 13 i Komitetit të Ministrave, i cili rekomandon që Shtetet të miratojnë ligje për qasjen në arkiva të cilat balancojnë kriteret konfliktuozë të transparencës dhe sekretësisë, mbrojtjes së privatësisë dhe qasjes në informacione historike.

---

[210] *Hurbain k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 korrikut 2023, Nr. 57292/16 tek §199 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

- » Rekomandimi Rec(2003)13 i Komitetit të Ministrave për ofrimin e informacioneve përmes mediave në lidhje me procedurat penale, i cili thekson rëndësinë e raportimit nga mediat në informimin e publikut rreth procedurave penale, duke e bërë të dukshëm funksionin pengues të së drejtës penale dhe duke siguruar këqyrjen publike të funksionimit të sistemit të drejtësisë penale.
- » Rekomandimi Rec (2012) i Komitetit të Ministrave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në lidhje me makinat e kërkimit, i cili, ndërkohë që thekson rëndësinë e makinave të kërkimit për gjetjen e përmbajtjeve të dobishme në internet, njëkohësisht thekson impaktin e makinave të kërkimit tek e drejta për jetë private dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, që del nga fakti që këto makina kërkimi janë të kudondodhura dhe i ruajnë të dhënat.

#### *Instrumentet dhe udhëzimet e Bashkimit Evropian*

- » Udhëzuesit e Bordit të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave 5/2019 mbi kriteret e së Drejtës për t'u Harruar në makinat e kërkimit sipas GDPR, 7 korrik 2020.
- » Udhëzuesit për implementimin e vendimit të GjDBE-së në çështjen *Google Spain SL dhe Google Inc k. Agencia Espanola de Proteccion de Datos and Gonzalez*,<sup>[211]</sup> miratuar më 26 nëntor 2014.

### **Domethënia e lirisë së shprehjes për lirinë për t'u harruar**

Gazetarët dhe gazetat kanë kërkuar të mbështeten tek liria e shprehjes sipas Nenit 10 për t'i rezistuar kërkesave individuale për fshirje ose, si tek *Hurbain*, anonimizimit të artikujve. Në këto raste, Gjykata ka njohur tensionet mes Nenit 8 dhe Nenit 10, dhe ka konsideruar nëse gjykatat vendase kanë identifikuar dhe angazhuar mjaftueshëm konsideratat përkatëse gjatë marrjes së vendimeve të tyre.

Dhoma e Madhe në *Hurbain* theksoi rëndësinë e lirisë së shprehjes.<sup>[212]</sup> Ajo përsëriti që liria e shprehjes përbën një prej themeleve thelbësore të shoqërisë demokratike dhe një prej kushteve bazë për avancimin e saj dhe për vetpërbushjen

[211] (C-131/12) *Google Spain SL dhe Google Inc k. Agencia Espanola de Proteccion de Datos dhe Gonzalez*, vendim i Dhomës së Madhe i 13 majit 2014.

[212] *Hurbain k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 korrikut 2023, Nr. 57292/16 tek §§176-179 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

e individëve. Ajo deklaroi se, sa i përket lirisë së shtypit, megjithëse shtypi nuk duhet t'i kalojë disa kufij të caktuar, sidomos kur bëhet fjalë për reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve, detyra e tij sidoqoftë është përcëmi – në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e tij – të informacioneve dhe ideve mbi të gjitha çështjet me interes publik. Kështu, detyra e përcimit të informacioneve domosdoshmërisht që përfshin detyra e përgjegjësi si dhe kufij të cilët shtypi duhet t'ia vërë vetes në mënyrë spontane. Publiku gjithashtu ka të drejtë t'i marrë këto informacione dhe ide. Shtypi po ashtu duhet të jetë në gjendje të luajë rolin jetik të “rojtarit publik”, dhe duhen arsye shumë të forta për çdo masë që kufizon qasjen në informacione të cilat publiku ka të drejtë t'i marrë. Dhoma e Madhe theksoi se nuk i takonte Gjykatës, aq sa nuk i takonte as gjykatave vendase, që të zëvendësonte pikëpamjet e veta me ato të shtypit në lidhje me teknikat e raportimit që duhen përdorur në një rast të caktuar apo mënyrat se si duhet ushtruar profesioni, përfshirë mënyrën e transmetimit të opinioneve ose informacioneve.

Dhoma e Madhe parashtroi me hollësi rëndësinë e ruajtjes së arkivave. Ajo theksoi se, krahas funksionit primar të shtypit si “rojtari publik”, shtypi ka gjithashtu një rol dytësor të vlefshëm për mbajtjen e arkivave me lajme që janë raportuar përpara dhe për t'i vënë ato në dispozicion të publikut.<sup>[213]</sup> Arkivat në internet japin kontribut të madh në ruajtjen dhe vënien në dispozicion të lajmeve dhe informacioneve. Arkivat dixhitale përbëjnë burim të rëndësishëm edukimi dhe hulumtimi historik, sidomos për faktin që janë të gatshme për publikun dhe përgjithësisht falas. Ky funksion i shtypit, ashtu si interesi legjitim i publikut në arkiva, është i mbrojtur nga Neni 10.

Edhe në kontekstin e një publikimi shpifës Dhoma e Madhe theksoi se Gjykata ka deklaruar që nuk është roli i autoriteteve gjyqësore të merren me rishkrimin e historisë duke urdhëruar heqjen nga domeni publik të të gjitha gjurmëve të publikimeve që në të kaluarën janë gjetur, me vendime gjyqësore përfundimtare, se përbëjnë sulme të pajustificuara kundër reputacioneve individuale.

Dhoma e Madhe vuri në dukje se gjatë dekadës së fundit është shfaqur konsensus në lidhje me rëndësinë e arkivave të shtypit. Në kontekstin e përpunimit të të dhënave personale në nivel të Bashkimit Evropian, GDPR parashikon në mënyrë eksplicite përjashtimin nga e drejta për fshirjen e të dhënave personale kur përpunimi i të dhënave është i nevojshëm për ushtrimin e të drejtës për

---

[213] *Hurbain k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 korrikut 2023, Nr. 57292/16 tek §§180 dhe 182-186 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

lirinë e shprehjes dhe informacionit. Ai u kërkon Shteteve Anëtare të BE-së që të parashikojnë përjashtime ose derogime në ligjet e tyre për përpunimin e të dhënave për qëllime gazetareske nëse janë të nevojshme për të pajtuar të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale me lirinë e shprehjes dhe informacionit. Në të njëjtën linjë, në kontekstin e Këshillit të Evropës, raporti shpjegues i Konventës 108+ specifikon që përjashtimet dhe kufizimet e parashikuara në Nenin 11 të asaj Konvente duhet të aplikohen në mënyrë të veçantë gjatë përpunimit të të dhënave personale në arkivat e lajmeve dhe në bibliotekat e shtypit.

Dhoma e Madhe theksoi se që, meqenëse roli i arkivave është të sigurojnë qenien në dispozicion të informacioneve të publikuara ligjërisht në kohë të caktuara, ato duhet, si rregull i përgjithshëm, të mbeten autentike, të besueshme dhe të plota. Integriteti i arkivave të shtypit duhet të jetë parimi që udhëheq shqyrtimin e çdo kërkesë për heqjen ose modifikimin e të gjithë ose një pjese të një artikulli të arkivuar i cili i kontribuon ruajtjes së kujtesës, sidomos nëse (siç ishte rasti në *Hurbain*) ligjshmëria e artikullit nuk u vu në pikëpyetje në asnjë moment. Autoritetet kombëtare duhet të jenë veçanërisht vigjilente gjatë shqyrtimit të kërkesave, duke u bazuar në respektimin e jetës private, për heqjen ose modifikimin e versionit elektronik të një artikulli të arkivuar ligjshmëria e të cilit nuk u vu në diskutim asnjëherë në kohën e publikimit të tij fillestar. Për kërkesa të tilla duhen bërë shqyrtime të hollësishme.

### **Analiza e Gjykatës gjatë përcaktimit nëse ka pasur shkelje të së drejtës për t'u harruar**

Në secilën çështje që ka përpara, Gjykata bën analizën e saj të zakonshme për të përcaktuar nëse ka pasur shkelje të ndonjë të drejte të Konventës. Fazat e analizës janë si vijon:

- 1) Nëse ka pasur ndërhyrje.
- 2) Nëse ndërhyrja ka qenë në përputhje me ligjin.
- 3) Nëse ka pasur qëllim legjitim.
- 4) Nëse ndërhyrja është proporcionale me qëllimin legjitim të synuar dhe nëse arsyet e nxjerra nga autoritetet kombëtare për të justifikuar ndërhyrjen janë relevante dhe të mjaftueshme. Gjatë këtij përcaktimi, Gjykata do të konsiderojë hapësirën e vlerësimit që duhet t'i jepet vendimit nga autoritetet kombëtare.



## 1) A ka pasur ndërhyrje?

---

Gjatë shqyrtimit nëse ka pasur ndërhyrje, Gjykata do të marrë parasysh siç duhet:

- 1) Kontekstin specifik në të cilin është regjistruar dhe ruajtur informacioni;
- 2) Natyrën e regjistrimit; dhe
- 3) Mënyrën se si këto regjistrime janë përdorur dhe përpunuar dhe rezultatet që mund të nxirren.<sup>[214]</sup>

Në përgjithësi, Gjykata ka ndërmarrë një qasje të gjerë ndaj pyetjes nëse ka pasur ose jo ndërhyrje. Siç ceket në seksionin 3, lart, mbrojtja e të dhënave personale ka rëndësi themelore për gëzimin nga një person i të drejtës për respekt të jetës private dhe familjare, dhe mbledhja, ruajtja, modifikimi, zbulimi, përdorimi dhe publikimi i informacioneve lidhur me jetën private të një individi mund të përfaqësojë ndërhyrje tek Neni 8.

Gjykata i ka konsideruar me interes çështjet që mund të dalin në të ardhmen në lidhje me ruajtjen dhe zbulimin e të dhënave nga celularët, ADN-ja, gjurmët e gishtërinjve, fotografitë dhe incizimet me zë. Dhoma e Madhe në *S. dhe Harper k. Mbretërisë së Bashkuar*,<sup>[215]</sup> vendosi që shqetësimi i një individi për përdorimin e mundshëm në të ardhmen të informatave private të mbajtura nga autoritetet është legjitim dhe relevant për përcaktimin e pyetjes nëse ka pasur ndërhyrje. Duke pasur parasysh ritmin e shpejtë të zhvillimeve teknologjike në fushën e gjenetikës dhe teknologjisë së informacionit, Gjykata nuk mund të hedhë poshtë mundësinë që në të ardhmen interesat e jetës private të lidhura me informatat gjenetike të mund të ndikohen në mënyrë negative në mënyra të reja ose në mënyra që nuk mund të parashikohen me saktësi sot.

## 2) A ka qenë ndërhyrja në përputhje me ligjin?

---

Çështjet lidhur me të drejtën për t'u harruar nuk kishin të bënin aq shumë me pyetjen nëse ndërhyrja ishte "në përputhje me ligjin". Gjykata është përpjekur të gjejë ose që ndërhyrja ka qenë në përputhje me ligjin, ose që kjo është më shumë çështje që duhet trajtuar në fazën e arsytimit. Për shembull, në *Catt k. Mbretërisë*

---

[214] *Gaughran k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 shkurtit 2020, Nr. 45245/15 tek §70.

[215] *S. dhe Harper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2008, Nr. 30562/04, 30566/04 tek §§70-71 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

së *Bashkuar*<sup>[216]</sup> Gjykata deklaroi se pyetja nëse mbledhja, ruajtja dhe përdorimi i të dhënave personale të kërkuesit ishte në përputhje me ligjin është e lidhur ngusht me çështjen më të gjerë të pyetjes nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Prandaj, Gjykata nuk e gjeti të nevojshme të vendoste nëse ndërhyrja ka qenë “në përputhje me ligjin”. Gjykata shprehu të njëjtën pikëpamje në *Gaughran*.<sup>[217]</sup>

### 3) A ka përcaktuar Shteti një qëllim legjitim?

Në lidhje me pyetjen e qëllimit legjitim, Gjykata i ka pranuar menjëherë qëllimet e mëposhtme si legjitime:

- (a) Mbrojtjen e sigurisë kombëtare.<sup>[218]</sup>
- (b) Pikasjen dhe parandalimin e krimeve dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.<sup>[219]</sup>
- (c) Ekzistenca e një regjistri kombëtar të kryesve të veprave seksuale për të parandaluar krimin dhe për të luftuar recidivizmin, dhe gjithashtu për ta lehtësuar identifikimin e të tjerëve.<sup>[220]</sup>
- (d) Nevoja për një regjistër gjithëpërfshirës të të gjitha kaucioneve, dënimeve, paralajmërimeve, qortimeve, shfajësimeve dhe informacioneve të ngjashme.<sup>[221]</sup> Gjykata bëri të qartë se mbledhja pa kriter dhe pa arsye e të dhënave penale nuk ka gjasa të jetë në përputhje me kushtet e Nenit 8 në mungesë të rregulloreve të qarta dhe të detajuara statutores me mbrojtjet e aplikueshme dhe rregullat që qeverisin, *inter alia*, rrethanat në të cilat të dhënat mund të merren, kohëzgjatja e ruajtjes së tyre, për çka mund të përdoren dhe rrethanat në të cilat duhet të shkatërrohen.<sup>[222]</sup>

---

[216] *Catt k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 janarit 2019, Nr. 43514/15 tek §5106-107.

[217] *Gaughran k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 shkurtit 2020, Nr. 45245/15 tek §73.

[218] *Segerstedt-Wiberg dhe të tjerë k. Suedisë*, vendim i 6 qershorit 2006, Nr. 62332/00 tek §87.

[219] *S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2008, Nr. 30562/04, 30566/04 tek §100 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim); *Catt k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 janarit 2019, Nr. 43514/15 tek §108.

[220] *BB k. Francës*, vendim i 17 dhjetorit 2009, Nr. 5335/06 tek §58; *Gardel k. Francës*, vendim i 17 dhjetorit 2009, Nr. 16428/05 tek §63; dhe *MB k. Francës*, vendim i 17 dhjetorit 2009, Nr. 22115/06 tek §50.

[221] *MM k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 nëntorit 2012, Nr. 24029/07 tek §199.

[222] *MM k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 nëntorit 2012, Nr. 24029/07 tek §199.

- (e) Nevoja për të pasur një databazë të ADN-ve.<sup>[223]</sup> Përsëri, Gjykata bëri të qartë se këto nuk mund të zbatohen si pjesë e hovit për të maksimizuar informacionit në to dhe kohëzgjatjen e mbajtjes së tyre. Pa respektuar proporcionalitetin e kërkuar karshi qëllimit legjitim të caktuar për këto mekanizma, avantazhet e tyre do të kishin më pak peshë sesa shkeljet e rënda që ato do t'u shkaktonin të drejtave dhe lirive që Shtetet duhet të garantojnë sipas Konventës për personat brenda juridiksionit të tyre.<sup>[224]</sup>
- (f) Mbajtja e të dhënave biometrike dhe fotografive për qëllime të pikasjes e rrjedhimisht parandalimit të krimeve. Marrja origjinale e një informacioni ndjek qëllimin e lidhjes së një personi të caktuar me krimin për të cilin ai/ajo dyshohet. Mbajtja e informatës ndjek qëllimin më të gjerë të mbështetjes së identifikimit të personave që mund të kryejnë vepra në të ardhmen.<sup>[225]</sup>

#### **4) A kanë qenë masat e marra nga Shteti proporcionale me qëllimin legjitim dhe të justifikuara?**

---

Fushëbeteja e vërtetë në praktikën gjyqësore lidhur me çështjen e proporcionalitetit: a është ndërhyrja proporcionale me qëllimin legjitim të synuar dhe a janë arsyet e nxjerra nga autoritetet kombëtare për të justifikuar ndërhyrjen relevante dhe të mjaftueshme? Testi i proporcionalitetit nuk është nëse do të mund të ishte vendosur ndonjë regjim tjetër më pak kufizues. Thelbi i çështjes është nëse, me marrjen e masave dhe gjetjen e ekuilibrit të gjetur, legjislatura ka vepruar brenda hapësirës së vlerësimit që i është dhënë.<sup>[226]</sup>

#### Hapësira e vlerësimit

Së pari, sa i përket hapësirës së vlerësimit, Gjykata ka ndërmarrë qasjen e mëposhtme në kontekstin e çështjeve në të cilat Shteti mban informacione rreth një individi i cili ka qenë objekt i, ose i dënuar pas, hetimeve ose procedurave gjyqësore:

*“Ndërkohë që u takon autoriteteve kombëtare të bëjnë vlerësimin fillestar në të gjitha këto aspekte, vlerësimi përfundimtar nëse ndërhyrja*

---

[223] *Aycaguer k. Francës*, vendim i 22 qershorit 2017, Nr. 8806/12 tek §34.

[224] *Aycaguer k. Francës*, vendim i 22 qershorit 2017, Nr. 8806/12 tek §34.

[225] *Gaughran k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 shkurtit 2020, Nr. 45245/15 tek §75.

[226] *Gaughran k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 shkurtit 2020, Nr. 45245/15 tek §95.

*është e nevojshme mbetet objekt shqyrtimi i Gjykatës për të parë respektimin e kriterëve të Konventës. Prandaj, hapësira e vlerësimit, shkalla e së cilës varet nga disa faktorë, përfshirë natyrën e aktiviteteve të kufizuara dhe qëllimet e synuara nga kufizimet, duhet në parim t'u lihen Shteteve në këtë kontekst. Hapësira mund të ngushtohet kur e drejta në fjalë është jetike për gëzimin efektiv nga individi të të drejtave intime ose kyçe. Kur vihet në rrezik një aspekt posaçërisht i rëndësishëm i ekzistencës ose identitetit të një individi, hapësira që i lejohet Shtetit ngushtohet. Megjithatë, kur nuk ka konsensus brenda shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në lidhje me rëndësinë relative të interesave në fjalë apo mënyrën më të mirë për t'i mbrojtur ato, hapësira zgjerohet.”<sup>[227]</sup>*

Gjykata merr në konsideratë praktikën më të gjera shtetërore mes shteteve anëtare kur shqyrton shkallën e hapësirës së vlerësimit që duhet t'i lejohet një Shteti në një çështje të dhënë. Në *Gaughran*, ku kërkuesi pretendoi sipas Nenit 8 që mbajtja e pakufishme e profilit të ADN-së së tij, gjurmëve të gishtërinjve dhe fotografisë së tij në përputhje me politikën e tërësishme të mbajtjes së të dhënave personale për çdo individ të dënuar për një vepër të regjistrueshme përbëri ndërhyrje joproporcionale, Gjykata deklaroi se kishte një numër të vogël Shtetesh mes të anketuarve që operonin regjime të mbajtjes së pakufishme të të dhënave, por Gjykata konsideroi se ato Shtete ishin një pakicë e dalluar.<sup>[228]</sup> Shumica e Shteteve kanë regjime në të cilat ekziston një kufi i caktuar kohor për mbajtjen e të dhënave. Gjykata nuk mundi të arrinte në përfundimin që hapësira e vlerësimit e Shtetit ishte zgjeruar në rastin konkret deri në shkallën e pretenduar nga Qeveria. Mbretëria e Bashkuar ishte një prej pak juridiksioneve të Këshillit të Evropës që lejonte mbajtjen e pakufishme të profileve të ADN-së, gjurmëve të gishtërinjve dhe fotografive të personave të dënuar. Shkalla e pëlqimit mes Shteteve Kontraktuese e kishte ngushtuar hapësirën e vlerësimit në dispozicion për Shtetin e paditur në lidhje me mbajtjen e profileve të ADN-së. Gjykata në *Gaughran* theksoi lidhjen mes hapësirës së vlerësimit dhe mbrojtjeve ekzistuese në sistemet vendase kundër abuzimit, duke thënë se kur një Shtet e vë veten në kufi të hapësirës së vlerësimit gjatë duke i dhënë vetes pushtetin më të gjerë të mbajtjes së pakufishme, ekzistenca dhe funksionimi i mbrojtjeve të caktuara bëhet vendimtare.<sup>[229]</sup>

---

[227] *MK k. Francës*, vendim i 18 prillit 2013, Nr. 19522/09 tek §31.

[228] *Gaughran k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 shkurtit 2020, Nr. 45245/15 tek §82 dhe 84.

[229] *Gaughran k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 shkurtit 2020, Nr. 45245/15 tek §88.

Sa i përket hapësirës së vlerësimit në kontekstin e raportimit gazetaresk, Dhoma e Madhe në *Hurbain* deklaroi që ajo kishte gjetur më parë se hapësira e vlerësimit që u jepet Shteteve për vënien e ekuilibrit mes të drejtave konkurruese ka gjasa të jetë më e madhe kur bëhet fjalë për arkivat e lajmeve të kaluara, e jo lajmet e tanishme.<sup>[230]</sup> Në mënyrë të veçantë, detyra e shtypit për të vepruar në përputhje me parimet e gazetarisë së përgjegjshme duke siguruar saktësinë e informacioneve historike, e jo informacioneve që shuhet, ka gjasa të jetë më ekzigjente në mungesë të urgjencës në publikimin e materialit. Dhoma e Madhe theksoi se këto gjetje duhet të interpretohen duke marrë parasysh si duhet konteksti i veçantë i çështjes në fjalë. Dhoma e Madhe nënvizoi se kishte rëndësi thelbësore që Konventa të interpretohej dhe aplikohet në mënyrë të atillë që e bën atë praktike dhe efektive, jo teorike dhe iluzive. Dështimin nga ana e Gjykatës për të ruajtur qasjen dinamike dhe evolutive do të rrezikonte që ajo të bëhej pengesë për reforma ose përmirësime.

### Proporcionaliteti

Konsideratat kyçe që janë marrë parasysh nga Gjykata gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të masave që janë gjetur se përbëjnë ndërhyrje adresohen poshtë sipas katër kategorive të gjera të individëve të identifikuar lart:

- 1) Individët e hetuar nga policia, ose të dyshuar ose të akuzuar për kryerjen e një vepre.
- 2) Individët e dënuar për një vepër.
- 3) Individët për të cilët shërbimet e sigurimit kanë mbledhur dhe ruajtur informacione.
- 4) Individët të cilët kanë qenë objekt i mbulimit gazetaresk si pasojë e hetimeve, arrestimit ose dënimit.

*Individët e hetuar nga policia, ose të dyshuar ose të akuzuar për kryerjen e një vepre*

*(a) Nëse ekziston nevoja urgjente sociale për mbledhjen e të dhënave personale*

Për çështjet që kanë të bëjnë me individë të cilët janë hetuar, dyshuar ose akuzuar për kryerjen e një vepre, Gjykata konsideron nëse ka ekzistuar nevoja

---

[230] *Hurbain k. Belgjikës*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 korrikut 2023, Nr. 57292/16 tek §181 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

sociale urgjente për të mbledhur të dhënat në fjalë. Në *Catt*, kërkuesi, pjesëmarrës i rregullt i demonstratave publike, i cili në të kaluarën ishte arrestuar por nuk ishte dënuar asnjëherë, u ankua se mbajtja e të dhënave të tij nga policia ishte në shkelje të së drejtës së tij për privatësi sipas Nenit 8. Gjykata njohu nevojën e mbledhjes së të dhënave sidomos në kontekstin e individëve që janë pjesë e grupeve protestuese që njihen si të dhunshme, dhe mori në shqyrtim "nevojën sociale urgjente".<sup>[231]</sup> Gjykata deklaroi se çështja që ajo duhet të shqyrtonte nuk ishte nëse kishte pasur "nevojë sociale urgjente" që policia të krijonte dhe të mbante një databazë të tillë. Për aq sa Gjykata e ekzaminon këtë çështje nga një aspekt më i përgjithshëm, ajo e kishte bërë këtë në përfundimin se krijimi i databazës ndoqi një qëllim legjitim. Në këtë fazë, Gjykata ishte duke ekzaminuar nëse mbledhja dhe mbajtja e të dhënave personale të kërkuesit mund të shihej si e justifikuar sipas Konventës. Gjykata pranoi se ekzistonte nevoja sociale urgjente për të mbledhur të dhënat personale të kërkuesit. Ajo që dakord me Gjykatën Supreme të Mbretërisë së Bashkuar që është pjesë e natyrës së mbledhjes së të dhënave të inteligjencës që policia së pari të grumbullojë informacione, përpara se t'i vlerësojë ato. Në këtë aspekt, Gjykata kujtoi se të dhënat personale në fjalë ishin marrë në mënyrë të hapur. Po ashtu, Gjykata që dakord se policia kishte rolin e natyrshëm të monitoronte protestat ku aktivitetet e atij grupi njiheshin si të dhunshme dhe potencialisht kriminale. Edhe nëqoftëse kërkuesi nuk do të ishte i dyshuar për përfshirje direkte në aktivitetet kriminale të një grupi, ishte e justifikueshme që policia të mblihte të dhënat e tij personale meqenëse ai kishte vendosur të rreshtohet publikisht me aktivitetet e një grupi protestuesish të dhunshëm.

*(b) Nëse ekziston nevoja sociale urgjente për mbajtjen e të dhënave*

Ndërkohë që Gjykata në *Catt* gjeti se ekzistonte nevoja për mbledhjen e të dhënave, Gjykata pati pikëpamje tjetër në lidhje me çështjen nëse të dhënat duhen mbajtur. Në *Catt*, Gjykata gjithashtu deklaroi se nuk ekzistonte nevoja urgjente për mbajtjen e të dhënave të kërkuesit.<sup>[232]</sup> Ajo pati të njëjtin mendim me gjykatën vendase që ekzistonte nevoja për të bërë kujdes para se të rrëzohej gjykimi i policisë se çfarë informacionesh mund ta ndihmojnë policinë gjatë punës së saj. Gjykata nënvizoi se përfundimi i saj nuk vuri në pyetje faktin se mund të ketë pasur nevojë urgjente që policia t'i mbante të dhënat personale të kërkuesit për një kohë pasi ishin mbledhur. Megjithatë, në mungesë të rregullave që përcaktonin një kufi kohor maksimal të vendosur, kërkuesi u mbështet krejtësisht në aplikimin

[231] *Catt k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 janarit 2019, Nr. 43514/15 tek §§116-118.

[232] *Catt k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 janarit 2019, Nr. 43514/15 tek §§119 dhe 124.

e zellshëm të mbrojtjeve tejet fleksibile për të siguruar mbajtjen proporcionale të të dhënave të tij. Gjykata deklaroi se kur Shteti vendos të ngrejë një sistem të tillë, nevoja për mbrojtje procedurale efektive bëhet vendimtare. Ato mbrojtje duhet të mundësojnë fshirjen e këtyre të dhënave sapo mbajtja e tyre e vazhdueshme të bëhet joproportionale. Parimi 2 i mbledhjes së të dhënave në Rekomandimin R (87) 15 deklaroi që mbledhja e të dhënave të individëve vetëm mbi faktin që ata i përkasin lëvizjeve ose organizatave të caktuara të cilat nuk janë të jashtëligjshme duhet të ndalohet përveç se kur është absolutisht e nevojshme ose me qëllim të një hetimi të veçantë. Gjykata konsideroi se mbajtja e të dhënave të kërkuesit, sidomos në lidhje me protesta paqësore, nuk ishte vërtetuar të ishte absolutisht e nevojshme, as për qëllime të ndonjë hetimi të veçantë.

### (c) Nevoja për mbrojtje

Gjykata është e ndërgjegjshme për nevojën e pranisë së mbrojtjeve në të drejtën vendase kurdo që autoritetet shtetërore mbajnë ose zbulojnë informacione rreth individëve. Në *MK k. Francës*, ku kërkuesi pretendoi shkelje të Nenit 8 mbi bazën e mbajtjes së të dhënave lidhur me të në databazën kombëtare të shenjave të gishtërinjve, Gjykata deklaroi se nevoja për mbrojtje është edhe më e madhe kur mbrojtja e të dhënave personale kalon në përpunim automatik, aq më shumë kur këto të dhëna përdoren për qëllime të policisë.<sup>[233]</sup> E drejta vendase duhet të sigurojë që të dhëna të tilla të jenë relevante dhe jo të tepërta në lidhje me qëllimet për të cilat ruhen, dhe të mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë jo më të gjatë sesa kërkohet për qëllimin për të cilin janë marrë ato të dhëna. E drejta vendase po ashtu duhet të ofrojë garanci të përshtatshme që të dhënat personale të mbajtura janë mbrojtur në mënyrë efektive nga keqpërdorimi dhe abuzimet.

Në *Catt*, Gjykata gjeti se mungesa e mbrojtjeve efektive ishte shqetësim i veçantë sepse të dhënat personale që tregonin opinione politike tërheqin një nivel të shtuar mbrojtjeje.<sup>[234]</sup> Gjykata deklaroi se pjesëmarrja në protesta paqësore kishte mbrojtjen specifike të Nenit 11 të Konventës, i cili po ashtu përfshin mbrojtje të veçanta për sindikatat, në ngjarjet e të cilave kishte marrë pjesë kërkuesi. Këtu, ajo shënoi se në deklaratën e Koordinatorit Kombëtar, përkufizimi i "ekstremizmit vendas" i referohej grumbullimit të të dhënave rreth grupeve dhe individëve që veprojnë "jashtë procesit demokratik". Prandaj, policia nuk u duk se kishte

[233] *MK k. Francës*, vendim i 18 prillit 2013, Nr. 19522/09 tek §32.

[234] *Catt k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 24 janarit 2019, Nr. 43514/15 tek §123.

respektuar vetë përkufizimin e vet duke mbajtur të dhënat mbi pjesëmarrjen e kërkuarit në ngjarje politike paqësore. Ngjarje të tilla janë pjesë jetike e procesit demokratik. Gjykata tashmë e kishte nënvizuar rrezikun e qasjes dykuptimëshe ndaj fushëveprimit të grumbullimit të të dhënave në rastin konkret. Ajo konsideroi që vendimet për mbajtjen e të dhënave personale të kërkuarit nuk morën parasysh nivelin e shtuar të mbrojtjes që ato kërkonin duke qenë opinione politike, dhe që, në ato rrethana, mbajtja e tyre do të ketë pasur efekt pengues.

*(d) Nevoja për të siguruar që argumentet e Shtetit nuk përbëjnë justifikim për depozitimin e informacioneve mbi tërë popullatën*

Ndërkohë që Gjykata ka pranuar një gamë të gjerë qëllimesh si "legjitime" në parim, Gjykata ka konsideruar me kujdes masat faktikisht të marra nga autoritetet shtetërore në ndjekje të atyre qëllimeve, përfshirë nëse masat janë të tepërta në aspektin e shtrirjes. Në *Mk k. Francës*, kërkuari pretendoi shkelje të Nenit 8 mbi bazën e mbajtjes së të dhënave lidhur me të në databazën kombëtare të shenjave të gishtërinjve. Qeveria pretendoi, *inter alia*, se mbajtja e të dhënave do t'i mbronte interesat e kërkuarit duke përjashtuar përfshirjen e tij nëqoftëse dikush do të përpiqej t'ia vidhte identitetin. Gjykata theksoi se, përveç faktit që një arsye e tillë nuk përmendet specifikisht në dispozitat vendase, pranimi i një argumenti të tillë mbi bazën e mbrojtjes së garantuar kundër vjedhjes së identitetit në praktikë do të përbënte justifikim për depozitimin e informacioneve të të gjithë popullatës së Francës, çka do të kishte qenë pa dyshim e tepërt dhe jorelevante.<sup>[235]</sup>

*(e) Kohëzgjatja e mbajtjes së të dhënave, nëse kjo përbën mbajtje të pakufishme, dhe nëse një kërkuar ka mundësi reale për të kërkuar fshirjen e të dhënave*

Kur autoritetet e Shtetit pretendojnë se masat e marra kanë qenë proporcionale sepse mbajtja e informacionit është e kufizuar në kohë, ose një kërkuar mund të bëjë kërkesë për fshirjen e informacionit, Gjykata do të japë prioritet substancës para formës, dhe do të konsiderojë praktikën që në fakt ndodh në nivel vendi. Në *MK k. Francës*, Gjykata deklaroi se në atë çështje e drejta që në çdo kohë të paraqitet në gjykatë kërkesa për fshirje binte ndesh me interesat e autoriteteve hetimore, të cilat kërkonin qasje në databazë me sa më shumë referenca që ishte e mundur.<sup>[236]</sup> Meqenëse interesat në fjalë ishin kontradiktore, qoftë edhe pjesërisht, fshirja, e cila në fakt nuk ishte e drejtë, ofronte një mbrojtje e cila ishte "teorike

[235] *MK k. Francës*, vendim i 18 prillit 2013, Nr. 19522/09 tek §37.

[236] *MK k. Francës*, vendim i 18 prillit 2013, Nr. 19522/09 tek §§41-42.



dhe iluzive” e jo “praktike dhe efektive”. Gjykata theksoi se, ndërkohë që mbajtja e informacioneve të ruajtura në dosje ishte e kufizuar në kohë, ajo shtrihej për 25 vjet. Duke pasur parasysh gjetjen e saj të mëparshme që shanset e suksesit për kërkesat e fshirjes ishin thujse hipotetike, kufiri kohor 25-vjeçar ishte praktikisht mbajtje e pakufishme, ose të paktën, siç pretendoi kërkuesi, periudhë standarde e jo periudhë maksimale.

Ngjashëm, në *Brunet k. Francës*,<sup>[237]</sup> një çështje lidhur me ankesën që të dhënat e kërkuarit ishin regjistruar në një databazë të veprave penale pas ndërprerjes së procedurës penale kundër tij, Gjykata gjeti që kërkuesi nuk kishte pasur mundësi reale të kërkimit të fshirjes nga databaza të informacionit lidhur me të, dhe se kohëzgjatja e mbajtjes së atyre të dhënave, 20 vjet, mund të asimilohej nëse jo si mbajtje e pakufishme, së paku si normë dhe jo kufi ligjor maksimal. Gjykata doli në përfundimin se kishte pasur shkelje të Nenit 8.

(f) *Nevoja për të konsideruar peshën e veprës në fjalë*

Pesha e veprës në fjalë është relevante në vlerësimin e Gjykatës lidhur me proporcionalitetin e masave për mbledhjen ose mbajtjen e informacionit personal. Në *MK k. Francës*, Gjykata doli në përfundimin se Shteti i paditur kishte dalë jashtë hapësirës së tij të vlerësimit, meqenëse rregulloret për mbajtjen e databazës së kontestuar të shenjave të gishtërinjve të njerëzve të dyshuar për kryerjen e veprave por jo të dënuar, ashtu siç iu aplikua kërkuarit, nuk vuri ekuilibrin e drejtë mes interesave konkurruese publike dhe private në fjalë. Rrjedhimisht, mbajtja e të dhënave u desh të shihej si ndërhyrje joproporcionale tek e drejta e kërkuarit për jetë private dhe nuk mundi të shihej si e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Me këtë gjetje, Gjykata deklaroi se përveç funksionit parësor të databazës (lehtësimi i përpjekjeve për të gjetur dhe identifikuar kryesit e veprave serioze dhe veprave të tjera të rënda) dekreti në fjalë përmendi një funksion tjetër, që ishte lehtësimi i “*ndjekjes penale, hetimit dhe gjykimit të çështjeve gjyqësore të referuara tek autoriteti gjyqësor*”, pa specifikuar nëse kjo vlente vetëm për krimet serioze dhe vepra të tjera të rënda.<sup>[238]</sup> Ajo gjithashtu mbulonte “*persona të cilët janë akuzuar në procedura penale, ku kërkohet identifikimi i tyre*”, kështu që mund të përfshinte të gjitha veprat *de facto*, duke përfshirë edhe veprat përmbledhëse, nëqoftëse, në teori, kjo do të ndihmonte në identifikimin e autorëve të krimeve

[237] *Brunet k. Francës*, vendim i 18 shtatorit 2014, Nr. 21010/10.

[238] *MK k. Francës*, vendim i 18 prillit 2013, Nr. 19522/09 tek §38.

dhe veprave siç specifikohet në dekret. Rrethanat e çështjes, që kishin të bënin me vjedhje librash që u ndërpre, treguan se instrumenti kishte të bënte me vepra të kundërvajtjes. Kështu që çështja ishte shumë e ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me vepra serioze siç është krimi i organizuar<sup>[239]</sup> apo sulmi seksual.<sup>[240]</sup>

(g) *Nevoja për të bërë dallimin mes individëve të akuzuar dhe individëve të dënuar*

Gjykata njeht faktin se pozicioni i një të akuzuari dhe një të dënuari duhet të trajtohen ndryshe. Një kritikë nga Gjykata në çështjen *MK k. Francës* ishte se dekreti në fjalë nuk kishte bërë fare dallim mes faktit nëse personi ishte dënuar ose jo nga gjykata, e madje nëse ishte ndjekur ose jo penalisht.<sup>[241]</sup>

(h) *Rreziku i stigmatizimit të njerëzve që vetëm akuzohen*

Gjykata ka njohur se mbajtja e të dhënave të njerëzve që thjesht janë hetuar ose akuzuar për një vepër, dhe nuk janë dënuar, sidoqoftë mund të çojë drejt stigmatizimit, ose së paku një supozimi që individi është në fakt fajtor për një vepër. Në *S. dhe Marper*, Gjykata shprehu shqetësimin e saj për stigmatizim nga fakti se personat në pozicionin e kërkuesve, të cilët nuk ishin dënuar për ndonjë vepër dhe kishin të drejtën e prezumimit të pafajësisë, u trajtuan në të njëjtën mënyrë si persona të dënuar.<sup>[242]</sup> Gjykata theksoi të drejtën e çdo njeriu për t'u prezumuar i pafajshëm dhe faktin që kjo përfshinte rregullën e përgjithshme që asnjë dyshim lidhur me pafajësinë e të akuzuarit nuk mund të shprehet me zë pas shfaqësimit të tij. Ishte e vërtetë që mbajtja e të dhënave private të kërkuesve nuk mund të barazohej me shprehjen e zëshme të dyshimeve. Megjithatë, Gjykata konsideroi që perceptimi i kërkuesve që ata nuk po trajtoheshin si të pafajshëm u intensifikua nga fakti që të dhënat e tyre do të mbaheshin pa kufi në të njëjtën mënyrë siç mbahen të dhënat e personave të dënuar, ndërkohë që të dhënat e personave që nuk ishin dyshuar asnjëherë për ndonjë vepër po kërkohej të fshiheshin. Gjykata deklaroi se Shteti duhet të paraqesë arsye shumë të forta para se Gjykata ta shohë si të justifikuar një dallim të tillë në trajtimin e të dhënave personale të kërkuesve

[239] *S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2008, Nr. 30562/04 dhe 30566/04 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[240] *BB k. Francës*, vendim i 17 dhjetorit 2009, Nr. 5335/06; *Gardel k. Francës*, vendim i 17 dhjetorit 2009, Nr. 16428/05; dhe *MB k. Francës*, vendim i 17 dhjetorit 2009, Nr. 22115/06.

[241] *MK k. Francës*, vendim i 18 prillit 2013, Nr. 19522/09 tek §39.

[242] *S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2008, Nr. 30562/04 dhe 30566/04 tek §§122-123 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

në krahasim me ato të njerëzve të tjerë që nuk ishin dënuar. Po kështu, në *Mk k. Francës* Gjykata deklaroi se kushtet e mbajtjes së të dhënave nuk duhet të japin përshtypjen që personat në fjalë nuk po trajtohen si të pafajshëm.<sup>[243]</sup>

(i) *Rreziku i dëmtimit të të miturve*

Gjykata njih se mbajtja e të dhënave për fëmijët e moshës së mitur mund të ndikojë në aftësinë e tyre afatgjatë për t'u rehabilituar dhe për t'u integruar në shoqëri. Gjykata e adresoi këtë pikë në *S. dhe Marper*, duke thënë se mbajtja e të dhënave të personave që janë dyshuar por nuk janë dënuar mund të jetë posaçërisht e dëmshme në rastet e të miturve, duke pasur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe rëndësinë e zhvillimit të tyre dhe integritet në shoqëri.<sup>[244]</sup> Gjykata citoi Nenin 40 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, dhe vuri në dukje pozicionin e veçantë të të miturve në sferën e drejtësisë penale. Ajo theksoi, në mënyrë të veçantë, nevojën për mbrojtjen e privatësisë së tyre në gjyqe penale. Gjykata konsideroi se duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë mbrojtjes së të miturve nga çdo e keqe që mund të rezultojë nga mbajtja prej autoriteteve të të dhënave të tyre private pas shfaqjes për një vepër penale. Gjykata pati të njëjtin mendim me Këshillin e Nuttfield për Bioetikën në lidhje me impaktin tek të rinjtë e mbajtjes së pakufishme të materialit të ADN-së së tyre dhe vuri në dukje shqetësimet e Këshillit që politikat e aplikuar kishin çuar në mbipërfaqësim në databazë të personave të rinj dhe pakicave etnike që nuk ishin dënuar për asnjë krim.

*Individët e dënuar për vepra*

Çështje të ngjashme si ato me individët e akuzuar janë shfaqur edhe në lidhje me individë që janë dënuar për vepra të ndryshme.

(a) *Nevoja për mbrojtje*

Gjykata ka theksuar nevojën për mbrojtje në çështjet lidhur me informacionin e mbajtur ose të shpërndarë rreth individëve që kanë qenë të dënuar për vepra. Në çështjen *Gardel*, Gjykata deklaroi se nevoja për mbrojtje të tilla është edhe më e madhe kur bëhet fjalë për faktin se mbrojtja e të dhënave personale kalon

---

[243] *Mk k. Francës*, vendim i 18 prillit 2013, Nr. 19522/09 tek §33.

[244] *S. dhe Marper k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i Dhomës së Madhe i 4 dhjetorit 2008, Nr. 30562/04 dhe 30566/04 tek §124 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

në proces automatik, edhe më shumë kur të dhëna të tilla përdoren për qëllime të policisë.<sup>[245]</sup> E drejta vendase duhet të sigurojë në mënyrë të dukshme që të dhëna të tilla janë relevante dhe jo të tepërta në lidhje me qëllimet për të cilat ruhen dhe se ato po mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë jo më të gjatë sesa kërkohet për qëllimet për të cilat ruhen. E drejta vendase po ashtu duhet të ofrojë garanci të mjaftueshme që të dhënat personale të mbajtura janë nën mbrojtje efikase nga keqpërdorimi dhe abuzimi.<sup>[246]</sup>

Në *MM k. Mbretërisë së Bashkuar*,<sup>[247]</sup> kërkuesja ishte ankuar për mbajtje dhe zbulim në kontekstin e një kontrolli të historisë penale lidhur me një kaucion që ajo kishte marrë nga policia. Ankesa e saj ishte depozituar pas tërheqjes së një oferte punësimi që iu bë asaj pasi ajo kishte treguar ekzistencën e kaucionit. Gjatë gjetjes së shkeljes së Nenit 8, Gjykata konsideroi efektin negativ potencial tek individët që aplikojnë për punë të mbajtjes së të dhënave për vepra të kundërvajtjes ose veprave me relevancë të diskutueshme. Gjykata deklaroi se sa më e madhe që është shtrirja e sistemit të regjistrimit, e rrjedhimisht më e madhe sasia dhe ndjeshmëria e të dhënave të mbajtura dhe me mundësi zbulimi, aq më e rëndësishme bëhet që përmbajtja e mbrojtjeve që duhen zbatuar në faza të ndryshme thelbësore gjatë përpunimit vijues të të dhënave. Detyrimi i autoriteteve përgjegjëse për mbajtjen dhe zbulimin e të dhënave të historisë penale për të siguruar respektimin e jetës private ishte veçanërisht me rëndësi, duke marrë parasysh natyrën e të dhënave të mbajtura dhe pasojat potencialisht shkatërruese të zbulimit të tyre. Edhe kur certifikata e historisë penale regjistron një dënim ose një kaucion për një vepër relativisht të vogël, ose me relevancë të diskutueshme, një punëdhënës potencial mund të ndihet më i sigurt që ta refuzojë kërkuesin. Gjykata që dakord që është realiste të supozohet se, në shumicën e rasteve, certifikata negative e historisë penale përfaqëson diçka të ngjashme me “*goditje fatale*” për shpresat e një personi që aspiron të hyjë në një vend pune që kërkon zbulimin e këtyre fakteve.

Gjykata theksoi mungesën e kornizës së qartë ligjore për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave, dhe mungesën e qartësisë lidhur me shtrirjen, shkallën dhe kufizimet e fuqive të së drejtës zakonore që policia t’i mbajë dhe t’i zbulojë të dhënat e kaucionit. Ajo iu referua mungesës së mekanizmave për shqyrtimin e pavarur të një vendimi për të mbajtur ose për të zbuluar të dhëna. Për fund, Gjykata theksoi

---

[245] *Gardel k. Francës*, vendim i 17 dhjetorit 2009, Nr. 16428/05 tek §62.

[246] *Aycaguer k. Francës*, vendim i 22 qershorit 2017, Nr. 8806/12 tek §38.

[247] *MM k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 nëntorit 2012, Nr. 24029/07.

filtrat e paktë në lidhje me zbulimet e bëra. Nuk bëhej asnjë dallim mbi bazën e natyrës së veprës, ecurisë së çështjes, kohës që kishte kaluar që nga ndodhja e veprës, ose relevancës së informatës për punësimin e kërkuar.

Efekti kumulativ i këtyre mangësive ishte që Gjykata nuk u bind se kishte mbrojtje të mjaftueshme në sistem për mbajtjen dhe zbulimin e të dhënave të historisë penale për të siguruar që të dhënat lidhur me jetën private të kërkuësës nuk ishte zbuluar, dhe nuk do të zbulohej, në shkelje të së drejtës së saj për respekt ndaj jetës së saj private.<sup>[248]</sup>

(b) *Nevoja për t'u siguruar që argumentet e Shtetit nuk përbëjnë justifikim për mbajtjen e informacioneve për të gjithë popullatën*

Ashtu si tek *MK k. Francës* në lidhje me personat e akuzuar, në *Gaughran*, në përgjigje ndaj konstatimit të Qeverisë që sa më shumë të dhëna që mbahen aq më shumë krime parandalohen, Gjykata theksoi se pranimi i një argumenti të tillë në kontekstin e një skeme të mbajtjes së pakufishme të informacioneve do të ishte praktikisht njësoj si të justifikohet mbajtja e informacioneve për të gjithë popullatën dhe për familjarët e tyre të vdekur, çka pa dyshim do të ishte e tepërt dhe jorelevante.<sup>[249]</sup>

(c) *Kohëzgjatja e mbajtjes, nëse kjo përbën mbajtje të pakufishme, dhe nëse kërkuesi ka mundësi reale për të bërë kërkesë për fshirjen e të dhënave*

Ashtu siç ndodh për personat e akuzuar, Gjykata merr në konsideratë, gjatë çështjeve lidhur me persona të dënuar, nëse mbajtja e informacionit është e kufizuar në kohë dhe nëse individ mund të bëjë kërkesë për fshirjen e informacionit. Në *Gardel*, një çështje lidhur me futjen e emrit të kërkuësit në databazën kombëtare të shkelësve për vepra seksuale, Gjykata deklaroi se periudha kohore gjatë së cilës u mbajtën të dhënat nuk ishte joproporcionale me qëllimin e synuar në ruajtjen e këtij informacioni dhe se individ kishte mundësi praktike për të kërkuar fshirjen e këtyre të dhënave.<sup>[250]</sup> Gjykata konsideroi që procedura gjyqësore për heqjen e të dhënave ofronte shqyrtimin e pavarur të justifikimit për mbajtjen e informacionit sipas kritereve të përcaktuara dhe jepte mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive për të drejtën për respekt ndaj jetës private, duke pasur parasysh seriozitetin e veprave

[248] *MM k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 nëntorit 2012, Nr. 24029/07 tek §§200 dhe 206-207.

[249] *Gaughran k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 shkurtit 2020, Nr. 45245/15 tek §89.

[250] *Gardel k. Francës*, vendim i 17 dhjetorit 2009, Nr. 16428/05 tek §69.

për të cilat u fut në regjistër. Mbjtja e të dhënave për të periudhë kaq të gjatë mund t'i jepte shkas një çështjeje sipas nenit 8. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se kërkuesi gjithsesi do të kishte mundësi praktike për të bërë kërkesë për heqjen e të dhënave të ruajtura duke nisur nga data kur vendimi për futjen e të dhënave në regjistër pushoi së qeni në fuqi. Në këto rrethana, Gjykata konsideroi se periudha kohore gjatë së cilës u mbajtën të dhënat nuk qe joproportionale me qëllimin e synuar me anë të mbajtjes së këtij informacioni. Çështjet *BB k. Francës* dhe *MB k. Francës* përmbanin faktorë të ngjashëm me *Gardel*. Gjykata nuk gjeti shkelje të Nenit 8 në asnjërën prej këtyre çështjeve.

Përkundrazi, në *Aycaguer*, nuk kishte dispozita për fshirjen e të dhënave të personave të dënuar. Duke gjetur shkelje të Nenit 8, Gjykata deklaroi se periudha 40-vjeçare në parim përbënte maksimumin e kohës që duhet të ishte rregulluar me dekret të ndarë.<sup>[251]</sup> Meqenëse asnjë dekret i tillë nuk është lëshuar ndonjëherë, periudha 40-vjeçare praktikisht trajtohej si mbajtje e pakufishme, ose të paktën si normë e jo si maksimum. Sa i përket procedurës së fshirjes, nuk u diskutua që qasja në një procedurë të tillë ishte e autorizuar vetëm për të dyshuarit, dhe jo për personat e dënuar siç ishte kërkuesi. Gjykata konsideroi se personave të dënuar po ashtu duhet t'u jepen mundësi praktike për bërjen e kërkesës për fshirjen e të dhënave të regjistruara. Ajo zgjidhje duhet të jetë në dispozicion për të siguruar që periudha e mbajtjes së të dhënave është proporcionale me natyrën e veprave dhe me qëllimet e kufizimeve.

Në *Gaughran*<sup>[252]</sup>, Gjykata gjeti që në praktikë nuk kishte mundësi që një individ t'i fshiheshin të dhënat. Të dhënat biometrike dhe fotografia e kërkuesit ishin mbajtur pa asnjë referencë ndaj peshës së veprës së tij dhe pa asnjë konsideratë për nevojën e vazhduar të mbajtjes së të dhënave pa kufi. Policia kishte fuqinë për të fshirë të dhënat biometrike dhe fotografitë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Nuk kishte dispozita që lejonin që kërkuesi të bënte kërkesë për fshirjen e të dhënave të tij nëqoftëse konservimi i këtyre të dhënave nuk dukej se ishte i nevojshëm më duke marrë parasysh natyrën e veprës, moshën e personit në fjalë, gjatësinë e kohës që kishte kaluar, dhe personalitetin e atij personi tani. Rrjedhimisht, shqyrtimi në dispozicion të individit dukej se ishte kaq i ngushtë sa që ishte thujse hipotetik.

---

[251] *Aycaguer k. Francës*, vendim i 22 qershorit 2017, Nr. 8806/12 at §34.

[252] *Gaughran k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 13 shkurtit 2020, Nr. 45245/15 tek §94.

(d) *Nevoja për të konsideruar peshën e veprës në fjalë*

Pesha e veprës në fjalë është relevante për vlerësimin nga Gjykata të proporcionalitetit të masave për grumbullimin ose ruajtjen e informacionit personal rreth individëve të dënuar. Në *Aycaguer*, Gjykata vuri në dukje se Këshilli Kushtetues kishte marrë një vendim me qëllim që dispozitat lidhur me dosjen kompjuterike të kontestuar ishin në përputhje me Kushtetutën, varësisht *inter alia* nga "përcaktimi i kohëzgjatjes së ruajtjes së këtyre të dhënave personale në varësi të qëllimit të dosjes së ruajtur dhe natyrës dhe/ose peshës së veprës në fjalë."<sup>[253]</sup> Megjithatë, nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim i përshtatshëm në lidhje me këtë rezervë. Nuk ishte bërë asnjë dallim duke u bazuar në natyrën dhe/ose peshën e veprës së kryer, pavarësisht nga pabarazitë domethënëse në situatat që mund të lindnin. Situata e kërkuesit e tregoi këtë, ku ndodhën ngjarje në një kontekst politik / sindikal, që kishin të bënin me thjesht disa goditje me çadër drejtuar policëve të cilët as që ishin identifikuar. Kjo ishte në kontrast me peshën e akteve që me gjasë përbënin vepra shumë të rënda të parashikuara në të drejtën vendase si vepra seksuale, terrorizëm, krime kundër njerëzimit, dhe trafikim me qenie njerëzore. Gjykata theksoi se çështja *Aycaguer* ishte shumë ndryshe nga çështjet lidhur me vepra të tilla të rënda siç është krimi i organizuar ose sulmi seksual.

(e) *Rëndësia e rehabilitimit*

Gjykata gjithashtu ka marrë në konsideratë zhvillimet në politikat penale evropiane në lidhje me të rriturit, dhe mënyrën se si ato përfshijnë qëllimin e rehabilitimit. Mbajtja e të dhënave, dhe vënia në dispozicion e tyre për publikun, mund të pengojë rehabilitimin e një personi dhe riintegrimin në shoqëri. Gjykata theksoi tek *Gardel* se politikat penale evropiane janë në evolucion e sipër duke i dhënë rëndësi gjithnjë më të madhe, krahas qëllimit të ndëshkimit, qëllimit rehabilitues të burgimit, veçanërisht nga fundi i një dënimi të gjatë me burg.<sup>[254]</sup> Rehabilitimi i suksesshëm do të thotë, mes të tjerash, parandalimi i përsëritjes së veprës.

---

[253] *Aycaguer k. Francës*, vendim i 22 qershorit 2017, Nr. 8806/12 tek §43.

[254] *Gardel k. Francës*, vendim i 17 dhjetorit 2009, Nr. 16428/05 tek §64.

(f) *Dispozicioni i informacionit*

Gjykata shqyrton se sa është në dispozicion të publikut informacioni i mbajtur rreth individëve, dhe për cilat qëllime mund të përdoret. Tek *Gardel*, ku kërkuesi u ankua për vendosjen e tij në regjistrin kombëtar të shkelësve seksualë pas dënimit të tij, mënyra e përgjegjshme se si u ruajt informacioni kontribuoi që të mos gjendej shkelje e Nenit 8. Rregullat për qasjen në regjistër nënkuptonin që ky regjistër mund të konsultohet vetëm nga autoritetet gjyqësore, policia, dhe organet administrative të cilat ishin të lidhura me detyrimin e konfidencialitetit, dhe në rrethana të përcaktuara saktë.<sup>[255]</sup>

*Individët në lidhje me të cilët shërbimet e sigurimit kanë mbledhur dhe ruajtur informacione*

Tek *Segerstedt-Wiberg*, Gjykata deklaroi se fuqitë e vëzhgimit sekret tolerohen sipas Konventës vetëm për aq sa është rreptësisht e nevojshme për mbrojtjen e institucioneve demokratike.<sup>[256]</sup> Një ndërhyrje e tillë duhet të jetë e mbështetur nga arsye relevante dhe të mjaftueshme dhe duhet të jetë proporcionale me qëllimin ose qëllimet legjitime të synuara. Në këtë rast, duke pasur parasysh natyrën dhe moshën e informacionit për disa prej kërkuesve, arsyet për ruajtjen e të dhënave, sado që relevante, nuk mund të gjykoheshin të mjaftueshme pas 30 vitesh.

*Individët të cilët kanë qenë objekt i mbulimit gazetaresk si rezultat i hetimeve, arrestimit, ose dënimit*

Dhoma e Madhe tek *Hurbain* ka adresuar gjerë e gjerë të drejtën për t'u harruar në kontekstin e informacionit rreth hetimit, arrestimit ose dënimit të një personi që është publikuar dhe ruajtur nga gazetarët ose gazetatat. Kërkuesi argumentoi se vendimi civil që e urdhëroi të anonimizonte një artikull të arkivuar online ku përmendej emri i plotë i shoferit (G) përgjegjës për një aksident rrugor fatal, shkeli të drejtat e tij sipas Nenit 10. Dhoma e Madhe gjeti se nuk kishte pasur shkelje. Aty Gjykata nuk kishte mbështetur asnjë masë për të hequr ose modifikuar informacionin e publikuar ligjërisht për qëllime të gazetarisë dhe i arkivuar në uebfaqen e një portali lajmesh.

---

[255] *Gardel k. Francës*, vendim i 17 dhjetorit 2009, Nr. 16428/05 tek §70.

[256] *Segerstedt-Wiberg dhe të tjerë k. Suedisë*, vendim i 6 qershorit 2006, Nr. 62332/00 tek §§88-92.



Nuk lindën çështje lidhur me faktin nëse kishte pasur apo jo ndërhyrje, bazë ligjore, apo qëllim legjitim (këtu, mbrojtja e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve në lidhje me G). E vetmja çështje që ajo e proporcionalitetit dhe justifikimit. Gjykata mori në konsideratë çështje të mëparshme, përfshirë *ML dhe WW k. Gjermanisë*<sup>[257]</sup> dhe *Biancardi k. Italisë*<sup>[258]</sup>.

- 1) *ML dhe WW* kishte të bënte me refuzimin e gjykatës vendase për të urdhëruar tri organizata mediale të ndryshme që të anonimizonin dosjet e shtypit në lidhje me dënimin e kërkuesve për vrasjen e një aktori të mirënjohur, ku kërkuesit përmendeshin me emrat e tyre të plotë. Duke gjetur se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 8 në lidhje me kërkuesit, Gjykata mori parasysh këto konsiderata: faktin që në kohën që kërkuesit paraqitën kërkesat për anonimizim raportet e kontestuara kishin vazhduar të kontribuonin në një debat me interes publik; faktin që kërkuesit nuk ishin thjesht individë privatë të panjohur për publikun; sjelljen e kërkuesve ndaj mediave, të cilave vetë ata u ishin afruar pas dënimit të tyre me qëllim të rihapjes së procedurave; faktin që raportet kishin pasqyruar faktet në mënyrë objektive dhe pa qëllimin e paraqitjes së kërkuesve nën dritë të pafavorshme ose dëmtimin e reputacionit të tyre; dhe informacionet e pakta në dispozicion. Në *ML dhe WW*, Gjykata theksoi se rreziku i dëmit të përmbajtjes në internet ishte më i lartë se rreziku nga shtypi për shkak të rolit të rëndësishëm të makinave të kërkimit.<sup>[259]</sup> Gjykata gjithashtu deklaroi se lehtësia me të cilën informacionet mund të gjenden në internet ka efekt amplifikues tek shpërndarja e informacioneve, kështu që detyrimet e makinave të kërkimit ndaj një individi që është subjekt i informacionit mund të dallojnë nga ato të entitetit që e ka publikuar informacionin origjinal.<sup>[260]</sup> Balancimi i interesave në fjalë mund të japë rezultate të ndryshme varësisht nëse kërkesa për fshirjen e të dhënave personale kishte të bënte me publikuesin origjinal të informatës, aktiviteti i të cilit ishte përgjithësisht në thelb të asaj që mbron liria e shprehjes, ose me makinën e kërkimit interesi kryesor i së cilës nuk ka qenë publikimi i informatës fillestare rreth personit në fjalë por lehtësimi i identifikimit të çdo informacioni lidhur me atë person dhe formësimi i profilit të tij.

---

[257] *ML dhe WW k. Gjermanisë*, vendim i 28 qershorit 2018, Nr. 60798/10 dhe 65599/10.

[258] *Biancardi k. Italisë*, vendim i 25 nëntorit 2021, Nr. 77419/16 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[259] *ML dhe WW k. Gjermanisë*, vendim i 28 qershorit 2018, Nr. 60798/10 dhe 65599/10 tek §91.

[260] *ML dhe WW k. Gjermanisë*, vendim i 28 qershorit 2018, Nr. 60798/10 dhe 65599/10 tek §97.

2) *Tek Biancardi*,<sup>[261]</sup> kërkuesi, ish-kryeredaktori i një gazete online, u mbajt përgjegjës në procedurë civile për faktin se kishte mbajtur në uebfaqen e gazetës së tij një artikull nga viti 2008 i cili raportonte për një përlëshje në një restorant dhe jepte detaje për procedurat penale që u hapën më pas. Gjykata gjeti që jo vetëm ofruesve të makinës së kërkimit në internet por edhe administratorëve të gazetës ose arkivave të gazetarisë në internet, siç ishte kërkuesi, mund t'u kërkohej që të deindeksonin dokumente. Gjykata gjeti se kishte pasur ndërhyrje tek e drejta e kërkuesit për të ofruar informacione por se për këtë kishte një qëllim legjitim – mbrojtja e reputacionit të pronarit të restorantit, dhe ndërhyrja kishte qenë e nevojshme. Për të arritur në këtë përfundim, Gjykata mori në konsideratë këto kritere: gjatësinë e kohës së mbajtjes së artikullit online, ndjeshmërinë e informacionit dhe peshën e sanksionit të vënë (gjohë civile dhe jo kërkesë për heqjen e artikullit).<sup>[262]</sup> Ajo vendosi që nuk kishte pasur shkelje të lirisë së shprehjes së kërkuesit sidomos meqenëse atij në fakt nuk i ishte kërkuar heqja e artikullit nga uebfaqja.

Arsyetimi kyç i Dhomës së Madhe tek *Hurbain* gjendet në paragrafët 201 deri në 211 të vendimit. Vlerësimi i Gjykatës mori në konsideratë kontekstin e ndryshëm të çështjes, si arkiva dixhitale, në krahasim me çështjet që kanë të bëjnë me publikime fillestare. Duke mbajtur parasysh parimet e përgjithshme të referuar më lart, posaçërisht nevojën për të ruajtur integritetin e arkivave të shtypit, dhe gjithashtu, deri diku, praktikën e gjykatave në Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, Gjykata konsideroi se balancimi i këtyre të drejtave të ndryshme me vlerë të njëjtë në kontekstin e një kërkesë për modifikimin e përmbajtjes gazetareske të arkivuar online duhet të ketë parasysh këto kritere:

- i) Natyrën e informacionit të arkivuar;
- ii) Kohën që ka kaluar qysh nga ndodhja e ngjarjes dhe qysh nga publikimi fillestar online;
- iii) Interesi aktual në këtë informacion;
- iv) Nëse personi që kërkon të drejtën për t'u harruar është i mirënjohur dhe sjellja e këtij person qysh prej ndodhjes së ngjarjes;
- v) Pasojat negative të qenies së vazhdueshme të informacionit në dispozicion online;

---

[261] *Biancardi k. Italisë*, vendim i 25 nëntorit 2021, Nr. 77419/16 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

[262] *Biancardi k. Italisë*, vendim i 25 nëntorit 2021, Nr. 77419/16 tek §§62-69 (përfshirë si përmbledhje në këtë publikim).

- vi) Shkalla e qasshmërisë së informacionit në arkivat dixhitale; dhe
- vii) Impakti i masës mbi lirinë e shprehjes dhe më specifikisht mbi lirinë e shtypit.

Dhoma e Madhe gjeti se në mënyrë që të hyjë në lojë Neni 8, sulmi ndaj reputacionit të një personi duhet të arrijë një nivel të caktuar të seriozitetit. Në shumicën e rasteve, duhet të merren parasysh një mori kriteresh njëkohësisht për të përcaktuar mbrojtjen që duhet t'i ofrohet jetës private kur vihet karshi interesave në fjalë dhe karshi mënyrave të përdorura për t'i dhënë efekt asaj mbrojtjeje në një rast të dhënë.

Subjektet e të dhënave nuk janë të detyruar të kontaktojnë uebfaqen origjinale për të ushtruar të drejtën e tyre karshi makinave të kërkimit, meqenëse përpunimi nga makinat e kërkimit dhe përpunimi nga uebfaqja origjinale janë dy forma të ndryshme përpunimi, secila me bazën e vet të legjitimitetit dhe me impakt të ndryshëm mbi të drejtat dhe interesat e individit. Po kështu, ekzaminimi i një veprimi kundër publikuesit të një uebfaqeje lajmesh nuk mund të varet nga një kërkesë e mëhershme drejtuar një makine kërkimi për delistim. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, dallimi mes aktiviteteve të operuesve të makinave të kërkimit dhe atyre të publikuesve të lajmeve merr kuptim kur Gjykata shqyrton ndërhyrjet tek liria e shprehjes, përfshirë të drejtën e publikut për të marrë informacione, duke u bazuar mbi pretendimin për të drejtën për t'u harruar.

Gjykata njohu që efekti pengues tek liria e shtypit që del nga detyrimi i një publikuesi për të anonimizuar një artikull që është publikuar fillimisht në mënyrë të ligjshme nuk mund të injorohet. Detyrimi për të shqyrtuar në një fazë të mëvonshme ligjshmërinë e qëndrimit të vazhduar online të një artikulli pas kërkesës nga një person që pretendon të jetë viktimë e situatës ngërthen rrezikun që shtypi në të ardhmen të frenohet nga mbajtja e raportimeve në arkivat online, ose që ai të heqë elemente të individualizuara nga artikujt të cilat me gjasë mund të jenë objekt i kërkesave të ngjashme. Sidoqoftë, ofruesve të përmbajtjeve u kërkohet të vlerësojnë dhe të peshojnë interesat e lirisë së shprehjes dhe respektit për jetën private vetëm kur personi në fjalë bën kërkesë eksplicite për atë qëllim.

Megjithëse në kontekstin e ushtrimit të balancimit mes të drejtës për lirinë e shprehjes dhe të drejtës për respekt ndaj jetës private këto dy të drejta duhet të shihen si të barasvlershme, kjo nuk do të thotë se kriteret që duhen aplikuar gjatë këtij ushtrimi kanë të gjitha të njëjtën peshë. Në këtë kontekst, në fakt, parimi i ruajtjes së integritetit të arkivave të shtypit duhet të mbështetet, çka nënkupton

garantimin që modifikimi dhe, *a fortiori*, heqja e përmbajtjes së arkivuar është e kufizuar me atë që është rreptësisht e nevojshme, me qëllim që të mos lejohet efekti pengues të këtyre masave mbi performancën nga shtypi të detyrës së tij për transmetimin e informacioneve dhe mbajtjen e arkivave. Prandaj, gjatë aplikimit të kriterëve të lartpërmendura, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë balancimit të duhur të, nga njëra anë, interesave të individëve që kërkojnë modifikimin ose heqjen e një artikulli në lidhje me ta nga arkivat e shtypit dhe, nga ana tjetër, impaktit të kërkesave të tilla tek publikuesit e lajmeve dhe gjithashtu, varësisht nga rasti, tek funksionimi i shtypit.

Në përfundim, Gjykata gjeti se gjykatat kombëtare kishin shqyrtuar në mënyrë koherente natyrën dhe seriozitetin e fakteve gjyqësore të raportuara në artikullin në fjalë, faktin që artikulli nuk kishte zgjuar interes tematik, historik, ose shkencor, dhe faktin që G nuk ishte i mirënjohur. Përveç kësaj, ato i dhanë rëndësi dëmit serioz të pësuar nga G si pasojë e qëndrimit të vazhdueshëm online të artikullit me qasje të pakufizuar, çka mundësoi krijimin e një "regjistri penal virtual" sidomos duke pasur parasysh kohën e gjatë që kishte kaluar qysh nga publikimi fillestar. Më tej, pas shqyrtimit të masave që mund të konsideroheshin për të balancuar të drejtat në fjalë, gjykatat vendase kishin deklaruar se anonimizimi i artikullit nuk vinte barrë të tepërt dhe jopraktike mbi kërkuesin, ndërkohë që ishte mënyra me efektive e mbrojtjes së privatësisë së G. Në këto rrethana, dhe duke mbajtur parasysh hapësirën e vlerësimit, Gjykata gjeti se gjykatat vendase kishin balancuar me kujdes të drejtat në fjalë në mënyrë të atillë që ndërhyrja tek Neni 10 që e kufizuar deri aty sa ishte rreptësisht e nevojshme, dhe kështu mund të shihej si e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale. Gjykata nuk gjeti arsye të forta për të zëvendësuar pikëpamjen e vet. Rrjedhimisht, nuk pati shkelje të Nenit 10.

# Kapitulli 6

## Përfundim

Kjo fushë e mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtës për t'u harruar, në kontekstin e procedurave hetimore dhe gjyqësore, është në evolucion gjatë gjithë kohës për shkak të zhvillimeve të shpejta të teknologjisë moderne. Gjykata është e vetëdijshme për vështirësitë që mund të përfaqësojë një gjë e tillë dhe për nevojën e balancimit të të drejtave konkurruese tani, me qëllim që të dhënat të përdoren ndryshe në të ardhmen e afërt.

Gjykata ka shprehur vullnetin për të përkufizuar “të dhënat personale” në kuptim të gjerë, për të përfshirë informacione që identifikojnë një individ direkt dhe indirekt. Fakti që të dhënat janë në domenin publik nuk do të thotë se ato i humbasin cilësitë e tyre “personale”. Gjykata gjithashtu i trajton disa kategori të caktuara të dhënash si më “të ndjeshme” dhe kërkon një shkallë më të lartë mbrojtjeje për ato të dhëna, duke njohur se zbulimi i të dhënave të tilla mund të ndikojë në mënyrë dramatike tek jeta private dhe familjare e një individi, si dhe tek situata sociale dhe profesionale, dhe t'i ekspozojë ata ndaj rrezikut të izolimit.

Gjykata i ka mbrojtur të dhënat gjatë fazave hetimore të procedurave dhe ka theksuar rëndësinë e kësaj. Kjo është fushë që po ndryshon me shpejtësi ku Shtetet po përdorin metoda të interceptimit të komunikimeve për parandalimin e krimit dhe ruajtjen e sigurisë, dhe njëkohësisht individët dhe grupet po gjejnë mjete komunikimi të cilat kanë për qëllim pikërisht mbrojtjen e komunikimeve private nga përgjimi. Siç u cek më lart, nuk është ende e qartë nëse grumbullimi, depozitimi dhe transferimi i të dhënave nga EncroChat, Anom dhe Sky ECC do të përbëjë shkelje të Nenit 8. Sa i përket përdorimit të ndonjë materiali të tillë në procedura gjyqësore, ai do të jetë relevant deri në masën ku mbrojtja e një individi mund të kontestojë dhe ekzaminojë autenticitetin dhe besueshmërinë e provave të tilla. Shtetet duhet të jenë veçanërisht vigjilente nëqoftëse duan të përdorin prova të marra në një juridiksion tjetër në të cilin mbrojtjet për provat e mbledhura mund të jenë të ndryshme.

Në kontekstin e publikimit të informacionit rreth procedurave gjyqësore, Shtetet duhet të vendosin një ekuilibër mes konsideratave të drejtësisë së hapur dhe mbrojtjes së të dhënave, ku gjatë gjithë kohës duhet të mbajnë parasysh rëndësinë e prezumimit të pafajësisë sipas Nenit 6.

E drejta për t'u harruar ka rëndësi gjithnjë më të madhe për individët. Teknologjia dhe përdorimi i saj nga shoqëria ka përparuar kaq shumë sa që artikuj me lajme rreth veprave të kryera nga një individ shfaqen me një klik dekada më pas. Kjo mund të ketë impakt të sertë tek marrëdhëniet personale dhe profesionale të individit. Gjykata ka njohur se qoftë edhe thjesht akuzat kundër një personi mund të çojnë në dyshime permanente rreth karakterit të tij. Mundësia që ADN-ja e një personi të ruhet përgjithmonë dhe të ndërlidhet me pasardhësit e tij gjithashtu krijon pyetje etike rreth kundërvënies së parandalimit të kimit dhe ruajtjes së sigurisë kombëtare kundrejt privatësisë së një individi dhe potencialisht familjarëve të tij. Tensionet mes Nenit 8 dhe Nenit 10 do të vazhdojnë të shfaqen në kontekste të ndryshme, dhe gjyqtarët vendas duhet të sigurohen që të marrin parasysh të gjitha konsideratat e rëndësishme para se të kalojnë tek privatësi ose shprehja e lirë.

Qeveritë, avokatët, gjyqësorët e Shteteve, dhe sektori i OJQ-ve duhet të vazhdojnë të edukohen në lidhje me mënyrat se si teknologjitë e reja mund të ndikojnë, dhe do të mund të ndikonin, tek të drejtat e individit që janë vendosur që një kohë të gjatë, dhe t'u bëjnë ballë sfidave që lindin për pasojë. Një ekzaminim i kujdesshëm dhe i imtë i të gjitha të drejtave konkurruese në fjalë është thelbësor për pajtueshmërinë me kriteret e Konventës në këtë epokë mahnitëse.

# P J E S A 2

## Përmbledhjet e Çështjeve

*Zbulimi i ligjshëm dhe proporcional i një bisede të përgjuar me Kryeministrin, në lidhje me një çështje të interesit publik, nuk shkeli Nenin 8 pavarësisht nga impakti në reputacion*

### VENDIMI NË ÇËSHTJEN **ALGIRDAS BUTKEVIČIUS K. LITUANISË**

(Kërkesa Nr. 70489/17)  
**14 qershor 2022**

#### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1958 dhe jetonte në Vilnius. Ai kishte qenë anëtar i Seimas (Parlamenti lituanez) që nga viti 1996; në kohën e çështjes ai ishte Kryeministër i Lituanisë, pozitë në të cilën ai qëndroi nga nëntori 2012 deri në nëntor 2016.

Në vitin 2015, një prokurori rajonale dhe Shërbimi Special Hetimor i Lituanisë ishin duke zhvilluar hetime paragjyqësore në lidhje me pretendimet për korrupsion politik rreth miratimit të një rezolute të caktuar të qeverisë. Rezoluta e qeverisë do të kishte impakt mbi statusin dhe privilegjet e territoreve të cilësuara si "rezorte"; ajo u miratua në shtator 2015 dhe më pas u anulua në maj 2016. Gjatë hetimeve, një gjykatë kishte autorizuar incizimin e thirrjeve telefonike të një politikani vendas (R.M.), kryetar bashkie i një territori që ishte rezort. Një prej thirrjeve telefonike të përgjuara gjatë hetimeve ishte mes kërkuesit dhe R.M. Gjatë kësaj bisede, u diskutua shkurt rezoluta e qeverisë.

Eventualisht, prokurori rajonal vendosi të mos i vazhdonte hetimet paragjyqësore, meqenëse dukej se nuk ishte kryer ndonjë krim. Vendimi për mosvazhdim përmbante transkripte të bisedës telefonike mes kërkuesit dhe R.M.

Ndaras, Komisioni Anti-Korrupsion i Seimas ("Komisioni") mori udhëzime që të zhvillonte hetime parlamentare në lidhje me miratimin e rezolutës së qeverisë. Gjatë këtyre hetimeve, prokurori rajonal i dërgoi Komisionit një kopje të vendimit për mos-vazhdim, përfshirë transkriptet e thirrjes telefonike. Komisioni më pas mbajti një seancë publike në lidhje me këtë çështje, gjatë së cilës u diskutuan hetimet paragjyqësore.

Një prej gazetarëve të pranishëm në seancën publike më pas publikoi një artikull online, me titull "Detaje pikante rreth bisedave që u bënë publike" me disa pjesë të shkëputura nga thirrja telefonike e kërkuesit, të cilat atij iu duk se paraqiteshin nën dritë negative. Mbi bazën e këtij zbulimi fillestar, më tej vijuan artikuj të shumtë me pjesë të shkëputura nga transkriptet. Kërkuesi bëri ankesë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, dhe më pas në gjykatat vendase, në lidhje me zbulimin publik të bisedës telefonike dhe ndërhyrjes së saj tek e drejta e tij nga Neni 8 për respekt ndaj jetës private dhe familjare, por këto përpjekje qenë të pasuksesshme.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se publikimi i korrespondencës së tij kishte treguar dështimin e Shtetit për të mbrojtur privatësinë e tij siç duhej, dhe se ai kishte ndikuar rëndë në jetën e tij private, në shkelje të të drejtave të tij nga Neni 8.

### Neni 8

Gjykata theksoi se bisedat dhe korrespondenca private, pavarësisht nga përmbajtja e tyre dhe vendi ku ndodhin, janë të mbrojtura nga Neni 8, pa kualifikim eksplicit ose implicit. Kjo mund të përfshijë aktivitetet profesionale, të cilat shpesh është e vështirë ose e pamundur të izoloohen nga jeta private dhe identiteti i një individi, përfshirë marrëdhëniet e tyre private. Prandaj, Gjykata gjeti se Neni 8 ishte i aplikueshëm në rrethanat e kërkuesit.

Më tej, Gjykata njohu se transmetimi i bisedës telefonike të përgjuar të kërkuesit, dhe ekzaminimi i transkripteve të bisedës në seancën publike, kishin përbërë ndërhyrje tek të drejtat e kërkuesit nga Neni 8.

Kërkuesi nuk e kontestoi faktin se ndërhyrja e deklaruar në jetën e tij private ishte ekzekutuar në mënyrë të ligjshme; por ai u ankua se transferimi nga prokurori i transkripteve, dhe mungesa e kufizimit të qasjes publike, përbënë dështim për të



mbrojtur jetën e tij private. Duke pasur parasysh se biseda në fjalë ishte në lidhje me korrupsion të mundshëm politik dhe aktivitete të mundshme ilegale, Gjykata vendosi që prokurori publik kishte pasur jo vetëm të drejtën por edhe detyrimin për t'i dërguar transkriptet në Krye-Komisionin Zyrtar të Etikës. Prandaj, prokurori publik kishte vepruar në përputhje me të drejtën dhe procedurën vendase.

Autoritetet vendase kishin arritur në përfundimin se prokurori nuk kishte shkelur rregulla ose standarde të etikës gjatë procedurës penale duke i lëshuar transkriptet; më tej, gjykatat vendase nuk e kishin parë të udhës në asnjë moment që t'i prishnin gjetjet e prokurorit. Për fund, transkriptet ishin zbuluar brenda kornizës standarde të Komisionit, siç ishte e rregulluar me të drejtën vendase. Duke respektuar pozitën, gjykimin dhe procedurat e autoriteteve lokale, dhe në mungesë të provave të qarta për arbitraritet nga ana e tyre, Gjykata kështu e refuzoi argumentin e kërkuarit se Shteti kishte dështuar të mbronte mjaftueshëm informacionin që kishte mbledhur gjatë hetimeve paragjyqësore.

Baza ligjore e ndërhyrjes së Shtetit ishte e qasshme dhe e parashikueshme. Më saktësisht, kërkuari do të duhet ta kishte parashikuar se veprimet e tij i nënshtroheshin këqyrjes publike, duke pasur parasysh rolin e tij zyrtar, dhe se detyrimi i autoriteteve për të promovuar transparencën politike e minonte më tej pretendimin e kërkuarit për privatësi. Për të gjitha këto arsye, kjo ishte në përputhje me ligjin.

Në rastin e kërkuarit, ndërhyrja kishte synuar qëllime legjitime, përfshirë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, llogaridhënien për korrupsion, dhe parandalimin e krimit. Më tej, korrespondenca ishte në lidhje me çështje politike, dhe nuk përfshinte informacione të ndjeshme rreth jetës private të kërkuarit, si p.sh. informacione rreth shëndetit të tij apo jetës së tij seksuale.

Më pas, Gjykata shqyrtoi nëse ndërhyrja kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike. Ajo theksoi rëndësinë e balancimit të interesave konkurruese të paraqitura në çështjen e kërkuarit, siç është e drejta e tij për nder dhe reputacion; e drejta e shtypit për të raportuar mbi çështje të interesit dhe shqetësimit publik; e drejta e publikut për të pasur qasje në informacione të tilla dhe në transparencë politike; dhe kufizimet mbi pritshmëritë e individëve publikë për privatësi gjatë kohës që veprojnë në cilësi zyrtare. Zyrtarëve publikë jo vetëm që nuk u takon privatësia totale, por çështjet e natyrës publike si rregull janë të mbrojtura nga Neni 8. Në fakt, jetët private të figurave publike mund të jenë çështje interesi popullor, dhe mund të implikojnë edhe të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Gjykata njohu se ndërhyrja kishte prekur jetën private të kërkuesit, e në mënyrë të veçantë reputacionin e tij; më tej, ajo pranoi se shqetësimet lidhur me reputacionin mund të kenë impakt të veçantë tek figurat publike dhe politikanët. Megjithatë, ndryshe nga çështjet e tjera që kanë të bëjnë me ndërhyrje tek të drejtat e Nenit 8 në ambiente profesionale, kërkuesi nuk kishte përjetuar ndonjë pasojë të matshme e konkrete përveç njëfarë humbjeje të reputacionit. Përveç kësaj, rezoluta e qeverisë, që ishte pjesë e thirrjes telefonike të kërkuesit dhe hetimeve paragjyqësore, ishte anuluar më pas, kështu që çdo lloj stigmatizimi rreth kësaj çështjeje kishte përfunduar ligjërisht.

Prandaj, Gjykata nuk mundi të arrinte në përfundimin se ndërhyrja kishte qenë joproporcionale me qëllimet legjitime të synuara. Gjykata gjeti që nuk kishte pasur shkelje.

*Përrjashtimi i një seance publike dhe i shqiptimit publik të vendimit në procedurën për rezidencën e fëmijës nuk shkeli Nenin 6 § 1 të Konventës*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**B. DHE P. k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesat Nr. 36337/97 dhe Nr. 35974/97)  
**24 prill 2001**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit ishin të lindur në vitet 1963 dhe 1949, dhe jetonin në Mbretërinë e Bashkuar. Të dy kërkuesit kishin nisur procedurat në Gjykatën Krahinore në Mbretërinë e Bashkuar për urdhrat e rezidencës sipas seksionit 8(1) të Ligjit për Fëmijët i vitit 1989 (Ligji) në lidhje me bijtë e tyre, respektivisht, pas ndarjes nga partneret ose gratë e tyre (kërkesat për rezidencë).

Të dy kërkuesit kërkuan që kërkesat e tyre të dëgjoheshin në seanca publike dhe që vendimet të shqiptoheshin publikisht. Këto kërkesa u refuzuan. Rregulli përkatës vendas për procedurat sipas Ligjit parashikonte që "nëqoftëse gjykata nuk udhëzon ndryshe, dëgjimi, ose caktimi i drejtimit, në procedura në të cilat aplikohet kjo Pjesë zhvillohen në seancë të mbyllur". Gjykata e Apelit i rrëzoi apelet e kërkuesve kundër vendimeve të gjyqtarëve mbi bazën se gjyqtarët respektivë e kishin ushtruar në mënyrën e duhur diskrecionin e tyre duke refuzuar të dëgjonin kërkesat në seancë të hapur gjyqësore dhe duke sjellë urdhra për anonimitet.

Çështja e B u mbajt në seancë të mbyllur (private) gjatë tërë kohës. Çështja e P gjithashtu u mbajt në seancë të mbyllur, megjithëse kërkesa e tij e dytë për kujdestari u mbajt në seancë të hapur. Në lidhje me B, gjyqtari i çështjes urdhëroi që asnjë dokument i përdorur gjatë procedurës të mos zbulohet jashtë gjykatës. B gjithashtu pretendoi se gjyqtari e paralajmëroi që çdo publikim i informacioneve të dala në kontekstin e procedurës do të përbënte përbuzje të gjykatës, për çka B mund të shkonte në burg. Vendimet e të dy procedurave u shqiptuan në seanca të mbyllura, dhe palëve iu dha nga një kopje e vendimeve me shkrim.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan se fakti që çështjet e tyre nuk u dëgjuan në seanca të hapura dhe që vendimet nuk u shpallën publikisht shkeli të drejtat e tyre sipas Nenit 6 §

1 të Konventës (e drejta për seancë të drejtë dhe publike). Më tej, ata u ankuan se ndalimi i zbulimit të informacioneve në lidhje me procedurat e tyre shkeli të drejtat e tyre nga Neni 10.

### Neni 6

Duke marrë në konsideratë së pari ankesën e lidhur me mungesën e seancës publike, Gjykata theksoi praktikën e saj gjyqësore në lidhje me rëndësinë e karakterit publik të procedurave drejt arritjes së qëllimit të një seance të drejtë sipas Neni 6 § 1. Megjithatë, kriteri për mbajtjen e një seance publike kishte përjashtime. Gjykata konsideroi se procedurat për rezidencën e fëmijës ishin shembuj kryesorë që rasteve kur përjashtimi i shtypit dhe publikut mund të justifikohet me qëllimin e mbrojtjes së privatësisë së fëmijës dhe palëve dhe shmangien e paragjytimeve në interes të drejtësisë. Në mënyrë që gjyqtari të kishte një pasqyrë sa më të plotë dhe të saktë të avantazheve dhe dizavantazheve të opsioneve të ndryshme të rezidencës dhe kontakteve, ishte thelbësore që prindërit dhe dëshmitarët e tjerë të ndiheshin që mund të shpreheshin hapur pa frikën e kureshtjes apo komenteve publike.

Megjithëse Gjykata njohu se Neni 6 § 1 thotë që procedurat duhet të jenë publike, nuk ishte në shpërputhje me këtë që një Shtet të caktonte një kategori të tërë çështjesh si përjashtime nga rregulli i përgjithshëm, kur një gjë e tillë konsiderohej e nevojshme për një qëllim legjitim. Rregulli procedural vendas ishte pasqyrim specifik i përjashtimeve të përgjithshme të parashikuara nga Neni 6 § 1. Gjykatat vendase gjithashtu kishin diskrecionin për të mbajtur seanca publike nëqoftëse kështu e meritonin tiparet e veçanta të çështjes, dhe gjyqtari duhet të shqyrtonte nëse do ta ushtronte këtë diskrecion po qe se kërkohej nga ndonjëra prej palëve.

Në lidhje me kërkesin e parë, megjithëse gjyqtari i shkallës së parë dukej se konsideroi që nuk e kishte fuqinë për të urdhëruar që seanca të zhvillohej me publik, ky keqdeklarim i të drejtës vendase u korrigjua në apel, dhe gjyqtari më pas kishte shpjeguar se seanca publike nuk ishte në interes të fëmijës. Në lidhje me kërkesin e dytë, gjyqtarët në shkallën e parë dhe në apel kishin shqyrtuar me kujdes dhe kishin detajuar me hollësi arsyet e tyre. Rrjedhimisht, Gjykata nuk konsideroi që kishte shkelje të Neni 6 § 1 në lidhje me mungesën e seancës publike.

Sa i përket refuzimit të gjykatave vendase për të shqiptuar publikisht vendimet e tyre për kërkesat e rezidencës, Gjykata kujtoi praktikën e saj të gjatë gjyqësore

që forma e publicitetit sipas të drejtës vendase në një vendim duhet të vlerësohet nën prizmin e tipareve të veçanta të procedurës në fjalë dhe duke iu referuar objektit dhe qëllimit të Nenit 6 § 1.

Gjykata theksoi përfundimin e saj se autoritetet vendase qenë të justifikuar për zhvillimin e procedurave me dyer të mbyllura me qëllim që të mbrohej privatësia e fëmijëve dhe palëve dhe për të shmangur paragjykimet në interes të drejtësisë. Gjykata konsideroi se shqiptimi i vendimit në publik do t'i kishte ngushtuar këto qëllime në masë të madhe.

Më tej, Gjykata theksoi se kushdo që mund të ketë një interes të caktuar mund të konsultohet ose të marrë një kopje të tekstit të plotë të urdhrave dhe/ose vendimeve, dhe vendimet e Gjykatës së Apelit dhe të gjykatave të shkallës së parë për çështje me interes të veçantë zakonisht publikoheshin. Pra, publiku kishte pasur mundësi të studioje mënyrën se si gjykatat u qaseshin çështjeve të rezidencës së fëmijëve në përgjithësi dhe parimet që aplikoheshin gjatë vendimmarrjes për to.

Një interpretim fjalpërfjalshëm i termave të Nenit 6 §1 në lidhje me shqiptimin e vendimeve jo vetëm që do të kishte qenë i panevojshëm për qëllime të këqyrjes publike, por edhe do të kishte ngushtuar më tej synimin parësor të Nenit 6 për sigurimin e një seance të drejtë.

Rrjedhimisht, Gjykata doli në përfundimin se Neni 6 §1 nuk kërkonte që vendimet e këtyre çështjeve të ishin publike.

#### Neni 10

Duke pasur parasysh gjetjet e saj në lidhje me Nenin 6, Gjykata doli në përfundimin se nuk ishte e nevojshme të shqyrtoheshin ndaras ankesat e kërkuessve sipas Nenit 10.

*Sanksionimi civil i një redaktori për refuzimin e zgjatur të deindeksimit të një artikulli lidhur me një çështje penale kundër personave privatë nuk shkeli të drejtat e redaktorit nga Neni 10*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**BIANCARDI k. ITALISË**

(Kërkesa Nr. 77419/16)  
**25 nëntor 2021**

## **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte shtetas italian i cili ishte i lindur në vitin 1972 dhe jetonte në Pescara. Ai ishte kryeredaktor i një gazete online.

Në mars të vitit 2008, ai publikoi një artikull në lidhje me një përlëshje me thikë në një restorant. Artikulli përmendte emrat e personave të përfshirë, konkretisht një familje, dy vëllezër, dhe djemtë e tyre respektivisht, të cilët ishin pronarë të restorantit. Në artikull po ashtu raportohej se arsyeja e përlëshjes mbase kishte pasur të bënte me një grindje të natyrës financiare rreth pronësisë së një ndërtese, dhe jepeshin detaje rreth arrestit shtëpiak dhe/ose paraburgimit të anëtarëve të familjes.

Në shtator të vitit 2010, njëri prej vëllezërve dhe restoranti i tij i dërguan një notë zyrtare kërkuesit duke i kërkuar që artikulli të hiqej nga interneti, pa dobi. Meqenëse nuk u ndërmor asnjë veprim, vëllai më pas bëri padi në gjykatat vendase.

Në janar të vitit 2013, gjykata e rrethit vendosi që nuk kishte nevojë ta shqyrtonte kërkesën që artikulli të hiqej nga interneti, meqenëse kërkuesi e kishte deindeksuar artikullin. Megjithatë, ajo gjeti se qasja e lehtë përmes internetit deri tek informacioni në lidhje me procedurën penale nga marsi 2008 në maj 2011, kur kërkuesi e kishte deindeksuar artikullin, kishte shkelur të drejtën e paditësit për respekt të reputacionit të tij. Ajo theksoi në mënyrë të veçantë se dështimi i kërkuesit për të deindeksuar etiketimet (ang. tags) në artikull do të thoshte se kushdo mund të kishte qasje në të dhëna të ndjeshme lidhur me procedurën thjesht duke futur emrat e paditësve në makinën e kërkimit. Kërkuesi u urdhërua t'i paguante secilit paditës 5,000 euro kompensim. Gjykata Supreme e mbështeti vendimin e shkallës së parë mbi të gjitha bazat në qershor 2016.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas Nenit 10 të Konventës (liria e shprehjes) se kishte pasur shkelje të së drejtës së tij për të transmetuar informacione dhe se 5,000 eurot që ishte urdhëruar t'i paguante secilit paditës si kompensim kishin qenë të tepërta.

### Neni 10

Gjykata vuri në dukje se mes palëve nuk diskutohej që tek liria e shprehjes së kërkuesit, siç garantohet nga Neni 10 i Konventës, ishte bërë ndërhyrje me vendimet e gjykatave vendase. As nuk diskutohej mes palëve që një ndërhyrje e tillë ishte "e parashikuar me ligj". Më tej, Gjykata qe e bindur që ndërhyrja në fjalë kishte për qëllim të mbronte "reputacionin ose të drejtat e të tjerëve" dhe kështu synonte një qëllim legjitim sipas Nenit 10 § 2 të Konventës.

Lidhur me pyetjen nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata tërhoqi vëmendjen në fillim ndaj specifikës dhe fushëveprimit të çështjes në fjalë. Kërkuesi u mbajt përgjegjës jo për dështimin në heqjen e artikullit, por për dështimin në deindeksimin e tij. Deindeksimi përkufizohej si aktiviteti i një makine kërkimi që kishte të bënte me heqjen, me iniciativë të operatorëve, nga lista e rezultateve të shfaqura pas kërkimit të bërë me emrin e personit, faqet e internetit të publikuara nga palë të treta që përmbajnë informacione lidhur me atë person. Në rastin konkret, dështimi kishte lejuar mundësinë, për një periudhë kohëzgjatja e së cilës ishte vlerësuar të ishte e tepërt nga gjykatat vendase, e shtypjes në makinën e kërkimit të emrave të paditësve për të marrë informacione në lidhje me procedurën penale.

Gjykata e pa këtë si pikënisje e rëndësishme për të përcaktuar ndërhyrjen tek liria e shprehjes së kërkuesit dhe për të identifikuar, përkatësisht, parimet e aplikueshme për të vlerësuar proporcionalitetin e asaj ndërhyrjeje. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të kaluar, Gjykata parashtroi parimet përkatëse për të udhëhequr vlerësimin e saj dhe identifikoi një numër kriteresh në kontekstin e balancimit të lirisë së shprehjes kundrejt të drejtës për reputacion<sup>[263]</sup>. Këto kritere ishin: (i) kontributi në një debat të interesit të përgjithshëm; (ii) shkalla deri ku personi i përfshirë është i mirënjohur dhe subjekti i raportit në fjalë; (iii) sjellja e mëparshme e personit të përfshirë karshi mediave; (iv) metoda e marrjes së

---

[263] *Axel Springer AG k. Gjermanisë*, vendimi i Dhomës së Madhe i 7 shkurtit 2012, Nr. 39954/08.

informacioneve në fjalë; (v) përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit në fjalë; dhe (vi) rreptësia e sanksionit të vënë mbi kërkuesin.

Kishte një sërë dallimesh faktike mes praktikës gjyqësore aktuale dhe praktikës gjyqësore më të vjetër, dhe Gjykata përfundimisht njohu se aplikimi strikt i kriterëve të lartcekura do të ishte i papërshtatshëm në rrethanat e çështjes aktuale. Ajo që duhet të merrej në konsideratë ishte nëse, nën dritën e parimeve themelore të përcaktuara në praktikën e saj gjyqësore, gjetja nga gjykata vendase e përgjegjësisë civile të kërkuesit ishte e bazuar mbi fakte relevante dhe të mjaftueshme, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të çështjes. Vëmendje e veçantë në këtë rast i duhej kushtuar (i) kohëzgjatjes së mbajtjes së artikullit online; (ii) ndjeshmërisë së të dhënave në fjalë; dhe (iii) peshës së sanksioneve të vëna ndaj kërkuesit.

Në lidhje me pikën e parë, Gjykata njohu se procedura penale ishte ende duke vazhduar në kohën kur Gjykata Supreme miratoi vendimin e saj në çështjen e kërkuesit. Megjithatë, duhet theksuar se informacionet e përmbajtura në artikull nuk ishin përditësuar qysh prej ndodhjes së ngjarjeve në fjalë. Për më tepër, pavarësisht nga nota zyrtare dërguar kërkuesit me kërkesën për heqjen e artikullit nga interneti, ai kishte mbetur online dhe kishte qenë lehtë i qasshëm për tetë muaj. Për shkak të kësaj, e drejta vendase e aplikueshme mbështeti idenë që relevanca e të drejtës së kërkuesit për të shpërndarë informacione ishte zvogëluar me kalimin e kohës në krahasim me të drejtën e subjektit të artikullit për respekt ndaj reputacionit të tij, duke e rrëshqitur ekuilibrin në favor të paditësve.

Për sa i përket ndjeshmërisë së të dhënave në fjalë në rastin konkret, Gjykata qe e vëmendshme se subjekti i artikullit kishte lidhje me procedurën penale. Rrethanat në të cilat publikohen informacione lidhur me të dhëna të ndjeshme përbënin faktor për t'u marrë në konsideratë gjatë balancimit të së drejtës për shpërndarjen e informacionit karshi së drejtës së një subjekti të të dhënave për respekt ndaj jetës së tij/saj private.

Lidhur me peshën e sanksionit, kërkuesi u mbajt përgjegjës sipas të drejtës civile dhe jo penale. Megjithëse shumica e kompensimit që kërkuesi u desh t'u paguante paditësve për shkeljen e të drejtës së tyre për respektim të reputacionit të tyre nuk ishte e papërfillshme, Gjykata qe e mendimit se rreptësia e dënimit dhe shumica e kompensimit në lidhje me dëmet jomateriale (5,000 euro për secilin paditës) nuk shihej si e tepërt, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes.



Kur ushtrimi i balancimit mes lirisë së shprehjes e mbrojtur nga Neni 10, nga njëra anë, dhe të drejtës për respekt të jetës private sipas Nenit 8 të Konventës, nga ana tjetër, zhvillohej nga autoritetet kombëtare në përputhje me kriteret e shtruara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, Gjykata nuk ishte e gatshme të zëvendësonte pikëpamjen e saj me atë të gjykatave vendase.

Konsideratat e lartcekura qenë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se gjetja nga gjykatat vendase që kërkuesi kishte shkelur të drejtën e paditësve për reputacion, për shkak të pranisë së vazhduar në internet të artikullit të kontestuar dhe për shkak të dështimit të tij për ta deindeksuar artikullin, përbëri kufizim të justifikueshëm të lirisë së tij të shprehjes; aq më tepër për shkak se kërkuesit nuk iu bë asnjë kërkesë për ta hequr artikullin nga interneti në mënyrë permanente.

Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 10 të Konventës.

*Përgjimi dhe ekzaminimi i komunikimeve nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar u vendos se që në shkëlqje të Neneve 8 dhe 10 pavarësisht nga hapësira e gjerë e vlerësimit që u jepet autoriteteve mbi bazën e sigurisë kombëtare*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN **'BIG BROTHER WATCH' DHE TË TJERË K. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesat Nr. 58170/13, 62322/14 dhe 24960/15)  
**25 maj 2021**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit në kërkesën e parë prej këtyre tri çështjeve të bashkuara ishin Kontrolli i Vëllait të Madh, English PEN, Grupi për të Drejta të Hapura dhe Dr. Constance Kurz. Kërkuesit në kërkesën e dytë të çështjeve të bashkuara ishin Byroja për Gazetari Hulumtuese dhe Alice Ross. Kërkuesit në kërkesën e tretë të çështjeve të bashkuara ishin Amnestia Ndërkombëtare, Bit për të Gjithë, Liria, Privatësia Ndërkombëtare, Unioni Amerikan i Lirive Civile, Shoqata Kanadeze e Lirive Civile, Iniciativa Egjiptiane për të Drejtat Personale, Unioni Hungarez i Lirive Civile, Këshilli Irlandez i Lirive Civile, dhe Qendra e Burimeve Ligjore<sup>[264]</sup>.

Të tri kërkesat erdhën në reagim të zbulimeve të bëra nga Edward Snowden në lidhje me përdorimin e gjerë të përgjimeve elektronike nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe Mbretëria e Bashkuar. Kërkuesit të gjithë besonin se komunikimet e tyre elektronike me gjasë ishin përgjuar dhe/ose qasur nga Mbretëria e Bashkuar me anë të ofruesve të shërbimeve të komunikimit (ang. CSP). CSP-të operojnë me kablllo optike nëndetëse ndërkombëtare të cilat mbajnë rrjetin e komunikimeve në internet. Secili kabëll mund të ketë disa "mbajtës" që transmetojnë komunikime të cilat janë të ndara në "paketa" të dhënash.

Skemat e përgjimit në fjalë drejtohen nga Shtabi Qendror për Komunikime i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar (ang. GCHQ) dhe Agjencia e Shteteve të

---

[264] (Shën. i përkt.) Emrat origjinalë të palëve kërkuese në anglisht, të ndara sipas kërkesave: Kërkesa e parë: Big Brother Watch, English PEN, Open Rights Group, Dr. Constance Kurz; Kërkesa e dytë: Bureau of Investigative Journalism, Alice Ross; Kërkesa e tretë: Amnesty International, Bytes for All, Liberty, Privacy International, The American Civil Liberties Union, The Canadian Civil Liberties Association, The Egyptian Initiative for Personal Rights, The Hungarian Civil Liberties Union, The Irish Council for Civil Liberties, Legal Resource Centre.

Bashkuara për Sigurinë Kombëtare (ang. NSA). GCHQ drejtonte TEMPORA-n, e cila hynte dhe ruante vëllime të dhënash të nxjerra nga mbajtësit. GCHQ mbledhte komunikimet që përputheshin me identifikues të caktuar, siç ishin adresat e emailave në lidhje me një shënjestër të caktuar të shërbimeve sekrete. Komunikimet e mbledhura më pas hapeshin dhe lexoheshin nga një analist i GCHQ-së vetëm kur konsiderohej se përmbanin vlerat më të larta sekrete. GCHQ gjithashtu kishte një sistem përpunimi sekondar i cili përzgjodhte automatikisht një nën-grup të vogël komunikimesh të mbledhura sipas kriterëve komplekse. Materialet përkuese potencialisht mund të hapeshin më tej nga analistët.

Korniza ligjore për përgjimet elektronike të GCHQ-së përfshihej në Ligjin për Rregulloren e Fuqive Hetimore të vitit 2000 (ang. RIPA), e cila lejonte që Sekretari i Shtetit të lëshonte urdhra për përgjimin e komunikimeve elektronike të jashtme. RIPA nuk lejonte që materiali i përgjuar të lexohej, të shihej apo të dëgjohej nëqoftëse individët e përfshirë ndodheshin në Ishujt Britanikë në atë kohë.

NSA kishte dy programe, të quajtura PRISM dhe Upstream. PRISM kishte në shënjestër materiale të veçanta nga Ofruesit e Shërbimeve të Internetit (ang. ISP) dhe ishte e rregulluar në përputhje me Ligjin për Shërbimet Sekrete të Punëve të Jashtme (ang. FISA), i cili kërkonte që aplikimet për qasje në materialet e mbledhura përmes PRISM të miratoheshin nga Gjykata e FISA-s e përbërë nga njëmbëdhjetë gjyqtarë të lartë. Upstream lejonte mbledhjen masive të përmbajtjeve dhe komunikimeve nga infrastruktura e komunikimeve në pronësi të ofruesve të shërbimeve të komunikimit në SHBA. Kështu programi mundësonte grumbullimin, ruajtjen dhe kërkimin e të dhënave globale, veçanërisht atyre të shtetasve jo-amerikanë. Dokumentet e rrjedhura nga Edward Snowden sugjerorin që GCHQ kishte pasur qasje në PRISM që nga viti 2010.

RIPA specifikisht e përjashtonte juridiksionin e Gjykatës së Lartë të Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me akuzat për të drejta të njeriut kundër shërbimeve sekrete. Përkundrazi, ankesat u dëgjuan para Tribunalit të Fuqive Hetimore (ang. IPT) i cili u ngrit për të dëgjuar akuzat nga qytetarët për ndërhyrje të gabueshme tek komunikimet e tyre. Kërkesit në kërkesën e parë dhe të dytë prej çështjeve të bashkuara nuk i sollën ankesat e tyre para IPT-së, ndërsa kërkesit në kërkesën e tretë prej çështjeve të bashkuara depozituan ankesë në vitin 2013. Seanca dëgjimore e IPT-së u zhvillua në seanca publike dhe të mbyllura, ku gjatë këtyre të fundit IPT zbuloi informacione më parë sekrete në lidhje me ndarjen e informacioneve mes shërbimeve sekrete të Mbretërisë së Bashkuar dhe SHBA-ve.

IPT deklaroi se regjimi i ndarjes së informatave me NSA-në nuk shkelte Konventën sepse ishte në përputhje me ligjin, korniza e tij rregullatore ishte efektive, dhe ai i nënshtrohej mbikëqyrjes dhe hetimeve nga Parlamenti, një komisioner i pavarur, dhe nga vetë IPT-ja. IPT vendosi që këto procese ishin të njohura për publikun me qartësi të mjaftueshme, dhe ofronin mbrojtjen e përshtatshme të individëve kundër ndërhyrjeve arbitrare. Korniza ligjore për përgjimin e tërësishëm të komunikimeve të jashtme (jashtë Mbretërisë së Bashkuar) sipas seksionit 8(4) të RIPA-s gjithashtu ishte në pajtueshmëri me Konventën meqenëse ishte në përputhje me ligjin dhe kishte mbrojtje për të parandaluar analistët e sigurisë nga ekzaminimi i komunikimeve të njerëzve në MB. Çdo diskriminim indirekt kundër individëve mbi bazën e origjinës së tyre kombëtare ishte justifikuar me anë të konsideratave të sigurisë kombëtare. Në dy raste individuale IPT gjeti që shërbimet e sigurimit kishin shkelur rregullat e veta dhe kishin shkelur Konventën, në rastin e parë për shkak të një gabimi teknik dhe në rastin e dytë pa ndonjë humbje materiale për paditësin. Asnjëherë prej viktimave nuk iu dha kompensim.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan rreth pajtueshmërisë së Nenit 8 (e drejta për jetë private dhe familjare) dhe Nenit 10 (liria e shprehjes) për tre regjime diskrete: regjimi për përgjimin e tërësishëm të komunikimeve sipas seksionit 8(4) të Ligjit për Fuqitë Hetimore të vitit 2000 (ang. RIPA); regjimi për pranimin e sekreteve nga shërbimet sekrete të huaja; dhe regjimi për përvetësimin e të dhënave të komunikimeve nga ofruesit e shërbimeve të komunikimit (ang. CPS).

Më 13 shtator 2018 një Dhomë e Gjykatës shpalli vendimin e saj në këtë çështje. Ajo iu referua Dhomës së Madhe sipas Nenit 43 me kërkesë të kërkuesve.

*Përgjimi i tërësishëm i komunikimeve (Regjimi i Seksionit 8(4))*

### Neni 8

Kërkuesit u ankuan se regjimi për përgjimin e tërësishëm të komunikimeve (seksioni 8(4) i RIPA-s) ishte në papajtueshmëri me Nenin 8 të Konventës.

Gjykata filloi duke vënë në dukje vështirësitë e veçanta në vlerësimin e këtij regjimi. Përgjimi i tërësishëm nuk ka në shënjestër individët dhe prandaj ka kapacitet për shtrirje shumë të gjerë, si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Shtetit përgjues. Ndërkohë që mbrojtjet janë thelbësore, ato janë të pakapshme

në praktikë, duke pasur parasysh se ato përdoren kryesisht për mbledhjen e sekreteve të huaja dhe identifikimin e kërcënimeve të reja nga aktorë të njohur dhe të panjohur. Për shkak të kësaj, Shtetet Kontraktuese kanë nevojën legjitime për sekretësi, e cila nuk ka thujse fare kuptim nëqoftëse informacionet rreth operimit të këtyre skemave janë të ditura. Më tej, kërcënimet me të cilat përballen Shtetet Kontraktuese janë shtuar, duke përfshirë terrorizmin global, trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve. Shumë prej këtyre kërcënimeve operojnë përmes rrjeteve ndërkombëtare të aktorëve armiqësorë, të cilët kanë qasje në teknologji që mund të përçajë infrastrukturën dixhitale, mund të shkaktojë sulme kibernetike dhe mund të kërcënojnë sigurinë kombëtare. Rrjedhimisht, Gjykata e njohu kapacitetin e vlefshëm të regjimeve të përgjimit të tërësishëm për të identifikuar kërcënime të reja në sferën dixhitale, dhe u përpoq të bënte një vlerësim të këtyre regjimeve në aspektin e pajtueshmërisë me Konventën duke iu referuar ekzistencës së mbrojtjeve kundër arbitraritetit dhe abuzimit.

Gjykata e pa përgjimin e tërësishëm të komunikimeve si një proces gradual në të cilin shkalla e ndërhyrjes tek të drejtat e individëve nga Neni 8 rritet gjatë kohës që procesi përparon. Fazat e procesit të përgjimit të tërësishëm mund të përshkruhen si më poshtë:

- (a) përgjimi dhe ruajtja fillestare e komunikimeve dhe të dhënave të ndërlidhura të komunikimeve (d.m.th. të dhënat rreth trafikut që ka të bëjë me komunikimet e përgjuara);
- (b) aplikimi i selektorëve specifikë në komunikimet e ruajtura / të dhënat e ndërlidhura të komunikimeve;
- (c) ekzaminimi nga analistët i pjesëve të selektuara nga komunikimet / të dhënat e ndërlidhura me komunikimet; dhe
- (d) ruajtja e mëtejshme e të dhënave dhe përdorimi i "produktit final", përfshirë ndarjen e të dhënave me palë të treta.

Secila prej katër fazave u gjet se ndërhynte tek të drejtat e individëve nga Neni 8. Megjithëse përgjimi fillestar nuk përbën ndërhyrje domethënëse, shkalla e ndërhyrjes tek të drejtat e individëve nga Neni 8 rritet në progresivisht gjatë kohës që procesi i përgjimit të tërësishëm vazhdon. Në fazën finale, kur informacioni rreth një personi analizohet ose përmbajtja e komunikimit ekzaminohet nga një analist, nevoja për mbrojtje është më e madhe se kurrë. Kështu, gjatë shqyrtimit nëse ndërhyrja ishte e justifikuar, Gjykata e bazoi vlerësimin e saj të regjimit të seksionit 8(4) mbi këtë ndërhyrje progresive.

Në lidhje me faktin nëse ndërhyrja ishte e justifikuar, Gjykata theksoi parimet e përgjithshme të vendosura në praktikën gjyqësore të mëparshme, të cilat afirmojnë se regjimet e përgjimit të tërësishëm nuk ishin *per se* jashtë hapësirës së vlerësimit të Shteteve. Duke pasur parasysh rritjen e kërcënimeve me të cilat përballen Shtetet nga rrjetet e aktorëve ndërkombëtarë që përdorin teknologji të sofistikuar, Gjykata konsideroi se vendimi për të operuar me një regjim të përgjimit të tërësishëm me qëllim të identifikimit të kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare ose kundër interesave themelore kombëtare hynte brenda hapësirës së vlerësimit të Shtetit.

Më tej, Gjykata u përpoq të përcaktonte nëse një regjim i përgjimit të tërësishëm është në përputhje me Konventën duke bërë një vlerësim global të operimit të këtij regjimi. Një vlerësim i tillë duhet të fokusohet në faktin nëse korniza ligjore vendase përmbante garanci të mjaftueshme kundër abuzimit dhe nëse procesi i është nënshtruar "mbrojtjeve fillim-fund" (ang. "end-to-end"). Kështu, vlerësimi duhet të ketë parasysh operimin faktik të sistemit të përgjimeve, përfshirë kontrollin dhe bilancin e ushtrimit të pushtetit, dhe ekzistencën ose mungesën e provave për abuzime.

Gjatë vlerësimit nëse Shteti ka vepruar brenda hapësirës së tij të vlerësimit, Gjykata u bind se Regjimi i seksionit 8(4) ndiqte qëllimet legjitime të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, parandalimit të trazirave dhe kimit, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Gjykata gjithashtu pranoi se e drejta vendase ishte e përdorshme në masë të përshtatshme, duke marrë parasysh se dispozitat ligjore që qeverisnin operimin e regjimit të përgjimeve të tërësishme ishin të shpjeguara në Kodin e Praktikës së Përgjimit të Komunikimeve (ang. Kodi IC). Kodi IC ishte dokument publik që jepte hollësi rreth mënyrës se si regjimi funksionon në praktikë.

Më tej, Gjykata vlerësoi nëse ligji përmbante mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive dhe garanci për plotësimin e kritereve të "parashikueshmërisë" dhe "nevojës në një shoqëri demokratike". Këtu, Gjykata u mbështet në praktikën e mëparshme gjyqësore dhe përcaktoi kriteret për vlerësimin e përgjimit të përmbajtjes së komunikimeve, pra nëse korniza ligjore vendase i kishte të definuara qartë:

1. bazat mbi të cilat mund të autorizohet përgjimi i tërësishëm;
2. rrethanat në të cilat mund të përgjohen komunikimet e një individi;
3. procedurat që duhen ndjekur për dhënien e autorizimit;

4. procedurat që duhen ndjekur për selektimin, ekzaminimin dhe përdorimin e materialit të përgjuar;
5. masat preventive që duhen marrë gjatë komunikimit të materialit tek palët e treta;
6. kufijtë e kohëzgjatjes së përgjimit, ruajtja e materialit të përgjuar dhe rrethanat në të cilat një material i tillë duhet të fshihet dhe të shkatërrohet;
7. procedurat dhe modalitetet për mbikëqyrjen nga një autoritet i pavarur i pajtueshmërisë me mbrojtjet e mësipërme dhe fuqitë e tij për adresimin e papajtueshmërisë;
8. procedurat për shqyrtimin e pavarur *ex post facto* të një pajtueshmërie të tillë dhe fuqitë e organit kompetent në adresimin e rasteve të papajtueshmërive.

Pas analizimit të secilit kriter, Gjykata përfundimisht deklaroi se regjimi i seksionit 8(4), pavarësisht nga mbrojtjet e tij, përfshirë disa të fuqishme, nuk përmbante mbrojtje "fillim-fund" (ang. "end-to-end") për të ofruar garanci të mjaftueshme dhe efektive kundër arbitraritetit dhe rrezikut të abuzimit. I ngërthyer në regjimin e përgjimit të tërësishëm ishte potenciali që ai të abuzohej në një mënyrë që ndikon negativisht tek të drejtat e individit për respekt të jetës private. Në mënyrë të veçantë, Gjykata identifikoi mangësitë themelore në regjim, siç ishin, mes të tjerash, dështimi për të përfshirë kategoritë e selektorëve në kërkesën për urdhër përgjimi dhe dështimin për t'i kaluar selektorët e lidhur me një individ për autorizim të brendshëm paraprak. Ndërkohë që Komisioneri i IC-së bënte mbikëqyrjen e pavarur dhe efektive të regjimit, dhe IPT ofronte zgjidhje të fuqishme gjyqësore për këdo që dyshonte se komunikimet e tij/saj ishin përgjuar nga shërbimet sekrete, këto mbrojtje të rëndësishme nuk ishin të mjaftueshme për të kundërbalancuar mangësitë.

Duke pasur parasysh ato që u thanë më lart, Gjykata gjeti se regjimi i seksionit 8(4) nuk e përmbushte kriterin e "cilësisë së ligjit" nga Neni 8 dhe prandaj e kishte të pamundur ta mbante "ndërhyrjen" brenda asaj çka ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike". Rrjedhimisht, kishte shkelje të Nenit 8.

### Neni 10

Sipas Nenit 10, Gjykata konsideroi nëse regjimi i seksionit 8(4) shkelte mbrojtjen e ofruar gazetarëve, pra mbrojtjen e komunikimeve të privileguara.

Gjykata afirmoi se mbrojtjet që duhet t'i ofrohen shtypit janë me rëndësi të veçantë, dhe mbrojtja e burimeve gazetareske është një prej gurrthemeleve të lirisë së shtypit. Një ndërhyrje tek mbrojtja e burimeve të gazetarisë nuk mund të jetë në përputhje me Nenin 10 nëqoftëse nuk është e justifikuar nga një kusht mbizotërues i interesit publik. Çdo ndërhyrje tek e drejta për mbrojtjen e burimeve gazetareske duhet të shoqërohet me mbrojtje ligjore procedurale në proporcion me rëndësinë e parimit të rrezikuar.

Gjykata pranoi se regjimi i seksionit 8(4) ndërhynte tek të drejtat e gazetarëve nga Neni 10 për lirinë e shprehjes. Regjimi ishte i bazuar në ligj, megjithatë, gjatë vlerësimit të parashikueshmërisë dhe nevojës sipas Nenit 8, Gjykata tashmë i identifikoi mangësitë në regjim dhe tek mbrojtjet, siç ishte mungesa e autorizimit të brendshëm paraprak për selektorët e lidhur me një individ të identifikueshëm.

Në kontekstin e Nenit 10, Gjykata shqyrtoi mbrojtjet ekzistuese në lidhje me materialin gazetaresk konfidencial të cekur në Kodin e IC-së dhe i gjeti ato të mjaftueshme për qëllimet e Nenit 10. Megjithatë, mbrojtjet nuk adresonin dobësitë e identifikuar nga Gjykata në analizën e saj të regjimit sipas Nenit 8 dhe nuk përmbushnin kriteret e mbrojtjeve ligjore procedurale sipas Nenit 10. Në mënyrë të veçantë, nuk kishte kriter për përdorimin e selektorëve ose termave të kërkimit që dihej se ishin të lidhura me një gazetar të autorizuar nga një gjyqtar ose nga një organ tjetër i pavarur vendimmarrës me pushtetin për të përcaktuar nëse ishte "i justifikuar nga një kusht mbizotërues në interesin publik" dhe nëse një masë më pak ndërhyrëse mund të kishte mjaftuar për t'i shërbyer interesit publik mbizotërues. Për më tepër, Kodi i IC-së kërkonte vetëm që të kihej "konsideratë e veçantë" për një përgjimit që mund të kishte përmbajtur materiale gazetareske konfidenciale, e jo t'i kërkohej një gjyqtari ose një organi të pavarur që të vendoste mbi ruajtjen e vazhdueshme të materialeve.

Duke pasur parasysh dobësitë e identifikuar, Gjykata gjeti se kishte pasur gjithashtu shkelje të Nenit 10 të Konventës për shkak të operimit të regjimit të seksionit 8(4).

*Pranimi i të dhënave sekrete nga shërbimet sekrete të huaja*

### Neni 8

Kërkuesit u ankuan në lidhje me pranimin nga autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar të materialeve nga shërbimet e huaja sekrete. Specifikisht, që pranimi



nga Shteti i paditur i materialeve të përgjuara nga NSA në kuadër të programeve PRISM dhe Upstream ishte shkelje e të drejtave të tyre sipas Nenit 8 të Konventës.

Gjykata riafirmoi fushëveprimin e përgjegjesisë së Shteteve Kontraktuese sipas Nenit 8 si kërkesa fillestare dhe pranimi i mëpasëm i materialeve të përgjuara, ndjekur nga ruajtja, ekzaminimi dhe përdorimi i tyre nga shërbimet sekrete të Shtetit pranues. Përveç kësaj, kur një Shteti jo-kontraktues i drejtohet një kërkesë për materiale përgjimi, kërkesa duhet të jetë e bazuar në ligjet vendase dhe ato ligje duhet të jenë në dispozicion të personit në fjalë, ku efektet e tyre duhet të jenë të parashikueshme. Më tej, çdo regjim që u lejon shërbimeve sekrete të kërkojnë përgjime ose materiale përgjimesh nga Shtetet jo-kontraktuese, ose të kenë qasje direkte në këto materiale, duhet t'i nënshtrohet mbikëqyrjes së pavarur dhe mundësisë për shqyrtim *ex post facto*.

Gjykata konsideroi se regjimi për kërkimin dhe pranimin e të dhënave sekrete nga Shtetet jo-kontraktuese kishte bazë të qartë në ligjet vendase dhe ishte në dispozicion në masë të mjaftueshme. Regjimi pa dyshim që synonte qëllimet legjitime të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, parandalimit të trazirave dhe krimit, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Për sa i përket parashikueshmërisë dhe nevojës së regjimit, Gjykata konsideroi se kishte rregulla të qarta e të detajuara që u tregonin si duhet qytetarëve rrethanat në të cilat autoriteteve iu dha fuqia për t'i bërë kërkesë një shërbimi sekret të huaj. Përveç kësaj, Gjykata u bind që Mbretëria e Bashkuar kishte mbrojtje të mjaftueshme për ekzaminimin, përdorimin, ruajtjen, transmetimin e mëtejshëm, fshirjen dhe shkatërrimin e materialeve. Një shtresë e mëtejshme mbrojtjeje po ashtu ofrohej nga Komisioneri i IC-së dhe IPT, të cilët bënë mbikëqyrjen e regjimit të ndarjes së të dhënave sekrete dhe shqyrtimin *ex post facto*, respektivisht.

Për shkak të gjetjeve të mësipërme, Gjykata vendosi që regjimi për kërkimin dhe pranimin e materialeve të përgjuara ishte në përputhje me Nenin 8 dhe rrjedhimisht nuk gjeti shkelje.

### Neni 10

Kërkuesit u ankuan se regjimi i ndarjes së të dhënave sekrete kishte shkelur të drejtat e tyre nga Neni 10. Megjithatë, Gjykata gjeti se ankesa nuk i jepte shkas një çështjeje të ndarë që shkon përtej çështjes që ngrihet nga Neni 8. Prandaj, nuk kishte as shkelje të Nenit 10.

*Përvetësimi i të dhënave të komunikimeve nga ofruesit e shërbimeve të komunikimit*

## Neni 8

Kërkuesit u ankuan se regjimi për përvetësimin e të dhënave të komunikimeve sipas Kapitullit II të RIPA-s ishte në papajtueshmëri me të drejtat e tyre nga Neni 8.

Dhoma kishte vendosur më parë që e drejta vendase kërkonte që çdo regjim që u lejon autoriteteve të kenë qasje në të dhënat e mbajtura nga CSP-të duhet ta kufizojë qasjen brenda qëllimit të luftimit të "krimeve të rënda", dhe që qasja duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit paraprak nga një gjykatë ose një organ administrativ i pavarur. Meqenëse regjimi aktual nuk e plotësonte këtë kriter, Dhoma deklaroi se ai nuk mund të ishte "në përputhje me ligjin" brenda kuptimit të Nenit 8.

Qeveria nuk i kontestoi gjetjet e Dhomës, dhe Dhoma e Madhe nuk gjeti baza për të mos qenë dakord me përfundimet e Dhomës. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 8.

## Neni 10

Kërkuesit u ankuan sipas Nenit 10 për regjimin për përvetësimin e të dhënave të komunikimeve nga CSP-të.

Dhoma kishte pranuar më parë që regjimi i Kapitullit II ofronte mbrojtje të shtuar kur të dhënat kërkoheshin me qëllim të identifikimit të burimit të një gazetari. Megjithatë, këto mbrojtje aplikoheshin vetëm kur qëllimi ishte përcaktimi i burimit dhe nuk aplikoheshin në çdo rast kur kishte kërkesa për të dhënat e komunikimeve të një gazetari, ose kur një ndërhyrje e tillë anësore kishte gjasë të ndodhte. Për pasojë, Dhoma konsideroi se regjimi nuk ishte "në përputhje me ligjin" për qëllimet e Nenit 10.

Qeveria nuk i kontestoi gjetjet e Dhomës, dhe Dhoma e Madhe nuk gjeti baza mbi të cilat të mos ishte dakord me përfundimet e Dhomës. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 10.

#### Neni 41

Gjykata u caktoi kërkuesve në të parën e çështjeve të bashkuara 227,500 euro; kërkuesve në të dytën e çështjeve të bashkuara 90,000 euro dhe kërkuesve në të tretën e çështjeve të bashkuara 36,000 euro për kosto dhe shpenzime. Kërkuesit nuk parashtruan pretendime në lidhje me dëme materiale kështu që Gjykata nuk caktoi të tilla.

*Ankesa lidhur me anonimizimin e dokumenteve të gjykatës në databazën online dhe një rregull për pengimin e publikimit të vendimeve gjyqësore të deklaruara të papranueshme, meqenëse Neni 10 nuk mund të aplikohet për informacione abstrakte që nuk ishin instrumentale për ushtrimin e të drejtës së kërkuarve për lirinë e shprehjes*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**MITOV DHE TË TJERË K. BULLGARISË**

(Kërkesa Nr. 80857/17)  
**28 shkurt 2023**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuarët ishin tetë gazetarë bullgarë nga portale të ndryshme mediatike të specializuara në raportimin e çështjeve lidhur me gjyqësorin. Në tetor 2016, ata kërkuar shqyrtimin gjyqësor të rregullave të brendshme të anonimizimit të cilat ishin vendosur nga Kryetari i Gjykatës Supreme Administrative ("SAC") pas procedurave para Komisionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pas një ankesë nga dy individë që SAC kishte përpunuar të dhënat e tyre personale në mënyrë të paligjshme. Komisioni e kishte gjobitur SAC-n, dhe e kishte udhëzuar të sillte të gjitha dokumentet e publikuara në databazën e saj online ku përmbaheshin të dhënat personale të individëve në linjë me kriteret e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Prandaj rregullat parashikonin redaktimin e të dhënave personale në të gjitha dokumentet e publikuara në databazën e SAC-së online.

Kërkuarët kishin kërkuar shqyrtimin gjyqësor të Rregullave 1, 2 dhe 3. Rregulla 1 sqaronte llojin e dokumenteve që përmbante databaza, ku të dhënat personale do të redaktoheshin nga të gjitha pjesët. Rregulla 2 përcaktonte trembëdhjetë kategoritë e "të dhënave personale" që duhet të redaktoheshin nga ato dokumente, dhe Rregulla 3 deklaronte që, meqenëse materialet e skenuara të çështjeve nuk mund të redaktoheshin në atë mënyrë, ato nuk do të vireshin në dispozicion online. Kërkuarët ishin veçanërisht të shqetësuar që rregullat nuk parashikonin publikimin online të vendimeve administrative nën kontestim ose kërkesat për shqyrtim gjyqësor. Më tej, kërkuarët u ankuan se kategoritë e të dhënave që i nënshtroheshin redaktimit sipas Rregullës 2 nuk ishin të dhëna personale, ose ishin përkufizuar shumë gjerë për të qenë të dhëna personale në të gjitha rastet. Në shkurt 2017, Gjykata Administrative e Qytetit të Sofias i deklaroi të papranueshme dy pretendimet e depozituara nga kërkuarët. Megjithatë kërkuarët

apeluan kundër këtij vendimi, në maj 2018 SAC e mbështeti vendimin e gjykatës më të ulët.

Në nëntor 2017 hyri në fuqi një amendament i Seksionit 64(1) të Ligjit Gjyqësor të vitit 2007 ("rregulla e publikimit të shtyrë"). Seksioni 64(10) fillimisht kishte prezantuar kriterin që të gjitha vendimet gjyqësore të publikoheshin në uebfaqen e gjykatës relevante, megjithëse kjo ishte ndryshuar në vitin 2009 për të siguruar që këto vendime do të publikoheshin online menjëherë pas shpalljes së tyre. Sipas rregullës së publikimit të shtyrë, vendimet gjyqësore në çështjet penale ku dikush shpallej fajtor dhe dënohej ose ku mbështeteshin dënimet dhe ndëshkimet do të publikoheshin online vetëm pasi autoritetet prokuroriale të informonin gjykatën përkatëse që ishin ndërmarrë hapat për zbatimin e tyre.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan sipas Nenit 10 të Konventës për rregullat e anonimizimit të shtruara nga Kryetari i SAC-së në shtator 2016, dhe për amendamentin legjislativ të nëntorit 2017 që solli në fuqi rregullën e publikimit të shtyrë.

### Pranueshmëria e ankesës kundër rregullave të anonimizimit të vitit 2016 nga SAC

Neni 10 nuk ofron të drejtën automatike të papenguar për qasje në informacionet e mbajtura nga autoritetet, as nuk i detyron autoritetet të shpërndajnë informacione të tilla sipas kërkesave. Duke vënë theksin te fakti që të drejtat e Nenit 10 angazhohen vetëm nëse qasja në këto informacione është kritike për ushtrimin e të drejtës për lirinë e shprehjes, Gjykata nënvizoi se në rastin konkret asnjëri prej kriterëve të praktikës gjyqësore për përcaktimin e atij kufiri nuk ishin plotësuar. Këto kritere ishin: a) qëllimi i kërkesës për informacione; b) natyra e informacioneve të kërkuara; c) roli i veçantë i kërkuesit të informacionit për "marrjen dhe dhënien" e tij në publik; d) nëse informacioni është i gatshëm dhe në dispozicion.

Në përputhje me parimet e vendosura të praktikës gjyqësore, kriteret e mësipërme duhet të vlerësoheshin nën dritën e rrethanave të veçanta të secilës çështje. Në rastin konkret, ankesa e kërkuesve nuk kishte të bënte me një informacion të veçantë, ose me një kategori të definuar të mbajtur nga autoriteti publik, por ajo ishte e bazuar thjesht mbi çështjen tërësisht abstrakte të pamundësisë së qasjes në të gjitha materialet e skenuara që ndodheshin në databazën e SAC-së. Praktika gjyqësore e vendosur thoshte se kërkuesi nuk

mund të ankohet në mënyrë abstrakte për kufizimin e qasjes në informacione, dhe gjithashtu thoshte se deklarimet e përgjithshme se përse lloje të caktuara informatash të mbajtura nga autoritetet duhet të vireshin në dispozicion nuk ishin të mjaftueshme për të angazhuar Nenin 10. Meqenëse nuk kishte informacione të sakta e specifike se për çka po ankoheshin kërkuesit se nuk kishin qasje, nuk mund të thuhej se dhënia e kësaj qasjeje ishte instrumentale për ushtrimin e drejtës së tyre për lirinë e shprehjes. Prandaj Neni 10 nuk mund të aplikohet dhe nuk aplikohet, sepse nuk kishte rrethana specifike mbi bazën e të cilave të aplikohet kriteri i kufirit. Kështu që ankesa u refuzua si e papajtueshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës.

#### Pranueshmëria e ankesës kundër rregullës për publikimin e shtyrë për vendime të caktuara penale

Qeveria argumentoi se kërkuesit nuk mund të ishin viktime sepse ato nuk kishin referuar ndonjë çështje specifike ku rregulla e publikimit të shtyrë kishte penguar punën e tyre, por ishin duke u ankuar thjesht për vetë rregullën. Meqë nuk kishte prova se rregulla e publikimit të shtyrë i kishte penguar kërkuesit nga qasja në informacione të caktuara, vetë rregulla nuk mund të kishte prekur të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes. Ashtu si me gjetjen sipas rregullave të anonimizimit të SAC-së, Gjykata përsëriti qëndrimin e saj që Neni 10 nuk angazhohej sepse nuk mund të përcaktohej e informacioni në të cilin kërkuesit kërkonin qasje ishte thelbësor për ushtrimin e të drejtës së tyre për lirinë e shprehjes.

Prandaj Gjykata gjeti që Neni 10 nuk aplikohet, dhe ankesa u refuzua si e papajtueshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës. Kështu, kërkesa u deklarua e papranueshme dhe u rrëzua.

*Interceptimi nga policia i komunikimeve të kërkuesit, mungesa e mbrojtjeve të duhura e rrjedhimisht rreziku i shtuar i arbitraritetit qenë në papajtueshmëri me kriteret e ligjshmërisë, gjë që përbëri shkelje të Nenit 8*

VENDIM I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN  
**BYKOV k. RUSISË**

(Kërkesa Nr. 4378/02)

**10 mars 2009**

### 1. Faktet kryesore

Kërkuesi ishte shtetas rus i lindur në vitin 1960 dhe jetonte në Rusi. Në kohën e arrestimit të tij në tetor 2000, ai ishte aksionar i madh dhe në pozitë ekzekutive në një korporatë, dhe gjithashtu anëtar i Asamblesë Parlamentare Rajonale të Krasnoyarsk.

Në shtator 2000, kërkuesi supozohet se urdhëroi V, anëtar i grupit të tij, për të vrarë Zotëri S, ish-bashkëpunëtor biznesi. V nuk veprroi sipas urdhrorit por e raportoi kërkuesin tek Shërbimet Federale të Sigurimit ("FSB"). FSB-ja dhe policia vendosën të zhvillonin një operacion të fshehtë për të marrë prova për qëllimin e kërkuesit për vrasjen e S. më 29 shtator 2000, policia sajoi zbulimin e dy trupave të vdekur në shtëpinë e S. Policia zyrtarisht deklaroi në media se një prej personave të vrarë ishte identifikuar si S. Personi tjetër ishte partneri i tij i biznesit, Zotëri I.

Më 3 tetor 2000, V shkoi ta takonte kërkuesin në shtëpinë e tij. Ai mbante me vete një pajisje radio-transmetuese ndërkohë që një polic jashtë mori dhe incizoi transmetimin. Sipas udhëzimeve që iu dhanë, V e futi kërkuesin në bisedë, duke i treguar që e kishte kryer vrasjen. Si provë, ai i dha kërkuesit disa objekte të marra nga S dhe I. Policia mori një incizim 16 minutësh të bisedës mes V dhe kërkuesit. Më 4 tetor 2000 shtëpia e kërkuesit u bastis. Objektet që ia kishte dhënë V u konfiskuan. Kërkuesi u arrestua dhe u vu në paraburgim. Ai u akuzua për komplot për të kryer vrasje dhe komplot për të marrë, poseduar dhe përdorur armë zjarri.

Paraburgimi paragjyqësor i kërkuesit u zgjat shumë herë, dhe apelet e tij të shumta dhe kërkesat për lirim u refuzuan për shkak të peshës së akuzave kundër tij dhe rrezikut që ai mund të fshihej dhe të bënte presion mbi dëshmitarët. Në qershor 2002, kërkuesi u gjet fajtor për të dy akuzat dhe u dënua me gjatë vjet e gjysmë burgim. Ai u lirua me kusht për pesë vjet. Dënimi u vërtetua në apel.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua sipas Nenit 5 § 3 që paraburgimi i tij kishte qenë tepër i gjatë dhe se ai ishte zgjatur shumë herë pa arsye relevante dhe të mjaftueshme. Sipas Nenit 6 § 1, ai u ankua se procedurat kundër tij kishin qenë të padrejta, sepse policia kishte ngritur një kurth që ai të inkriminonte veten në bisedën e tij me V dhe se gjykata e kishte pranuar incizimin e bisedës si provë në gjyq. Kërkuesi po ashtu u ankua se operacioni i fshehtë i policisë kishte përbërë ndërhyrje të paligjshme në shtëpinë e tij dhe se interceptimi dhe incizimi i bisedës së tij me V përbëri ndërhyrje tek jeta e tij private dhe korrespondenca e tij, në shkelje të Nenit 8.

### Neni 5 § 3

Paraburgimi i vazhduar mund të justifikohet vetëm kur ka tregues specifike të kriteri të interesit të madh publik i cili, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, peshon më shumë sesa rregulli i respektimit të lirisë individuale që shtron Neni 5 i Konventës. Megjithatë, Gjykata gjeti se bazat e paraburgimit në këtë rast nuk ishin vërtetuar fare nga gjykatat në fjalë, sidomos gjatë fazave fillestare të procedurës, dhe se prandaj kishte pasur shkelje të Nenit 5 § 3.

### Neni 6 § 1

Gjykata përsëriti se Neni 6 garanton të drejtën për proces të rregullt në tërësi, dhe nuk shtron rregulla lidhur me pranueshmërinë e provave si të tilla, qofshin edhe prova të marra në mënyrë të paligjshme sa i përket të drejtës vendase. Këtu ajo theksoi se kërkuesi kishte pasur mundësi të kontestonte metodat e përdorura nga policia, në procedurën e kontradiktorialitetit në shkallën e parë, dhe në apel. Kështu, ai e kishte pasur mundësinë të argumentonte se provat e nxjerra kundër tij ishin marrë në mënyrë të paligjshme dhe se incizimi i kontestuar ishte keqinterpretuar. Gjykatat vendase i kishin adresuar të gjitha këto argumente me hollësi dhe i kishin rrëzuar të gjitha ato në vendimet e tyre të arsyetuara. Më tej, Gjykata theksoi se deklaratat e kërkuesit që ishin incizuar në sekret nuk ishin bërë nën presion; nuk ishin marrë direkt parasysh nga gjykatat vendase, të cilat ishin mbështetur më shumë tek raporti ekspert i hartuar pas incizimit; dhe ishin vërtetuar nga shumë prova fizike. Kështu Gjykata doli në përfundimin se të drejtat e mbrojtjes së kërkuesit dhe e drejta e tij për të mos inkriminuar veten ishin respektuar, dhe se rrjedhimisht nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1.



## Neni 8

Gjykata vuri në dukje se nuk diskutohej që masat e marra nga policia kishin përbërë ndërhyrje tek e drejta e kërkuesit për respektim të jetës së tij private. Ajo theksoi se, për të qenë në pajtueshmëri me Konventën, një ndërhyrje e tillë duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike për qëllimet e renditura në Nenin 8 § 2.

Gjykata theksoi se Ligji rus për Aktivitetet Operacionale-Kërkimore kishte specifikisht për qëllim të mbronte privatësinë individuale duke kërkuar autorizim gjyqësor për çdo aktivitet apo operacion që mund të ndërhynte në privatësinë e shtëpisë ose komunikimeve me telefon ose postë. Në rastin e kërkuesit, gjykatat vendase kishin deklaruar që meqenëse V ishte ftuar në shtëpinë e kërkuesit, dhe shërbimet telefonike apo me postë nuk kishin qenë të përfshira (meqë biseda ishte incizuar me pajisje të radio-transmetimit në distancë), operacioni i policisë nuk kishte shkelur rregulloret në fuqi.

Në lidhje me këtë, Gjykata përsëriti se, në mënyrë që kriteri i ligjshmërisë nga Neni 8 të plotësohet në lidhje me interceptimin e komunikimeve për qëllime të hetimeve policore, e drejta vendase duhet të ofrojë mbrojtje kundër ndërhyrjes arbitrare tek e drejta e një individi nga Neni 8, dhe duhet të tregonte qartë rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet policore u autorizuan të përdornin masa të tilla. Më tej, Gjykata theksoi se ligji duhet të tregojë shtrirjen e një diskrecioni të tillë dhënë autoriteteve kompetente dhe mënyrën e ushtrimit të tij. Në rastin konkret, Gjykata konsideroi se përdorimi i një pajisjeje të radio-transmetimit në distancë për të incizuar bisedën mes V dhe kërkuesit ishte thuajse identike me përgjimin e telefonit, sa i përket natyrës dhe shkallës së ndërhyrjes në privatësinë e individit në fjalë. Ajo konsideroi se kërkuesi nuk kishte përfituar nga ajo që ishte procedurë mbrojtjeje e neglizhueshme përmes së cilës ishte interceptuar biseda e tij me V, dhe se shtrirja dhe mënyra se si autoritetet kishin mundur të ushtronin diskrecionin e tyre nuk ishte e definuar. Argumenti i Qeverisë se kriteret e nevojshme ishin plotësuar me mundësinë që kërkuesit të hapte procedurë gjyqësore kundër ligjshmërisë së "eksperimentit operativ" nuk e bindi Gjykatën, sidomos duke pasur parasysh mungesën e rregulloreve specifike për mbrojtje. Në fund, ajo theksoi se meqenëse ligji rregullonte vetëm interceptimin e komunikimeve me telefon dhe postë, diskrecioni ligjor i autoriteteve të policisë gjatë përdorimit të teknikave të vëzhgimit kishte qenë tepër i gjerë, dhe rrjedhimisht linte hapësirë për arbitraritet dhe dështoi të plotësonte kriterin e ligjshmërisë, ndaj Gjykata konsideroi që ndërhyrja tek e drejta e kërkuesit për respekt ndaj jetës private nuk

ishte në përputhje me ligjin. Prandaj, Gjykata nuk kishte pse të përcaktonte nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, dhe as nëse kishte pasur ndërhyrje tek e drejta e kërkuarit për respekt ndaj shtëpisë së tij. Prandaj, kishte pasur shkelje të Nenit 8.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuarit € 1,000 për dëme jomateriale dhe € 25,000 për kosto dhe shpenzime.

*Dështimi i Qeverisë suedeze për të siguruar procedura të mjaftueshme mbrojtjeje për të parandaluar rrezikun e abuzimit të regjimit të vëzhgimit të interceptimit të tërësishëm të informatave çoi në gjetjen e shkeljes së Nenit 8*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN **CENTRUM FÖR RÄTTVISA K. SUEDISË**

(Kërkesa Nr. 35252/08)

**25 maj 2021**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkesja, Centrum för rättvisa, ishte një organizatë jofitimprurëse që përfaqësonte klientët në procedura lidhur me të drejtat dhe liritë e Konventës ose në procedura të ndërlidhura sipas ligjeve suedeze. Kërkesja besoi se, për shkak të natyrës së funksioneve të saj si organizatë joqeveritare që kontrollonte veprimet e aktorëve të Shtetit, ekzistonte rreziku që komunikimet e saj në celularë dhe në valë ceulare ishin ose do të ishin interceptuar dhe analizuar përmes inteligjencës së sinjaleve.

Kërkesja kontestoi legjislacion të caktuar në lidhje me inteligjencën e sinjaleve, konkretisht Ligjin për Inteligjencën e Sinjaleve (shkurt SIA), i cili autorizonte Qendrën Kombëtare për Radio-Mbrojtjen (*Försvarets radioanstalt*, shkurt "FRA") që të zhvillonte analizën e inteligjencës së sinjaleve, e cila vendoste një sistem vëzhgimi sekret që potencialisht prekte të gjithë përdoruesit e shërbimeve celulare dhe internetit pa paralajmëruar përdoruesit rreth vëzhgimeve të tilla. Meqenëse nuk kishte mbrojtje vendase që ofronin bazë për apel për një individ që dyshonte se mund t'i ishin interceptuar komunikimet, kërkesja argumentoi se SIA përbënte ndërhyrje tek të drejtat e saj nga Neni 8.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkesja u ankua se legjislacioni dhe praktika suedeze në fushën e inteligjencës së sinjaleve, në mënyrë të veçantë lidhur me interceptimin e tërësishëm të komunikimeve, shkelnin të drejtat e saj për respekt ndaj jetës private dhe korrespondencës sipas Nenit 8 të Konventës, dhe se kjo nuk kishte zgjidhje efektive në kundërshtim me Nenin 13.

Më 19 qershor 2018, një Dhomë deklaroi se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 8 dhe se nuk kishte nevojë të shqyrtohej ndaras ankesa nga Neni 13. Çështja u referua Dhomës së Madhe në përputhje me Nenin 43 me kërkesë të kërkueses.

### Pranueshmëria

Qeveria së pari kundërshtoi statusin e viktimës të kërkueses, duke thënë se ajo nuk i përkiste një "grupi personash ose entitetesh të vënë në shënjestër nga legjislacioni" në lidhje me inteligjencën e sinjaleve brenda inteligjencës së huaj. Qeveria gjithashtu tha se SIA nuk prekte direkt të gjithë përdoruesit e shërbimeve të telefonisë mobile dhe internetit sepse kjo ishte e kufizuar vetëm për shërbimet e inteligjencës së huaj, dhe se meqenëse komunikimet e kërkueses me celular dhe internet nuk kishin gjasa të interceptoheshin, nuk kishte pothuajse fare rrezik që ato të mbaheshin për analiza të mëtejshme përtej fazës së përpunimit automatik. Meqenëse nuk do të kishte ndërhyrje tek të drejtat e Nenit 8 deri në fazën kur ekzaminimi analitik i sinjaleve të selektuara ishte i mundur, Qeveria kërkoi që Dhoma e Madhe ta deklaronte kërkesën të papranueshme për shkak të mungesës së statusit të viktimës.

Gjykata tha që kërkesja mund të pretendojë të jetë viktimë e një shkeljeje të të drejtave të saj të Konventës thjesht për shkak të ekzistencës së legjislacionit që lejon masat e vëzhgimit sekret. Dy kriteret parësore të konsoliduara të të qenit viktimë ishin, së pari, shqyrtimi nëse shtrirja e legjislacionit "*prek direkt të gjithë përdoruesit e shërbimeve të komunikimit duke ngritur një sistem ku çdo personi mund t'i interceptohen komunikimet*", dhe, së dyti, marrja në konsideratë e "*ekzistencës [dhe efektivitetit] të zgjidhjeve në nivel kombëtar*". Duke theksuar se kërkesja nuk kishte pretenduar se i përkiste një grupi personash të vënë në shënjestër të veçantë nga legjislacioni, Gjykata e refuzoi argumentin e Qeverisë kundër statusit të viktimës nga ana e kërkueses, dhe qe dakord me kërkuesen se SIA lejonte mundësinë që komunikimet e çdo personi ose entiteti në Suedi mund t'i nënshtrohej së paku fazave fillestare të përpunimit automatik nga FRA. Duke qenë se zgjidhjet vendase në dispozicion në Suedi i nënshtroheshin kufizimeve të caktuara, me rezultatin praktik që thjesht kërcënimi i vëzhgimit sipas legjislacionit suedez për interceptimet e tërësishme në vetvete mund të gjendej se kufizonte komunikimin e lirë, u gjet se kjo mund të përbënte, për të gjithë përdoruesit ose përdoruesit potencialë, ndërhyrje direkte tek të drejtat e tyre nga Neni 8. Rrjedhimisht, u vendos që kërkesja e kishte statusin e viktimës, dhe kërkesa u deklarua e pranueshme..

## Neni 8

Duke nisur me ekzistencën e ndërhyrjes, Gjykata ravigjëzoi katër fazat e përgjithshme të procesit të interceptimeve të tërësishme, dhe deklaroi se ajo e shihte interceptimin e tërësishëm si proces gradual ku shkalla e ndërhyrjes tek të drejtat e individit nga Neni 8 rritej gjatë kohës që procesi avanconte. Neni 8 aplikohet në secilën prej katër fazave, por në fund të procesit, kur informacionet rreth një personi të caktuar apo përmbajtja e komunikimeve ekzaminohet nga nja analist, nevoja për mbrojtje kundër abuzimit bëhet më e lartë se kurrë. Prandaj, ekzistenca e një ndërhyrjeje tek të drejtat e kërkueses nga Neni 8 u konstatua dhe u confirmua nga Gjykata në rastin konkret.

Më pas u shqyrtua nëse ndërhyrja ishte e justifikuar, dhe Gjykata përsëriti parimet e vendosura të praktikës gjyqësore që një ndërhyrje e tillë mund të justifikohet vetëm nëqoftëse është në përputhje me ligjin, ndjek një ose disa qëllime legjitime, dhe është e nevojshme në një shoqëri demokratike. Nuk u kontestua mes palëve që ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin dhe që ajo synonte qëllimin legjitim të mbrojtjes së sigurisë kombëtare.

U theksua se Shtetet gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi për të vendosur se cili lloj regjimi i interceptimeve do të ishte i nevojshëm për të arritur qëllimin legjitim të mbrojtjes së sigurisë kombëtare. Për shkak të zhvillimeve në teknologjinë e vëzhgimit sekret, ishte e nevojshme të rivlerësoheshin gjashtë kriteret e mbrojtjes minimale që ishin hartuar gjatë praktikës gjyqësore të mëparshme për interceptimet e shënjestruara, për të pasqyruar rrezikun e abuzimit dhe nevojën legjitime për sekretësi sipas regjimit të interceptimeve të tërësishme. Prandaj, për të vlerësuar nëse Shteti përgjegjës veprroi brenda hapësirës së tij të vlerësimit në lidhje me regjimin e interceptimeve të tërësishme, Gjykata mori në shqyrtim tetë kriteret e tjera për të përcaktuar nëse korniza ligjore suedeze ofronte garanci të mjaftueshme kundër abuzimit, dhe nëse procesi i ishte nënshtruar "mbrojtjeve fillim-fund" të kërkuara.

Secili prej tetë kriterëve u adresua me radhë për të përcaktuar nëse ligji përmbante mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive dhe garanci për të plotësuar kriterin e "parashikueshmërisë" dhe "nevojshmërisë në shoqëri demokratike", dhe Gjykata identifikoi mangësi tek tre prej tetë kriterëve.

Tek kriteri i pestë, masat preventive që duheshin marrë kur materialet e interceptuara u përcilleshin palëve të treta, Gjykata identifikoi një sërë mangësish

në mungesë të një kërkese specifike ligjore që FRA të vlerësonte nevojshmërinë dhe proporcionalitetin e ndarjes së inteligjencës kur informacione që komprometonin seriozisht të drejtat e Nenit 8 ndodheshin në materialin që do të transmetohej jashtë vendit. Legjislacioni i inteligjencës së sinjaleve që ishte në fuqi në atë kohë mund të lejonte informacione të cilat shkelnin në mënyrë kritike të drejtat e privatësisë për t'u transmetuar jashtë vendit, edhe në rrethana kur transmetimi nuk kishte vlera domethënëse në aspektin e inteligjencës.

Tek kriteri i gjashtë, Gjykata gjeti një mangësi tjetër tek mungesa e dispozitave që detyronin FRA të anulonte një mision për interceptimin e informacioneve nëqoftëse kushtet e tij kishin pushuar së ekzistuari ose vetë masat nuk ishin më të nevojshme. Kërkuësja argumentoi se kjo lejonte mundësinë për misione vëzhgimi të tepërta dhe të papërshtatshme që mund të zgjasnin me muaj të tërë më shumë sesa ishte e nevojshme. Megjithatë, u gjet se kishte mekanizma të mjaftueshme për anulimin e një misioni të interceptimit të tërësishëm për të plotësuar kriterin e mbrojtjes, dhe ngjashëm u gjet vetëm një mangësi procedurale tek mungesa e dispozitave për shkatërrimin e materialeve të interceptuara që nuk përmbanin të dhëna personale.

Tek kriteri i tetë dhe i fundit për shqyrtimin *ex post facto*, Gjykata gjeti mangësi në mekanizmat mbrojtëse që SIA ofronte për shqyrtimin *ex post facto* me iniciativën e individëve ose personave ligjorë pa nevojën që ata të tregonin se mund të ishin prekur nga një operacion i interceptimeve të tërësishme. Sipas mekanizmit, Inspektorati i Inteligjencës së Huaj duhet të hetojë nëse komunikimet e individit ose personit ligjor janë interceptuar, dhe më pas të verifikojë nëse interceptimi ka qenë në përputhje me ligjin. U gjet se, meqenëse Inspektorati gjithashtu kishte detyrën e mbikëqyrjes dhe monitorimit të aktiviteteve të FRA, ky rol i dyfishtë mund të çonte në situata ku Inspektoratit do t'i duhej të vlerësonte aktivitetet e veta gjatë mbikëqyrjes së interceptimeve të bëra nga FRA, duke çuar kështu drejt një konflikti të qartë të interesit. Kombinuar me mungesën e një ruge se si anëtarët e publikut mund të merrnin vendime të arsyetuara në përgjigje të ankesave lidhur me interceptimin e tërësishëm të komunikimeve, Gjykata deklaroi se sistemi i shqyrtimit *ex post facto* nuk ishte mbrojtje efektive.

Duke pasur parasysh ekzaminimin e saj të mangësive të gjetura tek disa prej kriterëve të mbrojtjes në të drejtën vendase, Gjykata vendosi që kishte pasur shkelje të Nenit 8 për shkak të dështimit të Shtetit të paditur për të plotësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse kriteret për mbrojtjet "fillim-fund". Meqenëse mangësitë e theksuara nuk kompensoheshin mjaftueshëm nga mbrojtjet ekzistuese, regjimi

suedez i interceptimeve të tërësishme shkelte hapësirën e vlerësimit që u jepet Shteteve dhe nuk e arrinte kufirin e garancive të përshtatshme dhe efektive kundër arbitraritetit dhe rrezikut të abuzimeve.

### Neni 13

Dhoma kishte gjetur që nuk dilte çështje e veçantë sipas Nenit 13. Dhoma e Madhe miratoi të njëjtin përfundim, në lidhje me gjetjen e saj se kishte pasur shkelje të Nenit 8.

### Neni 41

Kërkuesja kishte deklaruar se gjetja e një shkeljeje do të përbënte shpërblim të mjaftueshëm, dhe Gjykata rrjedhimisht nuk caktoi shpërblim sipas këtij titulli. Gjykata i caktoi € 52,625 kërkueses për kosto dhe shpenzime.

*Leximi në gjyq i transkripteve të telefonatave të interceptuara në kontekstin e procedurave penale dhe lëshimi i tyre në sferën publike shkeli Nenin 8*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**CRAXI k. ITALISË (NR. 2)**

(Kërkesa Nr. 25337/94)  
**17 korrik 2003**

## **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1934. Ai ishte Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Socialiste të Italisë nga viti 1976 deri në vitin 1993 dhe Kryeministër i Italisë nga 1983 deri në 1987. Prej vitit 1994 ai jetoi në Tunizi, dhe kur ai vdiq në vitin 2000 familja e tij e vazhdoi procedurën. Gjatë fushatës së ashtuquajtur "duart e pastra" në Itali, kërkuesi në vitin 1994 u akuzua për korrupsion, pranim të pandershëm parash, fshehje të përfitimeve të pandershme dhe financim ilegal të partive politike.

Prokurori publik mori një urdhër nga Gjykata e Rrethit për interceptimin e thirrjeve telefonike të kërkuesit mes Italisë dhe shtëpisë së tij. Në seancën e procedurës penale, prokurori publik i depozitoi transkriptet e telefonatave në kancelarinë e gjykatës dhe kërkoi që ato të pranoheshin si prova. Prokuroria gjithashtu lexoi me zë disa pjesë të shkëputura në gjyq, dhe përmbajtja e disa pjesëve të bisedave dhe emrat e personave që flisnin u publikuan në shtyp më pas.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankuu se lëshimi në sferën publike i telefonatave të interceptuara të natyrës private, dhe sidomos vendimi i prokurorit për të depozituar transkriptet në kancelarinë e gjykatës, shkelën të drejtat e tij sipas Neneve 8, 14 dhe 18 të Konventës.

### Neni 8

Gjykata përsëriti se telefonatat mbulohen nga nocioni i "jetës private" dhe "korrespondencës" brenda Neni 8. Prandaj leximi në gjyq dhe zbulimi i përmbajtjes së interceptimeve telefonike në shtyp përbënë ndërhyrje tek Neni 8. Për këtë arsye, ishte e nevojshme të konsiderohej nëse ndërhyrjet qenë në përputhje me ligjin dhe proporcionale me një qëllim legjitim.



Në lidhje me publikimin në shtyp të pjesëve të shkëputura të bisedave telefonike, Gjykata kujtoi rëndësinë e lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike. Raportimi në shtyp, përfshirë komentimin, në lidhje me procedurat gjyqësore i kontribuon publicitetit të tyre dhe është në përputhje me kriterin e Nenit 6 § 1 që seancat të jenë publike. Mediat kanë detyrën e përcjelljes së informacioneve dhe ideve, dhe publiku ka të drejtën t'i ketë ato, sidomos kur bëhet fjalë për një figurë publike. Megjithatë, interesi publik në marrjen e këtyre informacioneve mbulon vetëm fakte që janë të lidhura me akuzat penale të ngritura kundër të akuzuarit. Shtypi duhet të abstenojë nga publikimi i informacioneve të cilat ka gjasa të paragjykojnë, me ose pa qëllim, të drejtën e të akuzuarit nga Neni 8.

Në rastin konkret, Gjykata vuri në dukje se disa nga bisedat e publikuara në shtyp ishin vetëm të natyrës private; përmbajtja e tyre kishte pak, ose aspak, lidhje me akuzat penale. Publikimi i tyre në shtyp nuk plotësoi ndonjë nevojë urgjente sociale. Prandaj, ndërhyrja nuk qe proporcionale me qëllimet legjitime që do të ishin ndjekur nga publikimi e rrjedhimisht jo e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Në lidhje me faktin nëse ndërhyrja e ankimuar mund t'i atribuohet Shtetit, Gjykata theksoi se publikimi u bë nga gazetatat private, të cilat nuk ishin nën kontrollin e autoriteteve publike. Burimi i informacionit të gazetarëve nuk ishte leximi nga bisedat gjatë seancës por tërësia e interceptimeve të depozituara në kancelarinë e gjykatës. Gjykata nuk e pranoi që duke i depozituar interceptimet në kancelari prokurori publik kishte zgjedhur që t'i lëshonte ato në sferën publike, meqenëse sipas të drejtës vendase depozitimi i një dokumenti e vinte atë në dispozicion vetëm për palët. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se zbulimi i bisedave në shtyp me gjasë u shkaktua nga ndonjë problem teknik në kancelari ose nga fakti që shtypi i mori informacionet nga ndonjëra prej palëve në procedurë ose nga avokatët e tyre.

Megjithatë, Gjykata përsëriti detyrimin pozitiv sipas Nenit 8 që një Shtet duhet të marrë hapat e nevojshëm për të siguruar mbrojtjen efektive të së drejtës së një individi për respekt ndaj jetës së tij private dhe korrespondencës. Kjo përfshin vënien në dispozicion të mbrojtjeve të duhura për të parandaluar zbulime të natyrës private, dhe zhvillimin e hetimeve efektive për të korrigjuar çështjen sa më shumë që është e mundur kur ndodhin zbulime të tilla. Në rastin konkret, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet publike kishin dështuar në përmbushjen e këtyre detyrimeve. Autoritetet kishin dështuar të ofronin ruajtjen e sigurt të transkripteve dhe nuk u duk se ishin zhvilluar hetime efektive. Prandaj, Gjykata deklaroi që Shteti nuk i kishte plotësuar detyrimet për të siguruar të drejtën e

kërkuesit për respekt ndaj jetës private dhe korrespondencës, dhe se kështu kishte pasur shkelje të Nenit 8.

Në lidhje me leximin në gjyq të përmbajtjes së disa transkripteve të telefonatave, Gjykata së pari shqyrtoi nëse ndërhyrja ishte “në përputhje me ligjin”. Gjykata përsëriti se u takon kryesisht autoriteteve kombëtare që të interpretojnë dhe të aplikojnë rregullat e brendshme relevante, sado që Gjykata mundet dhe duhet të ushtrojë njëfarë fuqie për të shqyrtuar nëse është vepruar në përputhje me të drejtën vendase.

Në rastin konkret, sipas Kodit të Procedurës Penale (“CCP”), pasi prokurori publik depozitoi transkriptet e bisedave të interceptuara në kancelarinë e gjykatës, duhet të kishte mbajtur një seancë private për të përcaktuar se cilat materiale duheshin zbuluar. Qëllimi i këtyre kritereve procedurale ishte t'u ofronin palëve dhe gjyqtarit mundësinë për të zgjedhur interceptimet të cilat nuk ishin relevante dhe zbulimi i të cilave mund të kishte ndikuar negativisht tek e drejta e të akuzuarit për respekt ndaj jetës private dhe korrespondencës. Sikur të aplikohesh, kjo do të kishte përbërë mbrojtje substanciale.

Gjykata e Rrethit kishte deklaruar se këto dispozita të CCP-së nuk aplikoheshin në çështjen e kërkuesit, megjithatë nuk kishte asgjë në urdhrin e Gjykatës së Rrethit që shpjegonte se përse këto garanci nuk mund të respektoheshin, dhe Gjykata konsideroi që CCP duhet të ishte aplikuar. Prandaj, Gjykata konsideroi se ndërhyrja nuk qe “në përputhje me ligjin”, meqenëse kërkuesi ishte privuar nga mbrojtjet procedurale substanciale të parashikuara në të drejtën vendase pa iu dhënë shpjegimet e duhura nga gjykatat e vendit. Nuk qe e nevojshme të shqyrtohej nëse ndërhyrje synoi një “qëllim legjitim” apo nëse qe “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

#### Nenet 14 dhe 18

Gjykata theksoi që ankesat sipas Neneve 14 dhe 18 dilnin nga të njëjtat fakte si ato të shqyrtuara në lidhje me Nenin 8. Duke pasur parasysh vendimin e saj në lidhje me Nenin 8, nuk qe e nevojshme që Gjykata ta shqyrtonte çështjen sipas Neneve 14 dhe 18.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi trashëgimtarëve të kërkuesit një total prej € 6,000 për dëme jomateriale.

*Dështimi për të përfshirë detaje relevante dhe specifike në urdhrat e vëzhgimit sekret në një çështje që kishte të bënte me përgjimin e telefonit të një të dyshuari për trafik droge nënkuptoi që nuk pati mbrojtje të mjaftueshme kundër abuzimit potencial, çka përbëri shkelje të Nenit 8*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**DRAGOJEVIĆ k. KROACISË**

(Kërkesa Nr. 68955/11)

**15 janar 2015**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte shtetas kroat, i cili punonte si marinar në një kompani anijesh të mallrave me seli në Kroaci.

Në vitin 2007, policia dhe Prokuroria e Shtetit për Shtypjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ("OSCOC") zhvilluan hetime rreth pretendimeve për trafik të mundshëm droge mes Amerikës Latine dhe Evropës përmes anijeve transoqeanike, duke përfshirë disa persona nga Kroacia. Mbi bazën e një raporti të policisë, në mars 2007 OSCOC kërkoi dhe fitoi autorizimin për të përdorur masa sekrete vëzhgimi për të përgjuar telefonin e kërkuesit dhe për ta monitoruar atë fshehtas.

Në janar 2009, kërkuesi u arrestua dhe u fut në burg për dyshime të trafikimit të drogës. Ai u akuzua në mars 2009 për trafikim droge dhe pastrim parash. Avokati i tij i kërkoi Gjykatës Krahinore të Dubrovnikut qasje në incizimet e radios të bëra përmes përdorimit të masave sekrete të vëzhgimit, dhe kërkesa u pranua. Më pas kërkuesi bëri kundërshtim ndaj aktakuzës duke u bazuar në faktin se rezultatet e masave sekrete të vëzhgimit nuk sugjeronin se ai kishte qenë i përfshirë në vepër. Ky kundërshtim u rrëzua si dukshëm i pabazuar mbi bazën se kishte dyshime të pamjaftueshme për ta dërguar çështjen në gjyq.

Pas kësaj, kërkuesi aplikoi për përjashtimin e rezultateve të masave sekrete të vëzhgimit nga dosja e lëndës si prova të marra në mënyrë të paligjshme, mbi bazën se urdhrat për përdorimin e tyre nuk kishin qenë mjaftueshëm të arsyetuar dhe kështu kishin qenë të paligjshme sipas të drejtës vendase. Kryetari i trupit gjykues e rrëzoi kërkesën si të pabazuar. Gjatë kësaj periudhe, paraburgimi paragjyqësor i kërkuesit u zgjat shumë herë.

Në dhjetor 2009, Gjykata Krahinore e Dubrovnikut e gjeti kërkuesin fajtor për akuzat e trafikimit të drogës dhe pastrimit të parave, dhe e dënoi me nëntë vjet burgim. Vendimi u bazua, mes të tjerash, në deklaratat e dëshmitarëve, prova të marra gjatë bastisjeve të shumta dhe konfiskimeve, si dhe përdorimit të masave sekrete të vëzhgimit. Dënimi i tij u mbështet nga Gjykata Supreme në shtator 2010 dhe ankesa e tij kushtetuese u rrëzua në maj 2011.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur tek Neni 8, kërkuesi u ankua rreth përgjimit sekret të bisedave të tij telefonike. Ai gjithashtu u ankua sipas Nenit 6 § 1 për padrejtësinë e procedurave kundër tij, duke pretenduar: mungesën e paanshmërisë në gjyq; dhe padrejtësinë për shkak të faktit se dënimi i tij ishte bazuar mbi prova të marra përmes masave të paligjshme sekrete të vëzhgimit.

### Neni 8

Gjykata theksoi se nuk vihej në diskutim se monitorimi i fshehtë i telefonit të kërkuesit kishte përbërë ndërhyrje tek të drejtat e tij nga Neni 8. Pyetja qendrore ishte nëse sistemi i vëzhgimit sekret, ashtu siç ishte aplikuar nga autoritetet kroate, ofronte mbrojtje të mjaftueshme kundër abuzimit.

E drejta vendase parashikonte qartazi se masat e vëzhgimit sekret në kontekstin e procedurave penale ishin të ligjshme, nëqoftëse ato urdhërohen nga një gjyqtar hetues me kërkesë të Prokurorit të Shtetit. Gjykata konsideroi se kërkimi i autorizimit me shkrim të vëzhgimit sekret, dhe përmbajtja e deklaratës së arsyeve, do të thoshte se e drejta vendase e parashikonte autorizimin paraprak të përdorimit të masave të vëzhgimit sekret, të cilat duhet të jenë mjaftueshëm të plota dhe të tilla që tregojnë se kushtet statutoare për përdorimin e vëzhgimit sekret janë plotësuar, dhe se përdorimi i këtyre masave ishte i nevojshëm dhe proporcional në rrethanat e dhëna.

Gjykata theksoi se një deklaratë e detajuar e arsyeve ishte e nevojshme kur urdhërohet përdorimi i masave të vëzhgimit sekret, meqenëse kjo garantonte ekzistencën e një shkakut të mundshëm për të besuar se vepra e parashikuar në ligj ishte kryer. Autoriteti që miraton përdorimin e vëzhgimit sekret duhet ta kufizojë atë për rastet kur ka baza faktike për të dyshuar se një person po planifikon të kryejë një vepër penale të rëndë. Masat e vëzhgimit duhet të urdhërohen nëqoftëse nuk ka perspektivë të konstatimit të suksesshëm të fakteve me ndonjë

metodë tjetër, ose kur kjo e fundit do të ishte shumë më e vështirë. Kjo siguron që masat e vëzhgimit sekret nuk urdhërohen në mënyrë arbitrare, të parregullt ose pa konsideratë të duhur.

Në rastin e kërkesit, katër urdhrat e vëzhgimit sekret të lëshuar nga gjyqtari hetues i Gjykatës Krahinore të Zagrebit u bazuan në thelb tek një deklaratë që i referohej ekzistencës së kërkesës nga OSCOC për përdorimin e vëzhgimit sekret. Nuk u dhanë hollësi që i referoheshin fakteve specifike të çështjes së kërkesit, as nuk pati referenca në ndonjë rrethanë që tregonte shkak të mundshëm për të besuar se veprat ishin kryer ose që hetimet nuk do të mund të ishin zhvilluar me mënyra të tjera.

Megjithëse kriteret statutores në lidhje me këqyrjen paraprake gjyqësore dhe arsye të hollësishme nuk ishin respektuar, praktika e Gjykatës Krahinore ishte miratuar nga Gjykata Supreme. Duke vepruar kështu, gjykatat kombëtare kishin futur efektivisht mundësinë e justifikimit retrospektiv, kur kriteret statutores nuk janë respektuar. Gjykata deklaroi se shmangia nga ky kriter përmes justifikimit retrospektiv nuk ofronte mbrojtje të përshtatshme dhe të mjaftueshme kundër abuzimit potencial. Një praktikë e tillë 'hap[i] derën arbitraritetit duke lejuar zbatimin e vëzhgimit sekret në kundërshtim me procedurën e parashikuar nga e drejta relevante'.

Duke shqyrtuar mundësinë e kërkesit për të kontestuar ligjshmërinë e masave të vëzhgimit, Gjykata theksoi se gjykatat penale e kishin kufizuar vlerësimin e tyre për përdorimin e vëzhgimit sekret brenda pyetjes nëse provat e marra në këtë formë duhet të pranoheshin, pa hyrë në substancën e pretendimeve të tij për ndërhyrje arbitrare tek të drejtat e tij nga Neni 8. Në fund, Qeveria kroate nuk kishte ofruar informacione në lidhje me zgjidhjet që do të kishte në dispozicion një person në pozicionin e kërkesit.

Rjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 8.

## Neni 6

Gjykata bëri të qartë se thjesht fakti që një prej gjyqtarëve të trupit gjykues po ashtu kishte qenë i përfshirë në vendimet për të zgjatur paraburgimin paragjyqësor të kërkesit nuk ngrinte një çështje të mungesës së paanshmërisë sipas Konventës.

Në lidhje me përdorimin e provave të marra përmes vëzhgimit sekret, Gjykata theksoi se kërkuesi nuk e kishte vënë në diskutim besueshmërinë e informacioneve të marra përmes atyre masave, duke e kufizuar kundërshtimin e tij me përdorimin formal të tyre si prova në procedurë. Meqenëse kërkuetit iu dha mundësia për të kontestuar autenticitetin e provave, dhe nuk ishin të vetmet prova mbi të cilat u vendos dënimi, Gjykata konsideroi se nuk kishte asgjë që e vërtetonte përfundimin që të drejtat e tij të mbrojtjes nuk ishin respektuar si duhet.

Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1.

#### Neni 41

Gjykata vendosi që Kroacia duhet t'i paguante kërkuetit € 7,500 për dëme jomateriale dhe € 2,160 për kosto dhe shpenzime.

*Një urdhër nga një gjyqtar hetues që autorizoi përdorimin e të dhënave të thirrjes telefonike personale të një të dyshuari gjatë hetimeve penale nuk shkeli Nenin 8*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**FIGUEIREDO TEIXEIRA K. ANDORRËS**

(Kërkesa Nr. 72384/14)  
**8 nëntor 2016**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1983 dhe jetonte në Andorra.

Kërkuesi u arrestua më 5 dhjetor 2011 në lidhje me dyshime për trafikim droge. Gjyqtari përgjegjës për hetimet penale ('batlle') në një urdhër të datës 30 gusht 2012 i kërkoi një kompanie telefonike (Andorra Telecom) që të paraqiste (a) një listë të thirrjeve hyrëse dhe dalëse nga dy numra telefoni që i përkisnin kërkuesit nga data 15 gusht 2011 deri më 4 dhjetor 2011; dhe (b) identitetet e abonentëve të numrave në atë listë (përmbledhtas referuar si "masa e kontestuar").

Kërkuesi u përpoq të hiqte urdhrin e batlle-s mbi bazën se ai shkelte të drejtën e tij për sekretësinë e komunikimeve të tij. Batlle e rrëzoi këtë kërkesë, dhe apelet e kërkuesit po ashtu u rrëzuan. Gjykata Kushtetuese gjithashtu e rrëzoi apelin e kërkuesit, pasi gjeti se ruajtja e të dhënave të konsumatorëve ishte e rregulluar me termat dhe kushtet e përgjithshme të shitjes së Andorra Telecom. Kodi i Procedurës Penale të Andorrës po ashtu e autorizonte batlle-n që të merrte masa të caktuara në kuadër të hetimeve, përfshirë, në rrethana të caktuara, edhe kërkimin e përgjimit të thirrjeve telefonike.

Më tej, kërkuesi u shpall fajtor dhe u dënua nga një gjykatë më 29 shtator 2015 për shitjen dhe posedimin e sasive të mëdha të drogës për qëllime komerciale. Gjykata më e Lartë e Drejtësisë në Andorra e mbështeti këtë vendim. Ajo gjykatë theksoi se gjykata e shkallës së parë kishte para saj një sërë provash që tregonin fajësinë e kërkuesit, përfshirë, mes provave të tjera, të dhënat e thirrjeve telefonike të kërkuesit.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua se ruajtja e të dhënave lidhur me komunikimet e tij telefonike dhe përdorimi i atyre të dhënave në hetime penale përbëri ndërhyrje të pajustificuar

tek të drejtat e tij nga Neni 8 i Konventës. Kërkuesi gjithashtu u ankua se të drejtat e tij nga Neni 6 po ashtu ishin shkelur.

### Neni 8

Masa e kontestuar përbëri ndërhyrje tek të drejtat e kërkuesit nga Neni 8. Në lidhje me faktin nëse ndërhyrja qe e parashikuar me ligj, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme të theksonte nëse kërkuesi ia kishte dhënë lejen kompanisë telefonike për të mbledhur të dhëna kur ai ishte pajtuar me termat dhe kushtet e përgjithshme të kompanisë telefonike. Sidoqoftë, ndërhyrja ishte direkt e parashikuar me Nenin 87 të Kodit shtetëror të Procedurës Penale dhe me Ligjin Nr. 15/2003 ("Kodi").

Çështja parësore lidhur me faktin nëse ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj, për qëllimet e Neni 8, ishte nëse efekti i ligjeve kombëtare, si ruajtja dhe komunikimi në gjykatën kombëtare i të dhënave telefonike të kërkuesit, e rrjedhimisht ndërhyrja tek e drejta e kërkuesit për jetë private, ishte mjaftueshëm i parashikueshëm.

Gjykata iu referua praktikës së saj gjyqësore të mëhershme dhe përsëriti se, sa i përket përgjimit të komunikimeve, parashikueshmëria nuk mund të vlerësohet në të njëjtën mënyrë si fushat e tjera. Në kontekstin e vëzhgimit, pra përgjimit të komunikimeve, parashikueshmëria nuk nënkupton që një individ ka mundësi të parashikojë se kur autoritetet mund të përgjojnë komunikimet e tij dhe t'u përshtatet sjelljes së tyre përkatësisht. Megjithatë, duke pasur parasysh rrezikun e arbitraritetit kur pushteti ekzekutiv ushtrohet në mënyrë sekrete, posaçërisht duke ditur se teknologjia e përgjimit të komunikimeve vazhdon të përmirësohet, ligji duhet të jetë mjaftueshëm i qartë për të treguar në mënyrë të mjaftueshme se në cilat rrethana dhe në çfarë kushtesh autoritetet publike mund të bëjnë përgjimin e komunikimeve. Më tej, saktësia e kërkuar nga një instrument kombëtar, i cili nuk mundet assesi të parashikojë çdo eventualitet, varet në masë të konsiderueshme nga përmbajtja e instrumentit në fjalë, nga fusha që i është caktuar të mbulojë, dhe nga numri dhe statusi i atyre të cilëve ai u adresohet.

Në rastin konkret, Gjykata vuri në dukje se Neni 87 i Kodit kërkonte që gjykatat kombëtare të ofronin një vendim të arsyetuar që shpjegon nevojshmërinë dhe proporcionalitetin e çdo mase, duke marrë në konsideratë provat e mbledhura dhe seriozitetin e veprës nën hetime. Gjykata konsideroi se urdhri i 30 gushtit 2012 u ishte përmbajtur këtyre kriterëve, duke pasur parasysh nevojat e hetimeve,



seriozitetin e veprës së pretenduar, dhe aspektet praktike të ndërhyrjes tek sfera private e kërkuarit.

Ligjet e Andorrës gjithashtu ofronin mbrojtje procedurale kundër ushtrimit të veprimeve arbitrare. Këtu përfshihej kërkesa për autorizim paraprak të një gjyqtari, kishte afat kohor statusor për kohëzgjatjen e masave, masat viheshin në funksion vetëm në rastet e veprave më serioze, dhe kërkuari mund të kontestonte në çdo kohë ligjshmërinë e provave të mbledhura gjatë procedurës.

Gjykata po ashtu vuri në dukje se ligjet dhe rregullat kombëtare nuk bënë dallim mes abonentëve me kontratë të telefonisë mobile dhe abonentëve me parapagim, dhe ishte e arsyeshme të konsiderohej se ligjet dhe rregullat kombëtare u aplikoheshin të dyja grupeve.

Prandaj, Gjykata doli në përfundimin se ligji kombëtar ishte mjaftueshëm i parashikueshëm për qëllimet e Nenit 8(2).

Gjykata nuk pati dyshime se ndërhyrja synonte një qëllim legjitim sipas Nenit 8(2), pra parandalimin e krimit. Për sa i përket proporcionalitetit të masës së kontestuar, Gjykata theksoi se masa ishte autorizuar për një periudhë më të shkurtër sesa periudha e kërkuar nga policia. Më tej, veprat e pretenduara ishin kryer të paktën gjashtë muaj para periudhës së mbuluar nga masa. Autoritetet e Andorrës kishin respektuar proporcionalitetin mes efekteve të masës së kontestuar dhe objektivit për parandalimin e krimit, dhe ato kishin përdorur një metodë jo-intruzive për të "mundësuar që vepra të zbulohet, të parandalohet ose të ndiqet penalisht me efektivitetin e duhur". Rrjedhimisht, ishte vendosur ekuilibri i përshtatshëm mes të drejtës për jetë private dhe parandalimit të krimit, dhe Gjykata nuk gjeti shkelje të Nenit 8.

### Neni 6

Në lidhje me Nenin 6, kërkuari konstatoi se në vendimet e marra në nivel vendi ishin ofruar arsye të pamjaftueshme, dhe termat e kushtet e kontratave telefonike ishin përdorur si prova para Gjykatës Kushtetuese, ndërkohë që këto prova nuk u ishin paraqitur gjykatave më të ulëta.

Gjykata përsëriti që detyrimi i gjykatave për të dhënë arsye për vendimet e tyre nuk nënkuptonte përgjigje të detajuar për çdo argument. Gjykatat e Andorrës kishin ofruar arsye të mjaftueshme. Gjykata po ashtu qe e qartë se, megjithëse

Konventa garanton të drejtën për gjyq të drejtë, ajo nuk rregullon pranueshmërinë ose vlerësimin e provave, çka është çështje e gjykatave vendase dhe ligjeve të vendit. Kërkuesi e kishte pasur mundësinë për të kontestuar provat e paraqitura para Gjykatës Kushtetuese, dhe vendimi i asaj gjykate nuk mund të konsiderohej arbitrar ose i paarsyeshëm.

Prandaj, ankesa sipas Nenit 6 u refuzua si dukshëm e pabazuar.

*Mungesa e arsyeve në miratimin gjyqësor të bastisjes së shtëpisë së kërkuesve  
nuk i përmbushi kriteret e ligjshmërisë të ngërthyera në Nenin 8*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**GUTSANOVI K. BULLGARISË**

(Kërkesa Nr. 34529/10)  
**15 tetor 2013**

### **1. Faktet kryesore**

Katër kërkuesit ishin një politikan i njohur, gruaja e tij, dhe dy vajzat e tyre të mitura të lindura në vitin 2002 dhe vitin 2004. Autoritetet dyshuan se kërkuesi i parë ishte i përfshirë në një grup kriminal të akuzuar për abuzim me pushtetin dhe zhvatjen e fondeve publike. Para agimit, rreth orës 6:30 të mëngjesit, më 31 mars 2010, një skuadër speciale e cila përfshinte policë të armatosur dhe të maskuar, arriti në shtëpinë e kërkuesve. Një kujdestare u tregoi atyre që gruaja dhe vajzat ndodheshin në shtëpi. Pasi kërkuesi i parë nuk iu përgjigj urdhrin për të hapur derën, policët hynë me forcë. Shtëpia u kontrollua dhe aty u morën disa sende si prova. Sipas kërkuesve, policët e maskuar hynë në dhomën e gjumit ku prindërit i kishin futur fëmijët e tyre, dhe i kërcënuan ato me armë zjarri dhe drita të forta. Pasi i vunë prangat kërkuesit të parë, policët urdhëruan kërkuesen e dytë t'i mbulonte fëmijët me një mbulesë për të mos i lënë të bërtisnin dhe të qanin nga frika. Policët e kundërshtuan këtë deklaram, duke thënë se ata nuk hynë në dhomë për t'i vënë prangat kërkuesit të parë, nuk folën me kërkuesen e dytë, të tretë dhe të katërt, dhe hynë në dhomën e gjumit të armatosur vetëm me ngacmuesit elektrikë për të ndihmuar kërkuesin e parë që të vishej.

Kërkuesi i parë eventualisht u arrestua dhe u shoqërua nga shtëpia në ora 1:00 të natës, ku u filmua nga gazetarët dhe një ekip televizioni të cilët ishin mbledhur jashtë shtëpisë së tij. Në të njëjtën ditë u mbajt një konferencë shtypi gjatë së cilës prokurori shqiptoi akuzat që do të ngriheshin kundër individëve të arrestuar, përfshirë kërkuesin e parë, për veprimet e tyre si pjesë të një grupi kriminal. Në ora 10:55 një prokuror ngriti formalisht akuzën kundër kërkuesit të parë për vepra të ndryshme, dhe urdhëroi paraburgimin e tij për 72 orë për të siguruar praninë e tij në gjykatë. Më 1 prill, një gazetë publikoi fjalën e prokurorit së bashku me pjesë të shkëputura nga një intervistë me Ministrin e Brendshëm, gjatë së cilës ai iu referua afërsisë së kërkuesit të parë me një të dyshuar tjetër dhe përfshirjen e tyre në një "komplot". Më 3 prill 2010, një gjykatë e vendosi atë në paraburgim paragjyqësor

mbi bazën e rrezikut që ai mund të kryente vepra të tjera. Më 5 prill 2010, Kryeministri dha një intervistë të drejtpërdrejtë në lidhje me situatën aktuale, në fund të së cilës iu kërkua të komentonte rreth arrestimeve të fundit. ai përmendi afërsinë e kërkuesit me një të dyshuar tjetër si dhe "përfitimet materiale" të tyre.

Apeli i kërkuesit të parë kundër paraburgimit paragjyqësor të tij më 13 prill 2010 dhe një kërkesë e mëtejshme për lirim më 18 maj 2010 u refuzuan. Më 25 maj 2010, Gjykata e Apelit e vuri kërkuesin e parë në arrest shtëpiak, duke cekur se rreziku që ai të kryente vepra të tjera nuk ekzistonte më. Më 26 korrik 2010, gjykata vendosi ta lironte me dorëzani. Në kohën e vendimit të Gjykatës, kërkuesi i parë ishte ende nën akuza penale.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesit u ankuan sipas Nenit 3 se ata i ishin nënshtruar trajtimit poshtërues gjatë operacionit policor në shtëpinë e tyre. Kërkuesi i parë më tej u ankua sipas Neneve 5 dhe 6 në lidhje me një sërë çështjesh, përfshirë faktin se ai nuk ishte sjellë menjëherë para një gjyqtari dhe se deklaratat e zyrtarëve publikë në shtyp kishin shkëlur prezumimin e pafajësisë së tij. Sipas Nenit 8, kërkuesit deklaruan se bastisja e kryer në shtëpinë e tyre përbëri ndërhyrje të pajustificuar tek e drejta për respekt ndaj jetës shtëpiake dhe familjare të tyre, dhe sipas Nenit 13 ata nuk patën zgjidhje efektive.

### Neni 3

Operacioni i policisë u përcaktua nga Gjykata se kishte synuar qëllimin legjitim të zhvillimit të arrestimit dhe bastisjes në interesin e përgjithshëm të ndjekjes penale të veprave penale. Megjithatë, planifikimi dhe ekzekutimi i operacionit të policisë nuk mori parasysh disa faktorë të rëndësishëm, siç ishte natyra e veprave për të cilat akuzohej kërkuesi i parë, faktin që ai nuk kishte histori dhune, dhe prania e gruas dhe fëmijëve të tij të vegjël në shtëpi. Këto faktorë tregonin se përdorimi i agjentëve të armatosur dhe të maskuar dhe përdorimi i metodave si ardhja në shtëpi shumë herët në mëngjes ishin të tepërta e jo diçka që do të kishte qenë domosdoshmërisht e nevojshme për të kapur një të dyshuar dhe për të mbledhur prova. Katër kërkuesit i ishin nënshtruar një përvojë të hidhur psikologjike e cila kishte shkaktuar ndjenja frike, ankthi dhe pafuqie. Prandaj veprimet e policisë u vlerësuan nga Gjykata se kishin përbërë trajtim poshtërues për qëllimet e Nenit 3, dhe përbënë shkelje të atij Neni.

## Neni 5

### *Neni 5(3) – dalja para gjyqtarit*

Kërkuesi i parë u paraburgos pa gjyq për tri ditë dhe gjashtë orë, por atij nuk iu kërkua të merrte pjesë në ndonjë masë hetimore pas ditës së parë. Ai nuk u dyshua për përfshirje në ndonjë aktivitet të dhunshëm dhe ishte në gjendje psikologjike delikate gjatë fazave fillestare të paraburgimit, pas trajtimit poshtërues që kishte vuajtur gjatë operacionit të policisë, i cili ishte rënduar nga fama e tij e keqe publike. Pavarësisht nga kjo famë e keqe, ai gjithashtu u paraburgos në të njëjtin qytet ku ndodhej gjykata, dhe nuk pati ndonjë masë sigurie të jashtëzakonshme. Këto elemente bënë që Gjykata të gjente shkelje të kriterit të Nenit 5 për paraqitje të menjëhershme para një gjyqtari.

### *Neni 5(3) – kohëzgjatja e paraburgimit*

Kërkuesi i parë u paraburgos për një periudhë prej 118 ditësh (31 maj deri më 30 qershor 2010), prej të cilave dy muaj ishte në arrest shtëpiak. Vendimet e gjykatave vendase për ta mbajtur atë në paraburgim u bazuan në rrezikun që ai mund të kryente ndonjë vepër tjetër, në mënyrë të veçantë ndërhyrja tek provat. Megjithatë, më 25 maj 2010 Gjykata e Apelit vendosi që, pas dorëheqjes së kërkuesit nga posti i tij, ky rrezik kishte kaluar. Por prapë se prapë, në kundërshtim me detyrimet e saj sipas të drejtës vendase, e njëjta gjykatë e vuri kërkuesin në arrest shtëpiak pa dhënë ndonjë arsye të veçantë për ta justifikuar këtë vendim. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet kishin dështuar në detyrimin e tyre për të ofruar arsye konkrete dhe të mjaftueshme për paraburgimin e kërkuesit të parë pas 25 majit 2010, dhe prandaj kishin shkelur Nenin 5(3).

### *Neni 5(5) – kompensimi*

Ligji për Përgjegjësinë e Shtetit nuk i ofronte kërkuesit zgjidhje efektive për dëmet që ai kishte pësuar gjatë paraburgimit, meqenëse kjo kërkonte gjetje formale nga një gjykatë vendase që paraburgimi i tij kishte qenë i paligjshëm. Meqenëse procedura kundër kërkuesit ende vazhdonte, paraburgimi i tij vazhdoi të konsiderohej i ligjshëm nga gjykatat vendase, dhe prandaj Ligji për Përgjegjësinë e Shtetit nuk aplikohet. Duke qenë se nuk ekzistonte ndonjë dispozitë tjetër vendore për kompensim, Gjykata gjeti se kishte pasur shkelje të Nenit 5(5).

## Neni 6

Gjykata shqyrtoi pretendimet e kërkuesit të parë që zyrtarë të ndryshëm publikë kishin shkelur të drejtën e tij për prezumim të pafajësisë. Pas mos-gjetjes së shkeljes në lidhje me intervistën e Kryeministrit dhe deklaratën për shtyp të prokurorit, Gjykata vazhdoi me shqyrtimin e implikimeve të intervistës së Ministrit të Brendshëm, gjatë së cilës ai deklaroi se “ajo që kishin bërë [kërkuesi i parë dhe një i dyshuar tjetër] përfaqëson një komplot të ndërlikuar gjatë një periudhe disa-vjeçare”. Gjykata dallooi natyrën e intervistës, që kishte të bënte ekskluzivisht me operacionin policor, nga fjalët spontane të Kryeministrit disa ditë më vonë. Përveç kësaj, fakti që ky fjalim u publikua të nesërmen e arrestimit të kërkuesit të parë, dhe para paraqitjes së kërkuesit të parë në gjykatë, nga një zyrtar i lartë publik i cili në këto rrethana do të duhej të kishte qenë i kujdesshëm për të shmangur konfuzionin, ishte domethënëse. Fjalët e Ministrit të Brendshëm ishin më shumë sesa një komunikim i thjeshtë informacionesh, dhe ato sugjeronin se kërkuesi i parë ishte fajtor. Prandaj kishte pasur shkelje të Nenit 6(2). Në fund, gjyqtari që refuzoi kërkesën për lirim më 18 maj 2010 deklaroi se gjykata e tij “mban pikëpamjen se është kryer një vepër penale dhe se i akuzuari ka qenë i përfshirë”. Kjo frazë ishte më shumë se një përshkrim i thjeshtë i dyshimit, ajo ishte deklarim i fajësisë së kërkuesit përpara se të ishte marrë ndonjë vendim në lidhje me themelet e çështjes. Për pasojë, edhe kjo shkeli Nenin 6(2).

## Neni 8

Gjykata theksoi se bastisja në fjalë ishte e bazuar në dispozita legislative që nuk përbënin problem në lidhje me qasshmërinë dhe parashikueshmërinë e tyre për qëllime të bastisjes si një veprim që është “në përputhje me ligjin”. Sa i përket kriterit të fundit cilësor që duhet përmbushur nga ligjet vendase, pra pajtueshmëria me shtetin e së drejtës, Gjykata kujtoi se në kontekstin e kontroleve dhe bastisjeve kërkohej që e drejta vendase të ofronte garanci të përshtatshme kundër arbitraritetit. Në rastin konkret, bastisja e shtëpisë së kërkuesve u zhvillua pa autorizimin paraprak të një gjyqtari. Një bastisje e tillë u lejua me kusht që një gjykatë ta shqyrtonte bastisjen në mënyrë retroaktive për të siguruar se ajo i kishte plotësuar disa kushte të caktuara materiale dhe procedurale. Në këtë rast, gjyqtari në fjalë megjithatë nuk dha arsye për aprovimin e tij – ai thjesht e kishte firmosur dhe vulosur procesverbalin me fjalën “aprovuar”. Si rezultat, Gjykata konsideroi se ai nuk kishte treguar kontroll efektiv mbi ligjshmërinë dhe nevojshmërinë e bastisjes. Andaj, ndërhyrja tek e drejta për respektim të shtëpisë nuk që “e parashikuar me ligj” dhe prandaj shkeli Nenin 8.

### Neni 13 në kombinim me Nenet 3 dhe 8

Në të drejtën vendase nuk ekzistonte asnjë zgjidhje efektive me të cilën kërkuesit mund të shfrytëzonin të drejtën e tyre për të mos iu nënshtuar trajtimit në kundërshtim me Nenin 3 dhe të drejtën për respektim të shtëpisë së tyre sipas Nenet 8. Prandaj u gjet shkelje e Nenet 13 në kombinim me këto dy Nene.

### Neni 41

Një shumë e përbashkët prej 40,000 € iu caktua kërkuesve si shpërblim i drejtë dhe 4,281 € për kosto dhe shpenzime.

*Përdorimi nga një autoritet publik i përgjimit sekret të telefonatave të bëra nga një vend pune, në një sistem ndërkombëtar të telekomunikimeve, pa paralajmërim apo njoftim të përshtatshëm, ose pa mundësinë e një zgjidhjeje apo rregulloreje vendase, shkeli Nenet 8 dhe 13 të Konventës*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**HALFORD k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa Nr. 20605/92)  
**25 qershor 1997**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja ishte e lindur në vitin 1940 dhe jetonte në Wirral. Nga viti 1962 deri në vitin 1992 ajo punoi në shërbimin policor.

Në maj të vitit 1983, kërkuesja u emërua Asistent/Kryeoficere në policinë e Merseyside. Pas promovimit të saj, kërkueses iu caktua një zyrë dhe dy telefona, një për çështje profesionale dhe një për përdorim privat. Të dy telefonat ishin pjesë e rrjetit telefonik të brendshëm të departamentit, dhe nuk u nënshtroheshin ligjeve për telekomunikimet publike. Kërkueses nuk iu vu ndonjë kufizim i veçantë, as nuk iu dhanë udhëzime të veçanta në lidhje me përdorimin e telefonave.

Gjatë shtatë viteve vijuese, kërkuesja aplikoi në mënyrë të përsëritur për t'u emëruar në pozitën Zëvendës/Kryeoficere. Ky promovim ishte nën diskrecionin e Ministrisë së Brendshme (ang. Home Office). Sipas kërkueses, Kryeoficeri i Merseyside nuk i ishte dakord me gratë në pozita udhëheqëse, dhe ndërhyri për t'ia mohuar kërkueses miratimin nga Ministria e Brendshme. Pasi mori një refuzim tjetër të promovimit në shkurt 1990, kërkuesja nisi procedurën kundër Kryeoficerit dhe Ministrit të Brendshëm (ang. Home Secretary), me akuzime formale për diskriminim mbi baza të seksit.

Në qershor 1990, u caktua një "Komision i Veçantë" për të adresuar akuzimet për diskriminim. Kërkuesja pretendoi se Autoriteti Policor në atë kohë nisi një fushatë hakmarrëse kundër saj, e cila përfshinte veprime si përgjimi i telefonatave të saj personale, me qëllim të marrjes së informacioneve për t'u përdorur kundër saj në procedurën për diskriminim, si dhe veprime disiplinore. Në shtator 1990, procedura disiplinore kulminoi në formën e një raporti me shkrim ku pretendoheshin sjellje e pahijshme nga ana e kërkueses. Në dhjetor 1990, kërkuesja u suspendua



nga detyra. Në fillim të vitit 1991, Komisioni Disiplinor vendosi të ngrinte akuzë formale.

Përfundimisht, akuzat u prishën për shkak të padrejtësisë së mundshme nga ana e autoriteteve. Kërkesja pranoi një marrëveshje në korrik 1991, dhe u pajtua që të dilte në pension pas kësaj, kinse për arsye që nuk kishin lidhje me rastin. Ministria e Brendshme ra dakord që të implementonte disa propozime të Komisionit për Mundësi të Barabarta dhe të shqyrtonte procedurat e saj të përzgjedhjes për pozita në polici.

Komisioni<sup>[265]</sup> e deklaroi kërkesën të pranueshme më 2 mars 1995, duke gjetur se kishte pasur shkelje të Neneve 8 dhe 13 në lidhje me përgjimin e thirrjeve telefonike të kërkuar nga telefoni i saj i zyrës. Ndërkohë që Qeveria pranoi para Komisionit se kërkesja kishte konstatuar, përmes provave të mbledhura, gjasat e arsyeshme që thirrjet e saj telefonike të zyrës ishin përgjuar, ajo [Qeveria] refuzoi të bënte gjetje të tilla për telefonin e saj të shtëpisë. Konstatimi u mbështet nga dy gjykata, si dhe nga Ministri i Brendshëm (ang. Home Secretary), qoftë si marrëveshje afirmative me përcaktimin e Qeverisë, ose si rezultat i kufizimeve juridikionale. Po ashtu, Komisioni nuk gjeti shkelje për pjesën e mbetur të ankesave të kërkuar, përfshirë Nenet 8 dhe 13, në lidhje me telefonin e saj të shtëpisë, Nenin 10 në lidhje me telefonin e saj të zyrës, dhe Nenin 14 në lidhje me diskriminimin e pretenduar seksual.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesja u ankua që përgjimi i thirrjeve të saj telefonike si nga shtëpia ashtu edhe nga zyra kishte shkelur të drejtat e saj nga Nenet 8 dhe 10 për respekt ndaj jetës private dhe lirinë e shprehjes, përkatësisht. Më tej, kërkesja u ankua se e drejta e saj nga Neni 13 për zgjidhje efektive gjithashtu ishte shkelur, si dhe e drejta e saj nga Neni 14 për ndalimin e diskriminimit.

### Neni 8

Gjykata theksoi se thirrjet telefonike të bëra si nga zyra e kërkuar ashtu edhe nga shtëpia e saj mbulohehin nga nocionet e "jetës private" dhe

---

[265] Në vitet 1954-1998 Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut (Komisioni) veprroi si ndërmjetës mes kërkuarve individualë dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Me miratimin e Protokollit 11, Komisioni u mbyll në favor të qasjes direkte në Gjykatë.

“korrespondencës” brenda kuptimit të Nenit 8. Për shkak se kërkuesja nuk kishte marrë njoftim për monitorimin e telefonave të saj, ishte e arsyeshme të pritej që telefonatat e saj të mbeteshin private. Kjo pritshmëri përforcohej nga fakti që zyra e saj ishte konceptuar për përdorim privat prej saj, si dhe nga garancia e autoriteteve që ajo mund ta përdorte telefonin e zyrës për thirrje në lidhje me procedurën për diskriminim seksual.

Për më tepër, kërkuesja kishte nxjerrë prova që konstatonin gjasa të arsyeshme që thirrjet e saj në zyrë ishin përgjuar me qëllim të mbledhjes së materialeve për të mundur pretendimet e saj për diskriminim. Në mënyrë që ndërhyrja të kishte qenë e justifikuar, ajo duhet të kishte qenë “në përputhje me ligjin”, pra në pajtueshmëri si me të drejtën ekzistuese vendase, ashtu edhe me nocionet e përgjithshme të shtetit të së drejtës. Për ta plotësuar këtë standard, autoritetet duhet të kishin ofruar një njoftim të përshtatshëm lidhur me rrethanat në të cilat autoritetet kishin fuqinë për të kaluar në masa sekrete kundër qytetarëve. E drejta vendase nuk përmbante dispozita të tilla për thirrjet telefonike të bëra në sistemet e komunikimeve të brendshme.

Sa i përket telefonit të shtëpisë së kërkueses, Gjykata së pari bëri dallimin mes çështjeve *Klass*<sup>[266]</sup> dhe *Malone*<sup>[267]</sup> për faktin se të drejtat e Nenit 8 nuk kërcënoheshin nga thjesht ekzistenca e masave të vëzhgimit të fshehtë; përkundrazi, ajo supozohej se i ishte nënshtruar këtyre masave në mënyrë të paligjshme. Megjithatë, Gjykata gjeti se provat e kërkueses për ndërhyrjen tek telefoni i saj i shtëpisë ishin spekulative dhe të pamjaftueshme për të konstatuar gjasat e arsyeshme të ndërhyrjes.

Ndërkohë që telefonat e shtëpisë dhe zyrës së kërkueses njësoj ishin të mbrojtur nga Neni 8, Gjykata mundi të gjente vetëm një gjasë të arsyeshme të ndërhyrjes tek telefoni i saj i zyrës. Në mungesë të standardeve që parandalonin abuzimin e pushtetit në lidhje me thirrjet e saj të zyrës, Gjykata gjeti se përgjimet nuk ishin në përputhje me ligjin, në shkelje të të drejtave të kërkueses nga Neni 8 për jetë private dhe familjare.

---

[266] *Klass dhe të Tjerë k. Gjermanisë*, vendimi i 8 shtatorit 1978, Nr. 5029/71, gjithashtu i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim.

[267] *Malone k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i 2 gushtit 1984, Nr. 8691/79, gjithashtu i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim.

### Neni 13

Gjykata njohu se kërkueses i takonte një zgjidhje efektive për shkeljen e të drejtave të saj nga Neni 8, në lidhje me përgjimin e thirrjeve të saj telefonike. Për shkak se nuk kishte ligje vendase që rregullonin përgjimin e telefonatave të bëra në sistemet e brendshme të komunikimit në përgjithësi, e as ato që operoheshin nga autoritetet publike si policia e Meyerside, kërkuesja nuk pati mundësinë që të kërkonte zgjidhje ligjore.

Meqenëse ngjarja kishte të bënte me telefonatat e shtëpisë së kërkueses, Gjykata tërhoqi vëmendjen ndaj faktit se një "ndërhyrje" brenda kuptimit të Nenit 8 kërkonte gjasa të arsyeshme që kërkuesja kishte qenë objekt i vëzhgimit. Gjykata përsëriti se ajo kishte gjetur më parë që provat e kërkueses në këtë aspekt ishin të pamjaftueshme.

Prandaj, Gjykata nuk gjeti shkelje të së drejtës së kërkueses nga neni 13 për zgjidhje efektive në lidhje me ankesën e kërkueses për telefonatat e shtëpisë, por gjeti se kishte pasur shkelje në lidhje me përgjimin e telefonatave të saj të zyrës.

### Nenet 10 dhe 14

Gjykata konsideroi se pretendimet e kërkueses në lidhje me Nenet 10 dhe 14 ishin duplifikim i ankesave të saj nga Neni 8, dhe prandaj e gjeti të panevojshme që t'i shqyrtonte ato ndaras.

### Neni 50 (tani Neni 41)

Gjykata i caktoi kërkueses 10,600 Euro në lidhje me dëme materiale dhe jomateriale, dhe 25,000 Euro për kosto dhe shpenzime.

*Pusheteti praktikisht i papenguar i ushtruar nga shërbimet sekrete kombëtare gjatë një operacioni vëzhgimi, dhe mbajtja e të dhënave sipas rregullave konfidenciale, përbënë shkelje të së drejtës së kërkuesit për respekt të jetës private sipas Nenit 8*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **HAŠČÁK k. SLLOVAKISË**

(Kërkesat Nr. 58359/12, 27787/16 dhe 67667/16)

**23 qershor 2022**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1969 dhe jetonte në Bratislavë. Tre aplikimet vinin nga fakte të ndryshme të lidhura me një operacion vëzhgimi për korrupsion të zhvilluar në vitet 2005 dhe 2006 nga Shërbimet Sekrete të Sllovakisë (slllov. SIS), të cilat ishin autorizuar nga dy urdhra të lëshuara nga Gjykata Rajonale e Bratisllavës (slllov. BRC). Vëzhgimi u zhvillua me qëllim të monitorimit të veprimeve private të z. Zoltán Varga dhe një bashkëpunëtori pa emër, për të cilin kërkuesi tha se ishte ai vetë. Në vitin 2011, ekzistenca e atij operacioni u bë publikisht e njohur me kodin "Gorilla" kur një pjesë e materialit që supozohej të ishte i lidhur me operacionin u postua në mënyrë anonime në internet. Gjykata vendosi në lidhje me pretendimet e ndërlidhura të bëra nga z. Varga në *Zoltán Varga k. Sllovakisë*.<sup>[268]</sup>

Në vitin 2012, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë vendosi në favor të z. Varga në një padi që ai ngriti në lidhje me hetimet "Gorilla", duke anuluar më pas urdhrat fillestarë për shkak se hetimet e zhvilluara gabim nga BRC-ja rezultuan me shkelje të të drejtave të z. Varga për privatësi. Materialet e para faktike të vëzhgimit supozohej të ishin fshirë tashmë qysh prej vitit 2008, por materialet vijuese, të cilat mund të kishin përfshirë përmbledhje, shënime dhe analiza, vazhduan të ruheshin nga SIS – një ruajtje për të cilën Gjykata Kushtetuese vendosi se ajo nuk kishte juridiksion për ta ndryshuar. Me ligj, në materialet vijuese mund të kishte qasje vetëm një gjykatë kompetente.

Kur materialet e hetimeve Gorilla u postuan anonimisht online në vitin 2011, kërkuesi tha se emri i tij përmendej mbi 800 herë në ato materiale. Ai bëri kërkesë pranë organeve të ndryshme qeveritare për fshirjen e të gjitha materialeve lidhur me hetimet, çka që e kotë sepse në hierarki nuk kishte asnjë organ më të lartë se

---

[268] *Zoltán Varga k. Sllovakisë*, vendimi i 20 korrikut 2021, Nr. 58361/12, 25592/16 dhe Nr. 27176/16.

SIS. Disa muaj më pas, Ministri i Brendshëm informoi publikun se hetimet Gorilla ishin në fakt hetime të SIS-it dhe se një pjesë e materialeve online ishin verifikuar se vinin nga ato hetime. Qeveria në mënyrë të përsëritur përditësonte publikun në lidhje me statusin e hetimeve në vazhdim për çështje korrupsioni publik. Kundër kërkuesit nuk u ngrit asnjë akuzë formale. Përmes procedurave të ndryshme ligjore vendase, kërkuesi kontestoi në mënyrë të përsëritur vendimin e Shtetit për ta përfshirë atë në mënyrë arbitrare në hetime, dhe kërkoi qasje në fshirjen e materialeve të vëzhgimit që e përfshinin atë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur në Nenin 6 (e drejta për gjyq të drejtë) dhe Nenin 8 (e drejta për respekt të jetës private), kërkuesi u ankua, në mënyrë të veçantë, se kishte pasur mungesë të mbikëqyrjes dhe shqyrtimit efektiv të zbatimit të atyre dy urdhrave për vëzhgim, se korniza e aplikueshme nuk ofronte mbrojtje për individët që rastësisht prekeshin nga masat e vëzhgimit, dhe se rregullat e brendshme të aplikueshme për ruajtjen e materialeve sekrete ishin të papërshtatshme.

### Neni 8

Së pari, duke pasur parasysh fushëveprimin e çështjes, Gjykata theksoi se ajo nuk përfshinte ndonjë ankesë për rrjedhje informacionesh nga SIS dhe as ndonjë ankesë në lidhje me statusin praktik dhe procedural të audio-incizimeve të marra nga hetuesit në vitin 2018.

Nuk vihej në diskutim se kërkuesi i ishte nënshtruar vëzhgimit mbi bazën e dy urdhrave dhe se një pjesë e materialeve të dala nga zbatimi i tyre, të cilat së paku pjesërisht kishin të bënin me vetë kërkuesin, vazhduan të mbaheshin nga SIS dhe BRC në kohën e vendimit të Gjykatës. Gjykata gjeti se zbatimi i urdhrave dhe mbajtja e materialeve të mbledhura ishte ndërhyrje tek e drejta e kërkuesit për jetë private brenda kuptimit të paragrafit 1 të Nenit 8.

Për të përcaktuar nëse ndërhyrja ngërthente shkelje të Nenit 8 të Konventës, Gjykata u desh të shqyrtonte nëse ajo ishte "në përputhje me ligjin", nëse synonte një ose disa qëllime legjitime ashtu siç përkufizohen në paragrafin e dytë të atij Neni, dhe nëse ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për të arritur një qëllim të tillë apo qëllime të tilla. Sa i përket frazës "në përputhje me ligjin", praktika gjyqësore e Gjykatës kërkon që të shqyrtohet nëse ndërhyrja ka qenë në përputhje me të drejtën vendase dhe nëse vetë e drejta vendase është në

pajtueshmëri me shtetin e së drejtës. Për të qenë në pajtueshmëri me shtetin e së drejtës, ligjet duhet të ofrojnë masa mbrojtjeje ligjore kundër ndërhyrjes arbitrare nga autoritetet publike me të drejtat e mbrojtura nga paragrafi 1 i Nenit 8. Pushteti ekzekutiv i ushtruar në mënyrë sekrete përbën rrezik për administrim arbitrar. Meqenëse zbatimi në praktikë i masave të vëzhgimit sekret nuk është i hapur për këqyrje nga individët e përfshirë ose publiku i gjerë, ligji duhet të tregojë fushëveprimin e çdo diskrecioni të tillë dhënë autoriteteve kompetente dhe mënyrën e ushtrimit të tij me qartësi të mjaftueshme, duke mbajtur parasysh qëllimin legjitim të masës në fjalë, për t'i dhënë individit mbrojtje të mjaftueshme kundër ndërhyrjes arbitrare ose ushtrimit të papenguar të pushtetit ekzekutiv.

Në lidhje me zbatimin e urdhrave, Gjykata gjeti se përfundimet e nxjerra në çështjen *Zoltán Varga* ishin drejtpërdrejt të aplikueshme në rastin konkret. Si të tilla, Gjykata përcaktoi se – duke parë mungesën e qartësisë së rregullave juridiksionale të aplikueshme dhe mungesën e procedurave për zbatimin e rregullave ekzistuese si dhe mangësitë në zbatimin e tyre (këto mangësi u gjetën nga Gjykata Kushtetuese dhe iu atribuuan BRC-së, gjykatës që kishte lëshuar urdhrat) – gjatë zbatimit të urdhrave SIS praktikisht kishte gëzuar diskrecion që përbëri pushtet të papenguar, i cili nuk kishte qenë i shoqëruar nga masa mbrojtëse ndaj ndërhyrjes arbitrare, çka do të thoshte se zbatimi i urdhrave nuk ishte “në përputhje me ligjin” për qëllimet e Nenit 8 § 2 të Konventës. Situata në rastin konkret u rëndua edhe më tej nga dy faktorë shtesë. Së pari, nuk kishte asnjë tregues se urdhri i vitit 2005 faktikisht kishte kërkuesin në shënjestër, duke çuar drejt mundësisë që ai ishte prekur rastësisht nga ushtrimi arbitrar i pushtetit vëzhgues nga qeveria. Së dyti, kishte një pasiguri themelore të shtrirë në kornizën ligjore lidhur me statusin praktik dhe procedural të materialeve fillestare kinse të rrjedhura nga zbatimi i dy urdhrave.

Në lidhje me depozitimin e materialeve të përfuara nga zbatimi i dy urdhrave, Gjykata edhe një herë gjeti se përfundimet e nxjerra në *Zoltán Varga* ishin drejtpërsëdrejti të aplikueshme në rastin konkret. Si të tilla, Gjykata vendosi që mbajtja e materialeve që janë rezultat i urdhrave nuk ishte bërë “në përputhje me ligjin” sepse mbajtja e materialeve qeverisëj nga rregulla konfidenciale të cilat ishin edhe të miratuara, edhe të zbatuara nga SIS, pa asnjë element kontrolli të jashtëm. Këtyre rregullave u kishte munguar qasshmëria dhe nuk i kishin ofruar kërkuesit asnjë mbrojtje kundër ndërhyrjes arbitrare tek e drejta e tij për respekt të jetës së tij private.

Duke pasur parasysh zbatimin e dy urdhrave dhe mbajtjen nga SIS të materialeve të dala nga zbatimi i këtyre urdhrave, Gjykata gjeti se kishte pasur shkelje të së drejtës së kërkuesit sipas Nenet 8 të Konventës për respekt ndaj jetës së tij private.

#### Neni 6

Në mënyrë që një ankesë të hyjë brenda fushëveprimit të Nenet 6, kërkuesi duhet të ishte akuzuar për veprë penale. Gjykata gjeti se as deklarimet publike të kontestuara, e as ndonjë rrethanë tjetër nuk tregonin se kërkuesi ishte ndodhur në pozitën e një personi të akuzuar për vepra penale. Rrjedhimisht, Gjykata përcaktoi që ankesat e kërkuesit nga Neni 6 ishin jashtë fushëveprimit të Konventës *ratione materiae*.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 9,750 euro në lidhje me dëme jomateriale.

*Incizimi i një bisede duke përdorur pajisje dëgjuese të montuar në trup dhe përgjimi i telefonatave, dhe përdorimi i mëtejshëm i informacionit të marrë gjatë procedurës penale, shkeli Nenin 8 por nuk shkeli Nenin 6*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**HEGLAS K. REPUBLIKËS ÇEKE**

(Kërkesa Nr. 5935/02 )  
**1 mars 2007**

## **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1976 dhe jetonte në Republikën Çeke. Kërkuesi u arrestua dhe u gjet fajtor, bashkë me një tjetër (i referuar si A.M.), për grabitje. Mes provave të tjera, vendimi i Gjykatës së Qytetit të Pragës u bazua mbi (1) një listë telefonatash mes kërkuesit dhe A.M. ("lista e telefonatave"); dhe (2) transkripti i një bisede mes kërkuesit dhe një individi tjetër (A.B.), e cila u incizua nga A.B. duke mbajtur në trup një pajisje dëgjuese të montuar nga policia, gjatë së cilës kërkuesi pranoi që ai kishte organizuar një grabitje me A.M. ("transkripti"). Gjykata e shkallës së parë e përshkroi këtë të fundit si provë thelbësore.

Kërkuesi dhe A.M. apeluan vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke përfshirë bazën e paligjshmërisë së transkriptit dhe listës së telefonatave. Gjykata e Lartë e Pragës i rrëzoi apelet. Gjykata Kushtetuese gjithashtu e rrëzoi apelin e kërkuesit mbi bazën e Neneve 6 dhe 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ajo gjykatë deklaroi, mes konsideratave të tjera, që kërkuesi ishte dënua mbi bazën e disa provave vlerësimi dhe vërtetimi i të cilave ishte jashtë çdo dyshimi.

Gjykata konsideroi se përdorimi i pajisjes dëgjuese nuk ishte i ndaluar sipas Kodit të Procedurës Penale ("KPP"), por se transkripti nuk duhet të ishte përdorur si provë në procedurën penale. Megjithatë, kjo nuk do të thoshte se vendimet e marra në atë procedurë ishin jokushtetuese sepse dënimi i kërkuesit u bazua mbi disa prova.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua që incizimi sekret i bisedës së tij me A.B. dhe përgjimi i listës së telefonatave, dhe përdorimi i mëtejshëm i të dyjave si prova në procedurën penale, shkelën të drejtat e tij sipas Neneve 8 dhe 6 § 1 të Konventës.



## Neni 8

Sa i përket përdorimit të listës së telefonatave mes kërkuesit dhe A.M. (lista e telefonatave), Gjykata konsideroi, në përputhje me praktikën gjyqësore të mëparshme, se përgjimi i fshehtë i telefonatave, përfshirë informacionet mbi datat e telefonatave, numrat e thirrur ose thirrjet e pranuar, dhe kohëzgjatja e bisedave telefonike, angazhonin Nenin 8. Prandaj përdorimi i listës së telefonatave si provë në procedurën penale ndërhyri tek e drejta e kërkuesit për respekt ndaj jetës private sipas Nenit 8.

Çështja kryesore ishte nëse ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin siç kërkohet nga Neni 8 § 2. Gjykata theksoi se përgjimi dhe incizimi i bisedave telefonike ishte urdhëruar nga një gjyqtar i rrethit nga 21 janari deri më 21 shkurt 2000 sipas KPP-së. Lista e telefonatave në fjalë gjithashtu ishte paraqitur me kërkesë të policisë në përputhje me dispozitat e KPP-së dhe Ligjin për Telekomunikime ("Ligji"). Megjithatë, dispozitat përkatëse të KPP-së dhe Ligji nuk kishin hyrë në fuqi në kohën materiale. Neni 88a i KPP-së dhe seksioni 84(7) i Ligjit, dispozitat që autorizojnë autoritetet e hetimeve penale të marrin lista të telefonatave, hynë në fuqi vetëm më 1 janar 2002 dhe 1 korrik 2000, respektivisht.

Më tej, edhe sikur e drejta vendase të parashikonte bazën ligjore për përgjimin e telefonatave, gjykatave vendase u ishte dërguar një listë e telefonatave duke nisur nga 19 janari 2000, pra dy ditë para datave të lejuara në urdhrin e gjyqtarit të rrethit.

Prandaj, ndërhyrja nuk kishte qenë në përputhje me ligjin dhe Neni 8 ishte shkelur. Nuk pati nevojë të konsiderohej nëse ndërhyrja ishte e justifikuar.

Sa i përket incizimit të fshehtë të bisedës mes kërkuesit dhe A.B. dhe përdorimit të mëtejshëm të transkriptit si provë në procedurën penale, Gjykata deklaroi se kjo ndërhyri tek e drejta e kërkuesit për respekt ndaj jetës private sipas Nenit 8.

Gjykata konsideroi se incizimi dhe përdorimi i transkriptit nuk ishte i autorizuar me një ligj që plotësonte kriteret e parashtruara nga praktika gjyqësore e Gjykatës. Incizimi ishte ndërmarrë sipas një praktike e cila nuk mund të shihej si e tillë që kishte ndonjë bazë ligjore specifike me kushte mjaft ueshëm të sakta se kur mund të ndodhte një ndërhyrje e tillë, përfshirë aspekte të pranueshmërisë, fushëveprimi, kontrollimit dhe përdorimit të informacioneve të mbledhura.

Gjykata arriti në përfundimin që nuk ishte demonstruar se ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin, dhe Neni 8 ishte shkelur. Nuk pati nevojë të konsiderohej nëse ndërhyrja ishte e justifikuar.

## Neni 6

Kërkuesi deklaroi se përdorimi i transkriptit dhe listës së telefonatave si prova në procedurën penale ndërhyri tek e drejta e tij për gjyq të drejtë. Ai theksoi se Gjykata Kushtetuese vendase kishte gjetur në një çështje tjetër se ishte e paligjshme të përdorej si provë një listë që përmbante informacione për telefonata.

Gjykata kujtoi, duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore të mëparshme, që, megjithëse Neni 6 garanton të drejtën për gjyq të drejtë, ai nuk rregullon pranueshmërinë e provave që është kryesisht për të drejtën vendase. Prandaj, Gjykata në parim nuk deklarohet në lidhje me pranueshmërinë e disa llojeve të caktuara të provave, përfshirë provat që mund të jenë përfutuar në mënyrë të paligjshme sipas të drejtës vendase. Përkundrazi, Gjykata shqyrton nëse procedura, përfshirë mënyrën se si janë përfutuar provat, ka qenë e drejtë në tërësi. Kjo kërkon shqyrtimin e paligjshmërisë në fjalë dhe, kur është e aplikueshme, natyrën e çdo shkeljeje të një të drejte tjetër të Konventës. Kështu, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse janë respektuar të drejtat e të akuzuarit për mbrojtje, përfshirë nëse të akuzuarit i është ofruar mundësia për të vënë në pyetje autenticitetin e provave dhe për të kundërshtuar përdorimin e tyre në procedurë. Interesi publik në ndjekjen penale të veprës dhe sanksionin penal po ashtu mund të merren në konsideratë dhe të balanohen kundrejt interesit të të akuzuarit. Megjithatë, interesi publik nuk mund të justifikojë masat që dëmtojnë vetë thelbin e të drejtës për gjyq të drejtë.

Në rastin konkret, Gjykata theksoi se para gjykatës së shkallës së parë, dhe më tej para Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi pati mundësinë të bënte të gjitha vërejtjet e nevojshme në lidhje me transkriptin dhe listën e telefonatave. Prandaj, kërkuesi ishte dënuar pas procedurave bazuar mbi parimin e kontradiktorialitetit. Për më tepër, transkripti dhe lista e telefonatave, sado që u konsideruan si provat më të rëndësishme ose esenciale nga gjykata e shkallës së parë, nuk ishin provat e vetme mbi bazën e të cilave gjykata e kishte marrë vendimin e saj. Në lidhje me interesin publik në përdorimin e provave të tilla për të arritur dënimin e kërkuesit, Gjykata vuri në dukje se masat ishin marrë kundër një personi që kishte kryer një veprë të rëndë dëmtuese, dhe i cili më pas kishte marrë një dënim me nëntë vite burgim.

Gjykata doli në përfundimin se përdorimi i transkriptit dhe listës së telefonatave në procedurat penale vendase nuk kishte shkelur të drejtën e kërkuarit për gjyq të drejtë.

#### Neni 41

Gjykata nuk i caktoi kërkuarit dëmshpërblim për dëme materiale ose jomateriale, dhe konsideroi që gjetjet e shkeljeve përbënin shpërblim të drejtë të mjaftueshëm. Gjykata i caktoi kërkuarit 1,018 euro për kosto dhe shpenzime.

*Një urdhër për anonimizimin e identitetit të një shkelësi në arkivat elektronike të një gazete mbi bazën e “të drejtës për t’u harruar” nuk shkeli Nenin 10*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN **HURBAIN K. BELGJIKËS**

(Kërkesa Nr. 57292/16)  
**4 korrik 2023**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1959 dhe jetonte në Belgjikë. Ai ishte botuesi i *Le Soir*, një gazetë e përditshme belge. Një kopje e shtypur e *Le Soir* e vitit 1994 përmbante një artikull në lidhje me disa aksidente me makinë, përfshirë një aksident që kishte shkaktuar vdekjen e dy personave dhe lëndimin e tre të tjerëve (artikulli). Artikulli përmendte emrin e plotë të shoferit përgjegjës (referuar si G). G u dënua në vitin 2000. Ai vuajti dënimin e tij dhe u rehabilitua në vitin 2006.

Në vitin 2008, *Le Soir* vendosi në uebfaqen e vet një version elektronik të arkivave të saj, përfshirë artikullin në fjalë. Në vitin 2010, G i kërkoi *Le Soir* që ta hiqte artikullin nga arkivat elektronike ose të paktën ta anonimizonte atë, gjë që *Le Soir* refuzoi ta bënte. Kërkesa e G përmendte profesionin e tij si mjek dhe faktin që artikulli paraqitej në mesin e rezultateve kur futej emri i tij në makinën e kërkimit në internet. Më pas G nisi procedurë kundër kërkuesit, në cilësinë e tij si botues i *Le Soir*, duke kërkuar të fitonte anonimizimin e artikullit. Procedura bazohej tek e drejta për jetë private, e cila sipas ligjeve belge përfshinte “të drejtën për t’u harruar”.

Në vitin 2013, gjykata belge e shkallës së parë aprovoi shumicën e pretendimeve të G. Në vitin 2014, Gjykata e Apelit në Liège e konfirmoi këtë. Apeli i kërkuesit pranë Gjykatës së Kasacionit u rrëzua në vitin 2016. Gjykatat vendase sollën urdhra që kërkuesit të kërkuesit të anonimizonte artikullin.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua që vendimet civile që e urdhëruan të anonimizonte versionin e arkivuar të artikullit shkelën të drejtat e tij sipas Nenit 10 të Konventës. Në vendimin e tij të 22 qershorit 2021, një Dhomë e Gjykatës deklaroi se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 10. Me kërkesë të kërkuesit, sipas Nenit 43, çështja u referua Dhomës së Madhe.

## Neni 10

Nuk u vu në diskutim që urdhri i anonimizimit ndërhyri tek Neni 10. Dhoma e Madhe gjithashtu që dakord me gjetjet e Dhomës që ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin. Nuk u diskutua nga palët që ndërhyrja kishte qëllim legjitim, pra të drejtën e G për respekt ndaj jetës private sipas Nenit 8. Prandaj Gjykata u fokusua në pyetjen nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Gjykata u mor vetëm me versionin e artikullit të vendosur në uebfaqen e *Le Soir*. Në pyetje ishte qenia e vazhdueshme e informacionit në internet, e jo publikimi i tij origjinal *per se*. Gjykata gjithashtu theksoi se artikulli origjinal i shtypur ishte publikuar në mënyrë të ligjshme dhe jo shpifëse.

Gjykata përsëriti praktikën e saj gjyqësore në lidhje me rëndësinë e lirisë së shprehjes dhe rolin e shtypit, ku përfshihet mbajtja e arkivave të lajmeve. Arkivat dixhitale / në internet japin kontribut të madh në ruajtjen dhe vënien në dispozicion për publikun të lajmeve dhe informacioneve, dhe janë burim i rëndësishëm për edukimin dhe hulumtimet historike. Në përgjithësi, arkivat duhet të mbeten autentike, të besueshme dhe të plota. Kjo kërkon që shtypi të ketë regjistra të plotësuar. Gjykata konsideroi se integriteti i arkivave të shtypit dixhital duhet të jetë parimi udhëheqës në çdo kërkesë për heqjen ose modifikimin e të gjithë ose një pjese të një artikulli të arkivuar, sidomos nëqoftëse ligjshmëria e artikullit nuk është vënë kurrë në diskutim.

Në lidhje me “të drejtën për t'u harruar”, Gjykata njohu se një individ i cili është objekt i një artikulli online ka interes që informacionet në artikull të hiqen ose të modifikohen, ose të kufizohet qasja ndaj tyre. Informatat personale që ndodhen në internet për një kohë mund të kenë impakt negativ të gjerë, p.sh. në opinionin publik ose kur një individ aplikon për punë. “E drejta për t'u harruar” është ndërlidhur në praktikën gjyqësore të Gjykatës me Nenin 8, pra me respektimin e reputacionit. Ajo nuk është e drejtë vetqëndruese në Konventë dhe mbulohet vetëm nga Neni 8 në situata të caktuara dhe në lidhje me informata të caktuara.

Gjykata gjithashtu konsideroi praktikën më të gjerë gjyqësore në lidhje me “të drejtën për t'u harruar”, përfshirë në sistemet ligjore kombëtare dhe në të drejtën e Bashkimit Evropian (BE). Në lidhje me të drejtën e BE-së, Gjykata vuri në dukje

vendimet e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian në *Google Spain*<sup>[269]</sup>, dhe çështjet e mëvonshme për “të drejtën për t'u harruar”, kryesisht në lidhje me veprimet e kryera nga një makinë kërkimi në internet. Gjykata, mes të tjerash, përmendi se si vendimi në *Google Spain* e theksonte rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale, impaktin e qenies së vazhdueshme të informatave online mbi jetën private të një individi, dhe efektin amplifikues të makinave të kërkimit në internet, si dhe konsideratat e ndryshme që mund të aplikohen tek kërkesat ndaj makinave të kërkimit kundrejt atyre ndaj publikuesit të uebfaqes.

Gjykata konsideroi që, duke pasur parasysh faktin se çështja në fjalë kishte të bënte me një artikull të arkivuar elektronikisht e jo me publikimin origjinal, kriteret e zhvilluara më parë për adresimin e një konflikti mes të drejtave nga Nenet 10 dhe 8 duhet të ristemosheshin. Në kontekstin e një kërkese për modifikimin e përmbajtjes gazetareske të arkivuar online, duhet të merren në konsideratë kriteret në vijim: “(i) natyra e informacionit të arkivuar; (ii) koha që ka kaluar prej ngjarjes dhe publikimit fillestar dhe atij online të lajmit; (iii) interesi bashkohor për informacionin; (iv) nëse personi që synon të drejtën për t'u harruar është i mirënjohur dhe sjellja e tij/saj që nga koha e ngjarjes; (v) pasojat negative të vazhdimit të qenies së informacionit online; (vi) shkalla e qasshmërisë së informacionit në arkivat dixhitale; dhe (vii) impakti i masës mbi lirinë e shprehjes dhe më specifikisht mbi lirinë e shtypit.” Gjykata gjithashtu theksoi se makinat e kërkimit dhe uebfaqja e publikuesit janë forma të ndryshme të procesimit. Ata që kanë të dhënat aty nuk duhet të jenë të detyruar të kontaktojnë uebfaqen për të mund të ushtruar të drejtat e tyre në lidhje me makinat e kërkimit, dhe anasjelltas.

Në rastin konkret, Gjykata përsëriti praktikën e saj gjyqësore në lidhje me hapësirën e vlerësimit që u lihet autoriteteve kombëtare në zgjidhjen e një konflikti mes Neneve 8 dhe 10. Gjykata e Apelit në Liège kishte marrë në konsideratë disa kriteret gjatë arsyetimit të vendimit të saj. Nëqoftëse vlerësimi i asaj gjykate ishte në përputhje me kriteret që Gjykata kishte identifikuar (cekur më lart), aplikimi i të cilave gjithashtu duhet të marrë parasysh karakteristikat specifike të çështjeve lidhur me modifikimin e arkivave online, Gjykata do të kërkonte arsye të forta për të zëvendësuar pikëpamjet e veta me ato të gjykatës vendase.

Sa i përket natyrës së informacionit të arkivuar, ishte e nevojshme të sigurohej nëse informacioni lidhur me jetën private, profesionale ose publike të personit të

---

[269] *Google Spain SL dhe Google Inc. k. Agencia Española de Protección de Datos (AEPD) dhe Mario Costeja González* (vendim i 13 majit 2014, C-131/12, EU:C:2014:317).

përfshirë, dhe nëse kishte impakt social apo hynte brenda sferës intime të jetës private. Megjithëse të dhënat për çështje penale ishin klasifikuar si “të ndjeshme”, Gjykata theksoi se informacioni rreth personit në fjalë është aspekt i rëndësishëm i artikujve të shtypit në lidhje me procedurat penale. Në rastin konkret, Gjykata që dakord me gjetjet e Gjykatës së Apelit në Liège se faktet e raportuara në artikull ishin të natyrës gjyqësore. Kjo sepse faktet e raportuara kishin të bënin me fakte të cilat më pas rezultuan me dënim penal. Megjithatë, Gjykata që e mendimit që faktet nuk hynin në kategorinë e veprave domethënies dhe të cilave, për shkak të peshës së tyre, mbetet e pandryshuar me kalimin e kohës. Gjykata po ashtu vuri në dukje se ngjarja nuk tërhoqi publicitetin të gjerë, ku i vetmi mbulim medial ishte artikulli në fjalë (një faktor të cilin e kishte marrë parasysh edhe Gjykata e Apelit në Liège).

Sa i përket kohës që kishte kaluar që nga ngjarja e ndodhur dhe nga publikimi fillestar dhe ai online, relevanca e informacionit do të ndërlidhej me tematikën e tij. Gjykata që dakord me Gjykatën e Apelit në Liège që kalimi i një periudhe domethënëse të kohës do të ishte relevant. Në rastin konkret, kishin kaluar 16 vjet mes publikimit fillestar të artikullit dhe kërkesës së parë për anonimizim. G ishte rehabilituar në vitin 2006 dhe kishte pasur interes legjitim për t’u ri-integruar në shoqëri.

Sa i përket interesit bashkohor për këtë informacion, këtu mund të përfshihej fakti nëse artikulli vazhonte të kontribuonte një debati të interesit publik, nëse ai kishte ndonjë interes historik, hulumtues apo statistikor, dhe nëse ende ishte relevant për kontekstualizimin e ngjarjeve të kohëve të fundit. Megjithatë, interesi publik nuk barazohet me etjen publike për informacion rreth jetës private të të tjerëve. Në rastin konkret, Gjykata nuk pa arsye të vinte në dyshim vlerësimin e arsyetuar të Gjykatës së Apelit në Liège që artikulli thjesht përbënte një kontribut statistikor në debatin publik rreth sigurisë në rrugë dhe nuk kishte domethënie historike meqenëse lajmi, sado tragjik, nuk ishte pretenduar as treguar të kishte qenë burim i shqetësimit të veçantë publik.

Në lidhje me faktin nëse personi që synon të drejtën për t’u harruar është i mirënjohur, dhe sjellja e tij/saj që nga ngjarja, Gjykata theksoi rëndësinë e këtij kriteri. Shkalla deri ku një individ ka profil publik, vlerësuar në kohën e bërjes së kërkesës, ndikon tek mbrojtja që jepet sipas Nenit 8. Sjellja e një njeriu edhe mund ta justifikojë refuzimin e “të drejtës për t’u harruar” ose mund të peshojë në favor të saj. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit në Liège kishte theksuar se G nuk kishte mbajtur ndonjë post publik, dhe kishte konsideruar që thjesht fakti që

G ishte mjek nuk e justifikonte identifikimin e tij të vazhduar në artikull. Gjykata që dakord me Gjykatën e Apelit në Liège, dhe gjithashtu theksoi se G nuk ishte figurë publike, çështja nuk kishte tërhequr publicitet të gjerë, dhe nuk kishte asgjë që sugjeronte se G kishte tentuar të publicizonte situatën e tij; përkundrazi, e tërë sjellja e G tregonte dëshirën për të qëndruar jashtë vëmendjes së mediave.

Në lidhje me pasojat negative të qenies së vazhdueshme të informacionit online, një person që kërkon modifikimin e një artikulli të ruajtur në arkivat dixhitale duhet të jetë në gjendje të ngrejë pretendim substancial për dëme serioze ndaj jetës së vet private. Në aspektin e informacionit gjyqësor, impakti i qenies së vazhdueshme të informacionit tek ri-integrimi i personit në shoqëri është relevant. Duhet siguruar nëse dënimi i personit është hequr nga dosja penale, megjithëse fakti që personi është rehabilituar në vetvete nuk mund ta justifikojë kërkesën për "të drejtën për t'u harruar". Në rastin konkret, Gjykata e Apelit në Liège kishte theksuar se kërkimet me emrin e G në makinat e kërkimit në internet rezultojnë me artikullin në fjalë. Kjo e bënte të lehtë gjetjen e informacioneve rreth dënimit të G nga një publik i gjerë dhe, meqenëse G ishte mjek, ku publik përfshinte pacientë, kolegë dhe të njohur. Kjo, sipas mendimit të Gjykatës së Apelit në Liège ishte pa dyshim burim dëmsh për G. Gjykata nuk pa arsye të forta për të vënë në dyshim vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Apelit në Liège në lidhje me këtë kriter.

Në lidhje me shkallën e qasshmërisë së informacionit në arkivat dixhitale, Gjykata përsëriti se, ndërkohë që faqet e internetit janë mjet informacioni dhe komunikimi i ndryshëm nga shtypi dhe me rrezik më të lartë dëmi, në përgjithësi për të gjetur të dhëna në arkiva duhet kërkime aktive në faqe të dedikuara. Megjithatë, në rastin konkret, ashtu siç kishin theksuar gjykatat vendase, arkivat dixhitale të *Le Soir* ishin në dispozicion falas dhe të gjithë kishin qasje në to. Prandaj Gjykata nuk pa arsye të fortë për të vënë në dyshim vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Apelit në Liège që, duke pasur parasysh shkallën e lartë të qasshmërisë, prania e vazhdueshme e artikullit në arkiva pa dyshim që e dëmshme për G.

Në lidhje me impaktin e masës tek liria e shprehjes dhe liria e shtypit, Gjykata përmendi zhvillimin masave të ndryshme që kishin për qëllim mbrojtjen e reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve në lidhje me informacionin në sferën dixhitale. Duke pasur parasysh rëndësinë e integritetit të arkivave dixhitale të shtypit, duhet t'i jepet preferencë masës që më së miri i përshtatet qëllimit të synuar, me supozimin që është e justifikuar, dhe më së paku kufizuese për lirinë e shtypit. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit në Liège kishte gjetur se mënyra më efektive për mbrojtjen e privatësisë së G, pa ndërhyrë në mënyrë joproporcionale



tek liria e shprehjes së kërkuesit, ishte anonimizimi i artikullit. Mënyrat e tjera (si shtimi i informacioneve në artikull ose t'u kërkohet makinave të kërkimit që të hiqin nga lista) ishin ose të papërshtatshme, ose të pamundura, ose nuk ishin kërkuar nga kërkuesi në gjykatat më të ulëta. Gjykata po ashtu theksoi praktikën e kaluar gjyqësore që njihte se anonimizimi është përgjithësisht më pak i dëmshëm ndaj lirisë së shprehjes sesa heqja e krejt artikullit. Më tej, Gjykata e Apelit në Liège ishte kujdesur që të bënte vlerësimin e pasojat e masës për G, për publikun dhe për kërkuesin. Ajo gjykatë gjithashtu kishte marrë parasysh rëndësinë që duhet t'i jepet integritetit të arkivave. Gjykata shtoi se vendimi i Gjykatës së Apelit në Liège ishte për anonimizimin vetëm të versionit të arkivuar online, ku arkiva e shtypit në letër mbetej e paprekur dhe mund të konsultohet nga kushdo.

Sa i përket efektit të mundshëm pengues tek liria e shtypit, Gjykata konsideroi se detyrimi për të anonimizuar një artikull që ishte publikuar në mënyrë të paligjshme në parim mund të hyjë brenda detyrave dhe përgjegjësi të shtypit. Sidoqoftë, nuk dukej se urdhri i anonimizimit e kishte dëmtuar aftësinë e *Le Soir* për të performuar detyrat e veta gazetareske.

Gjykata arriti në përfundimin se, duke pasur parasysh hapësirën e gjerë të vlerësimit, gjykatat kombëtare kishin balancuar me kujdes të drejtat në fjalë në përputhje me Konventën dhe kishin marrë parasysh, në mënyrë koherente, kriteret relevante. Gjykatat vendase kishin konkluduar se ndërhyrja tek liria e shprehjes së kërkuesit ishte kufizuar me aq sa ishte rreptësisht e nevojshme, dhe në rrethanat e rastit në fjalë mund të shihej si e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe proporcionale. Gjykata nuk pa arsye të fortë për të zëvendësuar pikëpamjet e saj me ato të gjykatave kombëtare ose për të shpërfillur rezultatin e balancimit të bërë prej tyre.

*Masat e vëzhgimit sekret nuk shkelën të drejtën për respekt ndaj jetës private; kufizimet në procedurën e kontestimit të këtyre masave nuk shkelën të drejtën për proces të rregullt*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**KENNEDY k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa Nr. 26839/05)  
**18 maj 2010**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1946 dhe jetonte në Mbretërinë e Bashkuar. Ai pretendoi se komunikimet e tij të biznesit, ato me telefon dhe email ishin duke u përgjuar nga agjencitë e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, dhe se kjo ishte për shkak se ai kishte qenë objekt i një çështjeje penale të profilit të lartë dhe më pas kishte ngritur zërin kundër gabimeve gjyqësore.

Kërkuesi nisi procedurën pranë Tribunalit të Fuqive Hetimore (ang. IPT) duke u ankuar se komunikimet e tij po përgjoheshin. Ai gjithashtu kërkoi që procedura të zhvillohej në mënyrë që të sigurohej paanësia e saj, përfshirë një seancë dëgjimore orale në publik, dhe inspektimin e ndërsjellë të deklaratave të dëshmitarëve dhe provave mes palëve.

IPT mori vendim që nuk ishte bërë asnjë përcaktim në favor të kërkuesit, që do të thotë se ose nuk kishte pasur përgjime, ose përgjimet kishin qenë të ligjshme.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankuar se përgjimet e pretenduara të komunikimeve të tij kishin shkelur të drejtat e tij sipas Nenit 8 të Konventës. Më tej ai u ankuar se regjimi legjislativ i Mbretërisë së Bashkuar, pra Ligji për Rregullimin e Fuqive Hetimore i vitit 2000 (ang. RIPA), nuk ishte në përputhje me Nenin 8. Përveç kësaj, ai u ankuar se seanca dëgjimore para IPT-së nuk kishte pasur mbrojtje të mjaftueshme dhe kështu kishte shkelur të drejtat e tij sipas Nenit 6 për proces të rregullt. Gjithashtu ai u ankuar se atij i ishte mohuar zgjidhja e drejtë, siç kërkohet nga Neni 13.

## Neni 8

Gjykata së pari vendosi që ankesat në lidhje me Nenin 8 ishin të pranueshme, edhe pse kërkuesi dështoi të paraqiste argumente lidhur me përputhshmërinë e tërësishme të RIPA-s me Konventën para IPT-së. Në mënyrë që Shteti të pretendojë mos-shterimin e zgjidhjeve, ai duhet ta bindë Gjykatën që zgjidhja e propozuar ka qenë efektive. Megjithëse IPT mund të kishte marrë një vendim të përgjithshëm publik në lidhje me përputhshmërinë e RIPA-s me Konventën, nuk ishte e qartë së çfarë përfitimi do të sillte një vendim i tillë, nëse mund të kishte ndonjë përfitim, meqenëse dispozitat e RIPA-s ishin legjislacioni primar. Prandaj, kërkuesi nuk ishte i detyruar ta sillte ankesën e tij para IPT-së në lidhje me përputhshmërinë e përgjithshme të RIPA-s me Nenin 8.

Gjatë shqyrtimit të themeleve të ankesës së kërkuesit, Gjykata përsëriti se kur kërkuesit ankohen që komunikimet e tyre janë përgjuar, Gjykata duhet të bindet se ekzistojnë gjasa të arsyeshme që një gjë e tillë ka ndodhur vërtet. Gjykata e bën vlerësimin e saj nën dritën e të gjitha rrethanave, dhe provat direkte që vëzhgimi ka ndodhur nuk kërkohen me domosdo. Kur Gjykata shqyrton nëse një kërkues mund të pretendojë ndërhyrje për shkak të legjislacionit që lejon vëzhgimin, Gjykata duhet të konsiderojë ekzistencën e ndonjë zgjidhjeje dhe rrezikun që masat sekrete të vëzhgimit t'i jenë aplikuar kërkuesit. Kur nuk ekziston mundësia e kontestimit të kërkesës së pretenduar për masa sekrete vëzhgimi në nivel vendi, edhe kur rreziku faktik i vëzhgimit është i vogël, ka nevojë për më shumë këqyrje nga Gjykata.

Në rastin konkret, ankesat e kërkuesit që thirrjet nuk i ishin transferuar atij dhe se ai kishte marrë thirrje fallso nuk dëshmuan gjasa të arsyeshme që kishte pasur në fakt përgjim të komunikimeve. Megjithatë, duke marrë parasysh pretendimet e kërkuesit që përgjimi po bëhej për ta frikësuar atë, nuk mund të përjashtohet se ai i ishte nënshtruar, ose ishte në rrezik t'i nënshtronte, masave të vëzhgimit sekret.

Sa i përket justifikimit për ndërhyrjen, Gjykata theksoi se Shtetet gëzojnë një hapësirë vlerësimi. Megjithatë, Gjykata ka rol mbikëqyrës në përcaktimin nëse procedurat e mbikëqyrjes së urdhërimit dhe zbatimit të masave të përgjimit janë të mjaftueshme për ta mbajtur "ndërhyrjen" të kufizuar deri aty sa është "e nevojshme në një shoqëri demokratike".

Gjykata theksoi se ndërhyrja, nëse do të ndodhte, do të synonte qëllimet legjitime të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe mirëqenies ekonomike të vendit si dhe parandalimin e krimeve, siç përcaktohej në RIPA, plotësuar nga Kodi i Praktikës së Përgjimit të Komunikimeve (Kodi). Regjimi i Mbretërisë së Bashkuar i përkufizonte me saktësi të mjaftueshme rastet kur lejohej përgjimi; nuk kërkohej një listë shteruese e veprave kundër sigurisë kombëtare ku mund të zhvillohej përgjimi i komunikimeve.

Sa u përket kategorive të personave të shënjestruar, Gjykata theksoi se, megjithëse sipas RIPA-s ishte e mundur që të përgjoheshin komunikimet e çdo personi në Mbretërinë e Bashkuar, në çdo rast kërkohej një urdhër që specifikonte qartë objektin e përgjimeve, qoftë me emër ose me përskrim. Përgjimi pa dallim i komunikimeve të gjerësishme nuk lejohej. RIPA gjithashtu tregonte qartë periudhën kohore deri kur skadonte urdhri dhe kushtet në të cilat urdhri mund të rinovohej, çka po ashtu kërkonte autorizimin e Sekretarit të Shtetit. Kohëzgjatja e masave të përgjimit varej nga kompleksiteti dhe kohëzgjatja e hetimeve, dhe, nëse ekzistonin mbrojtjet e nevojshme, nuk ishte e paarsyeshme që çështja të lihej në diskrecionin e autoriteteve vendase.

Sa i përket procedurës për ekzaminimin, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave, dhe përpunimin dhe komunikimin e materialit të përgjuar, RIPA dhe Kodi përmbanin mbrojtje të shumta. Sipas RIPA-s, të gjitha të dhënat duhet të ruheshin në mënyrë të sigurt, dhe kishte dispozita që rregullonin komunikimin e tyre. Kodi vinte kufizime të ndryshme, përfshirë procedurat për ruajtjen e sigurt të të dhënave, kufizimi i rreptë i numrit të personave të cilëve u zbulohet materiali, kriteri që personat të kalojnë filtrat e sigurisë para se të kenë qasje në të dhëna, kriteri që të dhënat të komunikohen vetëm kur “është e nevojshme të dihen” dhe, ku ka mundësi, kriteri që të zbulohen vetëm përmbledhje të të dhënave. Materiali i përgjuar, dhe çdo kopje, gjithashtu duhet të shkatërrohet sapo të mos kishte më baza për mbajtjen e tij, dhe rishikimi duhet të ndodhte në intervale të përshtatshme.

Gjithashtu, regjimi i RIPA-s kishte mbikëqyrje të mjaftueshme. Një Komisioner i Përgjimit të Komunikimeve, i cili ishte i pavarur nga ekzekutivi dhe legjislativi, kishte detyrën e mbikëqyrjes së funksionimit të përgjithshëm të regjimit të vëzhgimeve dhe autorizimit të urdhrave të përgjimit në raste specifike. Çdo person që dyshonte se komunikimet e tij ishin përgjuar ose ishin duke u përgjuar mund të bënte kërkesë në adresë të IPT-së, i cili gjithashtu ishte organ i pavarur dhe i paanshëm, dhe i cili kishte qasje në materialet e mbyllura.

Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se e drejta vendase tregonte me qartësi të mjaftueshme procedurat për autorizimin dhe procesimin e urdhrave të përgjimit si dhe procesimin, komunikimin dhe shkatërrimin e çdo materiali të mbledhur nga përgjimet. Po ashtu, nuk kishte prova të ndonjë mangësie domethënëse në aplikimin dhe operimin e regjimit të përgjimeve. Duke pasur parasysh mbrojtjet ekzistuese, çdo masë përgjimi, nëse një e tillë ishte zbatuar ndaj kërkuesit, do të kishte qenë e justifikuar sipas Nenit 8 § 2.

### Neni 6 § 1

Gjykata së pari konsideroi që, në rastin konkret, nuk ishte e nevojshme që ajo të nxirrte një përfundim nëse procedura në fjalë kishte të bënte me "të drejtat dhe detyrimet civile" në mënyrë të atillë që Neni 6 të ishte i aplikueshëm, meqenëse Gjykata konsideroi se rregullat e procedurës së IPT-së ishin në përputhje me kriteret e Nenit 6 § 1.

Gjykata përsëriti që, si në procedura penale ashtu edhe në ato civile, e drejta për procedurë sipas parimit të kontradiktorialitetit mund të kufizohet sipas nevojës kur ka interes publik kundërveprues, siç është siguria kombëtare. Megjithatë, çdo vështirësi shkaktuar kërkuesit duhet të kundërpeshohet mjaftueshëm nga procedura e ndjekur. Gjykata theksoi se nevoja për të mbajtur sekret informacionet e ndjeshme dhe konfidenciale i justifikonte kufizimet në procedurat e IPT-së. Megjithatë, çështja ishte nëse kufizimet, marrë në tërësi, ishin joproporcionale ose nëse dëmtonin thelbin e të drejtës së kërkuesit për gjyq të drejtë.

Gjykata rikujtoi që nuk ekziston një e drejtë absolute për zbulimin e provave relevante. Në rastin konkret, Gjykata qe dakord me qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar që nuk ishte e mundur të zbuloheshin dokumentet e redaktuara ose të emëroheshin avokues të veçantë, sepse një gjë e tillë nuk do ta kishte ruajtur sekretësinë e faktit nëse përgjimet kishin ndodhur apo jo. Detyrimi për të mbajtur seancë dëgjimore nuk është absolut, dhe siguria kombëtare nuk mund të justifikojë përjashtimin e publikut nga procedurat. Detyra për të dhënë arsye po ashtu mund të ndryshojë varësisht nga vendimi dhe rrethanat e çështjes. Në kontekstin e procedurave të IPT-së, Gjykata konsideroi se ishte e mjaftueshme që një ankues të këshillohej se nuk ishte bërë asnjë përcaktim në favor të tij/saj, dhe, nëqoftëse ia dilte me sukses ankuesit gjithashtu i takonte të merrte informacione lidhur me gjetjet e faktit.

Gjykata arriti në përfundimin që kufizimet në procedurën para IPT-së ishin të nevojshme dhe proporcionale me nevojën për të garantuar efikasitetin e regjimit të vëzhgimit sekret dhe nuk dëmtonin thelbin e të drejtës së kërkuesit për proces të rregullt. Me arritjen e këtij përfundimi, Gjykata theksoi shtrirjen e qasjes në IPT për ata/ato që ankohen rreth përgjimeve, duke përfshirë mungesën e barrës së provës për bërjen e ankesës.

### Neni 13

Duke pasur parasysh përfundimet në lidhje me Nenin 8 dhe Nenin 6, Gjykata konsideroi se IPT i ofroi kërkuesit zgjidhje efektive sa i përket ankesës së tij lidhur me përgjimin e pretenduar të komunikimeve të tij. Në lidhje me ankesën e përgjithshme që regjimi shkeli të drejtat e tij sipas Nenit 8, Gjykata përsëriti që Neni 13 nuk kërkon zgjidhje efektive kur shkelja e pretenduar del nga legjislacioni primar. Rrjedhimisht, nuk kishte pasur shkelje të Nenit 13.

*Përdorimi i audio-incizimeve të bëra ilegalisht dhe mungesa e zgjidhjes efektive në vend përbënë shkelje të Neneve 8 dhe 13, por jo të të drejtave të kërkuarit nga Neni 6*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**KHAN K. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa Nr. 35394/97)

**12 maj 2000**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi arriti në aeroportin e Mançesterit në një fluturim nga Pakistani më 17 shtator 1992 bashkë me kushëririn e tij N., i cili u gjet në posedim të heroinës e cila në rrugë kishte vlerën £ 100,000. N u intervistua dhe më pas u arrestua dhe akuzua. Kërkuesit nuk iu gjet drogë, dhe ai u lirua pa akuza. Më 26 janar 1993 kërkuesi vizitoi një mik, B., në Shefiled. B ishte nën hetime për shitblerje të heroinës. Më 12 janar 1993, Kryepolici i South Yorkshire autorizoi instalimin e një pajisjeje dëgjuese në shtëpinë e B, mbi bazën se metodat tradicionale të vëzhgimit nuk kishin gjasë të ofronin prova që ai merrej me heroinë. Përmes pajisjes dëgjuese, policia incizoi një bisedë ku kërkuesi pranoi që ai ishte qenë pjesë e importimit të drogës nga kushëririn e tij N më 17 shtator 1992. Kërkuesi u arrestua më 11 shkurt 1993, dhe ai dhe N u akuzuan së bashku për vepra sipas Ligjit për Menaxhimin e Doganave dhe Akcizave i vitit 1979 dhe Ligjit për Keqpërdorimin e Drogave i vitit 1991. Gjatë gjyqit, kërkuesi pranoi që ai kishte qenë i pranishëm në adresën në Shefiled dhe se zëri i tij ishte një prej atyre të incizuar. Megjithëse Qeveria pranoi se pa incizim nuk kishte argumente kundër kërkuesit, kryetari i trupit gjykues vendosi që prova ishte e pranueshme, dhe më 14 mars 1994 kërkuesi u dënua me tre vjet burgim. Kërkuesi apeloj në Gjykatën e Apelit mbi bazën se prova duhet të ishte konsideruar e papranueshme. Pasi apeli u rrëzua, kërkuesi apeloj pranë Dhomës së Lordëve, e cila po ashtu e rrëzoi apelin e tij.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua se të drejtat e tij nga Neni 8 ishin shkelur me përdorimin e pajisjes së fshehtë të dëgjimit për të incizuar biseda private në shtëpinë e B. Ai gjithashtu u ankua se kishte pasur shkelje të së drejtës së tij për proces të rregullt sipas Nenit 6, mbi bazën se e vetmja provë në rastin e tij ishte materiali që ishte marrë në shkelje të Nenit 8, dhe prandaj nuk ishte në pajtueshmëri me kriterin e "seancës së drejtë". Në fund, kërkuesi u ankua se e drejta e tij për zgjidhje efektive

ishite shkelur, gjë që shkelte Nenin 13, mbi bazën se gjykatat vendase duhet të kishin marrë parasysh që provat ishin marrë duke shkelur Konventën.

### Neni 8

Gjykata deklaroi se çështja kryesore në këtë rast ishte nëse ndërhyrja kishte qenë e justifikuar sipas Nenit 8 § 2, çka do të përcaktohej duke parë nëse ajo plotësonte dy kriteret e të qenit "në përputhje me ligjin" dhe "e nevojshme në një shoqëri demokratike". Gjatë shqyrtimit të këtyre dy kriterëve, Gjykata theksoi se në kontekstin e vëzhgimit të fshehtë nga autoritetet publike e drejta përkatëse vendase duhet të ofrojë mbrojtje kundër çdo ndërhyrjeje arbitrare tek të drejtat e individit sipas Nenit 8. Sipas kriterit të "parashikueshmërisë", ligji po ashtu duhet të jetë mjaftueshëm i qartë aq sa t'i ofrojë publikut tregues të përshtatshëm të rrethanave dhe kushteve në të cilat autoritetet patën të drejtën për të kaluar në përdorimin e masave të fshehta.

Duke u pajtuar me praktikën gjyqësore të kaluar, Gjykata theksoi se në atë kohë nuk kishte sistem statutor në vend për të rregulluar përdorimin e pajisjeve dëgjuese të fshehta, dhe se Udhërrëfyese i Ministrisë së Brendshme (ang. Home Office) nuk ishte as ligjërishit detyrues as i hapur direkt për publikun. Prandaj, Gjykata gjeti se ndërhyrja jo domosdoshmërisht mund të ishte "në përputhje me ligjin", e që për këtë arsye nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej nëse ndërhyrja kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike, dhe që rrjedhimisht kishte pasur shkelje të Nenit 8.

### Neni 6

Së pari, Gjykata theksoi se çështja qendrore në këtë rast ishte nëse procedura në tërësi ishte e drejtë, dhe nuk ishte funksion i Gjykatës të merrej me gabimet e faktit ose ligjit kinse të kryera nga një gjykatë kombëtare nëqoftëse ato nuk kanë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa. Ndërkohë që Neni 6 garanton të drejtën e seancës së drejtë, ai nuk shtron rregulla në lidhje me pranueshmërinë e provave, përfshirë si në rastin konkret provat e marra ilegalisht. Ndryshe nga praktika gjyqësore e mëparshme në raste të ngjashme, instalimi i pajisjes dëgjuese dhe incizimi i bisedës së kërkuesit nuk ishin specifikisht ilegale në sensin që ishin në kundërshtim me të drejtën penale vendase, por në kuptimin që nuk kishte një autoritet statutor për ndërhyrjen tek e drejta e kërkuesit për respekt ndaj jetës private, dhe që prandaj një ndërhyrje e tillë ishte domosdoshmërisht jo "në përputhje me ligjin".



Pas kësaj, Gjykata theksoi se incizimi i bisedës së kërkuesit ishte prova e vetme, dhe se fakti që kërkuesi ishte deklaruar fajtor ishte për shkak të vendimit të gjyqtarit që provat duhet të pranoheshin. Sërish, duke iu referuar praktikës gjyqësore të mëparshme, Gjykata njohu se kërkuesi kishte pasur mundësi të bollshme për të kontestuar autenticitetin dhe përdorimin e incizimit, dhe se në çdo nivel të juridiksionit gjykatat vendase kishin vlerësuar efektin e pranimi të provave në drejtësinë e gjyqit. Gjykata deklaroi se gjykatat vendase kishin pasur diskrecionin dhe mundësinë që ta përjashtonin këtë provë, po qe se pranimi i saj do t'i kishte dhënë shkas padrejtësisë substanciale. Duke pasur parasysh vlerësimin nga gjykatat vendase të drejtësisë së pranimi të provës, Gjykata gjeti se përdorimi i incizimit nuk qe në konflikt me të drejtën për proces të rregullt e garantuar me Nenin 6 § 1, dhe se rrjedhimisht nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6.

### Neni 13

Gjykata së pari njohu se gjykatat në procedura penale nuk ishin në gjendje të ofronin zgjidhje, sepse nuk ishte qëllimi i tyre të merrreshin me substancën e ankesës së Konventës që ndërhyrja tek e drejta për respekt ndaj jetës private të kërkuesit nuk ishte “në përputhje me ligjin”. Gjykata qe dakord me argumentin e kërkuesit se e drejta vendase nuk ishte në gjendje të ofronte zgjidhje praktike dhe efektive siç kërkohet nga Neni 13, dhe iu referua gjetjes së mëparshme nga Komisioni të një shkeljeje të Nenit 13 në rrethana të ngjashme. Pas shqyrtimit të rrugëve të tjera në dispozicion për kërkuesin në lidhje me ankesën e Nenit 8, Gjykata gjeti që sistemi i hetimit të ankesave nuk i plotësonte standardet e kërkuara të pavarësisë për të arritur kufirin e mbrojtjes së mjaftueshme kundër abuzimit të autoritetit duke ofruar kështu zgjidhje efektive brenda kuptimit të Nenit 13. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 13.

### Neni 41

Gjykata konsideroi se gjetja e shkeljes nga Neni 8 në vetvete përbënte shpërblim të drejtë për çdo dëm që mund të kishte pësuar kërkuesi, dhe caktoi një shpërblim prej £ 11,500 për kosto dhe shpenzime.

*Ndërkohë që ata që u prekën nga ekzistenca e fuqive të vëzhgimit sekret mbi qytetarët qenë "viktima" për qëllime pranueshmërie, masa të tilla nuk shkelën Nenet 6, 8 ose 13 të Konventës, meqenëse ofrimi i mbrojtjeve të mjaftueshme kundër abuzimit, dhe nevojshmëria e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, i bënë këto masa të ligjshme dhe proporcionale*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **KLASS DHE TË TJERË K. GJERMANISË**

(Kërkesa Nr. 5029/71)  
**6 shtator 1978**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, shtetas gjermanë, ishin avokatë dhe gjyqtarë. Në qershor 1971, kërkuesit pretenduan para Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut<sup>[270]</sup> (Komisioni) se Neni 10 paragrafi 2 i Grundesgesetz ("Ligji Themelor") dhe Ligji për Kufizimet e Sekretësisë së Korrespondencës, Postës dhe Telekomunikimeve (Gesetz zur Beschränkung des Brief, Post-und Fernmeldegeheimnisses, "G 10") u kishte dhënë pushtet autoriteteve që të monitoronin korrespondencën private të kërkuesve pa paralajmërim, duke përjashtuar kështu mundësinë e kontestimit të masave të tilla, në shkelje të të drejtave të tyre sipas Neneve 6, 8 dhe 13 të Konventës.

Megjithëse nuk u vunë në shënjestër të drejtpërdrejtë të vëzhgimit të Shtetit, kërkuesit theksuan se ata sidoqoftë mund të ishin bërë objekt i pushtimit të korrespondencës së tyre private, në rast se klientët e tyre mund të kishin qenë objekt i vëzhgimit pa dijeninë e kërkuesve. Qeveria nuk e kontestoi që kërkuesit i ishin nënshtruar vëzhgimit të zhvilluar në lidhje me një palë tjetër.

Komisioni i gjeti argumentet e kërkuesve të pranueshme, duke qartësuar se, ndërkohë që kërkuesit vetë mund të mos kenë qenë objekt i shkeljes së pretenduar, ata megjithatë duhet të konsiderohen "viktima" të kësaj sjelljeje dhe të pranohen si të tillë para Gjykatës. Personat që i nënshtrohen masave sekrete nga autoritetet jo gjithmonë njoftoheshin më pas në lidhje me masat e marra kundër tyre. Duke

---

[270] Nga viti 1954 deri në vitin 1998 Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut (Komisioni) veprimi si ndërmjetës mes kërkesave individuale dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Me miratimin e Protokollit 11, Komisioni u shfuqizua, në favor të qasjes së drejtpërdrejtë në Gjykatë.

pasur parasysh këtë fakt, Komisioni gjeti se, ndërkohë që nuk ishte gjithmonë e mundur që kërkuesit të demonstrojnë se të drejtat e tyre ishin shkelur, ata megjithatë duhet ta kenë të drejtën për të bërë kërkesë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Të gjithë kërkuesit u ankuan se dy ligje gjermane që rregullojnë vëzhgimin e komunikimeve private, "Ligji Themelor" dhe "G 10", ishin në kundërshtim me të drejtat e tyre sipas Neneve 6, 8 dhe 13. Më hollësisht, kërkuesit u ankuan se këto dispozita legjislative u lejonin autoriteteve të zhvillonin vëzhgime pa dijeninë e personave të prekur, dhe pa kritere të qarta për njoftimin e personave të shënjestruar pas përfundimit të vëzhgimit, duke përjashtuar efektivisht gjetjen e zgjidhjes para gjykatave.

### Neni 25 (tani Neni 34)

Gjykata filloi duke shqyrtuar statusin e kërkuesve si "viktima" brenda kuptimit të Nenit 25, dhe impaktin e tij mbi pranueshmërinë para Gjykatës. Duke rikujtuar vendosmërinë e Komisionit në lidhje me viktimshmërinë e kërkuesve, Gjykata përsëriti se Neni 25 nuk i lejonte një kërkuesi që të argumentonte *in abstracto* që një ligj ose veprim i Shtetit është në kundërshtim me Konventën.

Megjithatë, Gjykata nënvizoi që Neni 25 ishte thelbësor për makinerinë e zbatueshmërisë së Konventës dhe varej nga qasja individuale në Komision. Më tej, u theksua se vëzhgimi sekret, i cili mbetet i panjohur e rrjedhimisht i pakontestuar, mund të kishte efektin e reduktimit të Nenit 8 në nulitet. Gjykata theksoi se ishte e papranueshme që një individ të privohej nga të drejtat e tij pa zgjidhje thjesht për shkak të mungesës së dijenisë. Duke pasur parasysh këtë parim, Gjykata pranoi që një individ mund të pretendojë me të drejtë se është viktimë e një shkeljeje thjesht mbi bazën e ekzistencës së ligjeve që lejojnë masa sekrete kundër tij.

Gjykata deklaroi se ajo kishte juridiksionin për të vendosur nëse kërkuesit mund të pretendonin se ishin viktima brenda kuptimit të Nenit 25, dhe se ata mund ta ngrinin një pretendim të tillë këtu.

### Neni 8

Gjykata pranoi se bisedat telefonike janë të mbrojtura nga Neni 8 në përgjithësi, dhe se ekzistenca e ligjeve që lejojnë vëzhgimin sekret, pa mbrojtje të

mjaftueshme, përbënte kërcënim potencial për këto mbrojtje. Fuqia shtetërore e vëzhgimit, theksoi Gjykata, tolerohej vetëm kur ishte rreptësisht e nevojshme për mbrojtjen e institucioneve demokratike.

Të gjitha palët e pranuan legjitimitetin e qëllimeve të Qeverisë, pra mbrojtja e sigurisë kombëtare, mbrojtja e të drejtave të të tjerëve, dhe pengimi i krimit. Gjykata nënvizoi se pengimi efektiv i kërcënimeve të reja bashkohore, si avancimet e teknologjisë së spiunazhit dhe rritja e terrorizmit, nganjëherë kërkojnë vëzhgime sekrete. Megjithatë, Gjykata theksoi se këto masa kërcënonin të minonin demokracinë duke dashur ta mbronin atë, dhe se për këtë arsye masat e përshtatshme kundër abuzimit ishin esenciale.

Meqenëse natyra e masave sekrete kërcënonte t'i privonte individët nga e drejta për të kërkuar vetë zgjidhje efektive, Gjykata përcaktoi se ishte kritike që procedurat e vendosura t'i mbronin vetë dhe mjaftueshëm të drejtat individuale. Gjykata i kushtoi vëmendje të veçantë shkallës deri ku ligjet në fjalë ofronin dhe i ravijëzonin mbrojtje të tilla, duke përfshirë përkufizimin e mjaftueshëm të rrethanave në të cilat mund të zhvillohej vëzhgimi, kufizimet e shtrirjes dhe kohëzgjatjes së tij, kufizimet për palët që mund t'i autorizonin vëzhgimet, ekzistenca e mekanizmave të ngritura raportuese për monitorimin e ecurisë dhe fushëveprimit të vëzhgimeve, përpjekjet për të njoftuar subjektet e vëzhgimit pas përfundimit të tij, zgjidhjet në dispozicion për ata që mendonin se ishin shënjestruar ose trajtuar gabim, dhe procedurat për përfundimin e vëzhgimeve që vlerësohej se ishin të tepërta ose shkonin përtej fushëveprimit të ligjit.

Me gjetjen që mbrojtje të tilla ishin të ngritura, mbeti të përcaktohej nëse standardet ekzistuese ishin kufizuese mjaftueshëm për të limituar masat e vëzhgimit për aq sa ishte rreptësisht e nevojshme në një shoqëri demokratike. Në kontekstin e çështjes së kërkuesve, kjo kërkonte vendosjen e një ekuilibri të përshtatshëm mes të drejtave të individit nga Neni 8 dhe nevojshmërisë së vëzhgimit sekret për mbrojtjen e shoqërisë demokratike në tërësi.

Në pikëpamjen e Gjykatës, ky ekuilibër jo domosdoshmërisht u vu në rrezik nga mos-njoftimi. Ndërkohë që kërkuesit konstatuan se mungesa e kontrollit efektiv pas përfundimit të vëzhgimit i bënte të drejtat e Nenit 8 të dukeshin si iluzione, Gjykata u fokusua tek shkalla deri ku masa të tilla mbështeteshin tek sekretësia për të arritur qëllimet e tyre legjitime. Për sa kohë që ndërhyrja tek të drejtat e kërkuesve ishte në përputhje me ligjin dhe proporcionale me qëllimet legjitime të synuara, mungesa e njoftimit të individit në vetvete nuk mund të

ishite në papajtueshmëri, meqenëse sekretësia ishte thelbësore për efikasitetin e "ndërhyrjes". Sidoqoftë, Gjykata deklaroi se personi i prekur duhet të njoftohet pas përfundimit të vëzhgimit, meqenëse një gjë e tillë nuk do të rrezikonte qëllimet legjitime të Shtetit.

Gjetja që masat e vëzhgimit sekret nganjëherë ishin të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare dhe për parandalimin e trazirave, dhe gjetja që ligjet në fjalë përmbanin mbrojtje dhe zgjidhje të mjaftueshme për të shmangur abuzimin e diskrecionit, Gjykata deklaroi se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 8.

### Neni 13

Në përputhje me përfundimet e saj se vëzhgimi sekret nganjëherë mund të jetë i nevojshëm në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare dhe për parandalimin e trazirave ose krimit, Gjykata doli në përfundimin se rrethanat e çështjes së kërkuesve nuk përfshinin shkelje të Nenit 13.

Më tej, Gjykata gjeti se zgjidhjet vendore në dispozicion të kërkuesve sipas ligjeve gjermane, sado të kufizuara në aspektin e efektivitetit, ishin aq efektive sa ç'mund të pritej apo dëshirohej duke pasur parasysh rrethanat.

Gjykata njëzëri deklaroi se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 13.

### Neni 6

Duke marrë parasysh përfundimin e saj se vëzhgimi i Qeverisë nuk shkeli Nenin 8, gjatë shqyrtimit të Nenit 6 Gjykata e pa të nevojshme të bënte dallimin mes fazave para dhe pas njoftimit të përfundimit të vëzhgimit. Në cilido rast, Gjykata theksoi se kërkuesit kishin në dispozicion një sërë zgjidhjesh ligjore kundër shkeljeve të mundshme të të drejtave të tyre, dhe se këto zgjidhje do të shërbenin për të përmbushur kriteret e Nenit 6.

Rrjedhimisht, Gjykata doli në përfundimin se Neni 6 nuk ishte shkelur.

*Publikimi sistematik i të dhënave personale të debitorëve tatimorë, përfshirë adresën e shtëpisë, u gjet se shkeli Nenin 8 të Konventës*

## VENDIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN

### **L.B. k. HUNGARISË**

(Kërkesa Nr. 36345/16)

**9 mars 2023**

#### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1996 dhe jetonte në Budapest.

Që nga viti 1996, sistemi hungarez i administrimit tatimor, Autoriteti Kombëtar i Tatimeve dhe Doganave ("Autoriteti") duhet të publikonte të dhënat që normalisht ishin pjesë e konfidencialitetit të tatimpaguesve në rrethana të jashtëzakonshme kur kjo ishte në interesin publik. Kjo përfshinte rastet kur tatimpaguesit individualë privatë kishin mbledhur borxhe tatimore që e kalonin shumën 10 milionë Fiorinta Hungareze (HUF) (afro 28,000 Euro), ose 100 milionë Fiorinta në rastin e entiteteve ligjore (afro 280,000 Euro).

Në përputhje me s55(3) të Ligjit të Administrimit Tatimor të vitit 2003 ("Ligji i vitit 2003"), Autoriteti Tatimor duhet të publikonte një listë të borxhlinjve kryesorë me të dhëna rreth emrit të tatimpaguesit, adresa e shtëpisë, zyrat e biznesit, numri identifikues tatimor, përveç shumës së borxhit. Kur të merrej vendimi përfundimtar që përcaktonte borxhet nga kuartali i mëparshëm, dispozita gjithashtu kërkonte publikimin e pasojave ligjore kur detyrimet tatimore të urdhëruara nuk paguheshin brenda periudhës kohore të caktuar.

Pas kësaj, Ligji Nr. LXI i vitit 2006 ("Ligji Ndryshues i vitit 2006") shtoi një nënseksion të ri (5) në seksionin s55 të Ligjit për Administrimin Tatimor, i cili kërkonte që listat e borxhlinjve të mëdhenj tatimorë të publikoheshin, me të dhënat e emrin të debitorit (emri i kompanisë) dhe adresën e shtëpisë (zyra e regjistruar) kur borxhi tatimor ishte mbi 10 milionë Fiorinta për një periudhë më të gjatë se 180 ditë.

Më 3 korrik 2013, pas një inspektimi tatimor të kryer më herët gjatë atij viti, Autoriteti Tatimor gjeti se kërkuesi kishte një deficit tatimor domethënës, të reduktuar nga shkalla e dytë e Autoritetit Tatimor pas apelit për 227,985,686 Fiorinta (afro 625,000 Euro), të klasifikuara si borxhe tatimore.

Kërkuesi aplikoi për shqyrtim gjyqësor, megjithatë padia e tij u rrëzua nga Gjykata Administrative dhe e Punës e Rrethinave të Budapestit, meqenëse u gjet se kërkuesit i ishin lëshuar fatura fiktive për një kompani me përgjegjësi të kufizuar në një kohë kur ai nuk kishte më marrëdhënie materiale me të. PAGESA PËR FATURAT FIKTIVE ISHTE BËRË NË LLOGARINË BANKARE TË KOMPANISË, PREJ SË CILËS KËRKUESI KISHTE TËRHEQUR 715,025,000 FIORINTA, PA PAGUAR TATIM NË TË ARDHURA PËR ATË SHUMË. Kompania nuk kishte as personelin e as burimet materiale të nevojshme për të zhvilluar aktivitetet.

Më tej, kërkuesi bëri kërkesë për shqyrtim nga *Kúria* e cila e mbështeti vendimin e shkallës së parë, duke vërtetuar arsyetimin e të dy vendimeve më të ulëta. Në fund, kërkuesi bëri një ankesë kushtetuese e cila u deklarua e papranueshme.

Autoriteti Tatimor publikoi të dhënat personale të kërkuesit, përfshirë emrin dhe adresën e shtëpisë, në listën e tatimpaguesve që kishin detyrime në uebfaqen e tij në kuartalin e fundit të vitit 2014, në përputhje me s55(3) të Ligjit të vitit 2003. Pas kësaj, emri i kërkuesit dhe adresa e shtëpisë së tij u publikuan në uebfaqen e Autoritetit Tatimor, në listën e "borxhlinjve të mëdhenj tatimorë", në përputhje me s55(5) të Ligjit të vitit 2003.

Më 16 shkurt 2016, një portal mediatik online publikoi një hartë interaktive të titulluar "harta kombëtare e borxhlinjve tatimorë". Këtu, adresa e shtëpisë së kërkuesit tregohet me një pikë të kuqe, krahas adresave të borxhlinjve të tjerë. Një klikim mbi pikën e kuqe zbulonte informatat personale të kërkuesit (emrin dhe adresën e shtëpisë), duke i bërë këto të dhëna të hapura për të gjithë lexuesit.

Më 5 korrik 2018, të dhënat personale të kërkuesit u hoqën nga lista e borxhlinjve të mëdhenj tatimorë kur borxhi i tij u vjetërsua për shkak të periudhës kohore.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua se publikimi i emrit të tij dhe adresës së shtëpisë në listën e borxhlinjve të mëdhenj tatimorë në uebfaqen e Autoritetit Tatimor kishte shkelur të drejtën e tij për respekt ndaj jetës së tij private sipas Nenit 8 të Konventës, në shkelje të së drejtës së tij për mbrojtjen e të dhënave të tij personale. Në vendimin e saj të datës 12 janar 2021, Gjykata deklaroi se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 8. Me kërkesë të kërkuesit, në përputhje me Nenin 43 të Konventës, çështja iu referua Dhomës së Madhe.

## Pranueshmëria

Dhoma e Madhe e kufizoi shtrirjen e shqyrtimit të saj për ankesën e kërkuesit brenda publikimit të të dhënave të tij personale të përfshira në listën e borxhlinjve të mëdhenj tatimorë sipas s55(5) të Ligjit të vitit 2003 për Administrimin e Tatimeve. Prandaj, ajo nuk vazhdoi me shqyrtimin e ankesës për ripublikimin nga palët e treta të të dhënave të tij personale në një "hartë kombëtare të borxhlinjve tatimorë" nga portali i lajmeve online, sepse kjo çështje nuk ishte pjesë e "kërkesës ashtu siç ishte deklaruar e pranueshme" nga Dhoma gjatë shqyrtimit të saj, duke mbetur rrjedhimisht jashtë fushëveprimit të çështjes referuar Dhomës së Madhe. Megjithatë, Dhoma e Madhe nuk e përjashtoi rrezikun e ripublikimit si element i vlerësimit të saj të tërësishëm.

## Neni 8

Gjykata gjeti se publikimi i të dhënave personale të kërkuesit mund të konsiderohej ndërhyrje tek e drejta e tij për respekt ndaj jetës private. Më tej, masa e kontestuar ishte marrë në përputhje me ligjin.

Kërkuesi e kontestoi konstatimin që ndërhyrja tek e drejta e tij për respekt ndaj jetës private i kishte shërbyer një qëllimi legjitim, duke thënë se qëllimi i zbulimit publik ishte turpërimi. Megjithatë, Gjykata gjeti se masa e kontestuar synonte një qëllim legjitim në interes të mirëqenies ekonomike të Shtetit duke optimizuar të ardhurat tatimore dhe duke siguruar mbledhjen e tatimeve. Një masë e tillë për mos-respektimin e ligjit kishte për qëllim rritjen e efikasitetit të sistemit tatimor. U pranua se objektivi i masës ishte përmirësimi i disiplinës tatimore dhe se zbulimi i të dhënave personale të borxhlinjve të mëdhenj tatimorë mund të pritej të kishte efekt pengues. Më tej, Gjykata pranoi se masat promovonin transparencë dhe besueshmëri në marrëdhëniet e biznesit duke ofruar një shikim mbi situatën fiskale të borxhlinjve tatimorë, duke mbrojtur "të drejtat dhe liritë" e palëve të treta.

Duke vlerësuar nëse ndërhyrja kishte qenë "e nevojshme në një shoqëri demokratike", Gjykata shqyrtoi nëse ishte vënë ekuilibri i drejtë mes, nga njëra anë, interesit publik në garantimin e disiplinës tatimore, mirëqenies ekonomike të vendit dhe interesit të partnerëve potencialë të biznesit përmes qasjes në të dhëna specifike shtetërore të individëve privatë kundrejt, nga ana tjetër, interesit të individëve privatë për mbrojtjen e formave të caktuara të të dhënave të mbajtura nga Shteti për qëllime të mbledhjes së tatimeve.



Gjykata nënvizoi se publikimi në fjalë nuk ishte vendim individual i Autoritetit Tatimor, përkundrazi ai ishte pjesë e skemës legjislative të publikimit sistematik të të dhënave personale të borxhlinjve të mëdhenj tatimore në uebfaqen e Autoritetit Tatimor, kur ato borxhlinj plotësonin kriteret objektive të cekura në s55(5). Kjo u aplikojë të gjithë tatimpaguesve të cilët, në fund të çdo kuartali, kishin borxhe të mëdha tatimore për një periudhë më të gjatë se 180 ditë të njëpasnjëshme, pavarësisht nga faktet e secilit rast. Nuk mereshin parasysh as rrethanat individuale e as ekzistenca e ndonjë faji subjektiv. Ishte një masë e përgjithshme për të trajtuar mos-respektimin e pagesës së detyrimeve tatimore.

Duke ditur këtë kontekst të përgjithshëm, Gjykata shqyrtoi nëse skema statutore ishte ende brenda hapësirës së vlerësimit të Shtetit. Shteteve u jepej hapësirë e gjerë vlerësimi kur duhet të vlerësonin nevojën për të ngritur një skemë për ndarjen e të dhënave personale të tatimpaguesve të cilët nuk plotësonin përgjegjësitë e tyre të pagimit të tatimeve si metodë për të siguruar funksionimin e sistemeve të mbledhjes së tatimeve. Megjithatë, gjatë përcaktimit të kufijve të saj, Gjykata duhet të bindet që autoritetet kompetente vendase kanë vënë një ekuilibër të drejtë të interesave konkurruese.

Gjykata nënvizoi domethënien e masës së përgjithshme për gjetjet e saj. Në mënyrë të veçantë, skema e publikimit sipas Ligjit të vitit 2003 nuk kërkonte që Autoriteti Tatimor të ndërmerre një ushtrim balancimi të vlerësimit të interesave konkurruese individuale dhe publike, ose një vlerësim të individualizuar proporcionaliteti. Megjithëse një skemë e përgjithshme nuk ishte problematike në vetvete, e po ashtu nuk ishte problematik as publikimi i të dhënave të tatimpaguesve, rasti konkret ishte i dallueshëm sepse të dhënat e publikuara përfshinë adresën e shtëpisë. Për të përcaktuar nëse Shteti përgjegjës kishte vepruar brenda hapësirës së tij të vlerësimit, Gjykata ekzaminoi cilësinë e shqyrtimit parlamentar të nevojshmërisë së ndërhyrjes, dhe nëse legjislatura i kishte peshuar drejt interesat konkurruese gjatë miratimit të masës së kontestuar.

Gjykata vuri në dukje objektivat e legjislaturës gjatë miratimit të amendamentit të vitit 2006 në Ligjin e vitit 2003 i cili futi s55(5), duke e konsideruar masën të nevojshme për "të zbardhur ekonominë" dhe për të forcuar kapacitetet e autoriteteve tatimore dhe doganore. Megjithatë, punët përgatitore nuk treguan ndonjë vlerësim të përshtatshmërisë ose impaktit të skemave të publikimit ekzistuese për pajtueshmërinë e tatimpaguesve. As nuk treguan ndonjë konsideratë për vlera potenciale plotësuese të skemës s55(5) përveç pasojës së

parashikueshme të dëmit ndaj reputacionit që mund të dilte nga identifikimi në listë si borxhli i madh tatimor.

Më tej, ndërkohë që një raport shpjegues për Ligjin e vitit 2003 i referohej të drejtës së tatimpaguesve për privatësi për të justifikuar rregullat e rrepta të konfidencialitetit, nuk kishte prova se të njëjtat konsiderata i ishin dhënë skemës së publikimit sipas s55(5) të Ligjit Ndryshues të vitit 2006, apo ndonjë keqpërdorimi potencial të adresës rezidenciale të borxhlinjve tatimorë nga publiku i gjerë.

Në fund, nuk ishte e dukshme që shtrirja potencialisht e pakufizuar e publikimit të të dhënave të ndjeshme, përmes uebfaqes së Autoritetit Tatimor, ishte shqyrtuar si duhet. Rrjedhimisht, Gjykata doli në përfundimin se Parlamenti nuk dukej se e kishte marrë në konsideratë shkallën deri ku këto kategori të ndjeshme të të dhënave personale të borxhlinjve tatimorë ishin të nevojshme me qëllim që të arrihej synimi i deklaruar, drejt mirëqenies ekonomike të vendit. Nuk ishte treguar se legjislatura ishte përpjekur të vinte ekuilibër të drejtë mes interesave publike dhe atyre private, gjatë kërkimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes. Pavarësisht nga hapësira e vlerësimit, duke ditur natyrën sistematike të publikimit të të dhënave të ndjeshme, përfshirë adresën e shtëpisë, megjithëse arsyet e legjislaturës hungareze për zbatimin e s55(5) u gjetën se ishin relevante, Gjykata nuk u bind që ato ishin të mjaftueshme për të treguar se ndërhyrja ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike". Neni 8 i Konventës u gjet se ishte shkelur.

#### Neni 41

Gjykata konsideroi se gjetja e shkeljes në vetvete ishte shpërblim i drejtë i mjaftueshëm për çdo dëm jomaterial që kërkuesi mund të kishte pësuar. Gjykata caktoi 20,000 Euro për kosto.

*Pranueshmëria dhe përdorimi i të dhënave mjekësore personale, dhe vazhdimësia e të qenit publike të tyre, gjatë procedurës së divorcit përbënë shkelje të Nenit 8*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **L.L. k. FRANCËS**

(Kërkesa Nr. 7508/02)  
**10 tetor 2007**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1957 dhe jetonte në Francë. Më 5 shkurt 1996, bashkëshortja e kërkuesit bëri kërkesë ligjore për divorc. Në një vendim të 4 shtatorit 1998, gjykata përgjegjëse e shpalli divorcin mbi bazën e fajit vetëm të kërkuesit.

Kërkuesi e apeloj vendimin, duke kërkuar që divorci të shpallej mbi bazën e fajit nga ana e të dy bashkëshortëve. Ai gjithashtu kërkoi që gjykata të përjashtonte nga dosja e lëndës një dokument të tij mjekësor të cilin gruaja e tij kinse e kishte marrë pa lejen e tij, dhe dokument mbi të cilin ajo ishte bazuar për të treguar se ai ishte i alkoolizuar. Dokumenti ishte një raport operacioni, që mbante datën 2 prill 1994, në lidhje me një splenektomi (operacion për heqjen e shpretkës) që kërkuesi kishte bërë. Ky raport i operacionit ishte i përfshirë në një letër që një kirurg specialist i sëmundjeve dixhestive ia kishte dërguar mjekut familjar të kërkuesit. Në letër, kirurgu i referohej një krize të pankreatitit akut me prapavijë alkoolizmi, dhe tregonte se pasojat e pankreatitit mund të viheshin nën kontroll vetëm nëqoftëse personi linte alkoolin.

Në një vendim të datës 21 shkurt 2000, Gjykata e Apelit i mbështeti dispozitat e vendimit dhe citoi, mes provave të tjera, vërtetimin e dhunës së nxitur nga alkooli që kërkuesi kishte ushtruar ndaj gruas së tij, dëshmi lidhur me alkoolizmin e kërkuesit dhe dokumentet mjekësore të kërkuesit që kishte paraqitur gruaja e tij. Megjithatë, gjykata i mbajti të drejtat e kërkuesit për kontakte dhe vizita me fëmijët e tij, gjë për të cilën ai qe i kënaqur.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi parashtrij se paraqitja dhe përdorimi i dokumenteve të tij mjekësore në gjykatë pa pëlqimin e tij ngërtheu një ndërhyrje të pajustificuar tek e drejta e tij për jetë private sipas Nenit 8 të Konventës.

## Neni 8

Për të gjetur shkelje të Nenit 8, Gjykata së pari duhet të përcaktojë: 1) nëse veprimet e Shtetit kanë qenë ndërhyrje tek e drejta e kërkuesit për respekt ndaj jetës private; 2) nëse ato kanë qenë në përputhje me ligjin; 3) nëse i kanë shërbyer një qëllimi legjitim; dhe 4) nëse ndërhyrja ka qenë e justifikuar, pra proporcionale dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Të dhënat e përmbajtura në dokumentet mjekësore të kërkuesit kishin lidhje me jetën e tij private meqenëse ato përmbanin informacione mjekësore personale. Të dhënat mjekësore janë të dhëna personale siç përkufizohen nga Konventa e Këshillit të Evropës e vitit 1981 për Mbrojtjen e Individëve në aspektin e Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale. Gjykata e Apelit pjesërisht e bazoi vendimin e saj mbi përmbajtjen e të dhënave mjekësore, duke cituar pjesë të raportit mjekësor në opinionin e saj. Për shkak se vendimet e divorcit janë publike, informatat mjekësore të kërkuesit u bënë publike si rezultat i pranueshmërisë së raportit në procedurën e divorcit dhe pas riprodhimit të opinionit. Gjykata gjeti se pranueshmëria dhe përdorimi nga gjyqtari i të dhënave mjekësore përbëri ndërhyrje tek e drejta e kërkuesit për respekt ndaj jetës private, siç garantohet nga Neni 8 § 1.

Në procedurat e divorcit, e drejta vendase parashikonte që provat për ankesat e parashtruara ishin të pakufizuara dhe mund të nxirreshin me çfarëdo mënyre të mundshme, përderisa nuk tregojë se ishin përfutur përmes shtrëngimit ose mashtrimit ose se raportet e hartuara me kërkesë të një bashkëshorti/eje i kishin dhënë shkas një ndërhyrjeje të paligjshme në jetën private ose hyrjeje pa leje në ambientet shtëpiake. Në këtë rast, nuk kishte prova që tregonin se raportet mjekësore ishin përfutur përmes shtrëngimit ose mashtrimit, përmes mënyrave të paligjshme ose hyrjes pa leje. Si të tilla, Gjykata gjeti, dhe palët qenë dakord, se ndërhyrja ishte "në përputhje me ligjin" brenda kuptimit të Nenit 8 § 2.

Qëllimi i ndërhyrjes në këtë rast i shërbente qëllimit legjitim të "mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve", pra të drejtës së bashkëshortes për të paraqitur prova për të realizuar pretendimet e saj. Kështu, Gjykata gjeti se ndërhyrja i shërbeu një qëllimi legjitim brenda kuptimit të Nenit 8 § 2.

Për t'u siguruar nëse ndërhyrja ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike", Gjykata konsideroi nëse arsyet e nxjerra për ta justifikuar atë ishin relevante dhe të mjaftueshme, dhe nëse ajo ishte proporcionale me qëllimi legjitim të synuar.

Gjykata përsëriti se mbrojtja e të dhënave mjekësore është e rëndësisë themelore për gëzimin nga një person i të drejtës së vet për respektim të jetës private – andaj e drejta vendase duhet të ofrojë mbrojtje të mjaftueshme ndaj zbulimit të të dhënave shëndetësore personale. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se rasti konkret kishte të bënte me procedura civile në fushën e divorcit, të cilat sipas përkufizimit të tyre janë procedura ku mund të zbulohen informacione rreth intimitetit të jetës private dhe familjare, dhe ku është në fakt detyra e gjykatës të ndërhyjë në sferën private të një çifti në mënyrë që të peshojë interesat konfliktuoze dhe të zgjidhë kontestin që ka përpara. Megjithatë, çdo ndërhyrje e pashmangshme në këtë pikë duhet të kufizohet sa më shumë që është e mundur deri kur bëhet rreptësisht e nevojshme nga tipare specifike të procedurës dhe nga faktet e çështjes.

Gjykata gjeti se ndërhyrja nuk ishte proporcionale me qëllimin e synuar dhe prandaj qe “e panevojshme në një shoqëri demokratike për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve” sepse prova nuk qe vendimtare për dhënien e divorcit, dhe u përdor si bazë alternative dhe sekondare për dëshmi të tjera. Gjykata qe e mendimit se, sikur prova të ishte deklaruar e papranueshme, gjyqtari do të kishte marrë të njëjtin vendim duke pasur parasysh provat fillestare të paraqitura.

Ligjet vendase nuk ofronin mbrojtje të mjaftueshme në lidhje me përdorimin dhe publikimin e të dhënave personale në lidhje me jetën private të palëve në procedura të kësaj natyre, dhe prandaj kishte pasur shkeljet të Nenit 8.

#### Neni 41

Gjykata nuk caktoi shpërblime meqenëse nuk kishte lidhje shkakësore mes shkeljes së vërejtur dhe dëmeve të supozuara materiale, dhe gjetja e shkeljes përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për dëmet jomateriale të pësuar.

*Në mungesë të provave dhe standardeve të qarta e të qasshme ligjore për të kufizuar fushëveprimin e fuqive policore, përgjimi sekret i korrespondencës private për qëllime të pikasjes së krimit nuk qe në përputhje me ligjin dhe shkeli të drejtën e Nenit 8 për respekt ndaj jetës private*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**MALONE K. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesa Nr. 8691/79)  
**2 gusht 1984**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1937. Në vitin 1977, ai dhe gruaja e tij, tregtarë të antikuarëve, u arrestuan dhe u akuzuan për trajtim të pakujdesshëm të mallrave të vjedhura. Përfundimisht, ata u shpallën të pafajshëm, falë një kombinimi të mungesës së provave prokuroriale dhe një jurie të pavendosur.

Pas gjyqit të tij, kërkuesi u ankua që kishte arsye të besonte se korrespondenca dhe telefonatat e tij ishin përgjuar nga policia duke nisur diku rreth vitit 1974 dhe se ato kishin vazhduar të monitoroheshin pas shpalljes së pafajësisë së tij. Ndërkohë që Qeveria në përgjithësi refuzoi të përgjigjej direkt për këto pretendime, gjatë gjyqit u bë e qartë se telefoni i kërkuesit ishte përgjuar të paktën në një rast, kur një bisedë private ishte incizuar nga policia. Qeveria pranoi që në këtë rast telefonata e kërkuesit ishte përgjuar në vijim të një urdhri nga Sekretari i Shtetit dhe me qëllim të pikasjes së një krimi.

Hollësitë e të drejtës dhe praktikës në lidhje me përgjimin e komunikimeve private fillimisht u konstatuan në Raportin e Komisionit Birkett, i emëruar në vitin 1957. Komisioni gjeti që, ndërkohë që origjina e fuqisë së Sekretarit të Shtetit për të përgjuar komunikimet private ishte e errët, këto fuqi ishin ushtruar në mënyrë legjitime për shekuj me radhë në rastet e korrespondencës fizike, dhe po ashtu që nga shpikja e telefonit. Një Letër e Bardhë e Qeverisë e publikuar në vitin 1980 riafirmoi gjetjet e Komisionit Birkett që Sekretari i Shtetit mund të autorizonte përgjimin e korrespondencës private në mënyrë që të pikaseshin krimet e rënda ose të mbrohej siguria e Shtetit. Letra e Bardhë shpjegonte që vepra duhet të ishte e rëndë, që metoda të tjera duhet të ishin përdorur dhe të kishin dështuar, dhe që duhet të kishte arsye të shëndosha për të besuar se përgjimi mund të çonte tek arrestimi dhe dënimi.

Në vitin 1969, Ligji për Postën e kishte përcaktuar Postën si korporatë publike, e jo si Departament i Shtetit. Ligji artikulonte funksionet dhe detyrat e Postës sipas ndryshimit të statusit të saj, duke përfshirë dispozita të qarta statutores për përgjimin e komunikimeve me autoritetin e një urdhri të Sekretarit të Shtetit. Seksioni 80 i Ligjit, mes të tjerash, i detajonte ato dispozita. Më vonë, në vitin 1981, Ligji për Telekomunikimet në Britani e ndau Postën, përgjegjëse për dërgesat postare, dhe Telekomunikimet Britanike, përgjegjëse për telefonat, në dy departamente, pa dallime funksionale në qeverisjen e përgjimeve.

Në procedurën kundër Qeverisë para Zv/Kancelarit, kërkuesi kërkoi pa sukses një deklaratë që vëzhgimi të cilit i ishte nënshtruar ai ishte zhvilluar në mënyrë të paligjshme, në shkelje të së drejtës së tij nga Neni 8. Ai tha se përgjimet ishin më të shpeshta sesa raportohej dhe përdorshin për arsye të papërshtueshme as në Raportin Birkett e as në Letrën e Bardhë. Zv/Kancelari gjeti se nuk ekzistonte një e drejtë e përgjithshme e privatësisë në ligjet britanike, që përgjimet telefonike nuk ishin shprehimisht të ndaluara, dhe që kriteret e Nenit 8 të "Klass Case"<sup>[271]</sup> nuk ishin plotësuar në rastin e kërkuesit; ai rekomandoi ligje për të adresuar mungesën e mbrojtjes së telekomunikimeve private, një rekomandim që Qeveria nuk e miratoi. Mbi bazën e këtyre rezultateve, kërkuesi diskutoi që ai i kishte shteruar të gjitha zgjidhjet vendase në dispozicion, dhe e solli çështjen e tij para Komisionit<sup>[272]</sup>, i cili e avancoi çështjen në Gjykatë.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që ai i ishte nënshtruar vëzhgimit sekret të pajustificueshëm nga ana e Qeverisë, në shkelje të së drejtës së tij nga Neni 8 për respekt ndaj jetës private. Më tej, kërkuesi u ankua që natyra e vëzhgimit sekret përgjithësisht ishte e tillë që viktimës mund t'i mohohet efektivisht qasja në zgjidhje të drejtë në shkelje të Nenit 13, meqenëse viktimat mund të mos e dijë kurrë që vëzhgimi ka ndodhur, nëse ai i ka ndjekur mbrojtjet ose procedurat e duhura, dhe mund të mos ketë kurrë qasje në provat e kërkuara për të ndërmarrë veprime ligjore kundër Shtetit.

---

[271] *Klass dhe të Tjerë k. Gjermanisë*, vendimi i 8 shtatorit 1978, Nr. 5029/71, i përfshirë si përmbledhje në këtë publikim.

[272] Nga viti 1954 deri në vitin 1998, Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut (Komisioni) veprroi si ndërmjetës mes kërkuesve individualë dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Me miratimin e Protokollit 11, Komisioni u shua, duke ia lënë vendin qasjes direkte në Gjykatë.

## Neni 8

Gjykata filloi duke ngushtuar fushëveprimin e çështjes para saj, duke theksuar se diskutimi bëhej për t'u fokusuar tek përgjimi i komunikimeve private vetëm për qëllimet e hetimeve të policisë, e jo në kuptim të çështjes më të gjerë të vëzhgimit nga Qeveria të qytetarëve në kontekste të tjera.

Gjykata iu referua analizës së mëparshme të Komisionit, i cili kishte konstatuar që përgjimi i komunikimeve postare dhe telefonike, për pikasjen e krimeve, përbënte ndërhyrje tek të drejtat e kërkuesit nga Neni 8. Çështja ishte nëse një ndërhyrje e tillë ishte e justifikuar, në përputhje me ligjin, dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike për qëllime të pengimit të krimit. Në mënyrë të veçantë, ankesat e kërkuesit ngritën pyetje nëse procedurat që rregullonin përgjimin e korrespondencës private mund të ishin në përputhje me ligjin nëqoftëse ato nuk ishin direkt të rregulluara me ligj, dhe, në lidhje me këtë, nëse procedura të tilla ofronin mbrojtje të mjaftueshme.

Gjykata theksoi se, për të qenë në pajtueshmëri me shtetin e së drejtës, parashikueshmëria shërben si mbrojtje e nevojshme ligjore ndaj ndërhyrjes arbitrare në një shoqëri demokratike. Një ligj duhet të jetë mjaftueshëm i qasshëm aq sa t'i lejojë individit që të modifikojë sjelljen e tij duke iu përmbajtur ligjit. Më tej, Gjykata theksoi se rregulloret ligjore duhet të tregojnë qartë fushëveprimin e fuqisë së dhënë autoritetit përkatës, në mënyrë që të parandalojë si duhet abuzimet. Prandaj, pyetja ishte nëse fushëveprimi i fuqive në rastin e përgjimit të komunikimeve private ishte mjaftueshëm i qasshëm, i parashikueshëm dhe i definuar.

Ndërkohë që Qeveria deklaroi që Seksioni 80 i Ligjit të Postës i vitit 1969 definonte dhe kufizonte fuqinë e policisë për përgjime, referencat në kufizimet kohore dhe kufizimet në mënyrën dhe marrësin e informacionit të përgjuar, Gjykata nuk e pranoi këtë argument. Gjykata theksoi që ishte e paqartë se cilat aspekte të përgjimit mbeteshin nën diskrecionin absolut të Sekretarit të Shtetit, dhe se kishte mungesë të dukshme të kufizimeve të qarta në lidhje me "qëllimet" ose "mënyrën" e përgjimit. Në mënyrë të veçantë, Gjykata iu referua si përkufizimit të një "vepre të rëndë", i cili ishte zgjeruar me kalimin e kohës, ashtu edhe mosmarrëveshjes së brendshme nga ana e Qeverisë në lidhje me shkallën deri ku Seksioni 80 vepronte si kufizim ligjor detyrues.

Gjykata njohu se një shkallë e caktuar e fuqisë për përgjimin e komunikimeve, me qëllim të pengimit ose pikasjes së krimeve, mund të jetë e nevojshme në një



shoqëri demokratike brenda kuptimit të paragrafit 2 të Nenit 8, veçanërisht në shoqërinë moderne. Megjithatë, për të qenë jo vetëm e nevojshme, por edhe në përputhje me shoqërinë demokratike, një ndërhyrje e tillë mund të shihet si e nevojshme vetëm nëqoftëse sistemi i miratuar përmban mbrojtje të mjaftueshme nga abuzimet. Duke qenë se një mbrojtje e tillë është parashikueshmëria, Gjykata theksoi se, ndërkohë që ligjet duhet t'u japin qytetarëve informata të mjaftueshme të rrethanave në të cilat mund të përdoret vëzhgimi sekret, ato nuk kanë nevojë të jenë aq të detajuara sa të lejojnë që individët ta përshtasin sjelljen kriminale në mënyrë që t'i ikin pikasjes.

Më pas, Gjykata diskutoi përdorimin e "matjes" si e dallueshme nga format e tjera të ndërhyrjes qeveritare në komunikimet private. Ajo nuk e pranoi argumentin e Qeverisë që, edhe pse i dallueshëm nga shqetësimet në lidhje me Nenin 8 të ngritura nga forma të tjera të vëzhgimit, matja kurrë nuk mund t'i jepte shkas një shkeljeje të Nenit 8.

Gjykata deklaroi se niveli minimal i qartësisë së kërkuar për të mbrojtur qytetarët nga ndërhyrja qeveritare arbitrare mungonte, si për format tradicionale të përgjimit ashtu edhe për matjen, dhe se për këtë arsye përgjimet nuk mund të gjendej se ishin "në përputhje me ligjin". Duke pasur parasysh këtë deklaram, Gjykata nuk e gjeti të nevojshme të konsideronte më tej nëse praktikata e Qeverisë ishin "të nevojshme në një shoqëri demokratike".

### Neni 13

Gjykata deklaroi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej çështja sipas Nenit 13.

### Neni 50 (tani Neni 41)

Gjykata deklaroi se Neni 50 nuk ishte ende gati për opinion, dhe ia referoi çështjen sërish Dhomës. Pas kësaj, kërkuesi dhe Qeveria arritën një dakordim me marrëveshje.

*Një urdhër nga prokurori grek për të publikuar në shpallje publike një fotografi të kërkueses dhe akuzave penale kundër saj përbëri shkelje të Nenit 8*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**MARGARI K. GREQISË**

(Kërkesa Nr. 36705/16)  
**20 qershor 2023**

## **1. Faktet kryesore**

Kërkuesja ishte e lindur në vitin 1978 dhe jetonte në Athinë. Më 16 nëntor 2015, ajo u arrestua bashkë me gjashtë persona të tjerë, dhe u akuzua për dhënien e ndihmës për mashtrim, falsifikim dhe përdorim të dokumenteve të falsifikuara, dhe pjesëmarrje në një organizatë kriminale, me qëllim të kryerjes së mashtrimit në lidhje me transaksione të pronave. Kërkuesja dhe të bashkakuarët e saj u akuzuan se kishin marrë mbi 70,000 Euro duke u shtirur sikur ishin agjentë pronash dhe duke përdorur dokumente të falsifikuara për të kontaktuar me pronarë dhe blerës potencialë, dhe më pas që kishin transferuar ose premtuar të transferonin pronësinë e disa pronave me qëllim të marrjes dhe vjedhjes mashtruese të depozitave. Më 25 nëntor 2015, Departamenti i Sigurisë Publike në Policinë e Atikës Lindore i kërkoi prokurorit publik të Gjykatës së Shkallës së Parë të Athinës që të publikonte të dhënat personale dhe fotografitë e të akuzuarve. Pas kësaj, prokurori publik lëshoi një urdhër që autorizonte publikimin e të dhënave dhe fotografive nga platformat mediatike për një periudhë prej gjashtë muajsh prej 2 dhjetorit 2015 deri më 2 qershor 2016. Urdhri u aprovua nga prokurori publik i Gjykatës së Apelit të Athinës, i cili vlerësoi se ishin plotësuar të gjitha kushtet ligjore për këtë urdhër. Urdhri përmendte emrin e kërkueses në vendin e katërt, dhe veprat për të cilat akuzohej secili individ jepeshin të ndara nga akuzat e të akuzuarve të tjerë. Më pas, më 16 dhjetor 2015 u publikua një shpallje tjetër në uebfaqen e Policisë Helenike, ku përmendeshin "anëtarët e një organizate kriminale që kishte kryer mashtrime në kurriz të pronarëve të pronave", dhe rendiste një sërë akuzash kundër të akuzuarve. Kërkuesja ishte personi i tretë i përmendur në këtë shpallje, e cila nuk bënte dallime mes akuzave të bëra kundër kërkueses dhe atyre kundër të bashkakuarve të saj.

Më 26 dhjetor 2015, kërkuesja u informua nga miqtë e saj, e jo nga një njoftim zyrtar nga autoritetet, rreth publikimit të të dhënave të saj personale në platforma të ndryshme mediatike më 22 qershor 2017, kërkuesja u shpall fajtore

dhe u dënua me njëmbëdhjetë vjet e gjashtë muaj burgim pa kusht. Kërkesja dhe të bashkakuzuarit e saj apeluan, por kërkesja nuk u paraqit para gjykatës së apelit dhe nuk pati përfaqësues të saj aty. Apeli i saj u refuzua si i pambrojtur, dhe kërkesja në kohën e vendimit të Gjykatës Evropiane u konsiderua e arratisur.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkesja u ankua se publikimi i fotografisë së saj dhe të dhënave personale në shtyp për një periudhë prej gjashtë muajsh pas akuzimit të saj kishte shkelur të drejtën e saj për respekt ndaj jetës private siç parashikohet nga Neni 8 i Konventës, dhe se ajo nuk kishte pasur zgjidhje efektive sipas Neni 13.

### Çështja Paraprake

Gjykata së pari vuri në dukje se, megjithëse dyshohej nëse kërkesja ende dëshironte ta vazhdonte kërkesën, ajo e kishte diskrecionin sipas Neni 37 për ta vazhduar shqyrtimin e saj "nëqoftëse këtë e kërkon respekti për të drejtat e njeriut siç përkufizohet në Konventë dhe në Protokollin e saj". Duke pasur parasysh që publikimi i të dhënave personale nga autoritetet prokuroriale në kontekstin e procedurave penale në vazhdim ishte çështje posaçërisht e rëndësishme e të drejtave të njeriut, Gjykata vendosi që ta vazhdonte shqyrtimin e kërkesës mbi bazën e themeleve të saj.

### Neni 8

Kërkesja argumentoi se publikimi i fotografisë së saj dhe të dhënave personale, pa dijeninë e saj paraprake rreth publikimit, pa pasur mundësinë që ta kontestonte vendimin, dhe pa u bërë dallimi mes saj dhe të bashkakuzuarve të tjerë në lidhje me veprat për të cilat ishin akuzuar, i kishte dhënë shkas një shkeljeje të Neni 8. Nuk vihej në diskutim mes palëve që kishte pasur ndërhyrje tek e drejta e kërkeses për jetën private, dhe prandaj Gjykata iu kthye për shqyrtim çështjes nëse ndërhyrja ishte e justifikuar. Ajo gjeti se ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin, duke cituar dispozitën e ligjit grek që e lejonte prokurorin publik të urdhëronte publikimin e të dhënave personale. Më pas Gjykata shqyrtoi nëse publikimi synonte një qëllim legjitim, dhe konstatoi se publikimi i fotografisë dhe të dhënave kishte synuar qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve në shoqëri, duke cituar arsyetimin në urdhër që publikimi ndihmonte hetimet penale në lidhje me vepra të tjera të mundshme të cilat kërkesja dhe të bashkakuzuarit e saj mund t'i kishin kryer.

Më pas, Gjykata mori në shqyrtim nëse publikimi ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Ajo theksoi kriterin e proporcionalitetit, dhe njohu se autoriteteve kombëtare duhet t'u lejohej që të vendosnin një ekuilibër të drejtë mes interesave konkurruese publike dhe private në publikimin e këtij informacioni. Duke i parë fotografitë dhe të dhënat ndaras, Gjykata theksoi se dobia objektive e publikimit të fotografisë rridhte nga fakti se kërkuesja nuk ishte në burg, dhe autoritetet mund të përdornin foton e saj për të marrë në mënyrë legjitime mbështetjen publike dhe për të hetuar vepra të thera që mund të ishin kryer nga kërkuesja dhe të bashkakuarit e saj. Në lidhje me të dhënat, Gjykata theksoi se ishin publikuar vetëm informacionet e nevojshme për të arritur qëllimin legjitim, dhe se urdhri nuk përmbante asnjë deklaratë që mund të shkelte prezumimin e pafajësisë.

Më tej, Gjykata vlerësoi proporcionalitetin e shpalljes, dhe e pa si problematike dispozitën e ligjit grek që lejonte derogimin nga dy mbrojtjet (e drejta për apel dhe e drejta për t'u njoftuar paraprakisht për publikimin) për vepra të caktuara. Meqenëse kërkuesja ishte akuzuar për një tërësi prej këtyre veprave, pra për pjesëmarrje në një organizatë kriminale, policia e pati mundësinë që ta publikonte shpalljen pa e njoftuar kërkuesen, dhe pa mundësinë e apelit. Të qenit objekt i procedurave penale nuk ia ulte vlerën mbrojtjes së gjerë të jetës private të një individi, dhe kërkuesja duhet të ishte njoftuar paraprakisht rreth publikimit. Për më tepër, mungesa e një mekanizmi që kërkuesja të apelonte kundër urdhrin të prokurorit për publikimin e fotografisë së saj dhe të dhënave personale nënkuptonte se procesi nuk ishte i drejtë, dhe nuk i kishte dhënë respekt të mjaftueshëm të drejtave individuale të mbrojtura nga Konventa. Gjykata theksoi që, edhe pse Neni 8 i Konventës nuk përmbante kriteret procedurale eksplicite, ishte e rëndësishme për gëzimin e të drejtave të garantuara nga ajo dispozitë që procesi vendimmarrës relevant të ishte i drejtë dhe të përmbante respektin e duhur për interesat që ai mbron.

Në fund, Gjykata tërhoqi vëmendjen drejt dallimit mes informacionit të përmbajtur në urdhër dhe atij të publikuar në shpallje, duke theksuar se urdhri përshkruante me hollësi akuzat e sakta me të cilat përballëj secili i akuzuar, ndërsa shpallja nuk bënte dallime mes kërkueses dhe të akuzuarve. Meqenëse shpallja, dhe jo urdhri, u publikua në media, Gjykata deklaroi se të dhënat nuk pasqyronin saktë situatën dhe akuzat kundër kërkueses, duke përbërë kështu ndërhyrje joproporcionale tek e drejta e kërkueses për respekt ndaj jetës së saj private. Prandaj, Gjykata gjeti se kishte pasur shkelje të Nenit 8.

### Neni 13

Nën dritën e gjetjeve të saj sipas Nenit 8, Gjykata konsideroi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej ndaras ankesa nga Neni 13.

### Neni 41

Gjykata vendosi se gjetja prej saj e shkeljes së Nenit 8 përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm, dhe nuk caktoi shpërblim.

GJYKIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN  
**ROMAN ZAKHAROV k. RUSISË**

(Kërkesa Nr. 47143/06)

**4 dhjetor 2015**

## **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi, Roman Zakharov, ishte shtetas rus, i lindur në vitin 1977, dhe kryeredaktor i një kompanie botuese. Ai ishte i abonuar në shërbimet e disa operatorëve të rrjeteve të telefonisë mobile.

Në dhjetor 2003 ai hapi procedurë gjyqësore kundër tre operatorëve të telefonisë mobile, duke u ankuar për ndërhyrje tek e drejta e tij për privatësi në komunikimet e tij telefonike. Ai pretendoi se, sipas të drejtës përkatëse vendase – më saktësisht në vijim të Urdhrit Nr. 70 të lëshuar nga Ministria e Komunikimeve – operatorët mobilë kishin instaluar pajisje që lejonin përgjimin e pakufizuar të të gjitha komunikimeve telefonike nga shërbimet e sigurimit pa autorizim gjyqësor paraprak. Ai i kërkoi Gjykatës së Rrethit përgjegjës që të hiqte pajisjet e instaluara sipas Urdhrit Nr. 70, i cili nuk ishte bërë publik asnjëherë, dhe të siguronte që qasja në telekomunikime t'u jepej vetëm personave të autorizuar. Në dhjetor 2005 Gjykata e Rrethit të Shën Petërburgut i rrëzoi pretendimet e Z. Zakharov, duke gjetur që instalimi i pajisjeve në vetvete nuk dhunonte privatësinë e komunikimeve të tij, dhe që kërkuesi kishte dështuar të vërtetonte se bisedat e tij telefonike ishin përgjuar.

Kërkuesi apeloj. Ai pretendoi se Gjykata e Rrethit kishte refuzuar të pranonte disa dokumente si prova, përfshirë urdhrat gjyqësore që autorizonin përgjimin e komunikimeve mobile të disa personave, çka, sipas mendimit të kërkuesit, vërtetonte se operatorët e rrjeteve mobile dhe agjencitë e zbatimit të ligjit teknikisht e kishin kapacitetin për të përgjuar të gjitha komunikimet telefonike pa marrë autorizim gjyqësor paraprak. Në prill 2006, Gjykata e Qytetit të Shën Peterburgut e mbështeti gjykimin e apeluar, duke konfirmuar vendimin e Gjykatës së Rrethit.

## **2. Vendimi i Gjykatës**

Duke u mbështetur në Nenin 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Z. Zakharov u ankua rreth sistemit të përgjimit të fshehtë të komunikimeve në

telefonat mobil në Rusi, duke argumentuar se e drejta përkatëse vendase i lejonte shërbimet e sigurimit të përgjonin komunikimet e çdo njeriu pa marrë autorizim gjyqësor paraprak. Duke u mbështetur në Nenin 13, ai u ankua më tej që ai nuk kishte zgjidhje ligjore efektive në shkallë kombëtare për ta kontestuar atë legjislacion.

### Neni 8

Gjykata vërejti që, megjithëse Konventa nuk parashikon institucionin e një *actio popularis*, Z. Zakharov kishte të drejtë të pretendonte që ishte viktimë e një shkeljeje të Konventës, edhe pse ai pretendonte se kishte pasur ndërhyrje tek të drejtat e tij thjesht si pasojë e ekzistencës së legjislacionit që lejonte masat sekrete të vëzhgimit, dhe nuk kishte mundësi të pretendonte që ai kishte qenë objekt i një mase konkrete të vëzhgimit. Duke pasur parasysh natyrën sekrete të masave të vëzhgimit të parashikuara nga legjislacioni, fushëveprimin e gjerë të tyre – duke ndikuar tek të gjithë përdoruesit e komunikimeve përmes telefonisë mobile – dhe mungesën e mjeteve efektive për t'i kontestuar ato në nivel kombëtar, Gjykata konsideroi që shqyrtimi i legjislacionit përkatës *in abstracto* ishte i justifikuar. Si më lart, Gjykata konsideroi që Z. Zakharov nuk kishte nevojë të demonstronte se rrezikonte përgjimin e komunikimeve të tij, sepse vetë ekzistenca e legjislacionit të kontestuar në vetvete përbënte ndërhyrje tek të drejtat e tij sipas Nenit 8.

Pasi u konstatua që përgjimi i komunikimeve të telefonisë mobile bazohej në të drejtën ruse – pra në OSAA, CCrP, dhe Urdhri Nr. 70 i lëshuar nga Ministria e Komunikimeve – e cila synonte qëllimin legjitim të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe sigurimin e publikut, Gjykata u desh të konstatonte me siguri nëse ai ligj vendas ishte i tillë që ndaj tij kishin qasje të gjithë dhe përmbante mbrojtjet e garancitë e duhura dhe efektive.

### *Qasshmëria në të drejtën vendase*

Gjykata gjeti se ishte për të ardhur keq që shtojcat e Urdhrit Nr. 70 nuk ishin bërë publike asnjëherë në një botim zyrtar në dispozicion për të gjithë. Megjithatë, duke pasur parasysh që ai ishte botuar në një revistë zyrtare ministrore, dhe që ajo mund të lexohej nga publiku i gjerë përmes një databaze ligjore private në internet, Gjykata nuk e pa të nevojshme ta ndiqte më tej çështjen e qasshmërisë së të drejtës vendase.

### *Fushëveprimi i zbatimit të masave sekrete të vëzhgimit*

Gjykata konsideroi që legjislacioni rus sqaronte mjaftueshëm natyrën e veprave që mund t'i jepnin shkas një urdhri për përgjim. Njëkohësisht ajo vuri në dukje me shqetësim se ligjit i mungonte qartësia në lidhje me disa prej kategorive të njerëzve të cilëve mund t'u përgjoheshin telefonat, pra një person që mund të kishte informacione rreth një veprë, ose në lidhje me ndonjë çështje penale, ose ata që përfshiheshin në aktivitete që rrezikonin sigurinë kombëtare, ushtarake, ekonomike ose ekologjike të Rusisë. Në lidhje me atë pikë, OSAA u jepte autoriteteve një shkallë thujse të pakufishme diskrecioni për të vendosur se çfarë përbënte një kërcënim të tillë, dhe nëse ai kërcënim ishte aq serioz sa që justifikonte vëzhgimin sekret.

### *Kohëzgjatja e masave sekrete të vëzhgimit*

E drejta ruse përmbante rregulla të qarta rreth kohëzgjatjes dhe përtëritjes së përgjimeve, duke ofruar mbrojtjet e duhura kundër abuzimit. Sidoqoftë, Gjykata vuri re që kërkesa për ndërprerjen e përgjimeve kur nuk ishin më të nevojshme përmendej vetëm në CCRP, dhe jo në OSAA. Nga kjo rridhte që përgjimet në kuadër të procedurave penale kishin më shumë mbrojtje sesa ato në lidhje me aktivitete që rrezikonin sigurinë kombëtare, ushtarake, ekonomike ose ekologjike të Rusisë.

### *Procedurat për ruajtjen, përdorimin, komunikimin dhe asgjësimin e të dhënave të zëna*

Gjykata u bind që e drejta ruse përmbante rregulla të qarta që qeverisnin ruajtjen, përdorimin dhe komunikimin e të dhënave të zëna në përgjim, duke mundësuar minimizimin e rrezikut të qasjes apo zbulimit të paautorizuar.

Sa i përket asgjësimit të këtij materiali, Gjykata gjeti që e drejta ruse nuk ishte e qartë mjaftueshëm, meqenëse ajo lejonte ruajtjen automatike për gjashtë muaj të të dhënave jorelevante në çështje ku personi në fjalë nuk ishte akuzuar për veprë penale, dhe në rastet kur personi ishte akuzuar për veprë penale nuk ishin të qarta rrethanat në të cilat do të mbahej dhe asgjësohej materiali i zënë gjatë përgjimeve në përfundim të gjyqit.



## *Autorizimi i përgjimeve*

Gjykata vuri re që e drejta ruse përmbante një mbrojtje të rëndësishme kundër përgjimit arbitrar ose pa dallim, ku cekej se çdo përgjim duhet të ishte i autorizuar nga një gjykatë. Agjencia ligjzbatuese që kërkonte autorizimin për përgjim duhet t'i paraqiste një gjyqtari një kërkesë të arsyetuar për këtë qëllim, dhe gjyqtari duhet të jepte arsye për vendimin e autorizimit të përgjimeve.

Sa i përket fushëveprimit të shqyrtimit, këqyrja gjyqësore ishte e kufizuar, dhe, pavarësisht nga rekomandimet e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët nuk verifikonin ekzistencën e "dyshimit të arsyeshëm" kundër personit për të cilin ishte kërkuar përgjimi, e as nuk shqyrtonin nëse përgjimi ishte i nevojshëm dhe i justifikuar. Si rezultat, kërkesat për përgjim shpesh nuk shoqëroheshin me materiale mbështetëse, gjyqtarët kurrë nuk i kërkonin agjencisë përgjuese të paraqiste materiale të tilla, dhe një referencë e thjeshtë për ekzistencën e informacionit rreth veprës penale apo aktiviteteve që rrezikonin sigurinë kombëtare, ushtarake, ekonomike ose ekologjike konsiderohej e mjaftueshme për dhënien e autorizimit.

Sa i përket përmbajtjes së autorizimit të përgjimit, Gjykata vuri re se, ndryshe nga CCRP, OOSA i lejonte diskrecion shumë të gjerë autoriteteve ligjzbatuese. OOSA nuk përmbante kërkesa as në lidhje me përmbajtjen e kërkesës për përgjim, e as në lidhje me përmbajtjen e autorizimit të përgjimit, që do të thotë se gjykatat nganjëherë lëshonin autorizime për përgjime të cilat nuk përmendnin përgjimin e një personi të caktuar apo një numri telefonik të caktuar, por autorizonin përgjimin e të gjitha komunikimeve telefonike në zonën ku kinse ishte kryer një vepër penale, dhe nganjëherë pa përmendur fare kohëzgjatjen e autorizimit të përgjimeve. Për më tepër, "procedurës urgjente" jo-gjyqësore të ofruar nga OOSA – në kuadër të së cilës ishte e mundur të përgjoheshin komunikime pa autorizim gjyqësor paraprak deri në dyzet e tetë orë – i mungonin mbrojtjet e mjaftueshme për të siguruar që ajo të përdorej vetëm në rastet e justifikuara siç duhej. Procedurat e autorizimit të parashikuara nga e drejta ruse nuk ishin në gjendje të siguronin që masat sekrete të vëzhgimit të mos urdhëroheshin kuturu, në mënyrë të parregullt ose pa u shqyrtuar tamam siç duhej.

Më tej, Gjykata konsideroi që një sistem, si ai rus, i cili i mundësonte shërbimeve sekrete dhe policisë të gjurmonin direkt komunikimet e secilit dhe çdo qytetari pa kërkuar autorizim përgjimi nga ofruesi i shërbimeve të komunikimit ishte posaçërisht i prirur për abuzime. Prandaj nevoja për mbrojtje kundër arbitraritetit duhej posaçërisht e madhe.

### *Mbikëqyrja e zbatimit të masave të vëzhgimit sekret*

Gjykata mori në shqyrtim nëse mbikëqyrja e gjurmimit ishte në përputhje me kërkesat sipas Konventës që organet mbikëqyrëse të ishin të pavarura, të hapura ndaj shqyrtimit publik dhe të mvëshura me fuqi dhe kompetenca të mjaftueshme për të ushtruar kontroll efektiv dhe të vazhdueshëm.

Së pari, Gjykata shënoi që ndalimi i regjistrimit apo incizimit të përgjimeve i përcaktuar në të drejtën ruse e bënte të pamundur për autoritetin mbikëqyrës të zbulonte përgjimet e kryera pa autorizimin e duhur gjyqësor. Në kombinim me aftësinë teknike të autoriteteve ligjzbatuese për të përgjuar direkt të gjitha komunikimet, ky ligj bënte që çdo veprim drejt mbikëqyrjes të ishte i paaftë për të pikasur përgjimet e paligjshme, e rrjedhimisht jo efektiv.

Së dyti, mbikëqyrja e përgjimeve të kryera mbi bazën e autorizimeve të duhura gjyqësore i ishte besuar Presidentit, Parlamentit dhe Qeverisë, të cilëve ligji rus nuk iu jepte asnjë tregues se si mund t'i mbikëqyrnin përgjimet, si dhe prokurorëve kompetentë, mënyra e emërimit dhe përzjerja e funksioneve të të cilëve, ku e njëjta prokurori jepte miratimin për kërkesat për përgjime e më pas mbikëqyrjen e zbatimit, mund të ngrinte dyshime lidhur me pavarësinë e tyre. Më tej, fuqitë dhe kompetencat e prokurorëve ishin shumë të kufizuara, mbikëqyrja që kryhej prej tyre nuk ishte e hapur ndaj shqyrtimit publik, dhe raportet e tyre të shkurtra gjysmë-vjetore mbi masat operationale të kërkimit ishin dokumente konfidenciale, jo të publikuara ose me qasje publike të ndonjë forme tjetër.

Së fundi, Gjykata konsideroi që mbikëqyrja e përgjimeve nga prokurorët nuk ishte e aftë të ofronte garancitë e duhura dhe efektive kundër abuzimeve. Në lidhje me këtë pikë, Z. Zakharov kishte paraqitur dokumente që ilustrojnë pamundësinë e prokurorëve për të fituar qasje në materialet e fshehta të përgjimeve, ndërsa Qeveria nuk kishte paraqitur asnjë raport inspektimi ose vendimi nga prokurorët ku urdhërohej marrja e masave për të ndalur ose për të ndrequr një shkelje të pikasur të ligjit.

### *Njoftimi për përgjimin e komunikimeve dhe zgjidhjet në dispozicion*

Çështja e njoftimit për përgjimin e komunikimeve ishte pazgjidhshmërisht e lidhur me efektivitetin e zgjidhjeve para gjykatave. Gjykata vuri re se në Rusi njerëzit komunikimet e të cilëve përgjoheshin nuk njoftoheshin në asnjë moment për këtë fakt – përveç rasteve kur ky informacion bëhej i ditur për shkak të

përdorimit të tij si provë në procedura penale eventuale – dhe që mundësia për të marrë informata rreth përgjimeve ishte veçanërisht joefektive.

Zgjidhja ishte në dispozicion vetëm për personat të cilët posedonin informacione rreth përgjimit të komunikimeve të tyre. Kështu, efektiviteti i zgjidhjes në fjalë dëmtohej nga mungesa e kriterit për njoftimin e subjektit të përgjimit, ose mundësia e përshtatshme për të kërkuar dhe marrë informata rreth përgjimeve nga autoritetet. Rrjedhimisht, e drejta ruse nuk ofronte zgjidhje gjyqësore efektive ndaj masave sekrete të vëzhgimit në rastet kur nuk niste procedura penale kundër subjektit të përgjimeve. Gjithashtu, e drejta ruse nuk i ofronte zgjidhje efektive një personi që dyshonte se ai ose ajo i ishte nënshtruar vëzhgimeve sekrete. Duke ia mohuar subjektit të përgjimeve mundësinë efektive për kontestimin e përgjimeve në mënyrë retroaktive, e drejta ruse kështu i shmangej një mbrojtjeje të rëndësishme kundër përdorimit të paduhur të masave sekrete të vëzhgimit.

### *Përfundim*

Gjykata arriti në përfundimin që dispozitat ligjore ruse që qeverisnin përgjimin e komunikimeve nuk ofronin garancitë e përshtatshme dhe efektive kundër arbitraritetit dhe rrezikut të abuzimeve. Mangësitë në kornizën ligjore të identifikuar nga Gjykata tregonin ekzistencën e praktikave arbitrare dhe abuzive të vëzhgimit, prandaj e drejta ruse nuk e përmbushte kriterin e “cilësisë së ligjit” dhe ishte e paaftë ta mbante përgjimin e komunikimeve brenda asaj që ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës.

### Neni 13

Duke pasur parasysh gjetjet sipas Nenit 8, nuk qe e nevojshme të shqyrtohej ankesa nga Neni 13 ndaras.

### Neni 41

Gjykata vendosi që gjetja e një shkeljeje në vetvete përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për çdo dëm jomaterial të pësuar nga kërkuesi. Më tej, ajo vendosi që Rusia t'i paguante atij shumën 40,000 Euro në lidhje me kosto dhe shpenzime.

*Mbajtja e gjurmëve të gishtave dhe profilit të ADN-së nga autoritetet përbëri shkelje të Nenit 8*

## GJYKIMI I DHOMËS SË MADHE NË ÇËSHTJEN **S. DHE MARPER k. MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(Kërkesat Nr. 30562/04 dhe Nr. 30566/04)  
**4 dhjetor 2008**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesit, S. dhe Michael Marper, ishin të lindur respektivisht në vitet 1989 dhe 1963, dhe jetonin në Mbretërinë e Bashkuar.

Më 19 janar 2001, kërkuesi i parë u arrestua dhe u akuzua për grabitje në tentativë, në moshën njëmbëdhjetëvjeçare asokohe. Atij iu morën shenjat e gishtave dhe mostra e ADN-së. Ai u lirua më 14 qershor 2001. Kërkuesi i dytë u arrestua më 13 mars 2001 dhe u akuzua për ngacmim të partneres së tij. Atij iu morën shenjat e gishtave dhe mostra e ADN-së. Më 14 qershor 2001, çështja u ndërpre zyrtarisht meqenëse ai dhe partnerja e tij ishin pajtuar.

Pas përfundimit të procedurave, të dy kërkuesit kërkuan pa sukses që shenjat e gishtave të tyre, mostrat e ADN-së së tyre, dhe profilet e tyre të asgjësoheshin. Informatat ishin ruajtur mbi bazën e një ligji që autorizonte mbajtjen e tyre pa ndonjë kufi kohor.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesit u ankuan sipas Neneve 8 dhe 14 të Konventës për mbajtjen nga autoritetet të shenjave të tyre të gishtave, mostrave qelizore dhe profileve të ADN-së pas lirimit të tyre nga akuzat apo lëshimit të tyre.

#### Neni 8

Gjykata konsideroi që mostrat qelizore dhe profilet e ADN-së, si dhe shenjat e gishtave, përmbanin informacione të ndjeshme personale dhe që mbajtja e tyre përbënte ndërhyrje tek e drejta e kërkuesve për respekt ndaj jetës së tyre private, brenda kuptimit të Nenit 8 § 1 të Konventës. Gjithashtu, Gjykata shënoi që mbajtja e shenjave të gishtave të kërkuesve, të mostrave biologjike dhe profileve

të ADN-së kishin bazë të qartë në të drejtën vendase sipas Ligjit për Provat Policore dhe Kriminale të vitit 1984, dhe se ai synonte një qëllim legjitim, pra hetimin e rrjedhimisht parandalimin e krimit.

Gjykata vuri në pah se e drejta vendase duhet të ofronte mbrojtje për të parandaluar një përdorim të tillë të të dhënave personale që mund të ishte në shpërputhje me garancitë e Nenit 8. Më tej, nevoja për mbrojtje të tilla ishte edhe më e madhe kur bëhej fjalë për mbrojtjen e të dhënave personale që kalonin në përpunim automatik, e po ashtu kur të dhëna të tilla përdorreshin për qëllime të policisë.

Çështja që duhet të merrej në konsideratë nga Gjykata në këtë rast ishte nëse mbajtja e shenjave të gishtave dhe të dhënave të ADN-së së kërkuesve, si persona që kishin qenë të dyshuar, por jo të dënuar, për vepra të caktuara penale, ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Gjykata mori parasysh në mënyrën e duhur parimet thelbësore të instrumenteve përkatëse të Këshillit të Evropës si dhe të drejtën dhe praktikën e Shteteve të tjera Kontraktuese, sipas të cilave mbajtja e të dhënave duhet të ishte proporcionale në relatë me qëllimin e marrjes së tyre dhe e kufizuar në kohë.

Mbretëria e Bashkuar në atë kohë dukej se ishte i vetmi juridiksion brenda Këshillit të Evropës që lejonte mbajtjen e pacaktuar të shenjave të gishtave dhe materialit të ADN-së së çdo personi të çfarëdo moshe që dyshohej për ndonjë veprë të regjistrueshme. Të dhënat në fjalë mund të mbaheshin pavarësisht nga natyra e peshës së veprës për të cilën ishte dyshuar fillimisht individ apo nga mosha e të shkelësit të dyshuar; mbajtja nuk ishte e kufizuar në kohë; dhe ekzistonin vetëm mundësi të pakta që një individ të liruar nga akuza t'i hiqeshin të dhënat nga baza e të dhënave apo t'i asgjësoheshin materialet.

Gjykata shprehu shqetësim të veçantë për rrezikun e stigmatizimit, nga fakti që personat në pozitën e kërkuesve, të cilët nuk ishin dënuar për ndonjë veprë dhe kishin të drejtën e prezumimit të pafajësisë, ishin trajtuar në të njëjtën mënyrë si personat e dënuar. Mbajtja e të dhënave të personave të padënuar mund të ishte posaçërisht e dëmshme në rastin e të miturve siç ishte kërkuesi i parë, duke pasur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe rëndësinë e integritit të tyre në shoqëri.

Në përfundim, Gjykata gjeti që natyra gjithëpërfshirëse dhe joveçuese e fuqisë për të mbajtur shenjat e gishtave, mostrat qelizore dhe profilet e ADN-së

së personave të dyshuar por jo të dënuar për vepra, siç është rasti i kërkuessve në fjalë, nuk arrinte të vinte një ekuilibër të drejtë mes interesave konkurruese publike dhe private, dhe që Shteti i paditur kishte tejkaluar çdo hapësirë të pranueshme vlerësimi në këtë pikë. Rrjedhimisht, mbajtja në fjalë përbënte ndërhyrje joproporcionale tek e drejta e kërkuessve për respekt ndaj jetës private dhe nuk mund të shihej si e nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjykata arriti në përfundimin që kishte pasur shkelje të Nenit 8 në këtë rast.

#### Neni 14 në lidhje me Nenin 8

Duke pasur parasysh arsyetimin që shpuri drejt përfundimit të saj sipas Nenit 8 lart, nuk qe e nevojshme të shqyrtohej ndaras ankesa sipas Nenit 14.

#### Neni 41

Gjykata konsideroi që gjetja e një shkeljeje, me pasojat që kjo mund të kishte për të ardhmen, mund të shihej si e tillë që përbënte shpërblim mjaft të drejtë në lidhje me dëmet jomateriale të pësuar nga kërkuessit. Gjykata u caktoi kërkuessve 42,000 Euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet, minus shumën tashmë të paguar atyre në ndihmë ligjore.

#### Neni 46

Gjykata shënoi që, në përputhje me Nenin 46 të Konventës, do t'i takonte Shtetit të paditur të zbatonte, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, masat e përshtatshme të përgjithshme dhe/ose individuale për të përmbushur detyrimet e tij për të siguruar të drejtën e kërkuessve dhe personave të tjerë në pozitë të tyre për respekt ndaj jetës së tyre private.

*Përdorimi i incizimit ilegal të bisedës telefonike në dënimin e kërkuarit për nxitje në tentativë për vrasje nuk shkeli Nenin 6*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **SCHENK k. ZVICRËS**

(Kërkesa Nr. 10862/84)  
**12 korrik 1988**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1912 dhe jetonte në Tartegnin të Zvicrës. Në vitin 1947 ai u martua me Josette P ("Znj. Schenk"), e cila ishte e lindur në vitin 1927. Në vitin 1974, kërkuesi bëri kërkesë për divorc, i cili u zyrtarizua më 10 dhjetor 1981. Më herët atë vit, më 28 shkurt 1981, kërkuesi shkoi në një agjenci reklamash, ku duke përdorur një emër të rremë ai dha udhëzime që të publikohej kjo shpallje "Kërkohet. Ish-anëtar i Legjionit të Huaj ose ngjashëm për të kryer punë/detyra herë pas here; oferta me numër telefoni, adresë dhe biografi profesionale në adresën RTZ 81 posta restante CH Basle 2". Kërkuesi zgjodhi z. Richard Pauty, të cilin e kishte takuar disa herë dhe e kishte paguar për të kryer detyra të ndryshme, përfshirë një detyrë në Haiti në majin e vitit 1981. Z. Pauty e vizitoi znj. Schenk më 19 qershor dhe i tregoi se ai ishte komisionuar nga burri i saj për ta vrasur atë. Më pas ata shkuan bashkë tek gjyqtari hetues i Kantonit të Vaud më 20 qershor 1981. Në stacionin e policisë, gjyqtari hetues intervistoi z. Pauty and znj. Schenk. Më 22 qershor, gjyqtari hetues kërkoi që autoritetet franceze ta hetonin më tej vrasjen në tentativë, dhe që Inspektori Messerli do të autorizojë të merrte pjesë në hetime.

Më 24 qershor, z. Pauty u mor në pyetje në praninë e Inspektorit Messerli. Z. Pauty tha, mes të tjerash: "RTZ 81 do të thotë se z. Pierre Schenk pa dyshim do të më kontaktojë së shpejti për të kërkuar hollësi për vrasjen e gruas së tij, Josette Schenk. Ai duhet të më dërgojë ose të më sjellë shumën e dakorduar 40,000 \$ . Ju kërkua që të vij këtu, dhe tani unë ju kërkoj të më jepni udhëzime se si duhet të veprojmë kur z. Schenk të më kontaktojë". Z. Pauty priste që kërkuesi t'i telefononte, dhe vuri një magnetofon me kaseta në shtëpinë e nënës së tij në Houilles afër Parisit dhe e lidhi me mikrofoni me aparatit e dytë telefonik. Në mëngjesin e 26 qershorit, kërkuesi i telefonoi z. Pauty nga një kioskë, dhe z. Pauty e incizoi bisedën. Rreth orës 10:00 z. Pauty i telefonoi Inspektorit Messerli, e vuri incizimin që ta dëgjonte inspektori, dhe e pyeti nëse donte ta kishte kasetën. Inspektori Messerli tha që

e donte kasetën, dhe kështu pas rreth një ore z. Pauty arriti në zyrat e Ekipit të Krimeve dhe ia dorëzoi kasetën atij. Më 30 qershor 1981, Inspektori Messerli e vuri kasetën që ta dëgjonte znj. Schenk në mënyrë që ajo të identifikonte zërin e burrit të saj. Kërkuesi u arrestua të nesërmen, dhe më 13 gusht 1982 u gjet fajtor për nxitje në tentativë për vrasje dhe u dënua me 10 vjet burgim nga Gjykata Penale e Rolle. Më pas kërkuesi bëri apele në Divizionin e Kasacionit Penal të Gjykatës Kantonale të Vaud dhe në Gjykatën Federale, ku të dy apelet u rrëzuan, para se të depozitonte kërkesën e tij pranë Komisionit<sup>[273]</sup> më 6 mars 1984, i cili vendosi se nuk kishte pasur shkelje të Konventës.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesi u ankua që incizimi i bisedës së tij telefonike me z. Pauty, dhe përdorimi i incizimit më pas si provë, ishte shkelje e Nenit 6 § 1 të Konventës. Kërkuesi gjithashtu u ankua se për shkak të përdorimit të incizimit ilegal ai nuk ishte dëshmuar fajtor “në përputhje me ligjin”, dhe që kishte pasur dështim në aplikimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të garantuar me Nenin 6 § 2. Në fund, kërkuesi u ankua mbi bazën e Nenit 8 se ai ishte viktimë e shkeljes së të drejtës së tij për respekt ndaj jetës private dhe korrespondencës, e drejtë e cila përfshinte të drejtën e konfidencialitetit të komunikimeve të tij telefonike.

### Neni 6 § 1

Qeveria nuk e vuri në diskutim që incizimi i bisedës telefonike mes kërkuesit dhe z. Pauty kishte qenë i paligjshëm, megjithëse u pranua se të tria gjykatat vendase e kishin pranuar incizimin si provë. Meqenëse Neni 6 nuk shtron rregulla në lidhje me pranueshmërinë e provave, u theksua se roli i Gjykatës ishte të siguronte nëse gjyqi i kërkuesit në tërësi ishte i drejtë, dhe të mos përjashtonte provat e marra ilegalisht si çështje parimi dhe në formë abstrakte. Nëqoftëse një gjykatë kombëtare nuk ka shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa, Gjykata deklaroi se nuk është funksioni apo roli i saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit kinse të bëra nga gjykata në fjalë.

Aty u theksua së pari nga Gjykata se të drejtat e mbrojtjes nuk ishin shpërfillur, dhe se kërkuesi kishte pasur mundësi për të kontestuar autenticitetin e incizimit

---

[273] Që nga viti 1954 deri në vitin 1998 Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut (Komisioni) veprroi si ndërmjetës mes kërkuesve individualë dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Me miratimin e Protokollit 11, Komisioni u hoq në favor të qasjes direkte në Gjykatë.



dhe për ta kundërshtuar përdorimin e tij si provë kundër tij. U deklarua se kërkuesi kishte qenë në dijeni se incizimi ishte marrë ilegalisht, dhe në fakt ai fillimisht ishte pajtuar që incizimi të dëgjohej në gjykatë. Më tej, avokati i kërkuesit nuk kishte kërkuar të merrte në pyetje z. Pauty në gjyqin e parë, dhe kërkuesi nuk e kishte ftuar Inspektorin Messerli të paraqitej. Më tej u theksua se sidoqoftë do të kishte qenë e mjaftueshme të dëgjohej dëshmia e z. Pauty si dëshmitar në lidhje me përmbajtjen e incizimit, çka ishte arsye e mëtëjshme përse kasete nuk ishte deklaruar e papranueshme. Në fund, Gjykata theksoi se incizimi nuk ishte e vetmja provë mbi të cilën u mbështet Gjykata Penale në Rolle për dënimin e kërkuesit, dhe se ishin marrë parasysh një kombinim i elementeve provuese të cilat detajoheshin plotësisht në disa pjesë të vendimit përfundimtar. Duke parë këto arsye, Gjykata gjeti se përdorimi i incizimit ilegal të bisedës mes kërkuesit dhe z. Pauty nuk e privoi të parin nga procesi i rregullt, dhe se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 § 1.

#### Neni 6 § 2

Kërkuesi u ankua se për shkak të përdorimit të incizimit të marrë ilegalisht ai nuk ishte vërtetuar fajtor "në përputhje me ligjin". Në parashtrimin e kërkuesit kishte pasur dështim për të aplikuar parimin e prezumimit të pafajësisë i garantuar me Nenin 6 § 2. Gjykata gjeti se asgjë nuk sugjeronte që Gjykata Penale në Rolle e kishte trajtuar kërkuesin sikur të ishte fajtor para se ta dënonte, dhe thjesht përfshirja e kasetës dhe incizimit në prova nuk e mbështeste akuzën e kërkuesit për neglizhim të prezumimit të pafajësisë. Prandaj, Gjykata gjeti se nuk kishte shkelje të Nenit 6 § 2.

#### Neni 8

Kërkuesi pretendoi në fund se ishte viktimë e shkeljes së të drejtës së tij nga Neni 8 për respekt ndaj jetës private dhe korrespondencës së tij, e cila përfshinte të drejtën për konfidencialitetin e komunikimeve telefonike.

Gjykata nënvizoi se Komisioni tashmë e kishte deklaruar ankesën e kërkuesit të papranueshme në lidhje me bërjen e incizimit sipas Nenit 8 në vendimin e tij të 6 marsit 1986, mbi bazën se zgjidhjet vendase nuk ishin shteruar. Prandaj, Gjykata deklaroi se ajo tashmë e kishte trajtuar përdorimin e kasetës gjatë hetimeve gjyqësore dhe gjyqit nga këndvështrimi i Nenit 6, dhe se nuk ishte e nevojshme të shqyrtuar mundësia e një shkeljeje të Nenit 8.

*Transmetimi i të dhënave tek Autoriteti Holandez i Konkurrencës të cilat u përftuan në mënyrë të paligjshme në kuadër të hetimeve penale, dhe u përdorën në procedura ligjore të ndara të konkurrencës, nuk shkelti Nenin 8*

VENDIMI NË ÇËSHTJEN  
**SHIPS WASTE OIL COLLECTOR B.V. k. HOLLANDËS**<sup>[274]</sup>

(Kërkesa Nr. 2799/16)  
**16 maj 2023**

## 1. Faktet kryesore

Kërkuesja ishte një kompani holandeze e përfshirë në grumbullimin e mbetjeve të lëngshme nga anijet në rajonin e portit të Roterdamit. Në prill 2008, në kuadër të hetimeve penale për hedhjen ilegale potenciale të mbetjeve të ndotura, Shërbimi i Inteligjencës dhe Hetimeve nga Ministria për Strehim, Planifikim Hapësinor dhe Mjedis, duke vepruar me autorizimin e një gjyqtari hetues, përgjoi dhe incizoi telefonata mes një punonjësi të njëjës prej kompanive nën hetime dhe një punonjësi të kompanisë kërkuese, bisedë e cila përmbante tregues të marrëveshjeve për caktimin e çmimeve mes tyre.

Këto incizime u gjykua se ishin me interes potencial për Autoritetin Holandez të Konkurrencës (NMA). Në përputhje me Ligjin për të Dhënat Gjyqësore dhe Penale (WJSG), Shërbimi Prokurorial Publik (PPS) dha leje që incizimet të transmetoheshin në NMA. Incizime të ndryshme u transmetuan disa herë, duke nisur nga qershori 2009 e deri në vitin 2010.

Pas kësaj, NMA hapi hetimet zyrtare për shkelje të mundshme të Ligjit të Konkurrencës (Ligji), të cilat kulminuan me gjetjen e një shkeljeje nga kërkuesja të seksionit 6 të Ligjit. Në nëntor 2011, NMA i vuri kërkueses një gjobë në shumën 834,000 Euro. Së bashku me disa kompani të tjera holandeze të cilat po ashtu ishte gjetur se kishin kryer shkelje të seksionit 6 të Ligjit, kërkuesja nisi një apel të suksesshëm në Gjykatën Rajonale, i cili i prishi vendimet e NMA-së. Pas një apeli të mëtejshëm nga organi pasardhës i NMA-së në Gjykatën Supreme Administrative për Tregti dhe Industri, një vendim i marrë në korrik 2015 prishi vendimin e Gjykatës Rajonale, rrëzoi kundër-apelin e kompanisë kërkuese, dhe e ktheu çështjen në Gjykatën Rajonale.

---

[274] Vini re që kërkesa për referim drejtuar Dhomës së Madhe sipas Nenit 43 është pranuar dhe Dhoma e Madhe do të marrë vendim të ri në lidhje me këtë çështje.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Kërkuesja u mbështet tek Neni 8 (e drejta për respekt ndaj jetës private dhe familjare) dhe Nenin 13 (e drejta për zgjidhje efektive) të Konventës, duke u ankuar që transmetimi dhe përdorimi i mëpasëm i të dhënave që ishin jorelevante për hetimet penale përbëri shkelje të të drejtave të saj nga Neni 8, dhe që ajo nuk kishte pasur qasje në zgjidhje efektive siç parashikohet në Nenin 13.

### Neni 8

Gjykata vlerësoi nëse kishte pasur shkelje të Nenit 8 duke shqyrtuar: (i) nëse kishte pasur ndërhyrje, (ii) nëse ndërhyrja kishte qenë në përputhje me ligjin, (iii) nëse ndërhyrja kishte synuar një qëllim legjitim, dhe (iv) nëse ndërhyrja kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Në lidhje me pikën (i), Gjykata përsëriti se personat ligjorë mund të pretendojnë të drejta për respekt ndaj ambienteve të tyre të biznesit dhe korrespondencën sipas Nenit 8, dhe pranoi se transmetimi tek NMA i të dhënave të përfuara gjatë hetimeve penale përmes përgjimit të telefonatave kishte përbërë ndërhyrje tek të drejtat e kërkueses sipas Nenit 8.

Në lidhje me pikën (ii), Gjykata së pari theksoi se ankesat e kërkueses kishin të bënin me transmetimin e të dhënave të cilat ishin mbledhur ligjërisht në kuadër të hetimeve penale dhe përdorimin e mëpasëm i këtyre të dhënave për procedura ligjore të konkurrencës. Ankesat e kërkueses nuk kishin të bënin me përgjimin e vetë të dhënave, ligjshmëria e të cilit nuk u vu në dyshim. Prandaj, Gjykata vazhdoi mbi bazën e faktit se të dhënat ishin marrë përmes metodave të pajtueshme me Nenin 8.

Gjykata njohu se fakti që transmetimi i të dhënave kishte ndodhur pa dijeninë e kërkueses ngrinte çështjen e kriterit të parashikueshmërisë së ligjit në kontekstin e vëzhgimit sekret. Kërkuesja kishte diskutuar se nuk kishte qenë e parashikueshme që të dhënat që nuk janë relevante për hetimet penale do të kualifikoheshin si të dhëna penale brenda kuptimit të WJSG-së, e rrjedhimisht do të ishin të transmetueshme. Kërkuesja gjithashtu kishte diskutuar që transmetimi nuk kishte qenë i parashikueshëm meqenëse legjislacioni kishte dështuar në përcaktimin e detajeve të mjaftueshme për shkallën e diskrecionit të autoriteteve për të ushtruar fuqitë e tyre sipas WJSG-së.

Duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore të mëparshme, Gjykata tërhoqi vëmendjen drejt kriterit që e drejta kombëtare duhet të jetë mjaftueshëm e parashikueshme aq sa t'u mundësojë individëve që të veprojnë në përputhje me të, dhe sqaroi se ky kriter i parashikueshmërisë, në kontekstin e masave të vëzhgimit sekret, nuk mund të nënkuptonte që një individ duhet të jetë në gjendje të parashikojë se kur komunikimet e tij/saj kanë gjasa të përgjohen nga autoritetet. Gjykata deklaroi se, meqenëse të dhënat ishin përgjuar e më pas transmetuar si pjesa e dytë e hetimeve të ndara penale, kriteri i parashikueshmërisë nuk nënkuptonte se autoritetet duhet të njoftonin kërkuesen që të dhënat penale do të transmetoheshin në NMA. Gjykata gjeti se ndërhyrja kishte bazë ligjore sipas seksionit 39f të WJSG-së, i cili përcaktonte kufijtë e, dhe kushtet për, transmetimin e të dhënave nga PPS. Gjykata theksoi se seksioni 39f përmbante dispozita eksplicite për autoritetet e ngarkuara me zbatimin e legjislacionit si të autorizuar për pranimin e të dhënave penale, dhe më tej konsideroi se ishte e qartë që NMA ishte e ngarkuar me zbatimin e Ligjit. Prandaj, Gjykata gjeti se ishte mjaftueshëm e parashikueshme që NMA ishte e autorizuar për të pranuar të dhëna penale, dhe që transmetimi i të dhënave kishte qenë në përputhje me ligjin.

Në lidhje me pikën (iii), Gjykata iu referua çështjeve të mëparshme në lidhje me konkurrencën, dhe e pranoi argumentin e Qeverisë se ishte e dukshme që transmetimi i të dhënave i kishte shërbyer qëllimit legjitim të mbrojtjes së ekonomisë dhe mirëqenies së vendit.

Në lidhje me pikën (iv), Gjykata theksoi që seksioni 39f i WJSG-së kishte përcaktuar kufijtë dhe kushtet për transmetimin e të dhënave penale nga PPS, çka përbënte masa të mjaftueshme mbrojtëse për të parandaluar abuzimin e ndërhyrjeve. Gjykata gjithashtu theksoi se historia legjislative e WJSG-së shprehimisht bënte lidhjen e një "interesi të përgjithshëm detyrues" me qëllimet legjitime të renditura në Nenin 8 § 2. Pas njohjes së domethënies së procedurës *ex post facto* të mbikëqyrjes gjyqësore, dhe pas gjetjes që gjykatat vendase e kishin realizuar aktin balancues duke konsideruar në mënyrë të përshtatshme interesat konkurruese të kompanisë kërkuese, karshi interesave të autoriteteve për të mbrojtur mirëqenien ekonomike të vendit, Gjykata deklaroi që ndërhyrja kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Prandaj, Gjykata gjeti që transmetimi i të dhënave në fjalë ishte në pajtueshmëri me Nenin 8, dhe që nuk kishte pasur shkelje.

### Neni 13

Gjykata gjeti që kërkesja nuk ishte privuar nga zgjidhja efektive duke mos u njoftuar për transmetimin paraprakisht, dhe që, pas ekzaminimit të Nenit 8, kërkesja kishte pasur rrugë në dispozicion për të ngritur ankesat e saj, dhe prandaj nuk kishte pasur shkelje të Nenit 13.

*Pas bastisjeve të pabazuara dhe konfiskimit të dokumenteve në zyrat e kompanive mbi bazën e një urdhërese që synonte shtypjen e veprave kundër ligjeve ekonomike, koncepti i "shtëpisë" u gjet se shtrihej edhe në ambientet profesionale, dhe u gjet shkelje e Nenit 8*

## ÇËSHTJA **SOCIÉTÉ COLAS EST DHE TË TJERË K. FRANCËS**

(Kërkesa Nr. 37971/97)  
**16 prill 2002**

### **1. Faktet kryesore**

Tri kompanitë kërkuese, të vendosura në rajone të ndryshme të Francës, ishin të angazhuara në punime publike rrugore. Pas ankesave që firma të mëdha ndërtimi ishin duke marrë pjesë në praktika ilegale, kompanitë kërkuese u bënë pjesë e hetimeve të gjera për sjelljen e kontraktorëve të punëve publike në procedurat e tenderimit në lidhje me 56 kompani në 17 *départements*, zhvilluar nga Departamenti i Konkurrencës, Çështjeve të Konsumatorit dhe Parandalimit të Mashtrimit ("DGCCRF").

Më 19 nëntor 1985, inspektorët e DGCCRF zhvilluan bastisje të papritura simultane tek të 56 kompanitë pa autorizim nga menaxhmenti i kompanive, ku konfiskuan mijëra dokumente. Kjo u ndoq nga hetime të mëtejshme që vijuan më 15 tetor 1986 për të mbledhur deklaratat. Inspektorët hynë në zyrat e kompanive kërkuese mbi bazën e Urdhëresës Nr. 45-1484 të 30 qershorit 1945 për identifikimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e shkeljeve të ligjeve financiare, që i lejonte ata të vepronin kështu pa autorizim ose mbikëqyrje gjyqësore.

Gjatë bastisjeve, inspektorët kapën shumë dokumente që provonin marrëveshje të paligjshme në lidhje me kontrata të caktuara të cilat nuk ishin të përfshira në listën e kontratave nën hetime. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, Këshillit të Konkurrencës iu kërkua nga Ministri i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit dhe DGCCRF që të hetonte rreth praktikave ilegale të supozuara, ku më pas kompanitë kërkuese morën gjoba të konsiderueshme.

Kërkuesit e kontestuan ligjshmërinë e bastisjeve dhe konfiskimeve të bëra pa autorizim gjyqësor sipas Urdhëresës së vitit 1945 në Gjykatën e Apelit të Parisit e cila, pas rigjyqimit, i mbështeti gjobat, megjithëse i reduktoi ato. Apelet e mëpasme drejtuar Gjykatës së Kasacionit u refuzuan.

## 2. Vendimi i Gjykatës

Duke u mbështetur tek Neni 8 i Konventës, kompanitë kërkuese u ankuan se bastisjet e kryera nga inspektorët zyrtarë më 19 nëntor 1985 dhe më 15 tetor 1986, të zhvilluara pa mbikëqyrje apo kufizime, shkelën të drejtën e tyre për respekt ndaj shtëpisë së tyre.

### Neni 8

Gjykata filloi duke rideklaruar parimet e vendosura sipas Nenit 8 të Konventës dhe zbatueshmërinë e tyre tek "shtëpitë" e personave juridikë, siç ishin kompanitë kërkuese. Duke përsëritur statusin e Konventës si instrument i gjallë, u deklarua se në rrethana të caktuara, të drejtat e garantuara me Nenin 8 mund të interpretohen si të tilla që përfshijnë të drejtën e respektit për zyrat e një kompanie, degëve ose filialeve të saj ose ambiente të tjera biznesi.

Gjykata gjeti se bastisjet e papritura të kryera në zyrat qendrore dhe lokale të kompanive kërkuese me qëllim të konfiskimeve për të marrë prova rreth marrëveshjeve ilegale mes kontraktorëve të punëve publike pas caktimit të kontratave për punime rrugore, përbëri ndërhyrje tek e drejta e këtyre kompanive për respektim të shtëpisë së tyre. Më tej, ato u zhvilluan në përputhje me ligjin dhe në vijim të qëllimeve legjitime për qëllimet e Nenit 8 § 2, si në interes të mirëqenies ekonomike të vendit ashtu edhe për parandalimin e veprave penale.

Megjithatë, duke iu kthyer çështjes nëse ndërhyrja e kontestuar mund të konsiderohej "e nevojshme në një shoqëri demokratike", Gjykata theksoi se megjithëse ndërhyrja mund të kishte qenë e justifikuar nga nevoja për operacione të gjera për të shmangur zhdukjen ose fshehjen e provave të praktikave anti-konkurrencë, ligjet dhe praktikat përkatëse sidoqoftë duhet të kishin siguruar mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive kundër abuzimeve. Gjykata gjeti se kjo nuk ndodhi në rastin konkret. Sipas urdhrit të vitit 1945 ashtu siç ishte i aplikueshëm në atë kohë, ku reformat legjislative të vitit 1986 nuk ishin ende në fuqi, departamenti përkatës kishte fuqi shumë të gjera që e lejonin që i vetëm të përcaktonte shpejtësinë, numrin, kohëzgjatjen dhe shkallën e këtyre operacioneve. Më tej, këto operacione ishin zhvilluar pa një urdhër të mëparshëm të lëshuar nga një gjyqtar dhe në mungesë të zyrtarëve të lartë policorë.

Për pasojë, megjithëse Gjykata pranoi se e drejta për të ndërhyrë mund të jetë më e gjerë në rastin e ambienteve komerciale të një kompanie, duke pasur

parasysh natyrën e bastisjeve të kontestuara dhe konfiskimeve të bëra në fushën e konkurrencës, ato nuk mund të konsideroheshin se ishin proporcionale me qëllimet e tyre legjitime. Prandaj, u gjet shkelje e Nenit 8.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi secilës kërkuese € 5,000 për dëme dhe € 6,700, € 12,000 dhe € 4,400 respektivisht kompanive kërkuese për kosto dhe shpenzime.



*Zbulimi i identitetit të një individi, në një vendim të publikuar në të cilin palë ishin autoritetet lokale e jo kërkuesi, dhe ku ato u akuzuan për sjellje stigmatizuese, shkeli të drejtën për respekt ndaj jetës private nga Neni 8*

## VENDIMI NË ÇËSHTJEN **VICENT DEL CAMPO k. SPANJËS**

(Kërkesa Nr. 25527/13)

**6 nëntor 2018**

### **1. Faktet kryesore**

Kërkuesi ishte i lindur në vitin 1957, dhe jetonte në León, Spanjë. Ai punonte si mësues dhe kryetar departamenti në Shkollën e Arteve dhe Zejeve në León, një shkollë publike lokale. Duke filluar nga viti 2006, një koleg dhe mësues në departamentin e tij bëri ankesa të shumta me shkrim kundër kërkuesit pranë autoriteteve lokale dhe rajonale. Në këto ankesa, kërkuesi akuzohej për ngacmim psikologjik të kolegut në vendin e punës.

Pasi ankesat e tij u rrëzuan nga autoritetet lokale dhe rajonale, kolegu nisi procedurën gjyqësore kundër administratës arsimore për dështimin e saj për të parandaluar ngacmimin e pretenduar, pa dijeninë e kërkuesit. Në vitin 2011, Gjykata e Lartë e Drejtësisë në Castilla-León gjykoi që ngacmimi i përsëritur psikologjik kishte ndodhur, përfshirë nënçmime të vazhdueshme publike dhe kërcënime me vdekje, duke e identifikuar kërkuesin me emër. Gjykata e Lartë e Drejtësisë urdhëroi administratën që të paguante 14,500 euro.

Kërkuesi më vonë mësoi rreth këtij vendimi përmes një artikulli në gazetën lokale, dhe në këtë kohë ai kërkoi të bëhej pjesë e procedurës. Gjykata e Lartë e Drejtësisë e refuzoi kërkesën e tij, me arsyetimin se ai nuk mund të konsiderohej "palë e interesuar" në një procedurë kundër administratës arsimore.

### **2. Vendimi i Gjykatës**

Kërkuesi u ankua se Gjykata e Lartë e Drejtësisë kishte shkelur të drejtat e tij nga Neni 8 i Konventës duke e asociuar atë publikisht me akuzën stigmatizuese të ngacmimit, gjë që kishte ndikuar negativisht në jetën e tij private dhe familjare, në reputacionin e tij dhe në perspektivën e tij të punësimit. Më tej, kërkuesi u ankua se, me refuzimin e kërkesës së tij për t'u bërë palë në procedurë, Gjykata e Lartë e

Drejtësisë ia kishte mohuar atij të drejtën për qasje në gjykatë, pra të drejtën e tij për zgjidhje efektive, në shkëlqje të Neneve 6 dhe 13, respektivisht.

## Neni 8

Gjykata theksoi se Gjykata e Lartë e Drejtësisë e kishte si mundësinë ashtu edhe detyrimin për të marrë masat e duhura për të mbrojtur reputacionin dhe jetën private të palëve, përfshirë diskrecionin për mos zbuluar emrat në vendim, për të shmangur identifikimin e palëve të paidentifikuara kudo që ishte e mundur, dhe për të kufizuar publikimin ose qasjen në vendim me qëllim të mbrojtjes së individëve të emërtuar.

Gjykata gjeti se veprimet e Gjykatës së Lartë të Drejtësisë ndërhyjnë tek të drejtat e kërkuarit nga Neni 8. Kur Gjykata e Lartë e Drejtësisë përcaktoi që veprimet e pretenduara përbënë ngacmim të përsëritur psikologjik dhe e identifikoi kërkuarin me emër, ajo e ekspozoi atë ndaj stigmës që kishte gjasa të sillte efekt domethënës mbi jetën e tij personale. Një impakt i tillë përfshinte humbjen e mundshme të gëzimit të jetës private dhe familjare, dëme në marrëdhëniet e tij ose në reputacionin e tij, dhe dëm në integritetin e tij moral dhe nderin personal.

Gjykata e Lartë e Drejtësisë kishte vepruar në përputhje me ligjin, dhe me qëllimet legjitime të transparencës gjyqësore, duke dekurajuar ngacmimin në vendin e punës, dhe duke kërkuar llogari nga autoritetet lokale për parandalimin e tij. Megjithatë, Gjykata gjeti se Gjykata e Lartë e Drejtësisë nuk e kishte kufizuar arsyetimin e saj brenda pyetjeve imediate nëse trajtimi i pretenduar kishte përbërë ngacmim, dhe, në rast se po, nëse autoritetet arsimore ishin drejtpërdrejt përgjegjëse për dështimin e tyre për të mbrojtur kolegun. Sipas të drejtës dhe praktikës vendase, përgjegjësia nga ana e autoriteteve arsimore nuk varej nga identifikimi i individit përgjegjës për ngacmimin; vendimi për ta përmendur me emër kërkuarin ishte në diskrecionin e Gjykatës së Lartë të Drejtësisë. Përtej justifikimeve të mëtejshme të politikave publike, ndërhyrja tek të drejtat e kërkuarit nga Neni 8 ishte e paarsyetuar.

Më tej, pas marrjes së vendimit ai do të bëhej publik, pra në vendim do të kishin qasje palët e treta dhe mediat, duke dalë kështu jashtë kontrollit mbikëqyrës të Gjykatës së Lartë të Drejtësisë. Në këtë rast, çështja pati rëndësi të konsiderueshme në media, siç u dëshmuua pjesërisht nga fakti që kërkuari mori vesh për procedurën përmes gazetës lokale. Për shkak se kërkuari nuk ishte palë në procedurë, dhe as nuk u ftua e as nuk u informua gjatë vijimit të procedurës, zbulimi i identitetit të

kërkuesit nuk mund të ishte konsideruar pasojë e parashikueshme e veprimeve të atij vetë. Gjykata nënvizoi se, duke mos qenë vënë në dijeni për procedurën deri pas marrjes së vendimit, kërkuesit i ishte mohuar mundësia qoftë për të mbrojtur veten, qoftë për të kërkuar që identiteti i tij të mos zbulohej publikisht.

Masat mbrojtëse ishin në dispozicion dhe mund të kishin përmirësuar dukshëm dëmin ndaj jetës private të kërkuesit. Përveç kësaj, Gjykata e Lartë e Drejtësisë kishte detyrimin afirmativ për të mbrojtur të drejtat e palëve nga Neni 8 për reputacion. Duke pasur parasysh të gjitha këto, dështimi i Gjykatës së Lartë të Drejtësisë për të futur mbrojtje efektive dhe të gatshme, pa justifikim të mjaftueshëm, ishte joproporcional me qëllimet legjitime të synuara.

Prandaj, Gjykata gjeti që kishte pasur shkelje të së drejtës së kërkuesit nga Neni 8 për respekt ndaj jetës private.

#### Neni 6 § 1

Pas gjetjes që argumentet e kërkuesit, duke iu referuar Nenit 6 § 1, ishin të lidhura me mohimin e të drejtave të tij nga Neni 8, nuk qe e nevojshme që ky pretendim të shqyrtohej në mënyrë të pavarur.

#### Neni 13

Më tej, pas gjetjes që argumentet e kërkuesit, duke iu referuar Nenit 13, ishin të lidhura me mohimin e të drejtave të tij nga Neni 8, nuk qe e nevojshme që ky pretendim të shqyrtohej në mënyrë të pavarur.

#### Neni 41

Gjykata i caktoi kërkuesit 12,000 euro për dëme jomateriale, dhe 9,268.60 euro për kosto dhe shpenzime.

*Mburoja e Privatësisë BE-SHBA, që ofronte një mekanizëm transferimi për të dhënat personale nga Shtetet Anëtare të BE-së tek SHBA, u deklarua se ishte e pavlefshme sepse qe e pamjaftueshme për të siguruar mbrojtje të mjaftueshme për të dhënat personale. Klauzolat kontraktuale standarde ishin ende mekanizëm i vlefshëm transferimi në parim, por kontrolluesit e të dhënave duhet të marrin përsipër punë shtesë për t'u siguruar që vendi i tretë ka mbrojtje të barasvlershme të të dhënave*

VENDIMI I GJYKATËS (DHOMA E MADHE) NË ÇËSHTJEN E  
**E KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E  
TË DHËNAVE K. FACEBOOK IRELAND  
LIMITED DHE MAXIMILLIAN SCHREMS**

(Çështja Nr. C-311/18)  
16 korrik 2020

## 1. Faktet kryesore

Kjo çështje ishte referencë paraprake që doli nga Gjykata e Lartë (Irlandë) në lidhje me vendimin e përshtatshmërisë së BE-së në lidhje me transferimin e të dhënave personale drejt SHBA-ve ("Mburoja e Privatësisë BE-SHBA")<sup>[275]</sup> dhe klauzolat kontraktuale standarde të BE-së për transferimin e të dhënave personale tek vendet e treta.

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (ang. GDPR) e kufizon transferimin e të dhënave personale jashtë BE-së por ofron disa mekanizma për transferimin e të dhënave tek të cilët mund të mbështeten kontrolluesit e të dhënave për të bërë transferimin e të dhënave personale nga një Shtet Anëtar tek një vend i tretë (ashtu siç funksiononte Direktiva për Mbrojtjen e të Dhënave (Direktiva 95/46/KE) para saj). GDPR lejon transferimet që bëhen në bazë të një vendimi nga Komisioni Evropian që vendi i tretë ofron nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje për të dhënat personale ("vendimi i përshtatshmërisë"). Në mungesë të vendimit të përshtatshmërisë, alternativa më e zakonshme është përdorimi i klauzolave kontraktuale standarde (ang. SCC) të miratuara nga Komisioni Evropian.

Maximillian Schrems, shtetas austriak, kishte nga viti 2008 që përdorte platformën e medias sociale Facebook. Në vitin 2013, Schrems bëri ankesë tek

---

[275] Në pajtim me Vendimin Implementues të Komisionit (EU) 2016/1250.

Komisioneri i të Dhënave në Irlandë ("Komisioneri") duke kërkuar që Facebook Ireland të ndalohej nga transferimi i të dhënave të tij tek Shtetet e Bashkuara, për shkak se vendimi i Komisionit Evropian për përshtatshmërinë në lidhje me entitetet amerikane që respektonte kornizën 'Porti i Sigurt' (ang. Safe Harbor) ishte i pavlefshëm meqenëse ligjet dhe praktikat në fuqi në SHBA nuk siguronin mbrojtje të mjaftueshme për të dhënat personale, në mënyrë të veçantë kundër aktiviteteve shtetërore të vëzhgimit.

Në një vendim të 6 tetorit 2015 në *Schrems I* (Çështja Nr. C-362/14), Porti i Sigurt u deklarua i pavlefshëm. Duke ia referuar çështjen mbrapa gjykatës referuese, Gjykata e Lartë (Irlandë) ia referoi vendimin Komisionerit përsëri. Gjatë hetimeve të Komisionerit, ndodhi që një pjesë e madhe e të dhënave personale u ishin transferuar SHBA-ve sipas klauzolave kontraktuale standarde në shtojcën e Vendimit 2010/87/EU, i ndryshuar nga Komisioni Implementues i Vendimit (EU) 2016/2297 ("Vendimi i SCC-së") në vend të mbështetjes tek Porti i Sigurt, dhe Komisioneri e ftoi Schrems që ta riformulonte ankesën e tij.

Pasi e bëri këtë, vlefshmëria e Vendimit të SCC-së u vu në pikëpyetje, dhe një referencë e mëtejshme u bë drejt Gjykatës së Lartë (Irlandë).

Çështja u kthye mbi bazën e vlefshmërisë së Vendimit të SCC-së dhe përshtatshmëria e vendimit në lidhje me Mburojën e Privatësisë (kornizë pasardhëse e Portit të Sigurt) duke marrë për bazë parimin themelor që të dhënat e transferuara tek një vend i tretë duhet të kenë mbrojtjet e duhura në krahasim me ato të garantuara brenda BE-së nga GDPR.

## **2. Pyetjet e bëra nga gjykata kombëtare**

Gjykata e Lartë (Irlandë) së pari pyeti nëse e drejta e BE-së i aplikohet transferimit të të dhënave personale nga një kompani private nga një Shtet Anëtar tek një vend i tretë në përputhje me Vendimin e SCC-së, kur ato të dhëna personale mund të përpunohen më tej për qëllime të sigurisë kombëtare dhe zbatimit të ligjit në vendin e tretë, pavarësisht nga Neni 4(2) i TEU dhe Neni 3(2) i Direktivës për Mbrojtjen e të Dhënave.

Së dyti, gjykata kombëtare pyeti se çfarë niveli mbrojtjeje kërkohen nga Nenet 46(1) dhe 46(2)(c) të GDPR-së në lidhje me transferimin e të dhënave personale tek një vend i tretë mbi bazën e SCC-së.

Së treti, gjykata kombëtare pyeti nëse Nenet 58(2)(f) dhe (j) GDPR nënkuptonin që kërkohet një autoritet mbikëqyrës kompetent për të suspenduar ose ndaluar transferimin e të dhënave personale tek një vend i tretë sipas SCC-së, sipas pikëpamjes së autoritetit mbikëqyrës, ato klauzola nuk respektohen ose nuk mund të respektohen në vendin e tretë dhe mbrojtja e të dhënave të transferuara (siç kërkohet nga GDPR dhe Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (CFR) nuk mund të sigurohet; dhe nëse ushtrimi i këtyre fuqive është i kufizuar tek çështje të jashtëzakonshme.

Në fund, gjykata kombëtare pyeti nëse Vendimi i SCC-së ishte i vlefshëm, nën dritën e Neneve 7, 8 dhe 47 të CFR-së; dhe (megjithëse referenca u bë para miratimit të saj), në thelb, nëse Mbyroja e Privatësisë BE-SHBA ofronte nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje.

### 3. Vendimi i GjDBE-së

Në përgjigje të pretendimeve që referenca paraprake ishte e papranueshme për shkak të shfuqizimit të Direktivës për Mbrojtjen e të Dhënave dhe zëvendësimin e saj me GDPR, GjDBE deklaroi se Direktiva për Mbrojtjen e të Dhënave ishte në fuqi kur u bë referenca paraprake, dhe se GDPR në thelb riprodhon disa nene relevante të Direktivës për Mbrojtjen e të Dhënave. GjDBE e mori vendimin e saj mbi bazën e GDPR-së e jo mbi bazën e direktivës pararendëse sepse Komisioneri i të Dhënave në Irlandë nuk e kishte marrë vendimin përfundimtar për ankesën *Schrem* (e cila kishte të bënte me përpunime të ardhshme të të dhënave) kur GDPR hyri në fuqi.

Sa i përket pyetjes së parë, GjDBE vendosi që, pavarësisht nga kufizimet e fushëveprimit të GDPR-së në lidhje me sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen, GDPR nuk i aplikohet transferimit të të dhënave personale nga një kompani private në një Shtet Anëtar drejt një kompanie private në një vend të tretë, pavarësisht nga fakti nëse, në atë kohë apo në një kohë tjetër, të dhënat mund të përpunohen nga autoritetet e një vendi të tretë për qëllime të sigurisë publike, mbrojtjes ose sigurimit të shtetit. Përpunimi nga një palë e tretë për qëllime të tilla nuk mund të ishte jashtë fushëveprimit të GDPR-së sepse, mes arsyeve të tjera, Komisioni Evropian duhet specifikisht të marrë parasysh ligjet e një vendi të tretë "*përfshirë ato që kanë të bëjnë me sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë kombëtare dhe të drejtën penale dhe qasjen e autoriteteve publike tek të dhënat personale, si dhe zbatimin e një legjislacioni të tillë*" gjate vlerësimit të përshtatshmërisë së mbrojtjeve të atij vendi të tretë (Neni 45(2)(a) GDPR).

Sa i përket pyetjes së dytë, GjDBE vendosi që mbrojtjet e përshtatshme, të drejtat e zbatueshme dhe zgjidhjet efektive ligjore të kërkuara nga Nenet 46(1) dhe 46(2)(c) GDPR duhet të sigurohen që subjektet e të dhënave të dhënat personale të të cilëve janë transferuar tek një vend i tretë sipas SCC-së të kenë një nivel mbrojtjeje “në thelb të barasvlershëm” me ato të garantuara nga GDPR nën dritën e CFR-së. Gjatë vlerësimit të barasvlerës, duhet të merren parasysh të dy klauzolat kontraktuale të dakorduara mes kontrollorit/përpunuesit të të dhënave dhe pranuesit të vendit të tretë, si dhe sistemit ligjor të vendit të tretë (përfshirë faktorët joshterues të përcaktuar në Nenin 45(2) GDPR).

Sa i përket pyetjes së tretë, në mungesë të një vendimi për përshtatshmërinë e vlefshme nga Komisioni Evropian, autoriteti mbikëqyrës i një Shteti Anëtar duhet të suspendojë ose të ndalojë transferimin e të dhënave tek një vend i tretë sipas SCC-së së Komisionit Evropian nëqoftëse, sipas pikëpamjes së autoritetit mbikëqyrës dhe nën dritën e rrethanave të transferimit, SCC-të nuk respektohen ose nuk mund të respektohen në vendin e tretë dhe niveli i kërkuar i mbrojtjes nuk mund të sigurohet. Autoritetet mbikëqyrëse të Shteteve Anëtare janë përgjegjëse për monitorimin e pajtueshmërisë me GDPR-në dhe sigurimin e zbatimit të saj. Edhe kur ka një vendim të përshtatshmërisë, një autoritet kompetent kombëtar mbikëqyrës duhet të arrijë të vlerësojë në mënyrë të pavarur nëse transferimi i të dhënave relevante është në përputhje me GDPR-në dhe, kur duhet, të nisë procedura para gjykatave kombëtare ose të bëjë referencë për vendim paraprak nga GjDBE në lidhje me vlefshmërinë e vendimit të përshtatshmërisë. Megjithatë, kur ka një *vendim të përshtatshmërisë*, autoriteti mbikëqyrës kombëtar nuk e ka fuqinë për të suspenduar ose ndaluar transferimin mbi bazën se ai konsideron, në kundërshtim me vendimin e Komisionit Evropian, që nivelet e duhura të mbrojtjes nuk sigurohen dot nëqoftëse dhe deri kur GjDBE ta deklarojë të pavlefshëm vendimin e përshtatshmërisë.

Ndërkohë që Vendimi i SCC-së u vendos të qëndronte i vlefshëm, Mburoja e Privatësisë BE-SHBA u vendos se ishte e pavlefshme. Bazat mbi të cilat u vunë në pikëpyetje mbrojtjet e Mburojës së Privatësisë BE-SHBA përqendroheshin rreth programeve amerikane të vëzhgimit PRISM dhe UPSTREAM, të cilat kërkonin që autoritete të ndryshme publike amerikane të kishin qasje të tërësishme tek të dhëna të caktuara personale të shtetasve joamerikanë që ndodheshin jashtë SHBA-ve. Të dhënat e përpunuara u gjet se ishin përtej asaj që konsiderohet rreptësisht e nevojshme për qëllimet e së drejtës së BE-së. Në mënyrë të veçantë, u theksua se shtetasit joamerikanë nuk kishin të njëjtat të drejta praktike për shqyrtim gjyqësor si shtetasit amerikanë kundër autoriteteve të SHBA-ve në lidhje me të dhënat e

tyre. Një mekanizëm ombudspersoni ishte futur si pjesë e Mburojës së Privatësisë BE-SHBA, por GjDBE gjeti që kjo ishte e pamjaftueshme për të zgjidhur mangësitë e gjetura në mbrojtjet gjyqësore të subjekteve të të dhënave të dhënat e të cilëve transferohen në SHBA meqenëse ombudspersoni nuk ka fuqinë për të miratuar një vendim që do të ishte detyrues për shërbimeve amerikane të inteligjencës. Kjo mungesë e mbrojtjes gjyqësore nënkuptonte se Mburoja e Privatësisë BE-SHBA nuk siguronte “barasvlerë thelbësore” për mbrojtjet e ofruara sipas GDPR-së, dhe prandaj Mburoja e Privatësisë BE-SHBA nuk ishte në pajtueshmëri me GDPR-në e rrjedhimisht ishte e pavlefshme.

Meqenëse SCC-të janë detyruese vetëm për kontrolluesit/përpunuesit në BE dhe për pranuesit e transferimit të të dhënave në vendin e tretë pranues (si palë në kontratë), dhe jo për autoritetet në vendin e tretë relevant, GjDBE deklaroi se ka rrethana në të cilat SCC-të mund të jenë të pamjaftueshme për të siguruar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave; për shembull, kur ligjet e vendit të tretë mundësojnë që autoritetet publike të ndërhyjnë në mënyrë joproporcionale tek të drejtat e subjekteve të të dhënave. U theksua se mekanizmi i SCC-së për transferimin e të dhënave dallonte nga mekanizmi për vendimin e përshtatshmërisë sepse nuk përfshinte ekzaminimin e legjislacionit në vendin e tretë, dhe se ishte përgjegjësia e kontrollorëve/përpunuesve në BE që të përcaktonin sipas rastit nëse kërkoheshin mbrojtje shtesë për të plotësuar ato që parashikonin SCC-të me qëllim që të sigurohej një nivel mbrojtjeje në thelb i barasvlershëm me atë të BE-së. Sipas SCC-ve, një importues të dhënash në një vend të tretë ishte i detyruar të njoftonte kontrolluesin e BE-së për çdo pamundësi të pajtueshmërisë me SCC-të.



*Direktiva 2006/24 nuk shtron rregulla të qarta dhe të sakta që qeverisin shkallën e ndërhyrjes tek të drejtat themelore të ngërthyera në Nenet 7 dhe 8 të Kartës së të Drejtave Themelore. Prandaj, Direktiva 2006/24 ndërthen një ndërhyrje të gjerë dhe veçanërisht serioze tek ato të drejta themelore në rendin ligjor të BE-së, ku një ndërhyrje e tillë nuk është saktësisht e përshkruar nga dispozita përkatëse për të siguruar që ajo në fakt të kufizohet me aq sa është rreptësisht e nevojshme. Prandaj Direktiva 2006/24 u deklarua e pavlefshme.*

VENDIMI I GJYKATËS (DHOMA E MADHE) NË ÇËSHTJET E BASHKUARA  
**LA QUADRATURE DU NET DHE TË TJERË K.  
PREMIER MINISTRE DHE TË TJERËVE, FRENCH  
DATA NETWORK DHE TË TJERË K. PREMIER  
MINISTRE DHE TË TJERËVE, SI DHE ORDRE DES  
BARREAUX FRANCOPHONES ET GERMANOPHONE  
DHE TË TJERË K. CONSEIL DES MINISTRES**

(Çështjet Nr. C-293/12 dhe C-594/12)  
**8 prill 2014**

## **1. Faktet kryesore**

Këto çështje ishin referenca paraprake të dala nga Gjykata e Lartë (Irlandë) dhe Verfassungsgerichtshof (Austri) në lidhje me detyrimet e vëna ndaj shërbimeve publike të komunikimeve elektronike ose rrjeteve të komunikimeve publike për të mbajtur të dhënat e trafikut dhe lokacionit të cilat gjenerohen ose përpunohen prej tyre dhe vlefshmëria e Direktivës 2006/24 të 15 marsit 2006 ("Direktiva për Mbajtjen e të Dhënave").

Qëllimi kryesor i Direktivës për Mbajtjen e të Dhënave ishte të harmonizonte legjislacionin e Shteteve Anëtare në lidhje me detyrimet e vëna ndaj ofruesve të shërbimeve elektronike publike ose rrjeteve të komunikimeve publike për mbajtjen e të dhënave të caktuara. Kjo u bë për të siguruar që të dhënat të ishin në dispozicion për parandalimin, hetimin, pikasjen dhe ndjekjen penale të krimeve të rënda. Kështu, në përputhje me Direktivën për Mbajtjen e të Dhënave, ofruesit ishin të detyruar të mbanin (ruanin) të dhënat për një periudhë mes gjashtë muajsh deri në dy vjet nga data e komunikimit. Përveç kësaj, Direktiva për Mbajtjen e të Dhënave kërkonte mbajtjen e metadata (të njohura si të dhënat e trafikut), por nuk kërkonte ruajtjen e përmbajtjes së komunikimeve mes abonentëve ose përdoruesve.

## 2. Pyetjet e bëra nga gjykata kombëtare

Në çështjen C-293/12, Digital Rights Ireland Ltd, organizatë irlandeze e të drejtave dixhitale, kontestoi ligjshmërinë e masave legislative dhe administrative kombëtare në lidhje me mbajtjen e të dhënave që kanë të bëjnë me komunikimet elektronike. Organizata i kërkoi Gjykatës së Lartë të Irlandës t'i deklaronte të pavlefshme Direktivën për Mbajtjen e të Dhënave dhe Pjesën 7 e Ligjit për Drejtësinë Penale (Veprat Terroriste) i vitit 2005. Meqenëse Gjykata e Lartë e Irlandës nuk mund të adresonte çështjet lidhur me të drejtën kombëtare pa shqyrtuar vlefshmërinë e Direktivës për Mbajtjen e të Dhënave, ajo zgjodhi t'i pezullonte procedurat dhe t'i referonte çështjet tek GjDBE për shqyrtim të mëtejshëm.

Sa i përket kërkesës për vendim paraprak të bërë nga Verfassungsgerichtshof (Gjykata Kushtetuese e Austrisë) në çështjen C-594/12, Kärntner Landesregierung (Qeveria e Provincës Carinthia), z. Seitlinger, z. Tschohl dhe 11,128 kërkues të tjerë kontestuan pajtueshmërinë me të Drejtën Kushtetuese Federale (*Bundes-Verfassungsgesetz*) të ligjit që zhvendoste Direktivën për Mbajtjen e të Dhënave në të drejtën austriake. Ata argumentuan se të drejtat e tyre themelore ishin shkelur. Gjykata referuese shprehu pasiguri në lidhje me çështjen nëse Direktiva për Mbajtjen e të Dhënave mund t'i arrinte objektivat e saj dhe vuri në pyetje proporcionalitetin e ndërhyrjes së saj tek të drejtat themelore në fjalë.

## 3. Vendimi i GjDBE-së

GjDBE e pa të nevojshme të adresonte çështjen e vlefshmërisë së Direktivës për Mbajtjen e të Dhënave nën dritën e të drejtës për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave ngërthyer në Nenet 7 dhe 8 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (ang. CFR).

GjDBE nuk pati vështirësi për të gjetur se Direktiva për Mbajtjen e të Dhënave ndërhynte tek mbrojtja e atyre dy të drejtave, duke theksuar se "*fakti që të dhënat mbahen dhe më pas përdoren pa u informuar abonenti ose përdoruesi i regjistruar ka gjasë të gjenerojë në mendjet e personave në fjalë ndjenjën që jetët e tyre private janë objekt i vëzhgimit të vazhdueshëm*". Pra analiza e saj u përqendrua në çështjen nëse një ndërhyrje e tillë mund të ishte e justifikuar.

Rregullat e justifikimit të ndërhyrjeve tek të drejtat e SFR-së përcaktohen në Nenin 52(1) të CFR-së. Çdo kufizim i të drejtave dhe lirive të CFR-së duhet të

jetë i parashikuar me ligj dhe të respektojë thelbin e atyre të drejtave dhe lirive. Duke iu nënshtruar parimit të proporcionalitetit, kufizimet mund të bëhen vetëm nëqoftëse janë të nevojshme dhe vërtet përmbushin objektivat e interesit të përgjithshëm të njohura nga BE-ja ose nevojën për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

GjDBE-ja iu referua justifikimit të interesit publik, pra sigurisë publike, për kufizimin e të drejtave të CFR-së në fjalë. Ajo gjithashtu theksoi se thelbi i të drejtave nuk prekej sepse, sa i përket të drejtës për privatësi, përmbajtja e komunikimeve nuk ishte incizuar dhe, sa i përket të drejtës për mbrojtjen e të dhënave, disa rregulla të përpunimit të të dhënave dhe sigurisë së të dhënave duhet të respektohen.

Për pasojë, çështja kyçe në vendimin e GjDBE-së ishte proporcionaliteti i ndërhyrjes tek të drejtat e CFR-së. GjDBE tregoi se shqyrtimi gjyqësor i diskrecionit të legjislaturës së BE-së duhet të ishte strikt në këtë rast, duke aplikuar faktorë siç janë fusha e së drejtës në fjalë, natyra e së drejtës, natyra dhe pesha e shkeljes, dhe objektivi i synuar.

Aspekti i parë i proporcionalitetit, pra i përshtatshmërisë së ndërhyrjes tek e drejta për arritjen e objektivit, përmbushej meqenëse të dhënat në fjalë mund të ishin të dobishme për hetime. Megjithatë, GjDBE gjeti se Direktiva për Mbajtjen e të Dhënave ishte problematike kur vinte puna tek aspekti i dytë i proporcionalitetit, pra nevojshmëria e masës në fjalë. GjDBE vendosi që objektivi i rëndësishëm i hetimit të krimeve të rënda dhe terrorizmit nuk e justifikonte mbajtjen e të dhënave.

Analiza e GjDBE-së më tej vazhdoi me përcaktimin e rëndësisë së përgjithshme të mbrojtjeve sa i përket mbrojtjes së të drejtave të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave mbi bazën e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Këto mbrojtje janë edhe më të rëndësishme kur të dhënat përpunohen automatikisht me rrezikun e qasjes së paligjshme.

Gjatë aplikimit të këtij testi, GjDBE dha tri arsye përse rregullat në Direktivën për Mbrojtjen e të Dhënave nuk ishin rreptësisht të nevojshme. Së pari, Direktiva për Mbajtjen e të Dhënave kishte fushëveprim jashtëzakonisht të gjerë, duke qenë se aplikohet në të gjitha mjetet e komunikimeve elektronike, të cilat shtrihen gjerësisht dhe kanë rëndësi gjithnjë e më të madhe në jetën e përditshme, pa u vënë në shënjestër mjaftueshëm. Për më tepër, GjDBE tha se kjo përfshin ndërhyrje tek të drejtat themelore të praktikisht tërë popullatës evropiane.

Së dyti, përveç mungesës së përgjithshme të kufizimeve në Direktivën për Mbajtjen e të Dhënave, ajo nuk e kufizonte qasjen në të dhënat me interes për autoritetet ligjzbatuese dhe përdorimin e mëtejshëm të atyre të dhënave. Në mënyrë të veçantë, Direktiva për Mbajtjen e të Dhënave nuk kufizonte qëllimin e qasjes vijuese tek ato të dhëna, nuk kufizonte numrin e personave që mund t'i shihnin ato të dhëna, dhe nuk kontrollonte qasjen tek të dhënat nga një gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër administrativ i pavarur.

Në fund, Direktiva për Mbajtjen e të Dhënave nuk përcaktonte mbrojtje të mjaftueshme në lidhje me periudhën e mbajtjes së të dhënave, mbrojtjen e të dhënave nga qasja dhe përdorimi i paligjshëm, mungesën e detyrimit për t'i shkatërruar të dhënat, si dhe heqjen e kërkesës për mbajtjen e të dhënave vetëm brenda BE-së.

*Rregulli që ndalon mbajtjen e përgjithshme dhe pa dallim të metadata-ve (informacion rreth të dhënave) qëndron, por masat legjislative që mundësojnë grumbullimin e të dhënave kur ekziston rreziku serioz ndaj sigurisë kombëtare mund të lejohen kur janë të kufizuara në kohë me aq sa është rreptësisht e nevojshme dhe në pajtueshmëri me liritë themelore dhe parimet e tjera të përgjithshme të së drejtës së BE-së.*

VENDIMI I GJYKATËS (DHOMA E MADHE) NË ÇËSHTJET E  
**BASHKUARA TË LA QUADRATURE DU NET DHE  
TË TJERË K. PREMIER MINISTRE DHE TË TJERËVE,  
FRENCH DATA NETËORK DHE TË TJERË K. PREMIER  
MINISTRE DHE TË TJERËVE, SI DHE ORDRE DES  
BARREAUX FRANCOPHONES ET GERMANOPHONE  
DHE TË TJERË V. CONSEIL DES MINISTRES**

(Çështjet Nr. C-511/18, C-512/18 dhe C-520/18)

**6 tetor 2020**

## **1. Faktet kryesore**

Këto tri çështje ishin referenca paraprake që vinin, respektivisht, nga Conseil d'État (Këshilli i Shtetit, Francë) dhe Cour Constitutionnelle (Gjykata Kushtetuese, Belgjikë) në lidhje me interpretimin e Nenit 15(1) të Direktivës 2002/58/EC të 12 korrikut 2002 ("Direktiva e e-Privatësisë"). Neni 15(1) i Direktivës së e-Privatësisë parashikon që Shtetet Anëtare mund të miratojnë ligje që kufizojnë të drejtat dhe detyrimet e caktuara në disa nene të tjera të Direktivës, përfshirë mbajtjen e kufizuar të të dhënave, kur është e nevojshme, e përshtatshme dhe proporcionale me mbrojtjen e sigurisë kombëtare, mbrojtjen në tërësi, sigurinë publike dhe parandalimin, hetimin, pikasjen dhe ndjekjen penale të veprave penale ose të përdorimit të paautorizuar të sistemeve të komunikimit elektronik.

Çështja e parë kishte të bënte me një numër grupesh avokuese dhe organizatash jofitimprurëse në Francë që bënë kërkesa në Conseil d'État për anulimin e disa dekreteve franceze të cilat ato pretenduan se shkelnin Kushtetutën e Francës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore ("KEDNJ") si dhe Direktivën e e-Privatësisë dhe Direktivën 2000/31/EC të 8 qershorit 2000 ("Direktiva e Tregtisë Elektronike"), lexuar nën dritën e Neneve 7, 8 dhe 47 të Kartës së të Drejtave Themelore (ang. CFR").

Çështja e dytë, e ngritur kryesisht nga i njëjti grup kërkuesish si më lart, kishte të bënte me kërkesën për anulimin e teksteve legjislativë që u pretendua se shkelnin Nenin 15(1) të Direktivës së e-Privatësisë (lexuar nën dritën e Neneve 7, 8 dhe 11 të CFR-së) duke vënë një detyrim për mbajtjen e përgjithshme dhe pa dallim të të dhënave të komunikimeve për qëllime gjyqësore në lidhje me vepra penale.

Çështja e tretë kishte të bënte me një numër organizatash që kishin bërë kërkesa të ndryshme para Gjykatës Kushtetuese të Belgjikës për anulimin e ligjit belg që kërkonte mbajtjen e të dhënave. Kërkuesit pretenduan se ligji dështonte të ofronte garancitë e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave të mbajtura, duke shkelur Kushtetutën e Belgjikës, dispozita të ndryshme të KEDNJ-së, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe Nenin 4(2) të Paktit të Bashkimit Evropian (ang. "TEU").

## **2. Pyetjet e bëra nga gjykatat kombëtare**

Gjykatat kombëtare referuese në secilën prej tri çështjeve pyetën, në thelb, nëse Neni 15(1) i Direktivës së e-Privatësisë pengonte legjislacionin kombëtar që vinte detyrime për ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike për të kërkuar mbajtjen e përgjithshme dhe pa dallim të të dhënave të trafikut dhe lokacioneve.

Conseil d'État në Çështjen Nr. C-511/18 më tej pyeti nëse Neni 15(1) i Direktivës së e-Privatësisë pengon legjislacionin kombëtar i cili kërkon që ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të zbatojnë në rrjetet e tyre masa që lejojnë (i) analizën automatike dhe grumbullimin në kohë reale të të dhënave rreth lokacionit të terminalit të përdorur; dhe (ii) grumbullimin në kohë reale të të dhënave teknike rreth lokacionit të terminalit të përdorur (dhe mos-ofrimi i mënyrave që personat e prekur nga ai përpunim dhe grumbullim të informohen rreth tij).

Në Çështjen Nr. C-512/18, Conseil d'État gjithashtu pyeti nëse dispozitat e Direktivës për Tregtinë Elektronike, lexuar nën dritën e Neneve 6, 7, 8, 11 dhe 52(1) të CFR-së, pengojnë legjislacionin kombëtar i cili kërkon që ofruesit e shërbimeve të komunikimit online dhe ofruesit e shërbimeve qendrore (host) që të mbajnë, në përgjithësi dhe pa dallim, të dhënat personale të atyre shërbimeve.

Në Çështjen Nr. C-520/18, Cour Constitutionnelle pyeti, në thelb, nëse një gjykatë kombëtare mund të zbatojë dispozitat e të drejtës kombëtare që e fuqizojnë

atë për të kufizuar efektet e përkohshme të një deklarate të paligjshmërisë që ajo duhet të bëjë në lidhje me legjislacionin kombëtar që u vë ofruesve të shërbimeve elektronike online (me qëllim të objektivave të mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe luftimit të krimit) një detyrim që kërkon mbajtjen e përgjithshme dhe pa dallim të të dhënave rreth trafikut dhe lokacionit, për shkak të faktit se legjislacioni është në pajtueshmëri me Nenin 15(1) të Direktivës së e-Privatësisë, lexuar nën dritën e Neneve 7, 8, 11 dhe 52(1) të CFR-së.

### 3. Vendimi i GjDBE-së

GjDBE-ja deklaroi se legjislacioni kombëtar që u kërkon ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike online të mbajnë të dhënat e trafikut dhe lokacionit për qëllime të mbrojtjes kundër kërcënimeve serioze ndaj sigurisë kombëtare dhe luftimit të krimit është brenda fushëveprimit të Direktivës së e-Privatësisë. Gjykata tha se qëllimi i direktivës është të mbrojë përdoruesit nga rreziqet ndaj të dhënave personale dhe privatësisë, përfshirë ndalimet për depozitimin e të dhënave personale pa pëlqimin e përdoruesve, dhe se derogimi nga dispozitat relevante domosdoshmërisht ngre çështje të pajtueshmërisë me Nenet e CFR-së që kanë të bëjnë me privatësinë, mbrojtjen e të dhënave personale dhe lirinë e shprehjes.

Në lidhje me pyetjen e parë dhe pyetjen e tretë, Gjykata doli në përfundimin se gjatë ushtrimit të fuqive, qoftë sipas Nenit 15(1) të Direktivës së e-Privatësisë apo sipas Nenit 23 të Direktivës për Tregtinë Elektronike, Shtetet Anëtare nuk lejohen të fusin masa legjislative që parashikojnë mbajtjen e përgjithshme dhe pa dallim të të dhënave të trafikut dhe lokacionit si masë preventive ose që u kërkojnë ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike online dhe shërbimeve qendrore (hosting) të mbajnë, në përgjithësi dhe pa dallim, të dhëna personale në lidhje me ato shërbime. Nëse veprohet kështu, duke ditur rrezikun e profilimit, do të dëmtonte respektin për jetën private, mes të drejtave të tjera të CFR-së, dhe derogimi do të lejohej vetëm varësisht nga kriteri i proporcionalitetit dhe kur është rreptësisht i nevojshëm. Nuk ishte e nevojshme që të dhënat të përdroeshin; thjesht mbajtja e tyre (duke pasur parasysh sasinë e të dhënave në fjalë në kontekstin e shërbimeve të komunikimeve elektronike) rrezikonte abuzimin dhe qasjen e paligjshme.

Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të miratojnë ligje për mbajtjen e të dhënave të trafikut dhe lokacionit në rrethana të caktuara kur kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare, luftimin e krimeve të rënda dhe/ose parandalimin e kërcënimeve

serioze për sigurinë publike, përdorimi i rregullave të qarta dhe precize në përputhje me CFR-në dhe me mbrojtje efektive kundër rrezikut të abuzimit. Për shembull, mekanizmat që mundësojnë që autoritetet shtetërore të udhëzojnë shërbimet e komunikimeve elektronike të mbajnë të dhënat si reagim ndaj një kërcënimi të vërtetë ose të parashikueshëm ndaj sigurisë kombëtare janë të lejueshme, siç është edhe mbajtja e shënjestruar e të dhënave të trafikut dhe lokacionit e cila është e kufizuar në shtrirje dhe kohë mbi bazën e kriterëve objektive dhe jodiskriminuese dhe deri në shkallën ku është rreptësisht e nevojshme. Të dhënat prej të cilave nuk mund të nxirren profilet e jetëve private gjithashtu lejohet të mbahen.

Në lidhje me analizën e automatizuar dhe grumbullimin në kohë reale pa njoftim, Gjykata deklaroi se Neni 15(1) i Direktivës së e-Privatësisë lexuar në lidhje me Nenet 7, 8, 11 dhe 52(1) të CFR-së nuk e pengon legjislacionin kombëtar që u kërkon shërbimeve të komunikimeve elektronike të analizojnë në mënyrë automatike ose të grumbullojnë në kohë reale të dhënat e trafikut dhe lokacionit ose të dhëna teknike rreth lokacionit të terminalit të përdorur. Megjithatë, analiza e automatizuar duhet të zhvillohet vetëm në situata kur një Shtet Anëtar përballet me një rrezik serioz për sigurinë kombëtare i cili është i vërtetë, i pranishëm ose i parashikueshëm, dhe duhet të ketë mënyra për shqyrtim efektiv nga një gjykatë ose një organ tjetër administrativ vendimi i të cilit është detyrues në mënyrë që të verifikohet justifikimi i asaj mase dhe observimi i kushteve dhe mbrojtjeve që ekzistojnë. Po kështu, grumbullimi në kohë reale duhet të bëhet vetëm për personat në lidhje me të cilët ka arsye valide për të dyshuar se janë të përfshirë në aktivitete terroriste, pas shqyrtimit paraprak nga një gjykatë ose një organ tjetër administrativ vendimi i të cilit është detyrues në mënyrë që të sigurohet se grumbullimi në kohë reale është i autorizuar vetëm brenda kufijve të asaj çka është rreptësisht e nevojshme.

Në fund, sa i përket mbajtjes së kufizimeve të përkohshme mbi efektin e një deklarate të paligjshmërisë në lidhje me legjislacionin kombëtar që gjendet se është në pajtueshmëri me të drejtën e BE-së, GjDBE deklaroi se gjykatat kombëtare nuk lejohen t'i zbatojnë këto dispozita. E drejta e BE-së ka përparësi ndaj të drejtës së Shteteve Anëtare, dhe, ndryshe nga shkelja e detyrimeve procedurale, dështimi për të respektuar Nenin 15(1) të Direktivës së e-Privatësisë përfshin vënien e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike që ndërhyjnë seriozisht tek të drejtat themelore të personave të cilëve u mbahen të dhënat.

Gjykatat penale kombëtare duhet të shpërfillin informacionet dhe provat e marra përmes mbajtjes së përgjithshme dhe pa dallim të të dhënave të trafikut



dhe lokacionit në shkelje të së drejtës së BE-së në procedura penale kundër personave të cilët nuk janë në pozicion që të komentojnë efektivisht në lidhje me informacionin dhe/ose provat, dhe informacioni/prova i përket një fushe për të cilën gjyqtarët nuk kanë njohuri dhe kur ka gjasa të ketë ndikim mbizotërues tek gjetjet e faktit. Megjithatë, GjDBE gjeti se, përveç rasteve kur aplikohet kuadri i mësipërm, u takon (në parim) ligjeve kombëtare që të përcaktojnë rregullat në lidhje me pranueshmërinë dhe vlerësimin e informacionit të marrë në procedura penale përmes mbajtjes së tillë të të dhënave në shkelje të së drejtës së BE-së.

*E drejta e BE-së e pengon legjislacionin kombëtar i cili, në mungesë të një kërcënimi terrorist të vërtetë ose të parashikueshëm me të cilin përballet një Shtet Anëtar, vendos një sistem për transferimin, me transport ajror dhe operatorë udhëtimesh, dhe përpunimin, nga autoritetet kompetente, të të dhënave PNR të të gjitha fluturimeve mes vendeve të BE-së dhe operacioneve të transportit të zhvilluara me mënyra të tjera brenda Bashkimit Evropian, që nisen nga, që shkojnë për në, ose që kalojnë tranzit nëpër atë Shtet Anëtar, për qëllimet e luftimit të veprave terroriste dhe krimeve të rënda. Aplikimi i sistemit të vendosur nga Direktiva 2016/681 duhet të kufizohet me transferimin dhe përpunimin e të dhënave PNR të fluturimeve dhe/ose operacioneve të transportit lidhur, mes të tjerash, me rrugë të caktuara ose forma udhëtimi ose në aeroporte, stacione ose porte të caktuara për të cilat ka tregues që e justifikojnë atë aplikim.*

VENDIMI I GJYKATËS (DHOMA E MADHE) NË ÇËSHTJEN  
**LIGUE DES DROITS HUMAINS ASBL**  
**k. CONSEIL DES MINISTRES**

(Çështja Nr. C-817/19)  
**21 qershor 2022**

## **1. Faktet kryesore**

Kjo çështje ishte referencë paraprake e dalë nga Cour constitutionnelle (Gjykata Kushtetuese, Belgjikë) në lidhje me interpretimin e Direktivës (EU) 2016/681 të 27 prillit 2016 ("Direktiva PNR"), e cila ka të bëjë me përdorimin e të dhënave të emrit të pasagjerit (PNR) për parandalimin, pikasjen, hetimin dhe ndjekjen e veprave terroriste dhe krimeve të rënda.

Direktiva PNR u miratua si pasojë e sulmeve terroriste në Paris në vitin 2015 dhe në Bruksel në vitin 2016. Ajo krijon një kornizë ligjore të BE-së për grumbullimin dhe përdorimin e të dhënave personale të pasagjerëve në fluturime për në ose nga vendet e treta. Shtetet Anëtare kanë fuqinë për të aplikuar Direktivën PNR në fluturimet brenda BE-së. Sipas Direktivës PNR, Shtetet Anëtare caktojnë një autoritet kompetent për të vepruar si Njësia e Informacionit të Pasagjerit (ang. PIU).

Më tej, Shtetet Anëtare duhet të vendosin një detyrim ligjor mbi transportuesit ajrorë për të transferuar tek PNR të dhënat e renditura në Shtojcën I të Direktivës PNR përmes mënyrave elektronike në databazën e PIU. Të dhënat PNR mund të përpunohen vetëm për qëllime të parandalimit, pikasjes, hetimit dhe ndjekjes së

veprave terroriste dhe krimeve të rënda. Të dhënat PNR duhet të de-personalizohen gjashtë muaj pas marrjes dhe të fshihen pas një periudhe prej pesë vitesh.

Megjithatë, organizatat e lirive civile argumentuan se mbajtja e të dhënave sipas Direktivës PNR nga agjencitë ligjzbatuese dhe autoritete të tjera është invazive dhe kundërvënie e pajustificuar ndaj të drejtave për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave të ngërthyera në Nenet 7 dhe 8 të Kartës së të Drejtave Themelore (CFR). Në vitin 2017, organizata *Ligue des droits humains* (LDH) me seli në Belgjikë dhe grupe të tjera e kontestuan Direktivën PNR në një gjykatë belge. Ato diskutuan se Direktiva PNR lejon grumbullimin e një numri tepër të madh të dhënash çka mund të rezultonte me vëzhgime masive, diskriminim dhe nxjerrje të profileve (profilizim).

## 2. Pyetjet e ngritura nga gjykata vendase

Kërkesa për vendim paraprak e bërë gjatë procedurave mes LDH dhe *Conseil des ministres* (Këshilli i Ministrave, Belgjikë) në lidhje me ligjshmërinë e *loi du 25 décembre 2016, relative au traitement des données des passagers* (Ligji i 25 dhjetorit 2016 për përpunimin e të dhënave të pasagjerëve).

Në kërkesën e saj, Gjykata Kushtetuese e Belgjikës ngriti disa çështje themelore në lidhje me pajtueshmërinë e Direktivës PNR me Nenet 7, 8 dhe 52(1) të CFR-së.

Neni 52(1) i CFR-së merret me rregullat e justifikimit të ndërhyrjeve tek të drejtat dhe liritë e CFR-së. Çdo kufizim ndaj të drejtave dhe lirive të CFR-së duhet të jetë i parashikuar me ligj dhe të respektojë thelbin e atyre të drejtave dhe lirive. Në linjë me parimin e proporcionalitetit, kufizimet mund të vihen vetëm kur janë të nevojshme dhe kur vërtet përmbushin objektivat e interesit të përgjithshëm të njohura nga BE-ja ose nevojën për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e të tjerëve.

Më tej, gjykata referuese bëri pyetje specifike rreth legjislacionit belg i cili zhvendos Direktivën PNR. Legjislacioni belg përfshin aktivitete të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë brenda kuadrit të qëllimeve për të cilat përpunohen të dhënat PNR, dhe i jep PIU fuqinë për të autorizuar qasje tek të dhënat PNR që janë më të vjetra se gjashtë muaj.

## 3. Vendimi i GjDBE-së

Duke pasur parasysh vlefshmërinë e Direktivës PNR nën dritën e Neneve 7, 8 dhe 52(1) të CFR-së, GjDBE përsëriti se "*një ligji BE-së duhet të interpretohet, sa më*

*shumë që është e mundur, në mënyrë të atillë që të mos preket vlefshmëria e tij dhe konform të drejtës primare në tërësi dhe, në mënyrë të veçantë, konform dispozitave të Kartës”.*

GjDBE gjeti që, meqenëse të dhënat PNR përfshijnë informacione rreth individëve të identifikuar, format e ndryshme të përpunimit nëpër të cilat kalojnë ato të dhëna ndikojnë tek e drejta për privatësi e garantuar me Nenin 7 të CFR-së. GjDBE gjithashtu gjeti se komunikimi i të dhënave personale tek një palë e tretë, siç është një autoritet publik, përbën ndërhyrje tek të drejtat për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave të ngërthyera në Nenet 7 dhe 8 të CFR-së, pavarësisht nga përdorimi i mëtejshëm i informacionit të komunikuar. Ajo arriti në përfundimin që *“Direktiva PNR përmban ndërhyrje pa dyshim serioze tek të drejtat e garantuara me Nenet 7 dhe 8 të Kartës, për sa i përket, mes të tjerash, faktit që ajo mëton të fusë një regjim vëzhgimi që është i vazhdueshëm, i pashënjestruar dhe sistematik, përfshirë vlerësimin e automatizuar të të dhënave personale të gjithkujt që përdor shërbime të transportit ajror”.*

Megjithatë, GjDBE tha që objektivat e Direktivës PNR për garantimin e sigurisë së brendshme të BE-së dhe luftimin e veprave terroriste dhe krimeve të rënda përbëjnë objektiva të interesit të përgjithshëm të BE-së të cilat mund të justifikojnë edhe ndërhyrje serioze tek të drejtat në fjalë. Ajo gjithashtu deklaroi se Direktiva PNR vazhdon të respektojë thelbin e të drejtave themelore në Nenet 7 dhe 8 të CFR-së sepse Direktiva PNR shtron në mënyrë precize fushëveprimin e kufizimit të ushtrimit të të drejtave në fjalë, qëllimin e përpunimit të të dhënave të PNR-së dhe rregullat e detajuara që qeverisin ato operacione përpunimi.

Sa i përket aplikimit të Direktivës PNR tek pasagjerët që fluturojnë mes BE-së dhe vendeve të treta, GjDBE deklaroi se Direktiva PNR nuk shkon përtej asaj që është rreptësisht e nevojshme thjesht sepse imponon tek Shtetet Anëtare transferimin sistematik dhe vlerësimin paraprak të të dhënave PNR të të gjithë atyre pasagjerëve.

GjDBE gjithashtu ndërmori vlerësimin paraprak të të dhënave PNR me përpunim automatik. Ajo doli në përfundimin se, në mënyrë që të fuqizohet mbrojtja e të drejtave themelore nën dritën e zhvillimeve shkencore dhe teknologjike, duhet të sigurohet që asnjë vendim që prodhon efekt ligjor negativ tek një person ose ndikon në masë domethënëse tek një person të mos merret nga autoritetet kompetente vetëm për arsye të përpunimit automatik të të dhënave PNR. Për më tepër, vetë PIU mund të transferojë të dhëna PNR tek ato autoritete

vetëm pas shqyrtimit individual përmes mënyrave jo-automatike. Përveç atyre verifikimeve që PIU dhe autoritetet kompetente i zhvillojnë vetë, ligjshmëria e të gjitha përpunimeve automatike duhet të jetë e hapur për shqyrtim nga zyrtari i mbrojtjes së të dhënave, nga autoriteti kombëtar i mbikëqyrjes dhe, në kontekstin e ndreqjes gjyqësore, nga gjykatat kombëtare.

Pas kësaj, GjDBE sqaroi se si duhet të organizohet vlerësimi paraprak i të dhënave PNR nga përpunimi automatik në përputhje me CFR-në. Të vetmet databaza me të cilat PIU mund të krahasojë të dhënat PNR janë databazat e personave ose objekteve që kërkohen ose në kërkim në përputhje me rregullat e BE-së, rregullat ndërkombëtare dhe kombëtare të aplikueshme për këto databaza. Këto databaza duhet të përdoren vetëm në lidhje me luftën kundër veprave terroriste dhe krimeve të rënda dhe të kenë lidhje objektive, qoftë edhe indirekt, me bartjen e pasagjerëve përmes shërbimeve ajrore.

Në fund, GjDBE deklaroi se mbajtja, gjatë periudhës fillestare prej gjashtë muajsh, e të dhënave PNR të të gjithë pasagjerëve *“pa asnjë tregues rreth përfshirjes së tyre në vepra terroriste ose në krime të rënda nuk duket, në parim, se shkon përtej asaj që është rreptësisht e nevojshme, përderisa lejon që të zhvillohen kërkimet e nevojshme me qëllim të identifikimit të personave që nuk dyshohen për përfshirje në vepra terroriste ose në krime të rënda”*.

Anasjelltas, GjDBE deklaroi se periudha pesëvjeçare e mbajtjes së përgjithshme të të dhënave PNR të të gjithë pasagjerëve ajrorë që ceket në Direktivën PNR, pa asnjë lidhje mes të dhënave PNR dhe objektivave të Direktivës PNR, *“përfshin një rrezik të ngërthyer të përdorimit dhe abuzimit joproporcional”*.

*Neni 15(1) i Direktivës 2002/58/EC pengon masat legjislative kombëtare të cilat ofrojnë, mbi baza preventive, për qëllime të luftimit të krimeve të rënda dhe parandalimin e kërcënimeve serioze ndaj sigurisë publike, mbajtjen e përgjithshme dhe pa dallim të të dhënave të trafikut dhe lokacionit. Megjithatë, Neni 15(1) i Direktivës 2002/58/EC, lexuar nën dritën e Neneve 7, 8, 11 dhe 52(1) të CFR-së nuk pengon disa masa të caktuara legjislative kombëtare, nëqoftëse ato masa sigurojnë, përmes rregullave të qarta dhe precize, që mbajtja e të dhënave në fjalë është në përputhje me kushtet e aplikueshme substanciale dhe procedurale dhe se personat në fjalë kanë në dispozicion mbrojtje efektive kundër rrezikut të abuzimit*

VENDIMI I GJYKATËS (DHOMA E MADHE) NË ÇËSHTJEN  
**BUNDESREPUBLIK DEUTSCHLAND k. SPACENET  
AG AND TELEKOM DEUTSCHLAND GMBH**

(Çështjet Nr. C-793/19 dhe C-794/19)  
**20 shtator 2022**

## **1. Faktet kryesore**

Kjo çështje ishte referencë paraprake nga Bundesverwaltungsgericht (Gjykata Federale Administrative, Gjermani) në lidhje me mbajtjen e përgjithshme dhe pa dallim të të dhënave të trafikut dhe lokacionit sipas Nenit 15(1) të Direktivës së e-Privatësisë.

SpaceNet AG dhe Telekom Deutschland GmbH operojnë në sektorin e industrisë së teknologjisë në Gjermani. Ato ofrojnë shërbime të rrjeteve publike me valë të gjera (broadband) për individë dhe klientë komercialë. Telekom Deutschland gjithashtu ofron shërbime telefonike. Ato nisën procedurat pranë Verwaltungsgericht Köln (Gjykata Administrative në Këln, Gjermani) për të kontestuar detyrimin sipas Telekommunikationsgesetz (Ligji për Telekomunikime) i 22 qershorit 2004 ("Ligji gjerman i Telekomunikimeve") për të mbajtur, duke nisur nga 1 korriku 2017, të dhënat e trafikut dhe lokacionit të klientëve të tyre të telekomunikimeve. Më 20 prill 2018, Verwaltungsgericht Köln (Gjykata Administrative, Këln, Gjermani) vendosi që detyrimet për mbajtjen e të dhënave ishin në shkelje të së drejtës së BE-së. Rrjedhimisht, Republika Federale e Gjermanisë apeloj kundër vendimeve pranë Bundesverwaltungsgericht (Gjykata Federale Administrative, Gjermani).

Sipas Ligjit gjerman të Telekomunikimeve, ofruesit e shërbimeve të teknologjisë së telekomunikimeve dhe informacionit duhet të mbajnë, në mënyrë të përgjithshme dhe pa dallim, shumicën e të dhënave të trafikut dhe lokacionit për përdoruesit e tyre përfundimtarë. Të dhënat e lokacionit duhet të mbahen për javë të tëra, ndërkohë që të dhëna të tjera duhet të mbahen për dhjetë javë. Kjo bëhet për qëllime të ndjekjes penale të veprave penale të rënda ose për parandalimin e rreziqeve specifike ndaj sigurisë kombëtare.

## 2. Pyetjet e ngritura nga gjykata kombëtare

GjDBE-së iu kërkua të interpretonte Nenin 15(1) të Direktivës së e-Privatësisë, lexuar nën dritën e Neneve 6 deri në 8 dhe 11 dhe Nenit 52(1) të Kartës së të Drejtave Themelore ("CFR") dhe Nenit 4(2) të Traktatit të Bashkimit Evropian ("TEU").

Në mënyrë të veçantë, gjykata gjermane e pyeti GjDBE-në nëse e drejta e BE-së e pengon legjislacionin kombëtar nga të kërkuarit prej ofruesve të shërbimeve të internetit që të mbajnë të dhënat e komunikimeve.

Duke u bazuar në çështjet e mëparshme të GjDBE-së, gjykata gjermane vuri në pyetje legjitimitetin e detyrimit gjerman për mbajtjen e të dhënave duke qenë se ai mbulon më pak të dhëna dhe një periudhë më të shkurtër mbajtjeje sesa legjislacioni kombëtar që tashmë ishte shqyrtuar nga GjDBE-ja (për shembull, në çështjet e bashkuara C-511/18, C-512/18 dhe C-520/18 *La Quadrature du Net dhe të Tjerë*).

Gjykata gjermane argumentoi se ato elemente të Ligjit gjerman të Telekomunikimeve reduktonte rrezikun që të dhënat e mbajtura të mund të lejonin nxjerrjen e përfundimeve precize në lidhje me jetën private të klientëve të cilëve u ishin mbajtur të dhënat. Më tej, gjykata gjermane qe e mendimit se Ligji gjerman i Telekomunikimeve ofron mbrojtje për të dhënat e mbajtura nga rreziqet e abuzimit dhe qasjes së paligjshme.

## 3. Vendimi i GjDBE-së

GjDBE-ja vendosi që një mbajtje e tillë për qëllimet e luftimit të krimeve të rënda ishte në kundërvënien e të drejtës së BE-së dhe CFR-së meqenëse ajo mund të mundësonte nxjerrjen e profileve ekzakte të jetëve private të njerëzve. Aftësia për të nxjerrë një profil të jetës së një personi do të çonte në pasoja serioze, pavarësisht nga periudha e mbajtjes ose sasia apo natyra e të dhënave të mbajtura.

Megjithatë, GjDBE-ja konfirmoi që e drejta e BE-së nuk e pengon legjislacionin kombëtar i cili:

- » mundëson që ofruesit e shërbimeve të telekomunikimeve dhe teknologjisë së informacionit të mbajnë, mbi baza të përgjithshme dhe pa dallim, të dhënat e trafikut dhe lokacionit për qëllimet e mbrojtjes së sigurisë kombëtare kur një Shtet Anëtar përballet me kërcënime serioze ndaj sigurisë kombëtare të cilat janë të vërteta dhe prezente ose të parashikueshme. Një urdhër i tillë duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor nga një gjykatë ose një organ administrativ i pavarur me fuqinë për të marrë vendime detyruese dhe i cili mund ta konfirmojë ekzistencën e një situatë të tillë, dhe të sigurojë që kushtet dhe mbrojtjet e kërkuara janë plotësuar. Udhëzimet mund të jepen vetëm për një periudhë të kufizuar kohore që është rreptësisht e nevojshme, por mund të zgjaten nëqoftëse rreziku vazhdon;
- » ofron dispozita për mbajtjen e shënjestruar të të dhënave të trafikut dhe lokacionit për qëllime të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, luftimit të krimeve të rënda dhe parandalimit të rreziqeve serioze ndaj sigurisë publike. Një dispozitë e tillë duhet të jetë e kufizuar gjeografikisht ose për kategori të caktuara të njerëzve;
- » për qëllime të luftimit të krimeve të rënda dhe parandalimit të kërcënimeve serioze ndaj sigurisë publike, ofron dispozita për mbajtjen e përgjithshme dhe pa dallim të IP adresave të lidhura me burimin e lidhjes së internetit për një periudhë që është e kufizuar në kohë për aq sa është rreptësisht e nevojshme;
- » për qëllime të luftimit të krimeve të rënda dhe parandalimit të kërcënimeve serioze ndaj sigurisë publike, ofron dispozita për mbajtjen e përgjithshme dhe pa dallim të të dhënave lidhur me identitetin civil të përdoruesve të sistemeve të komunikimeve elektronike; ose
- » për qëllime të luftimit të krimeve të rënda dhe parandalimit të kërcënimeve serioze ndaj sigurisë publike, ofron dispozita për rekurs në një udhëzim që u kërkon ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përmes një vendimi nga një autoritet kompetent që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor efektiv, të ndërmarrë, për një periudhë specifike kohore, mbajtjen e përsheptuar (ngrirjen e shpejtë) të të dhënave të trafikut dhe lokacionit në posedim të ofruesve të tyre shërbimeve.

Mbrojtjet e ofruara nga Ligji gjerman i Telekomunikimeve që ishin objekt i procedurave kryesore kanë për qëllim të mbrojnë të dhënat nga rreziku i abuzimit



dhe kundër çdo qasjeje të paligjshme. Megjithatë, GjDBE deklaroi se mbajtja e dhe qasja tek ato të dhëna përbën ndërhyrje të ndara tek të drejtat e garantuara nga CFR. Prandaj, GjDBE qe e mendimit që kërkohet një justifikim i ndarë në lidhje me CFR-në.

*Kur pretendohen pasaktësi në një kërkesë që rezultatet e makinës së kërkimit të de-referencohen (t'u hiqen referencat), një subjekt i të dhënave duhet ta vërtetojë pasaktësinë e dukshme të informacionit të cilit kërkon t'ia heqë referencat nga makina e kërkimit sipas të drejtës për fshirje dhe ofruesi i makinës së kërkimit nuk është i detyruar të bëjë hetime. Kur vlerësohet një kërkesë për de-referencimin e 'thumbnails' në kërkimet e pamjeve në makinën e kërkimit, pamjet e 'thumbnails' duhet të vlerësohen mbi bazën e informacionit që del direkt në rezultatet e makinës së kërkimit, pa referencë ndaj kontekstit në të cilin shfaqet pamja në uebfaqen ku të çon 'thumbnail' me hyperlink.*

VENDIMI I GJYKATËS (DHOMA E MADHE) NË ÇËSHTJEN  
**GOOGLE (DÉRÉFÉRENCIEMENT D'UN  
CONTENU PRÉTENDUMENT INEXACT)**

(Çështja Nr. C-460/20)  
**8 dhjetor 2022**

## 1. Faktet kryesore

Kjo çështje ishte referencë paraprake nga Bundesgerichtshof (Gjykata Federale e Drejtësisë, në Gjermani) në lidhje me të drejtën e fshirjes (e njohur si 'e drejta për t'u harruar') dhe vërtetimi i pasaktësive gjatë vlerësimit të kërkesave për fshirje.

TU dhe RE ishin individë me interesa në disa kompani. Disa artikuj që kritikojnë modelin e biznesit të kompanive u publikuan në një uebfaqe që ishte në pronësi të një kompanie amerikane, ku disa prej tyre përmbanin pamje të TU dhe RE. Këto artikuj dhe 'thumbnails' të pamjeve shfaqeshin nga Google kur kërkoheshin emrat e TU dhe RE, ose emrat e kompanive të tyre, në makinën e kërkimit. Deri në shtator 2017 (sa u përket pamjeve) dhe qershor 2018 (sa u përket artikujve), përmbajtja kishte pushuar së qeni e qasshme në uebfaqe ose në makinën e kërkimit Google.

Kërkuesit bënë kërkesë tek Google, si kontrollues i të dhënave personale të përpunuara në makinat e saj të kërkimit, që të de-referenconte vegzat (links) e artikujve dhe të hiqte 'thumbnails' të pamjeve nga rezultatet e kërkimit, mbi bazën se ato përmbanin pohime të pasakta dhe opinione shpifëse. Google refuzoi, mbi bazën se artikujt dhe fotografitë ishin në kuadër të kontekstit profesional dhe duke deklaruar se Google nuk ishte në dijeni të pasaktësisë së pretenduar të informacionit të përmbajtur në ato artikuj.

Në vitin 2015, TU dhe RE ngritën padi në Landgericht Köln (Gjykata Rajonale, në Këln, Gjermani) duke kërkuar lëshimin e urdhrin për heqjen e vegzave dhe pamjeve, e cila u rrëzua nga një vendim i 22 nëntorit 2017. Një apel drejtuar Oberlandesgericht Köln (Gjykata më e Lartë Rajonale në Këln, Gjermani) u rrëzua në nëntor 2018 mbi bazën se kërkuessit nuk e kishin vërtetuar se artikujt ishin të pasaktë dhe kishin shkelur ligjin dhe për shkak se Google, duke mos arritur të zhvillonte një vlerësim përfundimtar, nuk e kishte për detyrë të bënte de-referencimin e tyre. Pas një apeli të mëtejshëm pranë Gjykatës Federale të Drejtësisë, u dorëzua një referencë paraprake me interpretimin e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR).

E drejta e subjekteve të të dhënave për fshirjen e të dhënave personale i nënshtrohet përjashtimeve sipas GDPR, kur përpunimi i të dhënave personale është i nevojshëm për ushtrimin e të drejtës për lirinë e shprehjes dhe informacionit. Gjatë përcaktimit nëse ky përjashtim aplikohet, kërkohet një baraspeshim mes të drejtave të Neneve 7 dhe 8 (respekti për jetën private e familjare dhe mbrojtja e të dhënave personale) dhe Neneve 11 dhe 16 (liria e shprehjes dhe informacionit dhe liria për të zhvilluar biznes).

## **2. Pyetjet e bëra nga gjykata vendase**

Gjykata Federale e Drejtësisë së pari pyeti nëse, gjatë peshimit të të drejtave sipas CFR-së me qëllim të shqyrtimit të një kërkesë për de-referencim drejtuar një operatori të një makine kërkimi mbi bazën e pasaktësive në përmbajtjen e vegzuar, ai de-referencim i nënshtrohet kushtit që çështja e saktësisë së përmbajtjes së referuar të jetë zgjidhur (të paktën në mënyrë provizore) me anë të një vendimi gjyqësor.

Gjykata vendase gjithashtu pyeti nëse, kur pamjet e një subjekti të të dhënave janë të lidhura me emrin e tij në një makinë kërkimi dhe shfaqen si 'thumbnails' (pamje fillestare), përmbajtja origjinale e publikimit të atyre fotografive duhet të merret parasysh gjatë peshimit të të drejtave të CFR-së kur shqyrtohet një kërkesë për de-referencim drejtuar operatorit të makinës së kërkimit.

## **3. Vendimi i GjDBE-së**

GjDBE deklaroi se saktësia e përmbajtjes së referencuar është faktor me rëndësi gjatë vlerësimit të kushteve të Nenit 17(3)(a) të GDPR-së dhe nëse liria e shprehjes e ofruesit të përmbajtjes mund të jetë më e rëndësishme se të drejtat e subjektit

të të dhënave për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale. Gjithashtu u theksua se konstatimet faktike dhe gjykimet e vlerave dallojnë, meqenëse këto të fundit nuk mund të vërtetohen (në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut). Liria e shprehjes nuk mund të peshojë më shumë se e drejta për privatësi kur përmbajtja në fjalë është deklarim i pasaktë faktik; kur bëhet fjalë për gjykim vlerash, kërkohet një baraspeshim më i imtë dhe fushëveprimi i të drejtës për fshirje është më i ngushtë.

Në lidhje me pyetjen rreth vërtetimit nëse informacioni është i pasaktë, GjDBE deklaroi se nuk është kusht që saktësia e informacionit t'i jetë nënshtruar një vendimi gjyqësor, qoftë i përkohshëm apo përfundimtar, kur një kërkesë për de-referencim sipas Nenit 17 GDPR i drejtohet një makine kërkimi. Në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë mes subjektit të të dhënave dhe makinës së kërkimit gjatë përcaktimit të saktësisë, Gjykata deklaroi se një operatori të makinës së kërkimit nuk mund t'i kërkohet që të luajë rol aktiv në vërtetimin e fakteve, megjithëse ata duhet të marrin parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, kështu që barra e provës bie tek subjekti i të dhënave për të konstatuar, me *“prova që, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes në fjalë, atij ose asaj të mund t'i kërkohet me arsye ta gjejë”* *“pasaktësinë e dukshme”* të informacionit të gjetur në përmbajtje (qoftë në një pjesë të vogël ose në tërësi). Ofruesi i një makine kërkimi është i detyruar të de-referencojë përmbajtje të caktuara kur pasaktësia shihet qartë ose kur ka një vendim gjyqësor kundër uebfaqes së referuar i bazuar në gjetjen e pasaktësisë; dhe një ofrues nuk është i detyruar të de-referencojë nëqoftëse pasaktësia nuk është e dukshme ose nuk i është nënshtruar një vendimi të tillë gjyqësor. Gjykata gjithashtu deklaroi që do të ishte joproporcionale të de-referencohen informacione kur vetëm një pjesë e informatave me rëndësi të vogël në kontekstin e përmbajtjes së tërësishme vërtetohet se është e pasaktë.

Në lidhje me pyetjen e parë, Gjykata gjithashtu nënvizoi rëndësinë që subjektet e të dhënave të kenë mundësinë për ta sjellë çështjen para një autoriteti mbikëqyrës ose gjyqësor kur operatori i një makine kërkimi nuk e lejon kërkesën për de-referencim, sidomos duke ditur që autoritetet gjyqësore janë në pozicionin më të mirë që të bërë balancimin e kërkuar të të drejtave. Në këto rrethana, ofruesi i makinës së kërkimit është i detyruar të shtojë një paralajmërim për rezultatet relevante të kërkimit, duke njoftuar përdoruesit eventuale të internetit rreth ekzistencës së procedurave.

Në lidhje me pyetjen e dytë, që kishte të bënte me 'thumbnails' të pamjeve, GjDBE deklaroi se vlera informative e vetë fotografive duhet të merret në

konsideratë kur bëhet balancimi i lirisë së shprehjes me të drejtat e privatësisë (siç kërkohet nga Neni 17(3) i GDPR-së). Analiza nuk varet prej kontekstit të publikimit të tyre nga ofruesi i uebfaqes në fjalë. Megjithatë, duhet të merret gjithashtu në konsideratë çdo element i tekstit që shoqëron direkt shfaqjen e fotove në rezultatet e kërkimit. Gjykata theksoi se e drejta e privatësisë është posaçërisht akute në lidhje me pamjet sepse imazhi i një personi është *“një prej attributeve kryesore të personalitetit të tij ose të saj”*. Përveç kësaj, një pamje u deklarua se ishte mënyrë veçanërisht e fuqishme e transmetimit të informacionit tek përdoruesit e internetit, dhe njëkohësisht ka më shumë hapësirë për (keq)interpretim kur prezantohet jashtë kontekstit si 'thumbnail' e rrjedhimisht për ndërhyrje serioze tek të drejtat e subjektit të të dhënave në krahasim me informacionin që paraqitet me tekst. Duhet të merret parasysh vlera informative e atyre fotografive, pavarësisht nga konteksti i publikimit të tyre në faqen e internetit prej ku janë marrë, por duke marrë parasysh të gjitha elementet e tekstit të cilat shoqërojnë direkt shfaqjen e atyre fotove në rezultatet e kërkimit, dhe të cilat mund të hedhin dritë mbi vlerën informative të atyre fotove.

*Thjesht shkelja e Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme (ang. GDPR) nuk autorizon kompensim për dëme jomateriale; dëmi dhe shkaku kërkohen, por ka pak qartësi në lidhje me kufirin më të ulët për 'dëme jomateriale'.*

VENDIMI I GJYKATËS (DHOMA E TRETË) NË ÇËSHTJEN  
**UI k. ÖSTERREICHISCHE POST (PRÉJUDICE MORAL  
LIÉ AU TRAITEMENT DE DONNÉES PERSONNELLES)**

(Çështja Nr. C-300/21)  
**4 maj 2023**

### **1. Faktet kryesore**

Kjo çështje ishte reference paraprake që doli nga Oberster Gerichtshof (Gjykata Supreme, Austri) për interpretimin e Nenit 82(1) të Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme (ang. GDPR) në lidhje me dëmin jomaterial dhe kompensimin e subjekteve të të dhënave.

Që nga viti 2017, Österreichische Post, shërbimi postar austriak kishte bërë përpunimin e të dhënave lidhur me besimet dhe prirjet politike të qytetarëve austriakë. Österreichische Post përdorte një algoritëm për të përpunuar këto të dhëna dhe për të kategorizuar qytetarët përmes rreshtimit faktik ose të mundshëm me parti të caktuara politike. Kërkuesi, individ austriak, nuk kishte dhënë pëlqimin për këtë përpunim dhe u ndje i shqetësuar, pati humbje të besimit, dhe pati ndjenjën e ekspozimit për shkak të mbajtjes nga kompania të opinioneve të tij të supozuara politike.

Kërkuesi ngrihti padi për mbrojtjen e të dhënave në Landesgericht für Zivilrechtssachen Wien (Gjykata Rajonale për Çështje Civile, Vjenë, Austri) duke kërkuar lëshimin e urdhrin për ndërprerjen e përpunimit të vazhduar të të dhënave relevante dhe 1,000 Euro kompensim për dëme jomateriale sipas Nenit 82 të GDPR-së. Më 13 korrik 2020, urdhri u lëshua por kompensimi u refuzua.

Pas apelit të Oberlandesgericht Wien (Gjykata e Lartë Rajonale e Vjenës, Austri), vendimi i shkallës së parë u mbështet më 9 dhjetor 2020. U theksua se, sipas të drejtës austriake, shkelja e rregullave për mbrojtjen e të dhënave i jep shkas të drejtës për kompensim vetëm kur dëmi i pësuar arrin një kufi të caktuar të peshës. Ndjenjat negative të kërkuetit kishin peshë të pamjaftueshme për ta arritur këtë kufi.

Çështja u apelua pranë Oberster Gerichtshof (Gjykata Supreme e Austrisë), dhe apeli u lejua të procedonte vetëm sa i përkiste elementit të kompensimit (një kundër-apel i ngritur nga Österreichische Post për një pikë të ligjit në lidhje me urdhrin e lëshuar kundër tij u rrëzua nga një vendim i përkohshëm). Gjykata Supreme e Austrisë, në mbështetje të kërkesës së saj për vendim paraprak nga GjDBE, konsideroi se dispozita e Nenit 82 GDPR për dëmshpërblim duhet të përkufizohet në përputhje me të drejtën e BE-së e jo të drejtën kombëtare (për shkak të formulimit në recitalin 146), që këto dëme të jenë kompensuese e jo ndëshkuese, dhe që kompensimi duhet të bëhet kur ka dëme konkrete e mbase edhe të vogla, por kur dëmi nuk është krejtësisht i papërfillshëm (meqë gjykata më e ulët mendoi se kështu ishte për “ndjenjat thjesht të pakëndshme”).

## **2. Pyetjet e bëra nga gjykata kombëtare**

Gjykata Supreme e Austrisë së pari pyeti nëse caktimi i kompensimit sipas Nenit 82 GDPR gjithashtu kërkon, përveç shkeljes së dispozitave të GDPR-së, që kërkuesi të ketë pësuar lëndime, apo nëse shkelja e dispozitave të GDPR-së në vetvete është e mjaftueshme për caktimin e kompensimit. Me fjalë të tjera, nëse thjesht shkelja e GDPR-së i jep shkas të drejtës për kompensim.

Së dyti, gjykata kombëtare pyeti nëse vlerësimi i kompensimit varet nga kritere të tjera të së drejtës së BE-së, përveç parimeve të efektivitetit dhe barasvlerës.

Në fund, gjykata kombëtare pyeti nëse është në pajtueshmëri me të drejtën e BE-së të ndërmerret pikëpamja që caktimi i kompensimit për dëme jomateriale presupozon ekzistencën e një pasoje ose efekti të shkeljes me së paku njëfarë peshe që shkon përtej shqetësimit të shkaktuar nga ajo shkelje. Me fjalë të tjera, nëse ekziston një kufi minimal i dëmit që kërkohet për pagimin e kompensimit.

## **3. Vendimi i GjDBE-së**

GjDBE deklaroi se Neni 82(1) i GDPR-së përcakton tre kushte për të fituar të drejtën për kompensim: (i) shkelja e dispozitave të GDPR-së nga përpunimi i të dhënave personale; (ii) dëmi i pësuar nga subjekti i të dhënave; dhe (iii) lidhja shkakësore mes përpunimit të paligjshëm dhe dëmit. Kushtet e Nenit 82 GDPR janë koncepte autonome të së drejtës së BE-së, dhe prandaj duhen interpretuar në mënyrë uniforme nga Shtetet Anëtare të BE-së, pa iu referuar të drejtës kombëtare. Duke krahasuar dispozitat e Neneve 77 dhe 78 (ndreqjet lidhur me autoritetet mbikëqyrëse dhe shkeljet) dhe Neneve 83 dhe 84 (gjobat dhe dënimet

administrative), Gjykata theksoi se përdorimi i formulimit “dëm” tregonte qëllimin e synuar të dispozitës, që nuk ishte as ndëshkues e as i fokusuar tek shkelja *per se*. Prandaj thjesht shkelja e GDPR-së u deklarua të ishte e pamjaftueshme për dhënien e të drejtës së kompensimit për një kërkues.

Neni 82(1) u gjet se i pengonte rregullat ose praktikatat kombëtare nga caktimi i kufirit të peshës së dëmit që kërkohet të ketë pësuar subjekti i të dhënave. GjDBE theksoi se koncepti i dëmit duhet të përkufizohet në mënyrë autonome, duhet të interpretohet gjerësisht në përputhje me recitalin 146, dhe se caktimi i një kufiri të peshës do të rrezikonte minimin e koherencës së rregullores nëse gjykatat e juridiksioneve të ndryshme lejoheshin të aplikonin standarde të ndryshme për rastet kur mund të jepet kompensim.

Megjithatë, u vendos se i takonte të drejtës vendase të Shteteve Anëtare që të përmbante rregulla për vlerësimin sasior të dëmeve në kërkesat për kompensim sipas Neni 82, si dhe për rregullat procedurale për mbrojtjen e të drejtave të individëve, duke u bazuar në parimet e tërësishme të barasvlerës dhe efektivitetit. Gjykata shtoi se kompensimi financiar duhet të jetë “i plotë dhe efektiv”, duke kompensuar dëmin faktikisht të pësuar si rezultat i shkeljes në tërësinë e saj, pa ndonjë kriter për dëmshpërblym ndëshkues.





## Qendra AIRE

Qendra AIRE është organizatë joqeveritare e cila promovon zbatimin e të drejtës evropiane dhe ofron mbështetje për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Ajo ka një ekip juristësh ndërkombëtarë që ofrojnë ekspertizë dhe këshilla praktike në lidhje me standardet ligjore të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, dhe ka përvojë të veçantë në proceset gjyqësore para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ku ka marrë pjesë në mbi 150 çështje.

Për njëzet vite me radhë, Qendra AIRE ka krijuar një reputacion të pashoq në Ballkanin Perëndimor duke vepruar në të gjitha nivelet e sistemeve të drejtësisë në rajon. Ajo ka bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e drejtësisë, qendrat e aftësimin ligjor, dhe me gjykatat e larta dhe kushtetuese duke mbështetur dhe ndihmuar shtetin e së drejtës dhe projektet e reformave. Gjithashtu, Qendra AIRE bashkëpunon me sektorin e OJQ-ve në tërë rajonin për të ndihmuar fuqizimin e reformave ligjore dhe respektimin e të drejtave themelore. Puna e organizatës është gjithnjë e përqendruar në garantimin që secili/a të mund të gëzojë praktikisht dhe efektivisht të drejtat e tij/saj. Kjo nënkupton promovimin dhe lehtësimin e zbatimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke ndihmuar njëkohësisht integrimin evropian përmes forcimit të shtetit të së drejtës dhe garantimit të njohjes së plotë të të drejtave të njeriut, dhe përmes inkurajimit të bashkëpunimit mes gjyqtarëve dhe profesionistëve ligjorë në mbarë rajonin.

## Civil Rights Defenders

Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut (ang. Civil Rights Defenders, CRD) është një organizatë e të drejtave të njeriut e pavarur nga aspekti politik dhe fetar, e cila operon në partneritet dhe në mbështetje të mbrojtësve të të drejtave të njeriut që punojnë në disa nga rajonet më të shtypura të botës. Me veprimtari në katër kontinente, selia e organizatës ndodhet në Stokholm, dhe ka tetë zyra rajonale në tërë botën. Përmes avokimit, proceseve gjyqësore, dhe fushatave publike, organizata mbron të drejtat civile dhe politike të njerëzve në shkallë botërore, ndërkohë që vepron si rojtare e të drejtave civile në Suedi. Mbrojtësit e të Drejtave Civile është themeluar me emrin Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vitin 1982.

